



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 29TETOR DHE 2 NËNTOR 2009

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
29. OKTOBRA i 2. NOVEMBRA 2009. GODINE

TETOR – OKTOBRA
2009

Seancën e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

Hap punimet e seancës së sotme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 62 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Ju njoftoj se në bazë të rregullave 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit i ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Para se të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, ju njoftoj se në seancën plenare të datës 13 tetor 2009, në mungesë të kuorumit është shtyrë procedimi me votim të Raportit vjetor të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008. Andaj, propozoj që kjo të radhitet si pikë e rendit të ditës pas pyetjeve parlamentare. A jeni dakord? Kush është “për”? Faleminderit! A ka “kundër”? Një. Atëherë, u miratua.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare, të mbajtura më 12, 13 dhe 17 tetor 2009

Të nderuar deputetë, pyes nëse keni vërejtje në procesverbalet e përmendura?

(Reagim nga salla i deputetit Driton Tali)

Nuk ka pasur njoftim paraprak as me shkrim, as me gojë për pika shtesë dhe vazhdojmë me rendin e ditës. Kush ka vërejtje në procesverbal? Ju lutem, kjo çështje ka mund të bëhet me shkrim, s’e keni bërë. Vetëm për procesverbal, a ka ndokush vërejtje për procesverbale?

Konstatoj se Kuvendi miratoi procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 12, 13 dhe 17 tetor 2009.

2. Koha për pyetje parlamentare

Ju njoftoj se në pajtim me Rregullën 26.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta.

Procedimi i pyetjeve do të bëhet sipas kohës së parashtruar dhe numrit rendor të pyetjeve.

(Reagim i deputetit Driton Tali nga salla)

KRYETARI: Shko në vend, nëse s’do të dalësh jashtë, shko në vend!

DRITON TALI: Është për punëtorët e ”Ramiz Sadikut”.

KRYETARI: S’e ke bërë me kohë, shko në vend!

DRITON TALI: Me kohë e kërkova.

KRYETARI: Jo, s'ë ke kërkuar me kohë.

DRITON TALI: (Nuk dëgjohet për transkriptim)

KRYETARI: Kujt të duash jepja, je i lirë, shko në vend!

DRITON TALI: Nuk është në rregull kjo. Sikur të kisha pasur grup parlamentar, do të ma kishe dhënë fjalën...

KRYETARI: S'ke, nuk kam çka të bëjë, je vetë.

Procedojmë me pyetje parlamentare.

Deputetja Donika Kadaj – Bujupi, pyetje për ministrin e Bujqësisë, zotin Idriz Vehapi.
Vazhdojmë, deputeti Driton Tali, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi ose ministren Justina Pula- Shiroka. Fjalën e ka deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Po edhe një herë po e potencoj se ka qenë një çështje shumë me rëndësi të cilën desha ta ngre për punëtorët e "Ramiz Sadikut", ish punëtorët e ndërmarrjes shoqërore "Ramiz Sadiku", që ju nuk ua dhatë të drejtën atyre t'u dëgjohet zëri edhe pikërisht ka pasur të bëjë me kompetencat e Kuvendit të cilat i ka ndaj Agjencionit Kosovar të Privatizimit, ka të bëjë me 20%. Unë edhe një herë e thashë këtë publikisht, zoti Kryetar i Parlamentit, Jakup Krasniqi, ua mohoi të drejtën atyre punëtorëve për t'u mbrojtur e drejta e tyre këtu. Faleminderit!

KRYETARI: I nderuar deputet,

Sot nuk e ke fjalën më dhe mos e keqpërdor fjalën e dhënë. E ke keqpërdorur.

Vazhdojmë. Kjo nuk është çështje e ngutshme, është çështje që mund të bëhet me shkrim, është çështje që ke pasur mundësi ta paralajmërosh. Lexoje Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe pastaj jemi në rregull.

Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri Kryetar,

I nderuar zotëri ministër Shala,

Vendi ynë, për dallim nga shtetet moderne, nuk ka rezerva shtetërore të cilat janë aq të nevojshme dhe aq të dobishme, madje aktualisht nuk ekziston as akti ligjor për rezervat shtetërore.

Zotëri ministër,

Pse është situata e këtillë dhe si e konsideroni për ta tejkaluar këtë në të mirë të themelimit të rezervave shtetërore? Faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar zoti Kryetar i Parlamentit,

I nderuar zoti zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti deputet Smaka,

Qeveria e Republikës së Kosovës në strategjinë legislative për vitin 2008 kishte parashikuar edhe hartimin e Projektligjit për rezervat shtetërore të mallrave, iniciativë e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Ky projektligj është aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës nëpërmjet vendimit numër 12/47 të datës 12 dhjetor të vitit 2008. Më 9 janar të vitit 2009 u miratua për diskutim në Kuvendin e Republikës së Kosovës me vendimin numër 3-5/143 të datës 9 të muajit shtator 2009. Projektligji për rezervat shtetërore të mallrave dhe i kthehet sponsoruesit nga Kuvendi, përkatësisht Qeverisë së Kosovës sipas rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion.

Sipas rekomandimit të këtij komisioni, të cilin, nëse më lejohet do ta lexoj, sa vijon. Thotë: "I rekomandojmë Kryesisë që ta procedojë në Kuvendin e Republikës së Kosovës për shqyrtim përfundim të Komisionit që projektligji t'i kthehet sponsoruesit me kërkesë që të rimartohet, duke plotësuar standardet themelore të legjislacionit dhe nevojat përmbajtëse specifike të Republikës së Kosovës"

Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financës kanë formuar grupin punues që është duke shqyrtuar këtë ligj dhe ne do ta sjellim shumë shpejtë për aprovim në Qeverinë e Republikës së Kosovës, nën një, dhe pastaj në procedim për Kuvend dhe besoj se të gjitha vërejtjet ose vërejtjet e arsyeshme të Komisionit do të kihen parasysh dhe Kosova do ta ketë Ligjin për rezervat shtetërore shumë shpejt. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Deputet, a ke pyetje shtesë?

RIZA SMAKA: ... do të kisha apeluar, zotëri Shala, që ju me kapacitetin e autoritetit tuaj aq sa mundeni ta përshpejtoni, sepse vlerësoj se rezervat shtetërore janë jashtëzakonisht të nevojshme dhe, tek e fundit, janë kusht pa të cilin edhe shteti serioz nuk mund të jetë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Vazhdojmë me pyetjen e radhës.
Deputeti Naim Rustemi, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala.
Deputet, e ke fjalën!

NAIM RRUSTEMI: I nderuar ministër,
Në mbledhjen e Kuvendit të datës 17 shtator 2009, me fjalë të tjera para një muaji, në përgjigjen në pyetjen e deputetit Tali lidhur me punësimin e punëtorëve pa konkurs në ndërmarrjet publike, keni deklaruar se ju keni angazhuar juristët e Ministrisë së Ekonomisë së Financave. Me fjalë të tjera, po citoj fjalët tuaja dhe keni kërkuar edhe nga komiteti i auditimit që secila ndërmarrje publike të sjellë konform ligjit se çfarë dhe cilat kanë qenë ato rregulla në bazë të cilave janë punësuar dhe në momentin kur ta marr këtë përgjigje më të saktë, sepse pyetjen e mora para pak ditësh, do t'i japë për ju dhe për të tjerët sqarimet e sakta. Pavarësisht se ishte struktura e fjalive, unë isha shumë rigoroz në atë se çka keni thënë ju.
Kështu që pyetja është: Tani pas një kohe të nevojshme për marrjen e informacioneve, a mund të tregoni se në cilat ligje janë bazuar punësimet pa konkurs?

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar deputet Rustemi,

Ashtu siç ju kam thënë, unë kam angazhuar njësitë e auditimit dhe njësitë ligjore për të konstatuar se cila ka qenë baza ligjore për punësimin e përkohshëm apo punësimin në bazë të kontratës mbi vepër në Postën dhe Telekomunikacionin e Kosovës, pyetjen të cilën e keni bërë më herët dhe duke i zgjeruar, nëse mund të them, vlerësimet edhe për ndërmarrjet tjera publike dhe pas analizave të ekspertëve kam përgjigjen përafërsisht atë që e kam thënë edhe herën e kaluar, se njihet me legjislacionin në fuqi që ka të bëjë me Rregulloren, përkatësisht Ligjin themelor 2001/27 dhe kontratën kolektive të vitit 2004. Këto baza ligjore u mundësojnë ndërmarrjeve publike që në kohë të caktuar mund të angazhojnë me kontratë mbi vepër në qoftë se bordi i ndërmarrjeve publike aprovon këtë. Sipas të gjitha informacioneve që kam edhe në Postë- Telekomunikacionin e Kosovës, edhe nëpër disa ndërmarrje tjera publike përafërsisht është shfrytëzuar kjo bazë ligjore dhe plani veprues i aprovuar nga Bordi i ndërmarrjeve publike dhe komentimet e ekspertëve janë se të paktën ekziston një bazë minimale ligjore. Sigurisht që kjo çështje do të trajtohet edhe në vazhdim dhe edhe auditori gjeneral dhe të tjerët do të japin përgjigjen detale, por baza ligjore është konstatuar se ekziston të paktën në nivelin për të cilin unë jam i informuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Deputet, a ke pyetje shtesë?

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit!

Për atë çka e the, saktë nuk është ashtu, se ajo nuk e rregullon punësimin pa konkurs, si pikë e parë.

Dhe, pikë e dytë, mund të cek se Ligji i prokurimit e përcakton se edhe shërbimi prokurohet, pra është Ligji i prokurimit ai i cili e rregullon, kurse a kishte pasur mundësi që ju të na tregoni se a ndiheni përgjegjës në rast se këto çështje trajtohen si vepra penale?

KRYETARI: Ministër, urdhëro!

MINISTRI AHMET SHALA: Paragjykimet e tilla nuk besoj që kanë koment më shumë se sa shpjegimet ligjore. Ndërmarrjet publike menaxhohen dhe përgjegjësinë për çfarëdo respektimi të ligji dhe të procedurave, qofshin prokurorale, qofshin të prokurorimit pra, qofshin të menaxhimit i bart drejtori menaxhues i ndërmarrjes së bashku me bordin. Ministria e Ekonomisë dhe e Financave dhe ministritë, pesë ministrat që janë në Bordin, përkatësisht në Komitetin e ndërmarrjeve publike, nuk mikro- menaxhojnë ndërmarrjet. Dihet shumë saktë, me Ligjin për ndërmarrjet publike se kush është përgjegjës për zbatimin e ligjit në ndërmarrjet publike. Dhe, kjo ndoshta po përsëritet aq shumë herë, sa është bërë monoton, por besoj që kësaj radhe ke marrë shumë saktë përgjigjen. Ka ekzistuar baza ligjore edhe për punësim, ekziston në bazë të Rregullores, të Ligjit për themelimin e punës 2001/17 dhe është absolutisht konform këtyre procedurave të cilat janë në fuqi, ndërsa sa i përket pyetjes sate direkte, ta dhashë përgjigjen. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Pyetja e radhës, deputetja Myrvete Pantina, pyetje për ministren e Energjisë dhe të Minierave, Justina Shiroka Pula, apo për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi. Ministrja nuk është këtu, por ju mund ta bëni pyetjen. Zëvendëskryeministri është, ndoshta përgjigjet.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Me qenë se zëvendëskryeministri është këtu, atëherë do t'ia parashtroj pyetjen zëvendëskryeministrit Hajredin Kuçi.

Më datën 23 gusht të vitit 2001, është lidhur marrëveshja për kompensim të përkohshëm të pagës për ndërprerje të marrëdhënies së punës në mes të Korporatës Energjetike të Kosovës dhe 450 punëtorëve të KEK-ut, të cilët ishin lënduar në vendin e tyre të punës. Në bazë të kësaj marrëveshje, KEK-u ka për obligim që 450 pensionistëve invalidorë t'u paguajë 105 euro pension në muaj deri në ditën e fillimit të funksionimit të Fondit mbi sigurimin pensional-invalidor, por prej shtatorit të vitit 2006, 223 pensionistëve invalidorë të KEK-ut u është ndërprerë paga, derisa të tjerët vazhdojnë të marrin pagën sipas marrëveshjes deri në ditët e sotme. Pyetja është: Zonja ministre, pensionistëve invalidorë të KEK-ut u është ndërprerë pagesa e pensionit, pyesin se pse marrëveshja e lidhur në mes të KEK-ut dhe 450 punëtorëve të KEK-ut nuk vlen për të gjithë pensionistët invalidorë të KEK-ut në mënyrë të njëjtë?

KRYETARI: Pyetja është teknike, unë nuk besoj që përgjigjet zëvendëskryeministri. Ju e lexuat, presim botimin e saj.

Deputetja Kaqusha Jashari, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi Deputete, a doni ta parashtroni pyetjen? Mirë, vazhdojmë. Deputetja Nerxhivane Dauti, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala.

NERXHIVANE DAUTI: Ju faleminderit, Kryetar!

Ligji për ndihmën shtetërore krijon bazë juridike për formimin e saj dhe krijimin e mekanizmave shtetëror për funksionalizimin e asaj ndihme në shtetin tonë. Është e ditur se mungesa e rregullativës juridike në këtë fushë pamundëson funksionimin e ndihmës shtetërore. Për këtë projektligj afati i përcaktuar në Strategjinë legjislativë të Qeverisë për procedimin e tij për miratim nga organi legjislativ nuk është respektuar. Duke pasur parasysh rëndësinë e ndihmës shtetërore dhe nevojën për krijimin e bazës juridike për rregullimin e saj, ministrin e Ekonomisë dhe Financave e pyes: Kur do të procedohet ky ligj për miratim në Kuvendin e Kosovës?

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: E nderuara deputete Dauti,

Falënderoj për ngritjen e kësaj çështje dhe vërtet ky ligj u ka marrë më shumë kohë mbase qeverive të mëhershme se sa që është dashur. Ligji, përkatësisht projektligji ka qenë në planin legjislativ në vitin 2006 dhe nuk e di pse nuk është proceduar më herët. Pastaj, pas miratimit në Qeverinë e Republikës së Kosovës më 10.11.2006, projektligji është pranuar në këtë Kuvend, në Kuvendin e asaj kohe, me vendimin e Kuvendit numër 2-2 të datës 17 janar 2008, pra ende pa na ardhur neve në Qeveri, projektligji kthehet për rishqyrtim dhe rihartim. Ministria e Ekonomisë dhe Financave e ka futur në prioritet shqyrtimin e këtij ligji në legjislacionin e vitit 2009. Grupi punues është duke finalizuar fazën përfundimtare dhe unë besoj që konform planit tonë strategjik, para përfundimit të vitit 2009 do ta procedojmë në Kuvend.

KRYETARI: Faleminderit! Deputete, a ke pyetje shtesë? Jo. Faleminderit!

Pyetja e radhës. Deputetja, Nurishahe Hulaj, pyetje për ministrin Arsim Bajrami. Deputete, e ke fjalën!

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit!

Çështja është: Zgjedhjet komunale 2009 dhe pjesëmarrja e shërbyesve civilë në këto zgjedhje, kandidimi dhe zgjedhja e tyre në asamblетë komunale. Pyetja është: A do të kthehen në vendin e punës profesionale shërbyesit civilë që janë kandiduar për asamblетë komunale, gjegjësisht ata të cilët zgjidhen me votën e qytetarëve të komunave përkatëse në ciklin e zgjedhjeve për këshilltarë të asambleve komunale më 15 nëntor 2009?

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Ju falënderoj shumë për pyetjen, e nderuara deputete!
Pra, më lejoni t'ju sqaroj çështjen që ju e shtruat dhe që është diskutuar këto ditë për shkak se kjo çështje ka qenë jashtëzakonisht me rëndësi me rastin e kandidimit të shërbyesve civilë.

Aktualisht, çështja e shërbyesve civilë është e rregulluar me Rregulloren të UNMIK-ut dhe ne sot do ta diskutojmë Projektligjin për shërbimin civil, i cili është një bazë e re ligjore për rregullimin e pozitës së shërbyesve civilë.

Sipas Rregulloreve për shërbimin civil, në mënyrë taksative rregullohet pozita e shërbyesve civilë të cilët kandidojnë në zgjedhje dhe është fjala për dy lloje të shërbyesve civilë, shërbyes civilë që janë në pozita të larta, në pozita drejtuese dhe shërbyesit civilë të rëndomtë. Për pozitën e parë, Rregullorja në mënyrë eksplicite ka përcaktuar që në momentin e kandidimit shërbyesit e lartë civilë, është fjala për sekretarë permanentë, për drejtorë, për kryeshefa, duhet të japin dorëheqje në momentin e certifikimit si kandidatë dhe kjo dorëheqje është e përhershme, sepse ata nuk mund të rikthehen pa marrë parasysh epilogun e zgjedhjeve. Ndërkaq, për shërbyes civilë të rëndomtë, ata duhet të marrin pushim pa pagesë që nga dita kur kandidatura e tyre certifikohet nga Komisioni Qendror Zgjedhor dhe pas zgjedhjeve, në qoftë se ata do të zgjedhen si anëtarë të asamblesë komunale, ata do ta pezullojnë statusin e shërbyesit civil deri sa ushtrojnë një funksion politik. Ndërkaq, pas përfundimit të pozitës përfaqësuese në asamble komunale, ata e kanë të drejtën të rikthehen në shërbimin civil. Unë gjatë ekspozesë që do të bëjë sot për Ligjin për shërbimin civil, do të tregoj si është rregulluar kjo me Projektligjin e ri për shërbimin civil.

KRYETARI: Faleminderit! A ke pyetje shtesë, deputete?
E ka fjalën Nurishahe Hulaj.

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit!
Unë e kam një pyetje shtesë: A është miratuar dokumenti që është përpiluar nga Ministria e Shërbimeve Publike dhe Ministria e Pushtetit Lokal në Qeveri për këto çështje? Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, ministër.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Në fakt, këto dy ministri nuk kanë miratuar kurrfarë dokumenti, kanë dhënë një sqarim të domosdoshëm, sepse ne e dimë që në zgjedhjet e kaluara ka pasur jashtëzakonisht probleme dhe paqartësi. Ne ua kemi dhënë vetëm një sqarim të dy ministrave për të sqaruar shërbyesit civilë më herët, para se të kandidojnë për pozitën e tyre të rregulluar me ligjin në fuqi, kështu që ky dokument nuk ka pasur nevojë të kalojë në Qeveri, por sipas kompetencave që kemi, Ministria e Administratës Publike për nivelin qendror, kurse Ministria e Pushtetit Lokal për nivelin lokal, e kemi dhënë këtë sqarim, ua kemi drejtuar të gjitha komunave në mënyrë që shërbyesit civilë paraprakisht të njihen me pozitën dhe të drejtën e tyre.

KRYETARI: Faleminderit!
Vazhdojmë. Deputetja, Gjylnaze Syla, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryetar!
Me pyetjen time dëshiroj të ngre çështjen e procesit të zhvillimit të Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës.

Zoti ministër, mos u mërzitni, pyetja është e lehtë.

Sipas Ligjit për ndërmarrjet publike, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës është pasuri e Republikës së Kosovës, ndërsa Qeveria e Kosovës e luan rolin e aksionarit. Me rishikimin e Buxhetit për vitin 2009, Qeveria e Kosovës i merr Postë -Telekomunikacionit të Kosovës dividendin prej 200 milionë euro. Duke marrë parasysh se kjo mund të dëmtojë procesin e zhvillimit të PTK-së, ju pyes, zoti ministër, a është shuma prej 200 milionë euro dividendë e PTK-së, apo është pjesë e kapitalit të PTK-së, meqë sipas informatave të mia, pjesa e dividendit është diku pak më shumë se 50 milionë euro? Faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, i nderuar Kryetar i Parlamentit!

E nderuara deputete,

Mbase definicionet do të duhej t'i sqaroni me literatura pak më moderne dhe me qasje më profesioniste sa i përket se cili është dallimi mes dividendit dhe aseteve ose të drejtës së shpalljes së dividendit ndaj pasurisë si një ndërmarrje shtetërore.

Qeveria e Republikës së Kosovës, besoj, konform planeve dhe prioritetëve të veta ka ekzekutuar të drejtën e vetë ligjore dhe kushtetuese që për zhvillimin e projekteve të veta me prioritet të ekzekutojë të drejtën e marrjes së dividendit për projekte zhvillimore të Kosovës dhe konform këtij projekti ka ekzekutuar këtë, ka respektuar të gjitha procedurat e vendimmarrjes dhe ajo është faktikisht çështje tani më e vendosur nëpër skemat e buxhetimit të rregullt të Kosovës.

Qëllimi ynë ka qenë që të mos cenohet zhvillimi i Postës, por në të njëjtën kohë mos të investohet në projekte të cilat mbase do të jenë tepër të diskutueshme në fazën e privatizimit të Postës, të vendosen ato para në prioritetet e Republikës së Kosovës e jo në prioritetet vetëm të një ndërmarrje publike dhe, në anën tjetër, të ruhet stabiliteti bankar i sektorit të bankave në Kosovë. Të gjitha këto objektiva kanë qenë temë e diskutimeve me ekspertë të ndryshëm ndërkombëtarë dhe vendorë dhe besoj që janë respektuar të gjitha procedurat dhe të drejtat ligjore. Faleminderit!

KRYETARI: Deputete, ke drejtë të bësh pyetje shtesë.

GJYLNAZE SYLA: Pyetja ishte a është dividendë apo është kapital, ministër, mos e mbulonit papërgjegjësinë me mos përgjigje në pyetje. Me qenë se Fondi Monetar Ndërkombëtar ka tërhequr vërejtjen se shfrytëzimi i dividendit të PTK-së, si financim buxhetor do të çrregullojë financimin e bankave, Ju nga ana tjetër keni deklaruar para Kuvendit të Kosovës se 200 milionë euro vazhdojnë të mbeten në sistemin e bankave, unë ju pyes: Si dhe deri kur do të vazhdojnë të mbeten në këtë sistem këto shuma, kur dihet se i keni rritur dhe shpërndarë shpenzimet? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI AHMET SHALA: Këtu është çështja që po i lexoni mbrapsht rekomandimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar ose po i deformoni. Sigurisht që ne kemi marrë të gjitha masat qysh nga marsi i këtij viti që t'i koordinojmë të gjitha veprimet që sistemi bankar, e thashë në terma të përgjithshëm, të mos çrregullohet dhe i kemi njoftuar edhe pronarët e bankave, edhe Fondin Monetar Ndërkombëtar për hapat e duhur dhe asnjë mospërputhje për rekomandimet e Fondit Monetar apo të rrezikimit të bankave nuk ka. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Lus deputetët, për fjalë ta shfrytëzojnë vetëm mikrofonin. Deputetja, Donika Kadaj-Bujupi, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Deputete, a doni ta bëni pyetjen?

DONIKA KADAJ – BUJUPI: Po, i nderuar Kryetar,

Duke marrë parasysh që fushata do të zgjatë edhe dy javë dhe njerëzit janë të interesuar të dëgjojnë të marrin përgjigje, por i pari i Qeverisë është në fushatë, unë do t'ia bëj pyetjen, ndoshta diku në një fshat të Kosovës do ta dëgjojë edhe do të më jap përgjigje.

Unë këtu kam një memorandum me pesë pika, i cili është nënshkruar ndërmjet Kryeministrit Thaçi dhe pensionistëve të Kosovës dhe asnjë nga këto pesë pika të këtij memorandum nuk janë zbatuar, as nuk ka filluar zbatimin e tyre. Ky memorandum është bërë në periudhën 2007, kur ishin zgjedhjet nacionale dhe lokale bashkë. Prandaj, dua ta pyes palën e Qeverisë se deri kur do të vazhdojë t'i mashtrojë njerëzit me memorandume të fushatës dhe kur do të fillojë të paktën zbatimin e njërës nga këto pesë pikat kryesore të këtij memorandum? Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Edhe kjo ishte në shërbim të fushatës.

Urdhëro, zoti Shala.

MINISTRI AHMET SHALA: Unë dua vetëm të reflektoj se çfarë jemi duke bërë me pensionistët në kuadër të premtimeve dhe planit që ka dakorduar Kryeministri i Kosovës me pensionistët, përkatësisht një nga premtimet që ka qenë. Jemi në fazën finale të përfundimit të Ligjit për pensionistët, atë që është thënë dhe po thuaj se mund të them që në brendë të këtyre 10 ditëve jemi duke e përmbyllur procedimin e ligjit në Qeveri dhe jemi në dakordancë po thuaj se të mirëkuptueshme, jo 100% atë të realizueshme në kohën e tashme, por të mirëkuptueshme për të adresuar diçka që s'është adresuar asnjëherë deri më tani. Janë përgatitur të gjithë skenarët dhe një grup punues që ka punuar me vite të tëra më herët, është duke finalizuar çështjen tani. Dhe, unë besoj që kjo është konform atyre premtimeve që janë bërë. Unë po flas në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për përgjegjësinë time si ministër i Ekonomisë së Financave dhe jemi në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Punës dhe të Mirëqenies Sociale.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputete, je e interesuar të bësh pyetje shtesë? Fjala është për deputeten, Donika Kadaj – Bujupi.

DONIKA KADAJ BUJUPI: Faleminderit, shumë Kryetar!

Ministër, më duhet t'ju njoftoj që aq shumë janë degraduar premtimet e juaja, sa që askush s'po ju beson më tutje dhe, e dyta, unë s'e kam ditur që ju quheni Hashim Thaçi.

KRYETARI: Ministrat, në bazë të Rregullores kanë të drejtë të përgjigjen në pyetjet që parashtrihen Kryeministrit të Kosovës.

Deputeti, Riza Smaka, pyetje për ministrin e Drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi.

RIZA SMAKA: I nderuar zoti Kryetar,

Zonja Kelmendi,

Edhe për shkak të mungesës së Ligjit për punën, në vendin tonë, me të madhe praktikohen punësime kundërligjore, në radhë të parë në formë të improvizimeve të konkurseve, të punësimeve pa konkurs, të punësimeve jashtë kornizave të akteve për sistematizim, të punësimeve të përkohshme edhe në raste të ekzistimit të punëve të rregullta, të punësimeve pa kontratë, të abuzimeve pozicionale të punësuarve nga punëdhënësit e papërgjegjshëm, me

shantazhime vërtet më se të ndryshme. Pyetja i referohet aspektit juridik dhe legjislativ, zonja ministre. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja ministre, e ke fjalën!

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: I nderuar Kryetar i Parlamentit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

I nderuar deputet Riza Smaka,

Ndonëse kjo pyetje ishte dashur t'i adresohet ministrit të Punës dhe të Mirëqenies Sociale, unë për shkak të shqetësimeve që i keni ngritur në pyetjen tuaj, të cilat edhe unë i kam, kam vendosur që të përgjigjem në pyetjen tuaj në emër po thuaj se të ministrit për Punë dhe Çështje Sociale.

Çështja e punësimit dhe e marrëdhënieve të punës është rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/07, 8 tetor 2001. Prej asaj kohe kjo rregullore nuk është ndryshuar, përkatësisht Kuvendi i Kosovës nuk ka nxjerrë Ligj për punën, po sigurisht që do ta nxjerrë.

Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin numër 2002/9 për Inspektorin e punës, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/04, datë 21 shkurt 2003. Ky ligj trajton kushtet e punës, mbrojtjen në punë dhe ruajtjen e shëndetit të punëtorëve në përgjithësi. Funksionet e Inspektoratit të Punës janë: mbikëqyrja e zbatimit të ligjit, të kushteve të punës dhe mbrojtjen e punëtorëve, por ka edhe kompetenca të tjera. Pra, Inspektorati i Punës është mekanizëm që përkujdeset për çështjet e të punësuarve. Ky inspektorat, si autoritet ekzekutiv i përgjigjet ministrit për Punë dhe të Mirëqenie Sociale nga rezulton se nuk i përgjigjet Ministrisë së Drejtësisë.

Po kështu, me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/36 për shërbimin civil të Kosovës, të shpallur me Rregulloren 2008/12, me të cilën është ndryshuar dhe është themeluar Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, i cili me nenin 10 ka kompetenca të caktuara për shërbyesit civilë të punësuar në organet e punësimit, dëshmon se këto rregullore trajtojnë çështjen e punësimit të shërbyesve civilë.

E konsideroj se është më se e rëndësishme që Kosova të ketë Ligjin për punë, për mbrojtje më efikase të drejtave të të punësuarve, të cilat vërtet në të shumtën e rasteve po abuzohen nga punëdhënësit.

KRYETARI: Faleminderit, ministre!

Deputet, a ke pyetje shtesë?

RIZA SMAKA: E përshëndes përgjigjen e zonjës Kelmendi. Qëndrojnë ato hezitimet se ishte dashur t'i adresohet, po e zëmë, ministrisë tjetër, por unë për respektin edhe profesional, edhe funksional, ju kam adresuar juve, është fjala për aspektin legjislativ. Si mund të jetë një shtet, e ne jemi një shtet dhe kem mëtim për të qenë shtet tepër serioz, pa Ligj për punë, ju lutem! Unë e di që nuk varet kjo prej juve krejtësisht, po do të kisha apeluar që ta bëni atë që mund ta bëni edhe ky akt të bëhet dokument edhe të punojmë sipas ligjit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Naim Rustemi, pyetje për ministren e Drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi. Deputet, mund ta parashtroni pyetjen.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit!

E nderuara ministre,

Në pyetjen që u është parashtruar në mbledhjen e Kuvendit të Kosovës, të datës 19 shtator 2008, në lidhje me funksionimin e organeve të drejtësisë, në pjesën e veriut të Mitrovicës, sa i përket Burgut të Mitrovicës, ju keni deklaruar, ju citoj.”Ai funksionon dhe gjithnjë kemi raporte prej atij burgu për të gjitha ato që ndodhin, furnizohet dhe i nënshtrohet zinxhirit komandues të shërbimit korrektues të Kosovës”.

Pyetja: A janë kthyer të punësuarit shqiptarë në vendet e tyre të punës në Burgun e Mitrovicës dhe a ka ndonjë të burgosur shqiptar në atë burg qysh prej 17 shkurtit të vitit 2008?

KRYETARI: Ministre e ke fjalën.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: I nderuar deputet, Naim Rrustemi,

Qëndron ajo se unë në atë pyetjen tuaj kam deklaruar ashtu, siç e cituat ju.

Në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë kanë qenë të punësuar 32 shërbyes civilë dhe oficerë korrektues të komunitetit shqiptar. Me shpalljen e pavarësisë së Kosovës, i gjithë stafi i asaj qendre është risistemuar në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan, Qendrën Korrektuese në Lipjan dhe në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, kjo për shkak se në atë kohë vërtet kanë qenë krijuar trazira për shkak të pavarësisë që në atë pjesë të Kosovës nuk ka qenë e dëshirueshme shpallja e pavarësisë.

Nga momenti i tërheqjes së stafit, të burgosurit shqiptarë janë transferuar në Burgun e Dubravës dhe në qendra tjera të paraburgimit për shkaqe sigurie që të mos vijë deri te konflikti midis komuniteteve të ndryshme, përkatësisht pjesëtarëve të komuniteteve të ndryshme.

Tani në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë punon vetëm stafi i komunitetit serb, boshnjak e të tjerë, por shqiptarët ende nuk janë kthyer. Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me EULEX-in është duke i ndërmarrë hapat e mëtutjeshëm për kthimin e stafit shqiptar në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë, siç janë duke u ndërmarrë edhe hapat për kthimin e stafit serb në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan dhe në Qendrën Korrektuese në Lipjan, me ç'rast në Lipjan do të duhej të ktheheshin të gjithë serbët që e kanë braktisur punën nga aty dhe me këtë rast, kur të kthehen edhe shqiptarët në Mitrovicë, do të lirohen pra vendet e punës edhe për Mitrovicë, kështu që do të kemi një kthim paralel të të dy palëve. Dhe, besoj se janë pjekur kushtet, por duhet edhe një kohë që kjo të ndodhë, sepse situata është shumë më e qetë se sa që ka qenë përpara.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputet, a ke pyetje shtesë?

NAIM RRUSTEMI: E nderuara ministre,

Përgjigja juaj nuk dallon shumë nga përgjigja që është dhënë në shtator të vitit 2008. A mund të cekni saktë se sa kohë mund të pritet që të kthehen të burgosurit dhe punëtorët në Burgun e Mitrovicës, pra të kthehen edhe punëtorët tjerë që të mos kemi institucione të ndara mbi baza etnike? Dhe, mundësisht, për hir të opinionit publik edhe gjithë të tjerëve, të tregoni se çka me të vërtetë mund të quajmë Veri të Kosovës, ku fillon, a fillon në Vushtrri, a fillon te lumi Ibër, a është te Shipoli apo ku, sepse kohët e fundit kemi edhe përfaqësues për Veri të Kosovës ku fillon. Nëse është me lumin Ibër, atëherë janë tri fshatra që janë në komunën e Leposaviqit që janë të përzier në baza etnike.

KRYETARI: Urdhëro, ministre!

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Qendra e Paraburgimit në Mitrovicë shërben për pesë gjykatat komunale, që janë nën juridiksionin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë. Për kohën për të cilën ju po insistoni që ta caktoj unë, nuk jam në dijeni se kur do të ndodhë, por me siguri se do të ndodhë, sepse ende ne e kontrollojmë atë Qendër të Paraburgimit dhe kemi raporte shumë të mira edhe me drejtorin, edhe me stafin. Dhe, unë në gusht të këtij viti personalisht kam shkuar në atë Qendër të Paraburgimit e kam vizituar Qendrën, i kam vizituar edhe të burgosurit serbë, i kam vizituar edhe në dhomat e tyre ku janë të vendosur dhe këto janë hapat që ne po i bëjmë dhe nevojitet sigurisht edhe pak kohë që të ndodhë kjo. Sa i përket asaj se ku fillon e ku mbaron, unë nuk jam kompetente të përgjigjem.

KRYETARI: Po, sigurisht nuk fillon në lumin Ibër.

Vazhdojmë. Deputetja Nurishahe Hula, pyetje për Kryeministrin, zotin Thaçi. A doni ta bëni pyetjen, deputete?

NURISHAHE HULAJ: Ministri i Financave mund të japë përgjigje, me qenë se Ligji për sigurimin pensional e invalidor është në fazën e harmonizimit.

KRYETARI: Bëje pyetjen, nëse ministri mund të përgjigjet, përgjigjet.

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit!

Çështja ka të bëjë me pensionistët dhe Projektligjin për sigurimin pensional dhe invalidor. Definitivisht, pensionistët kërkojnë vetëm ligjin, është e drejtë elementare e tyre. Gjendja e pensionistëve në Republikën e Kosovës është e marginalizuar dhe në bazë të evidencave vetëm 15% prej tyre marrin shumën prej 85 euro në muaj, ndërsa të tjerët nuk e marrin këtë shumë.

Pyetja është: Në kuadër të Strategjisë legislative për vitin 2009, e plotësuar dhe e ndryshuar me vendimet e Qeverisë, në cilën shkallë të harmonizimit gjendet Projektligji për sigurimin pensional dhe invalidor në Qeveri në këtë gjashtëmujor të vitit 2009 dhe a do ta procedojë Qeveria në Kuvendin e Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim gjër në fund të vitit 2009? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, a dëshiron të përgjigjesh?

MINISTRI AHMET SHALA: Unë besoj që një pjesë të kësaj çështjeje e ofrova për opinionin dhe për audiencën këtu. Ne jemi në fazën përfundimtare, po thuaj se të gjetjes së një zgjedhjeje për Ligjin për pensionet. Janë disa komplikime të fuqishme buxhetore të cilat duhet të planifikohen në faza të caktuara, por premtimi që i është dhënë pensionistëve se do të adresohen fuqishëm të gjitha shqetësimet e tyre, besoj që këtu në këtë Parlament do të diskutohen me një ligj të sjellë këtu para përfundimit të këtij viti. Ky ishte edhe zotimi i Kryeministrit dhe jemi duke përfunduar po thuaj se të gjitha draftimet finale me Ministrinë e Punës dhe të Mirëqenies Sociale dhe me grupin punues. Është ligj i rëndë, nuk është ligj që do të kalohet lehtë, por ne kemi identifikuar disa mundësi, të cilat besoj që do t'i kënaqin të paktën interesat e atyre më të goditurve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputete, a ke pyetje shtesë? Faleminderit!

Deputeti, Driton Tali, pyetje për ministrin Ahmet Shala.

DRITON TALI: Paraprakisht më duhet të protestoj edhe një herë, zoti Kryetar. Kjo mënyra e sjelljes suaj është jo në suaza të demokracisë. Mos u sillni si monark, nuk keni të drejtë të ma merrni mua fjalën sa herë që t'ju teket juve, apo s'ju pëlqen se çka do të flas. Këtu prezantoj tjetërkënd, nuk më ke sjell ti, as të tjerët, kurrkush nuk më ka sjell, në emër të cilëve flas. Të lutem, sillu si kryeparlamentar, mos u sill si monark, nuk je monark, as mësuesi imi s'je.

KRYETARI: Nuk ke faj ti. Vazhdojmë. Unë tash nuk mund t'i edukoj ata që s'janë të edukuar në familje. Prandaj, nuk është detyra ime ta edukoj askënd në Parlament. Detyra ime është ta respektoj Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe jam i bindur që këtë po e respektoj. Deputetja Donika Kadaaj - Bujupi, pyetje për Kryeministrin Hashim Thaçi.

DONIKA KADAJ - BUJUPI: Faleminderit, Kryetar!

Unë do të bëj një citat në faqen..., në nëntor 2007, te fushata zgjedhore.

Ne kemi përgatitur planin i cili do t'u mundësojë bizneseve që të marrin kredi afatgjata dhe me interesa të ulët që do t'i ndihmojnë bizneset të rriten, të përparojnë dhe të krijojnë vende të reja të punës. Sot, më 2009, çka po ndërmerr Qeveria e Kosovës në mënyrë që të ndikohet që bankat t'i ulin kamatat, duke marrë parasysh që 250 milionë euro i keni nxjerrë jashtë vendit dhe keni marrë letra me vlerë. A nuk do të ishte më mirë që këto mjete t'u jepën bankave në Kosovë për kreditim? Dhe, cila është përgjigja e Kryeministrit Thaçi lidhur me premtimin e bërë në nëntor të vitit 2007 dhe mos mbajtjen e këtij premtimi dhe mashttrimin e biznesit dhe të opinioneve që po vazhdon t'i bëjë edhe sot, në tetor 2009. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pyetja e fundit, deputeti Riza Smaka, pyetje për Kryeministrin. Po urdhëro, mund të përgjigjesh zoti ministër.

MINISTRI AHMET SHALA: Meqë pyetja ka të bëjë me lëmin e ekonomisë dhe të financave, konsideroj që mund të përgjigjem në këtë pyetje në emër të Kryeministrit Thaçi.

Ligji për huan publike, i cili do t'i mundësojë Republikës së Kosovës kthimin e parave të investuara jashtë vendit, dje është harmonizuar finalisht me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Atë ligj Ministria e Ekonomisë dhe e Financave do ta procedojë në Qeveri javën që vjen dhe ne do ta procedojmë këtu në Parlament, i cili do të mundësojë që mbase një sasi e madhe e parave të investuara, siç bëjnë edhe shtetet të tjera në tranzicion, të kthehen në Republikën e Kosovës, që ka qenë një sfidë për ne dhe ka qenë një mungesë legislative. Nëse i shikoni ... e kredive që janë dhënë, mbase nuk mund të konfirmohet kjo, ju e nderuara Kadaaj, që keni thënë. Rritja e kamatave në fakt nuk ka qenë shkas i ndonjë elementi të mungesës së legjislacionit ose të mungesës së planeve të sistemit bankar në Kosovë. Përkundrazi, sasia e parave të investuara përkundër krizës, bankat e Kosovës kanë dhënë diku mbi 8% më shumë në fazat e caktuara kredi se sa në vitet paraprake dhe kamatat kanë filluar të rrëshqasin në disa segmente. Sigurisht, ne pas harmonizimit të këtij ligji do të bëjmë kredit rejting, që thonë, për shtetin dhe kanë filluar procedurat dhe në gjashtëmujorin e parë të këtij viti do të kemi edhe kredit rejting prej kompanive më të fuqishme ndërkombëtare të cilat do mundësojnë matjen e saktë të riskut dhe jo matjen imagjinative që është prezent tani dhe besoj që përmes këtyre masave kreditë do të fillojnë të zbresin, me këto dy masa jam i sigurt që në fund të vitit 2010 kamatat do të fillojnë të zbresin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputete, ke pyetje shtesë?

DONIKA KADAJ - BUJUPI: Zoti Shala, 266 milionë euro i keni nxjerrë jashtë vendit vitin e kaluar, pa ligj, pa pasur bazë ligjore, as kamata s'keni marrë, as kurrëgjë. Në cilin ligj jeni bazuar, domethënë, një herë rreth 300 milionë euro i keni nxjerr jashtë vendit, pa ligj, një vit e gjysmë mbrapa e bëni ligjin dhe e arsyetoni që ne tani jemi në përpunim, në bërje të ligjit për një veprim të paligjshëm që e keni ndërmarrë dy vite më parë. Unë besoj që kjo është një lëndë për prokurori dhe dikush duhet të japë llogari, se megjithatë Kosova është shtet? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: Vërtet, duhet të diskutohet aspekti i keqpërdorimit të foltres dhe niveli i komentimit ose i keqkuptimit të aspekteve profesionale.

Auditori Gjeneral e ka bërë, e ka përgatitur dhe e ka kthyer përgjigjen shumë profesionale, e cila besoj dhe do ta lus ta bëjë publike në lidhje me aligacionet, si të themi, të cilat i kanë bërë disa udhëheqës tuaj ose të nxitur nga disa “ekspertë” të juaj sa iu përket investimeve të 260 milionëve dhe është autoriteti i cili do t’ua japë përgjigjen publikisht. Letra iu ka dërguar edhe iniciuesve, pra edhe juve, edhe EULEX-it dhe të gjithëve dhe më vjen shumë mirë që po vërtetohen fjalët që janë thënë këtu nga kjo foltore – mos spekuloni se e trenuat popullin me spekulime? Mos u bëni prokurorë këtu, sepse prokurorët e kanë rolin e vet, auditori e ka rolin e vet dhe e ka dhënë përgjigjen dhe më vjen shumë mirë që e ka konfirmuar atë. Institucioni i cili merret me menaxhimin e parasë publike në emër të shtetit të Kosovës, Banka Qendrore e Kosovës, i cili është organ që i përgjigjet këtij institucioni dhe ju mund ta ftoni atë për t’i dhënë të gjitha përgjigjet se si, ku, dhe çfarë ka ndodhur me të gjitha paratë dhe asetet e Republikës së Kosovës të investuara jashtë vendit?

Po, çka desha të them, unë jam i sigurt që me këtë ligj të mundësohet që paratë të kthehen në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Lus regjinë që t’i ftojë deputetët që të jenë prezentë në pikën e radhës e cila kërkon të votohet.

(Ndërprerje e incizimit)

Koha është 50 minuta dhe të gjitha pyetjet që ishin në dispozicion janë harxhuar, prandaj ne vazhdojmë seancën me pikën e rendit të ditës.

Në sallë janë 64 deputetë.

Të nderuar deputetë,

Në seancën plenare të mbajtur më 13 tetor 2009 ka përfunduar debati lidhur me Raportin vjetor të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008, por në mungesë kuorumi, votimi është shtyrë për seancën e radhës. Andaj, pa hapur debatin, lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 55 vota “për”, 2 abstenime, 1 “kundër”, Kuvendi miratoi Raportin vjetor të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008, sipas rekomandimeve të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Pika e radhës:

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimin civil të Republikës së Kosovës,**

Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim, të këtij projektligji. Ftoj ministrin e Administratës Publike, zotin Arsim Bajrami, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar Kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që të prezantoj Projektligjin për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, parimet bazë të këtij projektligji dhe risitë që i sjell ky projektligj.

Nevoja për një projektligj të tillë ka qenë e kamotshme, sepse që nga periudha e pasluftës materia e shërbyesve civilë është rregulluar me Rregullore të UNMIK-ut dhe disa herë është plotësuar. Është një materie shumë e rëndësishme për funksionimin e mirë të administratës publike dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, pas shumë përpjekjeve ka arritur që të përgatitë këtë projektligj dhe t'ia prezantoj Kuvendit të Kosovës, për miratim.

Ky projektligj përcakton Shërbimin civil të Republikës së Kosovës si një shërbim profesional të paanshëm, të bazuar në parimin e meritës dhe për herë të parë e reformon shërbimin civil duke profilizuar dhe duke ndarë nga shërbimi civil kategoritë e shumta të punonjësve që deri më tani kanë qenë të trajtuar si shërbyes civilë.

Të nderuar deputetë,

Sigurisht që e dini që Shërbimi civil në Republikën e Kosovës aktualisht numëron rreth 75 mijë të punësuar dhe të gjithë këta e përbëjnë edhe administratën publike. Ka qenë nevojë e domosdoshme që të reformohet shërbyesi civil dhe me këtë projektligj risia kryesore është ndarja nga shërbyesit civilë e kategorive të veçanta të cilat do të trajtohen si kategori të veçanta. Më lejoni që të njoftoj se cilat kategori ndahen nga shërbyes civilë dhe bëhen shërbyes të veçantë profesionalë.

Fillimisht, në bazë të këtij projektligji punonjësit e sistemit arsimor, punonjësit e sistemit shëndetësor, punonjësit në institucionet e kulturës, zyrtarët policorë të Policisë së Kosovës, zyrtarët doganorë të doganave të Kosovës, zyrtarët korrektues të Shërbimit Korrektues të Kosovës, pjesëtarët e Forcës së Sigurisë janë kategori që ndahen nga shërbyesit civilë dhe trajtohen si shërbyes të veçantë shtetëror. Kjo ka qenë më se e domosdoshme, sepse specifikat e punës së këtyre shërbyesve civilë janë të veçanta.

Shërbyesit civilë në kuptimin e këtij ligji janë kryesisht njerëzit që punojnë në administratë të pastër publike, të punësuarit në Administratën e Kuvendit të Kosovës, të punësuarit në Qeverinë e Kosovës, të punësuarit në Administratën e Presidentit të Kosovës, të punësuarit në këto sfera të arsimit, të shëndetësisë që janë persona civilë, që nuk janë arsimtarë apo mjekë po që janë punëtorë administrativë, të punësuarit në Shërbimin Diplomatik dhe Konsullor të Kosovës dhe të punësuarit në organet tjera të administratës publike. Në kuptim të këtij ligji nuk janë shërbyes civilë edhe të emëruarit politikë dhe të gjithë ata që emërohen në pozita nga të emëruarit politikë, do të thotë është praktika që të emëruarit politikë janë përfaqësues politikë dhe anëtarët e kabineteve të tyre që nga Kabineti i Presidentit, Kabineti i Kryetarit të Kuvendit, Kabineti i Kryeministrit, i Presidentit dhe kabinetet e ministrave nuk janë shërbyes civilë, por janë të emëruar politikë.

Njësia kryesore e këtij ligji është ndarja e shërbyesve civilë në dy kategori të mëdha, në shërbyes civilë të karrierës dhe shërbyes civilë jo të karrierës. Shërbyes civilë të karrierës janë shërbyes të përhershëm, ata që njëherë pranohen në shërbimin civil, ata janë shërbyes të karrierës dhe ligji stimulon

avancimin e tyre në karrierë në bazë të meritave dhe në bazë performancës së tyre e cila matet për çdo vit, kurse shërbyesit civilë jo të karrierës janë shërbyes civilë që emërtohen në poste të caktuara, në periudha të caktuara kohore, në postet e larta drejtuese dhe në postet drejtuese dhe që mandati i tyre nuk është i përhershëm, por përcaktohet me mandat dyvjeçar apo me mandat tjetër.

Kjo ndarje ka qenë shumë e rëndësishme edhe për të bërë edhe një ndarje të qartë midis shërbimit civil dhe të emëruarave që emërohen në periudha të caktuara dhe për të mundësuar një shërbim civil të përhershëm apo të karrierës. Pastaj, ligji ka ndarë shërbyesit civilë në katër kategori, kjo është risia kryesore. Kategoria e parë janë: shërbyesit civilë të nivelit të lartë drejtues; shërbyes civilë të nivelit drejtues; shërbyes civilë të nivelit ekzekutiv dhe shërbyes civil të nivelit administrativ. Kjo ndarje është bërë në atë mënyrë që të gjithë shërbyesit civil të klasifikohen në njërën prej këtyre kategorive dhe me Ligjin për pagat i cili është pjesë i këtij ligji, pjesë e kësaj reforme, ata do t'i kenë edhe gradimet e caktuara në sistemin e pagave dhe koeficientet, varësisht se a janë shërbyes civil të kategorisë së parë apo të kategorisë së katërt.

Pra, esenca e këtij ligji është që shërbyesit civilë t'i motivojë që gjithë jetën të përparojnë në karrierë, që ata mund të pranohen, po e zëmë, në një pozitë të katërt të shërbyesit civil, por me avancime në karrierë dhe me aftësimet që do të bëhen brenda institucioneve qeveritare, siç është Instituti për Administratë Publike, i cili në kuptimin e këtij ligji është kompetent për të mundësuar trajnimet e vazhdueshme gjatë gjithë karrierës së shërbyesve civilë. Ata mund të lëvizin nga një nivel i shërbyesve civilë, deri te niveli më i lartë i shërbyesve civilë.

Ligji në mënyrë të qartë rregullon tri çështje që janë jashtëzakonisht të rëndësishme, është çështja e emërimeve të larta në Shërbimin civil, ka qenë një çështje që në periudhën e pasluftës është diskutuar shumë. Pra, ju e dini se deri me tani kemi pasur institucionin e KELP-it, Ligji tani parasheh një institucion tjetër të emërimit të shërbimit civil dhe parasheh që këto emërime të bëhen mbi bazat civile, mbi baza profesionale rregullon me standardet më të larta evropiane çështjen e emërimit të shërbyesve civilë.

Gjithashtu, ligji e fuqizon Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, si një këshill plotësisht të pavarur i cili është përgjegjës për ta monitoruar ligjshmërinë e menaxhimit të shërbimit civil. Siç e dini, Këshilli i Pavarur, në bazë të rekomandimeve ka kohë që është një institucion i pavarur, është i lidhur drejtpërdrejt për Kuvendin dhe Ligji jep tërë juridiksionin që ky ta menaxhojë plotësisht Shërbimin Civil, qoftë nga procesi i rekrutimit të shërbyesve civilë e deri te procesi i emërimeve në pozita të larta.

Ky ligj është një ligj shumë i rëndësishëm dhe në një kohë të gjatë kemi zhvilluar negociata me institucionet ndërkombëtare për ta përgatitur këtë reformë esenciale. Kemi biseduar gjatë dhe jemi në bisedime me Fondin Monetar Ndërkombëtar, në mënyrë që implementimi i këtij ligji, bashkë me Ligjin për paga të jetë plotësisht i përgatitur, sepse pas miratimit të këtij ligji edhe të Ligjit për paga, ne do të përgatisim tërë legjislacionin sekondar, një varg rregulloresh që do të klasifikojnë të gjithë shërbyesit civilë dhe ata do t'i gradojnë sipas pozitës dhe do t'ua caktojnë edhe sistemin e pagave. Ne e kemi një bashkëpunim të shkëlqyeshëm me Fondin Monetar Ndërkombëtar, kemi marrë imputet e para mbështetëse dhe ato impute i kemi pranuar, por do të vazhdojmë fuqishëm deri në leximin e dytë që të bashkëpunojmë me Fondin Monetar, në mënyrë që plotësisht ta përgatisim implementimin e kësaj reforme që ka edhe një kosto bukur të lartë financiare.

Gjithashtu, kemi bashkëpunuar edhe me institucionet tjera, kohëve të fundit edhe me sindikatat, të cilat i kemi këtu dhe i kemi bërë pjesë të këtij procesi të përgatitjes së këtij projektligji. Por, të nderuar deputetë, ne jemi të sigurt që Kuvendi i Kosovës dhe komisionet përkatëse do të mund ta plotësojnë këtë ligj, do të mund ta amendamentojnë, në mënyrë që implementimi i kësaj reforme të jetë një rast i suksesshëm. Mos të harrojmë, këto ligje janë ligje shtetërore, janë ligje të shtetit të Kosovës dhe të gjithë duhet të kemi përgjegjësinë që të ngrihemi pak nga situata aktuale politike dhe t'i miratojmë këto ligje për të plotësuar këtë vakum ligjor, sepse ka 10 vjet që materia e shërbyesve civilë dhe materia e pagave është një materie e parregulluar

apo materie jo mirë e rregulluar dhe për reformimin e administratës publike, për krijimin e një administrate shtetërore është e domosdoshme që ne t'i miratojmë këto ligje dhe pastaj të fillojmë ta aplikojmë këtë reformë jashtëzakonisht të rëndësishme për tërë reformën shtetërore.

Në fund, dëshiroj të theksoj që ne do të bashkëpunojmë si Qeveri plotësisht me komisionet parlamentare dhe jemi të gatshëm të ofrojmë çfarëdo asistence teknike apo asistence tjetër, në mënyrë që këto ligje të amendamentohen mirë, të plotësohen vakuomet e caktuara dhe miratimi përfundimtar i këtyre ligjeve të bëhet mbi bazën e diskutimeve profesionale dhe mbi bazën e përgjegjësive të përbashkëta që duhet t'i ndërmarrin të gjitha partitë politike për ta përgatitur dhe implementuar këtë reformë shtetërore. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr anëtari i Kryesisë, zoti Eqrem Kryeziu

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Pas kësaj paraqitjeje, e hapim debatin për diskutim, në parim. Meqë nuk po shohim se janë paraqitur përfaqësuesit e komisioneve funksionale, atëherë shkojmë menjëherë me grupet parlamentare. Nga Partia Demokratike e Kosovës, urdhëroni, zonja Selvije!

SELVIJE HALIMI: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra dhe kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, vëmendshëm ka shqyrtuar Projektligjin për shërbyesit civilë dhe mendon se ky projektligj edhe pse pak sa i vonuar, mirëpo duke ditur arsyet e vonës së këtij ligji, mendon se ky ligj duhet të aprovohet, në parim, dhe jep mbështetje për aprovim në parim, duke menduar se në të ardhmen kërkohet një bashkëpunim shumë i ngushtë në mes të komisionit funksional parlamentar dhe Ministrisë së Administratës Publike, në mënyrë që disa çështje teknike të konkretizohen dhe të rregullohen gjatë amendamentimit të këtij projektligji. Njëkohësisht, falënderojmë edhe ministrin e Administratës Publike për një shtjellim dhe për një arsyetim të thukshëm të këtij projektligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete! Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, zonja Pantina e ka fjalën!

MYRVETE PANTINA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Projektligji për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës të cilin po e shqyrtojmë sot, ka të bëjë me rregullimin e statusit të nëpunësve civilë, si dhe me marrëdhëniet e tyre të punës në institucionet e administratës qendrore dhe lokale, andaj edhe si i tillë është shumë i nevojshëm.

Shpërblimi për punën e shërbyesve civilë duhet të bëhet përmes sistemit të pagave, i cili do të rregullohet me një ligj të veçantë, me Ligjin për paga të shërbyesve civilë, andaj do të jenë dy ligje që duhet të shikohen si të ndërsjella dhe të varura.

Projektligji për Shërbimin civil do të ketë edhe kosto shtesë buxhetore për periudhën 2009-2011, që parashihet të jetë 123.500 euro. Por, të dhënat mbi bazën e të cilave është vlerësuar kostoja buxhetore e këtij projektligji në buxhetin e Kosovës nuk paraqesin fakte, por vetëm supozime, andaj edhe parqet rrezik financiar për zbatimin e këtij projektligji. Ndërsa, kostoja shtesë buxhetore e këtij projektligji, pra nuk është buxhetuar në buxhetin e vitit 2009, dhe as në Kornizën afatmesme të shpenzimeve 2009-2011, prandaj, mbetet që të gjenden burimet për financimin e këtij projektligji.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës mendon se ky Projektligj duhet të miratohet, në parim, dhe pajtohet që të miratohet, ndërsa kontributin tonë do ta japim në kuadër të komisionit funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Pantina!

Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën e ka zoti Shkumbin Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministra të Kabinetit qeveritar,

Grupi parlamentar për Ardhmërinë e Kosovës në parim e mbështet Projektligjin, jo se projektligji është i mirë, por ka nevojë administrata shtetërore të ketë edhe më në fund të jetë e rregulluar me ligj përkundër vërejtjeve që i kemi. Do të thotë, në të gjitha nenet e fushë veprimtarisë së Projektligjit parashihet në veçanti edhe vetë forma kur nëpunësit civilë kanë të drejtë për të krijuar marrëdhënie pune.

Kur thuhet se nëpunësi civil ka të drejtë për të krijuar marrëdhënie pune, nuk ka bazë ligjore në kuadër as të administratës lokale, as në kuadër të administratës qendrore e as të vetë Ministrisë së Shërbimeve Publike, për shkak se ende mungon Ligji për punë dhe përderisa mungon Ligji për punë, ne nuk mund të flasim për themelimin e marrëdhënies së punës në Republikën e Kosovës.

Rregullorja 2001/27 për Ligjin e punës në Kosovë ende është funksionale brenda territorit administrativ të Republikës së Kosovës edhe këtë gjë nuk ka mundur ta ndryshojë Qeveria edhe përkundër asaj se ka mundësi dhe ka mjete të mjaftueshme dhe nuk ka kosto buxhetore për implementimin e tij, vetëm se është pengesë e mundësisë së ekzekutimit të lëndëve nga vetë Inspektorati i Punës, që e përmendi ministria më herët, për shkak se neni 25 ku parashihen dënimet në kuadër të asaj rregulloreje, është kompetencë e përfaqësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara dhe ka mundur të bëhet një ndryshim në kuadër të kësaj rregulloreje edhe ai të funksionalizohet si ligj.

Rregullorja 2001/36 deri më tani, që ka ardhur Projektligji në Kuvend, ne para dy javëve i kemi shtyrë këto projektligje, edhe Projektligjin për Shërbimin Civil, po edhe për pagat në Shërbimin Civil për shkak se nuk kemi qenë të gatshëm dhe kemi pasur vërejtje nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe arsye tjera të ngjashme, sepse ne nuk kemi as ligj që rregullon punën e Qeverisë së Kosovës edhe ajo funksionon me Rregullore të UNMIK-ut. Dhe, këtë Qeveria nuk e ka paraparë deri me tash se a jemi me të vërtetë shtet dhe kemi Qeveri apo jemi në kuadër të OKB-së duke vepruar si UNMIK dhe, përfundimisht, është mirë që në kuadër të këtij projektligji shëndetësia, arsimi, policia e Kosovës, Forca e Sigurisë të trajtohen si mekanizma të veçantë, mirëpo duhet të jenë shërbyes publikë shëndetësia edhe arsimi, sepse numri 75.000 i shërbyesve civilë në Kosovë, pavarësisht kategorizimit të tyre, është numër shumë i madh dhe nuk ka kush i mbikëqyr. Ne kemi një komision në kuadër të Kuvendit, që është Komisioni për Mbikëqyrjen e Nëpunësve Civilë, mirëpo duhet të jenë mekanizma tjera adekuat, jo vetëm të rregullohet me një akt të veçantë nga Qeveria, apo një rregullore tjetër që mund ta përcaktojë këtë, sepse nuk mund të mbikëqyret shërbimi civil nga një komision që mund të formohet brenda administratës për momentin, kur e vlerëson në shkallën e parë.

Ne e përkrahim këtë projektligj, se është më se i nevojshëm për momentin dhe duhet sa më shpejt të vijë edhe ligjet tjera bazike, që të harmonizohen këto ligje, sepse puna dhe punësimi rregullohet me një ligj krejt tjetër që të mund, në radhë të parë të themelohet marrëdhënia e

punës, e për mbikëqyrje vendosin mekanizmat tjerë që janë të paraparë edhe me rregullore të tjera të ngjashme si kjo 2001/36, që tani shpresojmë se do të jetë ligj. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Shkumbin!

Në emër të Aleancës Kosova e Re, zoti Riza Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuar, zoti kryesues!

Zotërinj ministra të respektuar,

Deputetë të nderuar,

Për Ligjin për shërbimin civil, disa vërejtje të përgjithshme parimore, po e quaj ligj e jo projektligj. Ligji përcakton statusin juridik të nëpunësve civilë, mirëpo me nenin 1 të këtij ligji nuk përfshihen edhe nëpunësit civilë të organizatave tjera të cilat janë themeluar me ligj, e të cilat ndryshe i kanë pozitat e privileguara në ekonominë e tregut, jo në saje të punës, por për hir të pozitave monopoliste e të cilat janë të themeluara me akte ligjore sikundër apo së paku të ngjashme me institucionet publike tjera.

Institucionet e Administratës Qendrore, kështu quhet në tekst, do të duhej, mendoj, të Administratës Republikane, rregullohen me ligj të veçantë, në rregull. U nënshtrohen dispozitave të këtij ligji, veç rasteve kur ligji i posaçëm përmban dispozitat e ndryshme nga ai. Ky ligj, pra, nuk u referohet institucioneve qendrore të ashtuquajtura, lexo republikane, por nëpunësve publikë të tyre, nën një, dhe, dy, po ky dokument është dhe duhet të trajtohet ligj special i fundit lex specialis, ndërsa generales në këtë rast do të mund të ishte, po e zëmë, për momentin kemi Rregulloren për Ligjin për punën, që është një emërtim krejt i parëndomtë në jurisprudencë.

Të gjithë nëpunësit në kabinete, ju lutem, neni 3, paragrafi 3, thotë kësi soji: “Të gjithë nëpunësit në kabinete të funksionarëve publikë nuk janë nëpunës civilë”, u mor vesh të gjithë, do të binte, por ana materiale e çështjes. Çfarë u dashka të jenë nëpunësit e Kabinetit, por të mjeteve të funksionarëve publikë. Po e zëmë, çfarë u dashka të trajtohej një person që do të merrej, po e zëmë, me hartimin e shkresave teknike administrative e tjera e tjera. Mirë, asistent, por mund të quhet asistent/asistente, por është nëpunëse administrative, edhe nëpunëse civil.

Ministria përgjegjëse për administratën publike mendoj se do të duhej formulimi të jetë: “Ministria për Administratën Publike është kompetente për hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave të shërbimit civil”, neni 5, paragrafi 1. Ministria përgjegjëse për Administratën Publike është dhe duhet të jetë Ministria për Administratën Publike, ajo të theksohet një herë në fillim edhe me referencë Ministria, dhe formulimi për te, se hartimi, a po harton dhe mbikëqyr zbatimin e politikave, unë angazhohem jo që të hartojë, por të përcaktojë. Angazhohem që kjo ministri të ketë injerencia edhe kompetenca më të theksuara, se hartimi është më tepër aspekt administrativ-teknik, ndërsa kjo do të duhej t’i përcaktonte politikat edhe t’i monitoronte dhe t’i garantonte në ekzekutim. Është çështja të parimet, të disa vërejtje do të më thënë, kështu, substanciale.

Neni 7.5, Ministria përgjegjëse për administratën, në vend të MAP, përkatësisht apo të ministrisë, i propozon Qeverisë akte nënligjore. Do të duhej që kjo ministri të ketë autorizime t’i hartojë vetë aktet nënligjore në zbatimin e ligjit, e jo t’i propozojë, se do të krijohej një procedurë e ndërlikuar, e gjatë, e panevojshme dhe, tek e fundit, Qeveria nuk mund të jetë më kompetente sa i përket profesionalizmit se vetë Ministria për Administratën Publike. Prandaj, me një fjalë, do të ndryshohej krejtësisht koncepti i funksionit të kësaj ministrie.

Te neni 8, thotë: “Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës”. Ne e dimë se as Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk janë të pavarura dhe me këto pleonazma disi po e bëjmë disi njëfarë formulimi që me të vërtetë nuk përkon me realitetin. Ta quajmë Këshilli për Mbikëqyrjen e Kosovës, a me autorizimet ligjore, përpiqem që të jetë mundësisht edhe i pavarur.

Te neni 12.2: “Pranimi në Shërbimin Civil mund të kryhet deri 1 vit para moshës së pensionimit”. Kjo dispozitë po të miratohej, do të binte në kolizion me Kushtetutën, se të drejtë ka për të konkurruar ai/ajo qoftë edhe një ditë para pensionimit, a ne e dimë fare mirë se nuk do të pranohej dhe nuk do të duhej pranohej, sepse aty merren faktorë të ndryshëm dhe justifikimet e ndryshme, kështu që të mos bëhet ky formulim, ky do të binte, po e zëmë.

Te neni 12.4: “Në Shërbimin Civil mund të lejohet puna vullnetare pa pagesë e nëpunësit civil pas pensionimit deri në moshën 70 vjeçare. Ky është një nonsens, nuk besoj se në Kosovë do ta gjeni një person që do të punonte pa të holla 5 vjet, është formulim që, tek e fundit, nuk është kategori ligjore.

Te 13.2, “funksionarët publikë” do të duhet gjithkund në tekst të jetë në njëjës jo shumës, “mund të konkurrojnë si kandidatë të jashtëm për punësim në Shërbimin Civil të Kosovës dhe nuk do të kenë trajtim të privilegjuar”. Ky është më tepër formulim proklamativ, kjo është një. Dy, se mund të konkurrojnë kushdo, qoftë edhe ai apo ajo që nuk i plotëson kushtet. Është e drejtë elementare njerëzore dhe e garantuar me Kushtetutë, prandaj nuk është e nevojshme dhe nuk besoj që funksionari publik do të konkurronte në Shërbimin Civil se do të disfavorizohej apriori.

Përfundimisht, jashtë këtyre dhe disa vërejtjeve të tjera parimore që do të përpiqem për të dhënë një kontribut në procedurat që pasojnë. Ky dokument, ka formë dhe strukturë standarde dhe është në konformitet me Udhëzimin administrativ 1408 për hartimin e projektligjeve. Ky dokument juridik për të mirë dallon nga shumica e projektligjeve, të cilat i kemi pasur deri sot në Kuvend. Prandaj, angazhohem edhe në emrin e Grupit, por edhe personalisht që, natyrisht, aq sa mundemi ta amendojmë në të mirë të efikasitetit të aplikimit të tij dhe e përkrahim, në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Smaka!

Nga Lidhja Demokratike e Dardanisë, zonja Synavere Rysha.

SYNAVERE RYSHA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Anëtar të Kabinetit qeveritar,

Është hera e tretë që këto projektligje na vijnë në Kuvend. Projektligji për Shërbimin Civil të Kosovës, Projektligji për pagat e shërbyesve civilë dhe ai i Qeverisë, mirëpo kësaj radhe Ligji për Qeverinë nuk është në Kuvend që ndoshta është kah përgatitet një ligj më i mirë. Sido që të jetë, për këto dy projektligje ne i kemi pasur vërejtjet e tona si Lidhje Demokratike e Dardanisë, i kemi dhënë vërejtjet tona, duke pasqyruar përmbajtjen e projektligjeve dhe duke i parë të metat përbrenda ligjeve, mirëpo kjo nga Qeveria, si duket, nuk është marrë parasysht dhe për të tretën herë pa punuar pa asnjë ndërhyrje, as më të voglën ndërhyrje, janë kthyer në Kuvend dhe kësaj radhe mbetemi te ajo situata a të kemi, të bëjmë një ligj për shërbyesit civilë apo të vazhdojmë edhe më tutje të mos i mbështesim këto ligje? Duke pasur parasysht gjendjen e shërbyesve civilë, që vërtet për 10 vjet fare pak ose të mos themi fare nuk janë përkrahur nga Qeveria, kësaj radhe do të jemi më fleksibil dhe si Lidhje Demokratike e Dardanisë me të gjitha

vërejtjet që i kanë këto projektligje, do t'i përkrahim, në parim, dhe do ta japim kontributin në komisionet funksionale.

Shërbyesit civilë janë një kategori që vërtet kanë ardhur para një krize. Sindikata vazhdimisht po reagon dhe po e paraqet shumë qartë dhe shumë drejt çështjen e tyre, që vërtet po ballafaqohen me sfida dhe me probleme pa përkujdesje të institucionit, prandaj ne do të jemi në favor që këto ligje të miratohen, të zbatohet në praktikë vetëm ajo pjesë që është në favor të shërbyesve civilë, sepse aq shumë të meta, saqë të gjitha çështjet është menduar të rregullohen me rregullore të brendshme apo me akte të tjera juridike e jo të parashihen në ligj. Sido që të jetë, ne do ta përkrahim si Lidhje Demokratike e Dardanisë dhe do ta japim kontributin tonë të mëtutjeshëm. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Synavere! Nga Grupi “7+”, zonja Shpresa Murati.

ŠPRESA MURATI: Hvala, predsedavajući!

Pozdrav svima!

Cilj Nacrta zakona o civilnoj službi jeste uređivanje svih pitanja koje se odnose na civilne zvaničnike zapolslene u institucijama centralne i lokalne admnsitracije, počev od objavljivanja radnih mesta, njihovog izbora i zapošljavanja, pravila menadžiranja i organizovanja politički nepristrasne civilne službe, njihova prava i obaveze, disciplinske mere u slučaju kršenja službene dužnosti pa sve do završetka zapošljavanja.

Ono što bi trebalo istaći, jeste da Nacrtu zakona nedostaju definicije i upotrebljen je jedan sasvim drugi oblik pojašnjavanja odredjenih izraza. Kaznene odredbe ne preciziraju odgovarajuće mere i kazne za odredjena kršenja, lakša ili teža, i nema opisa povreda, koja su ta povreda lake, koje srednje, a koje teške.

Ne predvidja se u dovoljnoj meri ni funkcionisanje i kompetenije Disciplinske komisije kao i Komisije za žalbe na donetu odluku od strane Disciplinske komisije. To se odnosi na član 71. i 72. Mnoga suštinska pitanja se regulišu podzakonskim aktima, a koja bi trebalo biti urdjene zakonom.

U tekstu Nacrta zakona uočavaju se i mnoge greške, ne samo tehničke, već i sadržaje. I pored ovih propusta koje smo naveli, Parlamentarna grupa „7+“ podržaće ovaj nacrt zakona i daće svoj doprinos u toku njegove dalje procedure, jer smatramo da ovaj nacrt zakona uređjuje oblast od izuzetnog značaja za sve građane Kosova. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Murati! Grupi SLS nuk ka të paraqitur. Atëherë, shkojmë me deputetët, sipas radhës së paraqitjes. Zoti Emrush Xhemajli e ka fjalën!

EMRUSH XHEMAJLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Kabinet qeveritar,

Zoti ministër,

Kolegë deputetë dhe të pranishëm,

Përshtëndes ardhjen në lexim të Projektligjit për shërbyesit civilë, si një nga ligjet që do të ndikojnë në përmirësimin e jetës së mijëra punonjësve në Kosovë dhe në emër të Partisë Socialiste e mbështesë, në parim.

Ky ligj rregullon pozitën e shërbyesve civilë, të cilët sot dihet se janë në pozitë shumë të vështirë dhe janë duke e përballuar me vështirësi jetën. Në këtë ligj ka dy dukuri që vërehen. E para, nuk është krejt i qartë, megjithëse ministri i kategorizoi, nuk është i qartë përkufizimi i

shërbyesve civilë, administrata shtetërore, nëpunësit e kompanive publike, punonjësit administrativ të arsimit dhe të shëndetësisë, por megjithatë në ligj nuk është bash mirë kjo e rregulluar.

E dyta, janë lënë shumë nene që u cek edhe këtu, të cilat do të përcillen me akte nënligjore, me rregullore, dhe kjo ka rrezik që të ndryshojë në përmbajtje vet nenet e ligjeve dhe do ta lë një mundësi që në ministri të interpretohet gabim ligji në dëm të shërbyesve civilë. Të them, në fund, se për t'u bërë ky ligj i kompletuar, ka nevojë që në procedura të mëtejshme nga Komisioni për Administratë, Pushtet Lokal dhe Media, të thirret nga Komisioni dhe nga të interesuarit për Ligjin, dëgjim publik për të dhënë kontributin e tyre sidomos Sindikata e shërbyesve civilë, të cilët kanë propozimet e tyre dhe të gjithë të interesuarit nga shoqëria civile.

Ju e dini se ka pasur shumë reagime në këtë drejtim, jo vetëm për vonesën, por edhe për përmbajtjen e ligjit. Në emër të Partisë Socialiste, edhe një herë, e mbështes në parim dhe do ta votoj.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Xhemajli! Fjalën e ka Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Projektligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës është me një rëndësi të veçantë sepse duhet të krijojë kornizën ligjore për rregullimin e shërbimit civil. Është e rëndësishme që shteti i Kosovës të ketë një administratë efikase, meqenëse kjo mundëson funksionimin efikas të shtetit të Kosovës, por kjo duhet të përcillet edhe me krijimin e kushteve për shërbyesit civilë.

Megjithatë, zoti ministër, për t'u arritur kjo, unë konsideroj se është dashur të sillen një pako e ligjeve të cilat përfshijnë rregullimin e gjithë kësaj sfere, duke përfshirë edhe politika të qarta për shërbimin civil dhe strategjinë e reformave. Për shkak të kësaj, konsideroj se disa pjesë të Ligjit janë të mangëta dhe se duhet përmirësuar dhe do t'i cek. Që në fillim dëshiroj të theksoj se në parim e mbështes për shkak të rëndësisë që ka ky projektligj. E para projektligji duhet qartë të definojë se kush është shërbyesi civil. E dyta, duhet të definohet se kush nuk bën në kategorinë e shërbyesve civil, edhe pse sipas projektligjit kryesisht janë përfshirë punëtorët civilë të administratës qendrore dhe lokale, qendrore si të: Kuvendit, të Presidencës, të ministrive, të Zyrës së Kryeministrit, si dhe administratës komunale, agjencitë ekzekutive të pavarura dhe ato rregullatore. Në shërbimin civil me projektligj janë përfshirë edhe personeli diplomatik dhe konsullor, personeli administrativ në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Megjithatë, zoti ministër, është e paqartë se si do të rregullohet kjo në praktikë, kur dihet se statusi i tyre trajtohet me ligj të veçantë.

Në shërbimin civil janë përfshirë edhe personeli i punësuar në Policinë e Kosovës, në Forcën e Sigurisë së Kosovës, në doganat e Kosovës, në Shërbimin Korrektues dhe në sistemin gjyqësor dhe prokurorial. Megjithatë, në projektligj nuk janë përfshirë dhe nuk është i definuar statusi i punëtorëve siç janë: punëtorët shëndetësorë; zyrtarët e Policisë; punëtorët e arsimit; të atyre të institucioneve të kulturës e tjerë. Madje, në projektligj thuhet se personeli përgjegjës për kryerjen e funksioneve mbështetëse dhe të mirëmbajtjes nuk janë nëpunës civilë. Atëherë, cili është statusi i këtyre punëtorëve?

Deri me sot kjo fushë ka qenë e rregulluar kryesisht me aktet juridike të UNMIK-ut dhe me disa akte ligjore të Ministrisë të Shërbimeve Publike. Sipas këtyre rregulloreve, deri më sot në kategorinë e shërbyesve civilë janë futur të gjithë të punësuarit të cilët kanë marrë paga nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës. Tani, me ligjin e ri shfuqizohen këto rregullore të UNMIK-ut. Por, në memorandum shpjegues thuhet kështu, po citoj: "Shërbimi Civil i Republikës së

Kosovës nuk bie ndesh me kompetencat e rezervuara të PSSP-së”. Mendoj se kjo duhet të hiqet nga ligji për arsye se PSSP-ja nuk ka më kompetenca ligjore, sidomos duke marrë parasysh se vetë Qeveria ka deklaruar se misioni i UNMIK-ut duhet të përfundojë.

Gjithashtu, në projektligj ceket se kategoria e punëtorëve që nuk është definuar, siç i përmenda sidomos punëtorët shëndetësorë, të arsimit e tjerë, do të përcaktohet me Ligjin e punës. Meqenëse në Kosovë momentalisht janë 75.000 punëtorë civilë ose konsiderohen shërbyes civilë, ndërsa në ligjin aktual përfshihen vetëm 15.000 punëtorë, do të thotë, ata që do të kenë statusin e shërbyesve civilë, kurse, ngelë numri shumë më i madh i punëtorëve tjerë të cilëve nuk u dihet statusi.

Kjo e paraqet menjëherë urgjencën e asaj që e thashë se duhet të jetë një pako e fushës së shërbimit civil. Gjithashtu, sipas projektligjit, orari i rregullt i punëtorëve civilë është 40 orë në javë dhe nuk mund të tejkalohet. Është paraparë edhe puna jashtë orarit si raste të jashtëzakonshme. Por, punëtorët civilë, do të thotë, mund të punojnë jo më shumë se 4 orë në ditë, 20 orë më javë ose 40 orë në muaj, porse në praktikë dëshiroj të përmendi rastin e punëtorëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të cilët në rastin e vëllimit të punës, sidomos në muajt e verës kanë punuar jashtë orarit, diku ditët e punës deri 11 orë në ditë dhe të shtunave 8 orë në ditë. Meqenëse kjo punë jashtë orarit ka për të vazhduar dhe planifikohet nga Ministria e Punëve të Brendshme, atëherë me hyrjen në fuqi të këtij ligji, punëtorët e Ministrisë së Punëve të Brendshme nuk mund të punojnë jashtë orarit nga 23 orë në javë ose 93 orë në muaj nga se kjo do të jetë e jashtëligjshme.

Në fund, të përmend një ndryshim esencial të këtij ligji, që ka të bëjë me shuarjen e Këshillit për Emërime të Larta Publike, meqenëse tani zëvendësohet me Komisionin për Emërime të Larta Publike dhe mendoj se ky do të jetë më i politizuar se KELP-i. Kemi edhe një ndryshim tjetër në mes të sekretarëve permanentë, tani kemi sekretarë të përgjithshëm, të cilët zgjedhen brenda një periudhe tre vjeçare.

Gjithashtu, sipas Projektligjit, Kryeministri mund të kërkojë vlerësimin e performancës së të emëruarve në pozita të larta publike. Kjo, sipas meje, i vë nën kontroll të drejtpërdrejtë të emëruarit nga Kryeministri. Sa i përket harmonizimit me legjislacionin e BE-së, kjo fushë nuk rregullohet me legjislacionin e BE-së, por është përgjegjësi e shteteve anëtare. Nga aspekti i buxhetit, ka disa paqartësi, sidomos ajo që ka të bëjë me numrin e të punësuarve, por gjithashtu aktet nënligjore mund të kenë implikime buxhetore. Edhe njëherë theksoj se në parim e mbështes. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Sylja!
Në radhë është zoti Naim Rustemi.

NAIM RRUSTEMI: Ju faleminderit, kryesues!
Edhe pse shumë çka desha të them, u thanë deri me tani, por ndoshta nuk bëhem monoton nëse shkoj edhe një herë me rend.
Disi kam përshtypjen se ligji që është ofruar, nuk është debatuar shumë në opinionin publik, ka qenë paksa i mbyllur kur kemi parasysh se është një prej ligjeve më të rëndësishme për momentin kohor në Kosovë. Disi kam përshtypjen se Ligji tentohet që të bëjë zgjidhje për të gjithë, duke i larguar nga shërbimi civil, duke ofruar zgjidhje dhe zgjidhja ka qenë magjike. Ne nuk dëshirojmë të jemi shërbyes civil, shëndetësia, arsimi, policia dhe shumë organe tjera, duke mos e thënë as sa është mirë, as sa është keq, por të debatohet ka qenë shumë e nevojshme, të jetë shumë më i debatueshëm.

Në ligj unë do të shkoj nën për nën. Edhe një herë do të kthehem te neni 3, pika 3, “të gjithë nëpunësit e punësuar në kabinetet e funksionarëve publikë, nuk janë nëpunës civilë”. Ndoshta e ka atë logjikën se megjithatë sekretarët e përhershëm, funksionarët publikë po bienë vozitësit e vet, sekretarët, asistentët administrativë e tjerë me vete dhe zgjedhja është ofruar në këtë formë, por nëse i kanë prurë dhe ne po e dimë që i kanë prurë, atëherë ata kanë bërë thyerje të ligjit. Nëse kanë bërë thyerje të ligjit, ata duhet të përgjigjen para ligjit, sepse për funksionimin e demokracisë, sundimi i ligjit është qenësor.

Gjithashtu, në të njëjtin nën, në pikën 4, largohen nga shërbimi civil shumë punëtorë të mbikëqyrjes dhe të kryerjes së punëve të tjera të funksioneve mbështetëse, për momentin nëse ne e miratojmë këtë ligj, ku shkojnë ata? Me çka rregullohet puna e tyre. Me fjalë të tjera, mendoj se ky ligj është dashur të vijë në një formë si paketë me shumë ligje të tjera që mos të krijojnë hapësirë të zbrazët, që mos të krijojnë një situatë kur nuk di çka po bëhet apo nuk ke mundësi ta rregullosh krejt punën. Gjithashtu, në tërësi në ligj shpesh herë përmendet “shërbim civil”, herë “administratë publike”, kështu që unë kisha kërkuar që ata që e shkruajnë, të jenë më rigoroz në saktësi ose të vazhdohet gjithnjë me “shërbim civil” menjëherë pas definimit se çka është shërbimi civil dhe të mos përdoret fjala “administratë publike” si një terminologji pak më e gjerë se “shërbimi civil”. Kështu që të jemi rigoroz në përdorimin e terminologjisë që e rregullon, të terminologjisë adekuate për ligjshmëri.

Unë, gjithashtu, edhe në terminologjinë, për shembull, neni 6 – strukturat menaxhuese të shërbimit civil në kuadër të administratës publike. Unë po kuptoj që ne po adaptojmë shprehje të ndryshme, por që kjo shprehje për mua ka qenë pak qesharake, “organet e personelit”. Ndoshta kishte qenë mirë të kemi një terminologji që është adaptuar edhe është adekuate për fushën që e rregullojnë menaxhimin e resurseve humane. Kjo ishte çështje terminologjike. Më falni, se unë do të shkoj nën me nën. Gjithashtu, kur kemi të bëjmë me emërimet për afat të caktuar, për një periudhë më të shkurtër gjashtëmujore, e kemi fjalën për nenin 11, pika 4 – marrëveshje për shërbimet e veçanta të cilat i nënshtrohen ligjit për detyrimet. Më sa e di unë, ligj për detyrime nuk ka. Nëse ka ligj për detyrime, atëherë është në kolizion me Ligjin për prokurimin publik, sepse edhe shërbimi i nënshtrohet, konkursi i projektimit dhe i shërbimit i nënshtrohet Ligjit të prokurimit. Me fjalë të tjera, të harmonizohet edhe me Ligjin e prokurimit.

Për pranimin në shërbim civil nuk do ta diskutoj, se e përmendi edhe kolegu im Riza Smaka, kurse kur jemi në nenin 14 – emërtimi në pozita të larta drejtuese, unë mendoj, kisha sugjeruar që të rishikohet edhe një herë që ta gjejmë ndonjë modalitet i cili kishte për ta siguruar pavarësinë politike, paanësinë politike, sepse mendoj që ky është bash aty ku janë problemet më të mëdha në shërbimin civil, jo veç në Kosovë, por edhe në të gjitha vendet tjera, sepse aty është bash ku preket politika me njerëz që e kryejnë punën në mënyrë profesionale.

Neni 14, sipas mendimit tim nuk garanton paanësi politike, sepse vetë krijimi i komisionit është politik. Është tentuar me emërimin e një mësimdhënësi nga Universiteti publik, por nuk është shumë e madhe se ne e dimë ambientin në cilin veprojmë dhe e dimë se si mund të ndodhin.

Gjithashtu, lëvizja e zyrtarëve brenda shërbimit civil, neni 16, pika 2, por nuk qenka pika 2, më falni, është neni 17.3 – pranimi në shërbimin civil në pozicionet e karrierës është i hapur për të gjithë kandidatët. Këtu mendoj që e ka bërë ndryshimin në shërbimin civil, sepse deri më tani ne kemi pasur një sistem të hapur të shërbimit civil dhe tash po krijojmë një shërbim civil të mbyllur, të sistemit të mbyllur. Ata që e trajtojnë çështje të shërbimit civil, e dinë se sistemet e mbyllura të shërbimit civil janë jokreative, nuk janë inkurajuese dhe është një tendencë për të krijuar një shërbim civil të sistemit të mbyllur, një sistem i mbyllur dhe i plakur. Ne në njërin anë themi se Kosova është plotë me të rinj, kërkojmë që kreativiteti i të rinjve të vihet në

funksionimin, në funksion të funksionimit të organeve të shtetit të Kosovës, dhe në anën tjetër krijojmë një shërbim civil të tipit të mbyllur, që kishte për t'i mbajtur njerëzit dhe në njëfarë forme e plakë shërbimin civil. Me fjalë tjera, zgjedhja që është bërë në sistemin e shërbimit civil, është shumë jo kreative, sepse vetë fakti se futja në shërbim civil është e rregulluar që të fillohet prej nivelit më të ulët, nuk është atraktiv puna në shërbimin civil. Edhe ashtu nuk është atraktive puna në shërbimin civil, por me këtë ligj e bëjmë edhe më pak atraktive, sepse bëhet shumë e rëndë për njerëzit që mund të pretendojnë që janë kreativ në zgjidhje të probleme, të futen prej nivelit më të ulët në shërbimin civil. Kjo pikë rregullohet me nenin 17.7 sipas këtij ligji, kështu që sugjeroj që të kemi ndonjë zgjidhje pak më të ndryshme, nëse është e mundshme, normalisht.

Gjithashtu, unë kisha për ta komentuar edhe nenin 29 – transferimi i përkohshëm i nëpunësit civil në detyrat tjera. Edhe këtu ka njëfarë krijimi të kaosit, ku nëpunësi civil me pëlqim të tij apo të saj, mund të transferohet në detyra tjera me qëllim të dërgimit në detyra të veçanta në një organizatë ndërkombëtare, ndërmarrje publike e të tjerë. Unë frikohem se kjo do të krijojë një kaos, sepse ne po e dimë që nuk është atraktiv shërbimi civil për të punuar. Të gjithë ata që do të jenë përgjegjës për shërbimin civil, ata do t'i kenë duart e hapura dhe duart e lira dhe me ligj do të jenë në harmoni që të manipulojnë dhe të qojnë njerëzit e vet kurdo dëshirojnë sipas tekeve nëpër ndërmarrje publike, kështu që kjo po bien deri diku në kundërshtim me politikat korporative ose tendencat për t'i bërë korporatat ndërmarrje publike, ato çka i kemi në funksion sot.

Kështu që edhe këtë nën kisha për ta rishikuar, sugjeroj që të rishikohet më në detaje. Gjithashtu, kur kemi të bëjmë me nenin 31 – vlerësimi i rezultateve në punë. Në pikën 2, gjithsesi është vetëm koncentrimi, fokusi është deri te punëdhënësi, kurse punëmarrësi nuk është në fokus. Në trendet moderne, në trendet ku kërkohet të menduarit kritik, kreativ, punë efikase, efektive, sido që ta quajmë, bashkëveprimi i punëdhënësit me punëmarrësin është i pashmangshëm. Gjithashtu, edhe në metodat e vlerësimit të performancës nuk mund t'i izolosh, kështu që ne ashtu-kështu i kemi disa procedura për vlerësimin e performancës që janë ekzistente dhe në një formë po duken shumë më të avancuara ato atë vitit 2003, të avancuara në vlerësimin e performancës, se sa kjo çka tenton të përshkruaj neni 31 pika 2, sepse ka qasje diskriminuese ndaj punëmarrësit, është një lloj diskriminimi.

Për orarin e punës, 40 orë, kjo nuk e di sa është sot, se më duket që ka pasur një zhvendosje 37, kështu që mirë kishte të jemi konsekuent në atë drejtim.

Në përgjithësi, ligjin në parim kisha për ta përkrahur, por me ndryshimet edhe me...

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Rrustemi! Fjalën e ka zonja Tërmkolli, të bëhet gati zoti Naim Maloku.

MELIHATE TËRMKOLLI: Ju faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Mendoj se Ligji është vonuar së paku 1 vit, sepse ky ligj në shumë pika ka qenë i rregulluar dhe gati për t'u sjellë në Parlament, por kjo vonesë mendoj që është totalisht e pashpjegueshme nga ana e Ministrisë dhe nga ana e Qeverisë. Sido që të jetë, është mirë që është sjellë për shqyrtim në Parlamentin e Kosovës. Mendoj që problemi kryesor dhe i parë qëndron në përkufizimin e nocionit “shërbimi civil”. Çka është shërbimi civil dhe çka nuk hyn në shërbimin civil?

Ministria dhe Qeveria kanë bërë përpjekje me definuar pak a shumë se kush nuk bënë pjesë në shërbimin civil, por e kanë lënë shumë të paqartë atë se çfarë bën pjesë në shërbimin civil. Veç një shembull shumë thjeshtë po e marrë. Në Ligj thotë se punonjësit e sistemit arsimor janë në shërbimin civil. Ne e dimë se në sistemin arsimor punojnë edhe punonjës të administratës dhe a janë edhe ata pjesë e shërbimit civil apo janë jashtë shërbimit civil.

Kam përshtypjen se ligji është emërtuar Ligji për shërbimin civil, është menduar një ligj për Administratën Publike, ndërsa ka dalë një ligj për administratën shtetërore. Janë disa nga mekanizmat shumë të rëndësishëm që lidhen me shërbimin civil dhe të cilët nuk janë sqaruar dhe nuk janë definuar sa duhet në këtë ligj. Është fjala për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, i cili, siç dihet, tani punon me një rregullore të veçantë, është një këshill i pavarur që i përgjigjet Parlamentit të Kosovës, por në këtë ligj nuk është definuar, është lënë me dy-tri fjali pa e përcaktuar dhe definuar që ky është një mekanizëm i pavarur dhe që do të ketë një rregullativë të veçantë ligjore. Është fjala po ashtu për një institucion tjetër të rëndësishëm, Institutin e Kosovës për Administratë Publike, për të cilin po ashtu nuk është dhënë një sqarim të duhur se si do të duhej të rregullohej. Problemi kryesor dhe më i madhi, mendoj se qëndron tek KELP-i, Komisioni për Emërime të Larta Publike.

Gjatë periudhës së kaluar ky ka qenë një mekanizëm i cili ka bërë dëmet më të mëdha në shërbimin civil, sepse është menduar që është një mekanizëm profesional, ndërsa në fakt të gjithë ministrat janë fshehur pas saj dhe ka qenë një mekanizëm totalisht politik, do të thotë, përzgjedhjet janë bërë politike me një mekanizëm, pas të cilit janë fshehur gjëja se është një institucion profesional. Me këtë ligj tash, me këtë projektligj, në fakt, është bërë gabim edhe më i madh. Politizimi do të jetë shumëfish më i madh, sepse me këtë projektligj pretendohet që përzgjedhjen e niveleve më të larta në shërbimin civil, siç janë sekretarët permanent, siç janë kryeshefat ekzekutiv të agjencive, të bëhet nga një komision i cili është në kuadër të një ministrie dhe që do të ketë pasoja edhe më të mëdha.

Unë do t'i lutja shumë deputetët dhe ata që do ta punojnë, nëse vërtet mendohet, në bazë të një debati, që këto nivele të larta të jenë nivele të cilat i zgjedhin ministrat, të jenë nivele politike, pse kemi për t'u fshehur, le të bëhen hapur. Por, nëse mendojmë që vërtet duhet të jenë punonjës profesionalë, atëherë duhet të gjinden mekanizmat e plotë që kanë për të garantuar një profesionalizëm dhe një zgjedhje profesionale të këtyre niveleve të larta në shërbimin civil.

Gjatë gjithë ligjit, nëse keni mundur ta vëreni, shihni që përdoret termi: “më të mirë”, kush është ai që ka për të vlerësuar se kush janë më të mirët, më të mirët që kanë për t'u zgjedhur, më të mirët që kanë për t'u avancuar. Kush e përcakton atë se kush janë më të mirët, a ka rregulla dhe a ka rregullativë e cila duhet t'i përcaktojë këto, a ka kushte dhe parakushte mbi bazën e të cilave duhet bërë përcaktimi se kush janë më të mirët, apo në fakt, si ka mundësi që në ligj të përdoret termi “më të mirët”. Kjo lë hapësirën të madhe për voluntarizmin politik dhe gati për privatizim, ashtu siç është privatizuar gati edhe krejt Qeveria dhe krejt institucionet. Ajo çka është më esenciale, në këtë ligj mungon totalisht termi “profesionalizëm”. Merreni ligjin, hyni prej fillimit deri në fund, nuk keni për të gjetur askund që në administratë duhet të punojnë njerëzit profesionalë.

Unë mendoj se në këtë ligj po ashtu është dashur të sqarohen edhe disa çështje që mendoj se janë shumë të rëndësishme për punonjësit. Është dashur të sqarohen se cili do të jetë statusi i punonjësve në ndërmarrjet publike, duhet të rregullohet me një diçka. Nëse një punonjës i ndërmarrjeve publike, i ndërmarrjes publike ka një problem të caktuar dhe nuk e ka të rregulluar as me Ligjin e punës dhe as me këtë ligj, atëherë si do të rregullohet statusi i tij. Në rast se, po ashtu, siç është shumë e ditur, ka voluntarizëm edhe në largimin e tyre dhe në veçanti

voluntarizëm të madh në pranimin e tyre pa konkurse, pa kurrëgjë. Me qindra, me qindra e qindra njerëz që po punësohen pa asnjë konkurs. Nuk është sqaruar shumë kush do ta bëjë menaxhimin e personelit. Mendoj se nuk është paraparë, por që duhet të parashihet një provim shtetëror, sepse administratën e kemi të ndërtuar mbi baza politike dhe mbi baza sociale dhe kjo administratë nuk mund të jetë funksionale.

Me këtë ligj duhet ta shtrojmë edhe çështjen se a ofron ky ligj zgjidhje për një administratë e cila ka për ta bartur barrën e procesit të integriteteve evropiane. Sa do të mund të jetë e përgatitur administrata mbi bazën e këtij ligji që të bartë barrën e atyre proceseve për të cilët mendoj se administrata ka një rol jashtëzakonisht të madh dhe përgjigja është shumë negative.

Dhe një çështje, unë nuk e kam shumë të qartë, besoj asnjëri prej jush nuk e keni të qartë, pse ky ligj është tërhequr dy herë, një herë nga ministri dhe një herë nga Kryeministri. Do të kishte logjikë që tërheqja e ligjit të prodhonte një zgjidhje tjetër dhe një përmirësim të këtij ligji. Ju keni parë që janë dhënë vërejtje shumë esenciale nga Zyra ligjore e Kuvendit, të cilat e bëjnë këtë ligj me mangësi të atilla, të cilat është dashur të..., të cilat e bëjnë që ky ligj është dashur të ripunohet.

Mendoj se ky ligj më shumë ka krijuar një konfuzion dhe një kaos, se sa që ka ofruar zgjidhje të mirëfillta për shërbimin civil, ani pse është një nga ligjet bazike dhe një nga ligjet shumë të rëndësishme për funksionimin, jo veç të shërbimit civil dhe të Administratës publike, por edhe për funksionimin e shtetit në përgjithësi. Kam një pyetje për kryetarin e komisionit, i cili nuk është momentalisht këtu, por ishte kur u shtrua ky ligj, zotin Esat Brajshori, është kryetar i Komisionit për Administratë. Ai nuk e paraqiti qëndrimin e komisionit këtu dhe kisha për ta lutur publikisht që të deklarohet pse nuk e ka bërë një gjë të tillë dhe prej kujt po frikësohet kryetari i komisionit? Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka zoti Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Ky ligj dhe ligji që pason për pagat e nëpunësve civilë, janë dy ligje të mirëpritura në Kuvendin e Kosovës që fillojnë për ta rregulluar statusin e shërbyesve civilë në Republikën e Kosovës. Gjatë tërë këtij ligji, pra, shihet ku rregullohen çështjet e nëpunësve civilë. Ka qenë shumë i domosdoshëm që Ligji i punës të vijë dhe unë inkurajoj Qeverinë, Ministrinë që sa më parë ta sjell Ligjin e punës për shkak se janë disa dilema këtu që u shfaqën edhe nga parafolësit e mi për një numër të madh të atyre punonjësve të cilët nuk po përfshihen tani me këtë ligj dhe fati i tyre se çka do të bëhet me ta.

Më lejoni të përkufizohem në Administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, e cila që nga muaji prill i vitit 2007 funksionon në bazë të rregullave statusore për shërbyesit civilë të Administratës së Kuvendit, të miratuar nga Kryesia e Kuvendit, që kanë qenë këtu në pajtim me një urdhëresë administrative të PSSP-së, numër 2007/2, që ka pasur shmanjie nga këto rregullore lidhur me kushtet e punësimit. Kemi menduar se janë kushte specifike lidhur me punësimin në Administratën e Kuvendit, orarin e punës, i cili është specifik për Administratën e Kuvendit, kompensimin dhe kodin e sjelljes për stafin e shërbimit civil të Kuvendit.

Unë inkurajoj komisionin funksional që të shikojë edhe mundësinë e amendamentimit. Unë do të përpiqem me ju, zoti kryesues, që të hartojmë një amendament ose dy dhe të shikojmë edhe në debat me Zyrën ligjore të Ministrisë, por edhe me komisionin funksional se si të

rregullohet kjo çështje, pra, e Administratës së Kuvendit lidhur me këto specifika që i ka në punë Administrata e Kuvendit të Kosovës.

Edhe njëherë e përshëndes ardhjen e këtij projektligji në Kuvend dhe përkrah miratimin e tij. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Maloku! Fjalën e ka tani deputetja Hajzeraj.

RITA HAJZERAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Ligji për shërbyesit civilë është një ndër ligjet më të rëndësishme, unë mendoj, për vendin tonë dhe është vonuar pak ky projektligj. Unë e përkrah dhe e mbështes fuqishëm, duke pasur parasysh që janë disa gabime teknike po ashtu edhe përmbajtjesore, të cilat besoj që do të përmirësohen në punën e mëtutjeshme të komisioneve. Unë jam shumë dakord që punonjësit shëndetësorë, punonjësit arsimorë dhe policia të mos jenë nën ombrellën e shërbyesve civilë, sepse ata janë punonjës profesionalë dhe nuk kanë nevojë që të jenë në kuadër të administratës dhe ka qenë kërkesë e tyre e drejtpërdrejtë që të mos jenë në kuadrin e administratës. Andaj, një kategori e veçantë tjetër që mua më shqetëson, është në kuadër të shërbyesve arsimorë që është në institucionet parashkollore, të cilët vazhdimisht kanë bërë kërkesën, sidomos janë motrat që quhen nurse, të cilat vazhdimisht kanë qenë jo të kualifikuara si shërbyese profesionale, por gjithmonë kanë qenë të kualifikuara si shërbyese civile. Këtu askund nuk po e shoh se është përmendur një kategori e tillë, andaj kisha dashur ta shfrytëzoj rastin t'i bëjë pyetje edhe ministrit. Besoj që do ta jap një përgjigje më vonë kur të dalë që ta shpjegojë edhe një herë vendimin për projektligjin. Kisha dashur ta di një përgjigje se ku kanë mbetur këta shërbyes. Ata janë në proces edukativo-arsimor dhe të mbesin anash, sepse kemi parë se gjatë këtij viti, edhe nëse janë rritur pagat për shërbyes civilë, për shërbyesit administrativë dhe shërbyesit arsimorë, ata kanë mbetur të paprekur, do të thotë që nuk kanë marrë pjesë fare në këtë proces dhe janë në njëfarë forme të pa status.

Unë e kuptoj shumë mirë që edhe shërbyesit shëndetësorë, arsimorë, policët e Kosovës janë në njëfarë forme pa status sepse mungon Ligji i punës, andaj ne kërkojmë që Ligji i punës të vijë sa më shpejt në Parlament dhe të mos kemi kësi problemesh. Ndërsa, sa i përket kategorizimit të tyre, është shumë në rregull.

Dua të kaloj në çështjen e sekretarëve, të cilën përmendi edhe zonja më herët. Jam shumë dakord që këtu të bëhet një rikonfigurim ndoshta edhe i fjalive, se nuk është bash në atë esencën e duhur se si duhet të rregullohet kjo punë, sepse punonjësit, kategoritë e punonjësve publikë, të cilët janë sekretarët permanentë të ministrive gjegjëse, të jenë të rregulluara me një udhëzim administrativ pak më ndryshe dhe jo të përcaktohen me projektligj, ku ata nuk do t'iu nënshtrohen shërbyesve civilë, do të thotë që të jenë pak më të avancuar. Unë mendoj se ata duhet të jenë pjesë e shërbyesve civilë dhe të jenë në kuadër të këtij projektligji.

Unë mbështes Projektligjin dhe e përgëzoj ministrin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete Hajzeraj!

Zoti Hajredin Hyseni e ka fjalën. Le të përgatitet zoti Brajshori.

HAJREDIN HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë e ndjeva vetëm një obligim, pasi që jam anëtar i komisionit funksional dhe ishte mungesë e kryetarit të komisionit, Esat Brajshori, që të sqarojë se edhe Projektligjin për shërbyesit civil dhe Projektligjin për pagat ne i kemi shqyrtuar në Komision dhe të dy projektligjet kanë marrë miratimin e komisionit, ndërsa tani është prezentë edhe kryetari i Komisionit dhe mund të thotë fjalën e vet.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri Hyseni! Fjalën e ka zoti Brajshori.

ESAT BRAJSHORI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ia di për nder kryetares që është shumë e kujdesshme, anëtares së Komisionit.

Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media e ka shqyrtuar këtë projektligj, është votuar nga shumica e anëtarëve të Komisionit. Në këtë seancë, në leximin e parë, kryetari i komisionit nuk është obligues, obligataiv që të paraqet qëndrimin e komisionit kur ajo i shkon Kryesisë me shkresë, ashtu siç ju ka ardhur edhe juve. Nuk e kemi parë fare të arsyeshme ta përsërisim atë gjë që e keni të shkruar, të rekomanduar për Kryesinë e Kuvendit, që keni kërkuar njëkohësisht të procedohet për seancë plenare. Pra, Projektligji për shërbimin civil dhe Projektligji për pagat e shërbyesve civilë është trajtuar, është shqyrtuar në Komisionin për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media. Për çështjet tjera nuk lëshohem. Ju faleminderit, shume!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Brajshori! Tani fjalën e ka ministri Bajrami!

ARSIM BAJRAMI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në fillim të shpreh kënaqësinë për përkrahjen nga të gjitha grupet parlamentare dhe të shprehim gatishmërinë që të punojmë që këto ligje t'i bëjmë më të mira në leximin e dytë, sepse gjatë leximit të dytë këto ligje mund të përmirësohen për shkak që materia që e rregullon këtë ligj është një materie vërtetë specifike.

Unë dëshiroj vetëm tri-katër çështje. Nuk do të ndalem në disa çështje konkrete që i diskutoj tani sepse është mundësia me amendamente ato çështje të rinovojnë ligjin, por do t'ju siguroj se ne kemi punuar gjatë, kemi punuar nen për nen, kemi negociuar me institucionet ndërkombëtare të cilat i bëjnë këto reforma në krejt shtetet e Evropës Juglindore dhe në mënyrë të saktë e dimë se çka është tani shërbimi civil në kuptimin e këtij ligji dhe kemi përdorur dy metoda, metodën e enumeracionit pozitiv, duke i numëruar në mënyrë taksative se kush do të hyjë në shërbimin civil dhe me metodën enumeracionit negativ, duke i numëruar taksativisht se kush nuk trajtohet si shërbyes civil dhe e patë se nga shërbimi civil, i cili aktualisht ka 74.000 punëtorë, largohen sfera e arsimit, sfera e shëndetësisë, sfera e kulturës dhe të gjitha sferat e uniformuara: FSK-ja, zjarrfikësit dhe sferat tjera, por edhe në këto sfera kuptoni se administrata e këtyre sferave do të jetë pjesë e shërbimit civil. Kështu që nuk kemi lënë asnjë dilemë dhe kemi trajtuar në mënyrë shumë të kujdesshme çdo kategori. Dikush prej deputetëve e ceku pse edhe kategoritë teknike, siç janë: personeli i mirëmbajtjes së ndërtesave, pse janë larguar nga shërbyesit civilë. Ka qenë rekomandim i Fondit Monetar Ndërkombëtar. Këta janë punëtorë teknikë dhe nuk gëzojnë të drejtat e shërbyesve civilë, por i gëzojnë të drejtat e marrëdhënies së punës, e cila përcaktohet me marrëdhënien e punës.

Jashtë e shërbimit civil tani mbesin kategori të tëra, sepse ne po rregullojmë çështjen e 15.000 shërbyesve civilë, po ngelin edhe 60.000 të punësuar tjerë në sektorin publik dhe në kuptimin e këtij ligji pozita e tyre do të rregullohet një pjesë dërrmuese me Ligjin për marrëdhëniet e punës dhe pjesa tjetër me ligjet e veçanta, me ligje të veçanta të fushave të veçanta. Për shembull, në

sferën e arsimit do të mund të rregullohet me ligjet për arsimin e lartë, të mesëm dhe të lartë pozita e arsimtarëve dhe dëshiroj që edhe zonjën Hajzeraj ta siguroj se edhe në institucionet parashkollore, arsimtarët apo ato që japin mësim përfitojnë nga statusi i këtij ligji dhe nuk trajtohen shërbyes civilë.

Nuk do të ketë vakum ligjor, sepse ne paralel me këtë ligj, është e vërtetë se ky ligj është dashur të bëhet shumë më herët, por nuk është ligj i lehtë. Të gjitha qeveritë e kanë pasur në agjendë, por nuk kanë mund ta bëjnë sepse është ligj bukur i vështirë, ligj i cili do edhe përkrahje buxhetore. Paralel me këtë ligj ne kemi filluar të përgatisim 10 akte tjera nënligjore, të cilat do të inaugurohen bashkë me hyrjen në fuqi të ligjit. Po e zëmë, është punuar qysh tani Rregullorja për klasifikimin e shërbyesve civilë, Rregullorja për gradimin, Rregullorja për matjen e performancës së shërbyesve civilë, jemi duke punuar me shumë partnerë ndërkombëtarë, me partnerë që kanë implementuar këtë reformë në shumë vende të Evropës Juglindore dhe dëshirojmë që kur të startojë kjo reformë dhe reforma e sistemit të pagave, mos të lejojmë asgjë pa rregulluar dhe çdo gjë do të jetë e rregulluar. Nëse e keni parë, edhe në dispozita kalimtare ne kemi lënë një afat pak më të gjatë të hyrjes në fuqi të këtij ligji, në mënyrë që të sigurohemi që është siguruar edhe konstruksioni financiar për shkak se ky ligj është një ligj mjaft i kushtueshëm, të sigurohet edhe konstruksioni financiar, por edhe të përgatiten të gjitha aktet ligjore në mënyrë që reforma e shërbimit civil, reforma e sistemit të pagave që janë dy reforma të lidhura në mënyrë organike, të jetë e suksesshme, sepse nëse 10 vjet është tentuar për t'u sjellë, ka pasur arsye sepse kjo reformë nuk është e lehtë. Tani duhet të jemi të kujdesshëm që kjo reformë të ketë sukses edhe për shkak të obligimeve që kemi karshi fondit Monetar Ndërkombëtar, si anëtar i ri, i cili është i obliguar që t'i respektojë të gjitha parametrat sa i përket sistemit të pagave dhe sa i përket trajtimit të sektorit publik. Thjeshtë, ky ligj po krijon atë që ne e quajmë administratë të pastër publike. Nuk ka pasur pretendim të rregullojë pozitën e të punësuarve në ndërmarrje publike. Ata nuk janë shërbyes civilë, pozita e tyre do të rregullohet me Ligjin për marrëdhëniet e punës dhe me ligjet tjera. Intenca e këtij ligji është ta krijojë administratën e pastër publike dhe administratë e pastër publike është administrata lokale dhe administrata e nivelit republikan dhe të gjithë të punësuarit që punojnë për nevojat e këtyre dy administratave. Pjesa tjetër nuk trajtohet si shërbim civil dhe trajtohet me ligje të veçanta për shkak se specifikat e marrëdhënies së punës të një profesorit, të një mjekut, të një artistit apo të një ushtari apo të një polici është e veçantë dhe trajtimi duhet të jetë i veçantë, qoftë sa u përket të drejtave dhe detyrimeve nga marrëdhëniet e punës, qoftë sa i përket sistemit të pagave. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Tani Kuvendi do të deklarohet me votim për miratimin në parim të këtij projektligji.

Në sallë janë 63 deputetë, që do të thotë se kemi kuorum. Prandaj, lus regjinë dhe ju, deputetë të nderuar, të bëheni gati. Votojmë tash:

Atëherë, konstatojmë se me 60 vota “për”, 1 abstenim dhe asnjë “kundër”, miratohet në parim ky projektligj. Ju faleminderit shumë!

Dhe, në bazë të Rregullores së Punës, tani Kuvendi i ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, si komision funksional,
- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisionin për Buxhet e Financa,
- Komisionin për Komunitete, dhe

- Komisionin për Integritet Evropian.

Këto komisione duhet që brenda 2 muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime. Ju faleminderit shumë!

Shkojmë te pika tjetër e rendit të ditës, që është:

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pagat e nëpunësve civilë**

Në bazë të Rregullës 35 pika 1 të Rregullores së Punës janë përmbushur tashmë kushtet për shqyrtimin dhe miratimin në parim të këtij projektligji.

Së këndejmi, ftoj ministrin e Administratës Publike, zotin Arsim Bajrami që para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin. Urdhëroni, ministër!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

I nderuari zëvendëskryeministër,

Kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që tani të prezantoj Ligjin e dytë organik që është i lidhur me këtë reformën e sektorit publik – Ligjin për pagat e nëpunësve civilë dhe të theksoj se ky ligj është organikisht i lidhur me ligjin të cilin e votuam në mënyrë paraprake, sepse pretendon të rregullojë pagat e shërbyesve civilë.

Menjëherë dëshiroj t'ju njoftoj që Qeveria e Kosovës reformën e sistemit të pagave është duke e bërë me dy ligje organike, njërin që sot po e diskutojmë dhe tjetrin që do të miratohet së shpejti, pra Ligjin për pagat e të emëruarve politikë, funksionarëve politikë, ku përfshihen pagat e njerëzve të emëruar që nga paga e presidentit deri te pagat e niveleve më të ulëta, nivelet e kryetarëve të komunave. Ai ligj është dorëzuar në Qeveri dhe së shpejti Qeveria do ta përcjellë në Kuvend. Dëshira jonë ka qenë që t'i biem njëkohësisht, por për shkak të nevojës së negociimeve me faktorët ndërkombëtarë, ne sot po e prezantojmë Ligjin për shërbimin civil dhe jam i sigurt se brenda kësaj legjislature do ta debatojmë dhe do ta miratojmë edhe Ligjin për pagat e të emëruarve politikë, në mënyrë që kjo materie e pagave të rregullohet tani me ligjet shtetërore, të jetë kjo një reformë shtetërore dhe të tejkalojmë këtë situatën e pakënaqshme të sistemit të pagave, sepse aktualisht kemi një sistem jo të rregulluar të pagave, nuk po e quaj një sistem kaotik të pagave, por kemi një sistem ku nuk ka autoritete shtetërore që merren me sistemin e pagave, nuk ka politika shtetërore dhe këto ligje po krijojnë politika shtetërore të sistemit të pagave që është shumë e rëndësishme për seriozitetin e një shteti dhe për disiplinimin e funksionimit të administratës.

Ligji për pagat e nëpunësve civilë nisët nga definicioni i shërbyesve civilë dhe rregullon vetëm pagat e shërbyesve civilë duke marrë parasysh ndarjen e tyre në grada të caktuara dhe duke u bazuar në sistemin e ndarjes në katër grada kryesore, në gradën e shërbyesve civilë të nivelit të lartë drejtues, ku hyjnë disa kategori, filluar nga sekretari permanent, drejtorët në nivelin lokal dhe qendror, pastaj shërbyesit civilë të nivelit drejtues, shërbyes civilë të nivelit ekzekutiv dhe shërbyes civilë të nivelit administrativ. Brenda këtyre gradave, pra, katër grada, kemi koeficientë që përcaktohen sipas nomenklaturës së koeficienteve, krijohet një hierarki shtetërore e pagave dhe krijohet në bazë të përgjegjësisë dhe të përsëkrimit të vendeve të punës, në bazë të performancës që u bëhet shërbyesve civilë dhe në bazë të avancimeve permanente që Ligji për shërbimin civil stimulon. Thjeshtë, ky ligj pretendon që të promovojë politika shtetërore për sistemin e pagave dhe të përcaktojë pagën bazë dhe pagën shtesë. Paga bazë, siç e dini, është një

pagë që duhet të përcaktohet edhe me proceset e negocimit me sindikatat, është një pagë që bëhet edhe me paktin tripalësh, kurse pagat shtesë janë koeficientët që rregullohen dhe tani implementohen bashkë me pagën bazë. Ne në Ministrinë e Administratës Publike kemi kryer reformën e sistemit të pagave dhe ai sistem ka filluar të funksionojë. Sot çdo pagë dhe çdo shtesë merret vetëm me pagën bazë, nuk ka më pagesa nga thesari dhe me fillimin e zbatimit të këtij ligji çdo nëpunës civil në fund të muajit do ta ketë pagën dhe do t'i ketë të ardhurat shtesë të cilat dihen sipas të cilave burimeve. Relacioni midis pagës bazë dhe pagës shtesë do të jetë një relacion normal, do të caktohen koeficientë të caktuar në mënyrë që të eliminohen pagesat e dyfishta, pagesat e kontrolluara që vazhdimisht e kanë ngarkuar buxhetin e shtetit.

Ky ligj, në fakt, pretendon që të vendosë këtë sistem të pagave, nuk e ka pretendim rritjen e pagave, sepse rritjen e pagave do ta caktojë Qeveria për çdo vit buxhetor. Domethënë, vlera e koeficientit të pagës të çdo shërbyesi civil caktohet çdo vit buxhetor varësisht nga mundësitë buxhetore të Qeverisë për t'i ngritur pagat.

Ideja jonë ka qenë që me këtë ligj të vendosim parametrat e qëndrueshëm, koeficientët e qëndrueshëm dhe logjik të pagave, në mënyrë që t'i mundësojmë çdo shërbyesi civil që të stimulohet të avancojë në pozitën e shërbimit civil, duke u avancuar në shërbimin civil të përfitojë koeficient më të lartë të pagave.

Gjithashtu, kemi pasur parasysh që të respektojmë pak edhe hierarkinë në mënyrë që t'i eliminojmë disbalancet apo disproporcionet e mëdha të pagave, midis pagës më të ulët dhe pagës më të lartë, kemi përcaktuar në mënyrë taksative se çka konsiderohet pagë shtesë, mbi të cilat burime mund të merret paga shtesë për të eliminuar pagesat që nuk janë mbi bazën e një page, por mbi bazën e një pune ad-hoc që bëhet në institucionet tjera qeveritare.

Ky ligj është një ligj që ka një kosto financiare dhe kosto financiare e këtij ligji do të prodhohet dy vit pas hyrjes në fuqi, sepse në dy vitet e para nuk do të ketë lëvizje të shërbyesve civilë nga grada e parë në gradë të dytë apo të tretë, sepse për dy vite do të krijojmë mekanizmin e matjes së mirë të performancës, në mënyrë që ky sistem të jetë një sistem konsistent dhe i qëndrueshëm. Nuk do të lejojmë që në shërbimin civil të ketë lëvizje paushall apo lëvizje të pamërituar nga një koeficient në koeficientin tjetër. Duhet të ndërtojmë mekanizma stabilë, objektivë dhe efikasë që bëjnë evaluimin e shërbyesve civilë dhe që bëjnë avancimin e tij nga një pozitë në pozitën tjetër.

Të nderuar deputetë,

Duke ju ftuar që ta përkrahni këtë ligj dhe duke ju ftuar që në procesin e amendamentimit të punojmë së bashku, të punojmë me gjithë faktorët dhe ta amendantojmë këtë ligj në kuptim të mbulimit të ndonjë vakumi, unë jam i sigurt se miratimi i këtij ligji dhe të Ligjit për shërbimin civil do të mundësojë që ne të fillojmë të zbatojmë një reformë shumë të rëndësishme në sektorin publik, e cila reformë do të na çojë vërtet drejt krijimit të një administrate efikase, profesionale publike, që është parakusht për funksionimin e një shteti të ri, siç është Republika e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Pas paraqitjes së zotëri ministrit që i bëri Projektligjit, hap debatin për diskutim në parim. Kryetarët ose raportuesit e komisioneve nuk janë paraqitur ose në qoftë se e kam gabim, le të reagojnë tani, që do të thotë të rekomandojnë.

Atëherë, vazhdojmë me grupet parlamentare. Për Partinë Demokratike të Kosovës, është e vërtetë se zoti Hyseni do ta marrë fjalën. Po, zoti Hajredin Hyseni!

HAJREDIN HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti zëvendëskryeministër,

Ministra të pranishëm,

Të nderuar deputetë,

Përshëndes sjelljen në Kuvend të këtij projektligji, i cili rregullon një fushë të rëndësishme të nëpunësve civilë, e që janë pagat. Me këtë projektligj bëhet përcaktimi i sistemit dhe i strukturës së pagave, të shtesave dhe të kompensimeve të tjera të nëpunësve civilë, rregullativë kjo e cila deri më tani ka krijuar mjaft paqartësi në definimin e nivelit të pagës për sektorin e administratës publike.

Kjo fushë, pra, rregullimi i sektorit të pagave, e cila aktualisht është e mbuluar me Udhëzimin administrativ 2004/1, paraqet një hendikep mjaft serioz pa miratimin e këtij projektligji. Andaj, rëndësia e këtij projektligji qëndron në faktin se mbulon një fushë të rëndësishme dhe në këtë ligj ka ndryshime cilësore, pra për nëpunësit civilë. Me këtë projektligj, përpos pagës rregullohen edhe shtesat dhe kompensimet tjera për punën jashtë orarit të rregullt, siç janë fundjavët dhe festat, prandaj Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, duke parë rëndësinë e këtij projektligji, e mbështet në parim.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Për Lidhjen Demokratike të Kosovës, zoti Armend Zemaj!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke marrë parasysh rëndësinë që ka ky projektligj, Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar me një përkushtim të veçantë në bashkëpunim edhe me ekzekutivin, si dhe me ekspertë të kësaj lëmie. Mbulimi i kësaj fushe me ligj bazik për paga të shërbyesve civilë rezulton i drejtë si në aspektin politik dhe në atë ekonomik që të kemi administratë efikase sipas standardeve ndërkombëtare. Projektligji adreson çështjet për rregullimin e pagave, të shtesave dhe të kompensimeve të tjera për shërbimin civil, duke filluar edhe në bazë të gradave. Kjo nënkupton rregullim sa më të mirë, sidomos ku me të drejtë bëhet mbrojtja e të drejtave të shërbyesve civilë për kompensim të drejtë për punën dhe angazhimin e tyre. Kushtet, shumat dhe metoda për llogaritjen që nga paga bazë, shtesat si dhe kompensimet e pagesat tjera tregon se do të kemi avancim dhe efekt pozitiv si për të punësuarit, ashtu edhe për institucionet tona.

Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah në parim dhe shpreh përkushtimin se anëtarët tanë në komisionin funksional do të japin kontributin maksimal për plotësimin e të gjitha vërejtjeve dhe sugjerimeve të domosdoshme që mund të inkorporohen në këtë projektligj. Ju faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Zemaj! Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e konsideron të domosdoshëm procesimin dhe aprovimin e Ligjit për pagat e nëpunësve civilë dhe konsideron se tërheqja e tij nga procedura e miratimit para 4-5 muajve nuk ka pasur asnjë arsye dhe për ne është shumë e paqartë pse ka ndodhur kjo meqenëse ligji që ka ardhur sot nuk ka pësuar asnjë ndryshim në krahasim me versionin që ka qenë në rend dite para 5 muajsh. Po ashtu, insistojmë që ky ligj të plotësohet dhe plotëson boshllëkun ligjor, por është dashur që të përcillet edhe me ligjet ose aktet

tjera që rregullojnë pagat e kategorive tjera, siç e tha edhe ministri në prezantim, sepse ky është një rregullim parcial i çështjes së pagesave, pra vetëm për nëpunësit civilë.

Edhe pse e mbështesim në parim, konsiderojmë se ky version i Projektligjit për pagat e nëpunësve civilë ka disa zbrazësi dhe paqartësi të cilat domosdoshmërisht duhet të eliminohen në periudhën ndërmjet dy leximeve. Së pari, hyrja në fuqi e këtij ligji, siç thuhet në disa nga dispozitat, fillon të aplikohet pas miratimit të këtij ligji dhe në buxhetin e parë, ligjin e parë të buxhetit vjetor që aprovohet në Kuvend pas miratimit të këtij ligji, që do të thotë se në qoftë se ky ligj vonohet edhe një muaj, nuk ka mundësi të implementohet në vitin 2010 sepse Ligji për buxhetin, parametrat e të cilit është dashtë të përcaktohen nga Qeveria dhe brenda 2 ditësh duhet të vijë në Kuvend, pra janë parametra që nuk bazohen në këtë ligj sepse ky ligj nuk është i aprovuar dhe nuk mund të implementohet deri në fillim të vitit 2011.

Është shumë vështirë të tentohet të harmonizohen parametrat e buxhetit me kërkesat e këtij ligji për një periudhë të shkurtër kohore që na ka mbetur deri në fund të këtij viti.

Tjetër, vlerësimi i ndikimit buxhetor nga ana e Ministrisë së Financave na lë mjaft dilema. Edhe vetë në Ministrinë e Financave te vlerësuesi ka pasur dilema që shkruan në raportin e vlerësimit buxhetor. Në rastin më të mirë, sipas vlerësimit të MEF-it kostoja minimale për këta 14.700 shërbyes civilë, kostoja shtesë do të jetë 8.719.000 euro, vetëm për pagën bazë. Kjo kosto do të jetë për një vit, por ne e dimë që është edhe një pjesë e pagesës – kompensimet dhe shtesat që nuk kanë hyrë në vlerësimin e koston shtesë dhe ajo është pjesa më e diskutueshme dhe më problematike të cilën ne frikohemi se nuk do të ketë mundësi që të kontrollohet me rastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe kostoja mund të jetë edhe e papërballueshme.

Edhe pse sipas vlerësimit paga bazë do të shtohet për çdo shërbyes civilë 50 euro në muaj ose e shprehur në numra relativë i bie 22%, ne e mbështesim këtë mënyrë të lëvizjes, në qoftë se qeveria e vlerëson se do të ketë mundësi për të përballuar koston kur i shtohet edhe pjesa e koston së shtesave dhe të kompensimeve tjera.

Pra, mbetet që Qeveria të nxjerrë akte normative sipas këtij ligji, me të cilat rregullohet edhe pjesa e kompensimeve dhe shtesave. Ne kemi rezervë në këtë pjesë, sepse kjo është një pjesë mjaft e madhe e pagesave të buxhetit dhe mendojmë që kjo nuk duhet të mbetet në kompetencë të Qeverisë. Pra, këto akte normative ose kjo pjesë e Ligjit duhet të silltet në Kuvend, sepse mund të silltet në 30 deri 40% të pagesave për kompensime për pagesa për shërbyesit civilë dhe është pjesë që mbetet dhe mund të jetë shumë subjektive nga ana e Qeverisë. Pra, duhet me ligj të rregullohet ose të gjendet forma që këto akte nënligjore të vinë në Kuvend, sepse janë pjesë shumë e madhe dhe nuk mund të bëhen në bazë të vullnetit të dikujt i cili nuk e ka këtë kompetencë në bazë të ligjit. Prandaj është një dilemë që na e ngrehim si më themelore në miratimin e këtij ligji.

Dhe, në fund, shfrytëzimi i këtij ligji për pagat dhe kompensimet nga kategoritë tjera të papërfshira në këtë ligj do të ketë një implikim buxhetor që jo 8 milionë, por nuk besoj se do të mbulohet me 30 milionë euro, duke u nisur nga përvoja që kam në lëvizje në listat e pagave për 80.000 ose 78.000 persona që marrin paga, buxheti i Kosovës do të jetë shumë vështirë t'i mbulojë dhe t'i lë në kuadër të kornizës së buxhetit dhe të mundësive për shpenzimet buxhetore. Ju falënderoj dhe jemi të gatshëm që të japim kontributin tonë në përgatitjen finale të këtij ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Shatri!

Për Aleancën Kosova e Re, zoti Esat Brajshori.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti kryesues!

Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i AKR-së ka qenë kritik për kaosin e krijuar në sistemin e pagave, sidomos në garën që krijojnë ndërmjet të emëruarve politikë se kush po e rritë pagën më shumë se tjetri, pa menduar shumë për kategoritë tjera të cilat vërtet kishin nevojë. Ky projektligj rregullon këtë sferë me rëndësi deri diku, por kemi drojën se do ta çrregullojë tërë sistemin e të punësuarve, sepse krijon mundësi që të fryhen pozitat e larta ku do të siguroheshin paga më të mira dhe kështu ne do të kemi mbi gjysmën e të punësuarve me pozita të larta menaxheriale dhe shumë pak ekspertë.

Një dyshim të madh për zbatimin e këtij projektligji e kemi edhe në drejtim të mungesës së një data-baze të saktë, ku do të ishin të përshkruar të gjitha vendet e punës me titujt dhe detyrat, sepse ju e dini se ne sot kemi një laramani të madhe në këtë drejtim. Jo e njëjta pozitë paguhet njësoj në shërbimin civil dhe kjo për pasojë ka menaxhimin e keq të parasë publike dhe krijim të mosbarazisë përpara ligjit.

Kostoja financiare e këtij projektligji do të jetë shumë e lartë dhe vështirë e zbatueshme në praktikë, sepse nuk janë bërë parapërgatitjet që ky projektligji të zbatohet në tërësi.

Me gjithë këto rezerva të mëdha të Aleancës Kosova e Re, ne e mbështesim në parim dhe do të angazhohemi që në punën e mëtutjeshme në komisionet funksionale të japim kontributin tonë. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Brajshori!

Për Lidhjen Demokratike të Dardanisë, zonja Synavere Rysha.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë nuk i ka dhënë mbështetjen e vet Projektligjit për pagat e shërbyesve civilë për shkak se ka pasur vërejtje të shumta edhe në komisionin funksional, kur kjo është trajtuar diku para 6 muajsh, diku në muajin maj e kemi trajtuar këtë projektligj dhe kemi parë se ka vërejtje të mëdha, prandaj e kemi parë të arsyeshme që ky projektligj t'i kthehet Qeverisë, mirëpo kjo nuk ka ndodhur, edhe për 6 muaj i njëjti projektligj na ka ardhur në Kuvend dhe detyrohem të vijmë te kjo situatë, ta votojmë apo mos ta votojmë.

Unë do të mundohem shkurtimisht t'i paraqes vërejtjet tona si Grup Parlamentar që i kemi pasur rreth Projektligjit për pagat e shërbyesve civilë. Projektligji nuk përcakton qartë se kush dhe si përcaktohen pagat e shërbyesve civilë. Nëse pagat përcaktohen nga Qeveria apo i përcakton projektligji në fjalë. Në projektligji nuk kategorizohen në mënyrë të detajizuar nëpunësit civilë dhe nuk përcakton shkallën e udhëheqëse dhe profesionale të tyre. Projektligji parasheh mundësinë e largimit të nëpunësve civilë nga shërbimi civil me dy vlerësime negative vjetore, por nuk përcakton asnjë parametër matës dhe procedurë për dhënien e atij vlerësimi. Kjo ndoshta edhe mund të jetë subjektive. Sido që të jetë, këto janë disa nga vërejtjet që ne në fakt nuk e kemi mbështetur këtë projektligj, por duke pasur parasysh se kjo do të shkojë ndoshta edhe një periudhë shumë e gjatë dhe projektligji nuk do të ndryshojë nga Qeveria, ne si Lidhje Demokratike e Dardanisë së fundi kemi vlerësuar se është e nevojshme dhe e domosdoshme që në parim në këtë fazë ta përkrahim këtë projektligj dhe kontributin tonë ta japim në komisionin funksional, ndoshta me vërejtje më të mëdha kësaj radhe, që Qeveria të ketë parasysh se kemi edhe numër të madh të ligjeve që presin të votohen dhe shteti i Kosovës ka nevojë për ligje, ne në parim jemi si Lidhje Demokratike e Dardanisë që të vëmë një kornizë ligjore dhe të

funksionojmë si shtet e mandej brenda kësaj të hapim mundësinë apo të krijojmë mundësinë për të hyrë brenda ligjit. Në parim, e mbështesim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zonja Rysha!
Për Grupin “7+”, zonja Shpresa Murati.

ŠPRESA MURATI: Hvala, predsedavajući!

Nacrt zakona o platama civilnih službenika uredjuje prava civilnih službenika za pravednu i urednu platu, prava na nadoknade i dodatke, klasifikaciju pozicije civilnih službenika i utvrđuje vrednost koeficijenta na osnovu pozicije i ocenjivanja rada.

Nacrt zakona ima izvesnih nedostataka, recimo ne utvrđuje minimalnu ni maksimalnu platu, kao ni proporcijalni odnos izmedju njih. Takodje ne utvrđuje tačno ni koje se vreme rada smatra noćnim radom. Pojedine zakonske odredbe, recimo član 2, 5, 16. su odredbe koje su nejasne i treba ih preformulisati, a većinu članova jezički i terminološki urediti.

Ovaj nacrt zakona treba da reguliše status svih zaposlenih koji primaju plate iz budžeta Kosova. Ipak, Parlamentarna grupa „7+“ podržaće ovaj nacrt zakona u načelu i daće svoj doprinos u njegovoj daljoj proceduri i eliminisanju propusta koje smo naveli. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Murati!

Shkojmë tani me SLS. Nuk është paraqitur askush, prandaj po shkojmë menjëherë me listën e deputetëve të paraqitur tashmë dhe i pari është zoti Emrush Xhemajli.

xx

EMRUSH XHEMAJLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ju përshëndes të gjithëve!

Partia Socialiste e mbështet ardhjen në shqyrtim të Ligjit për pagat e nëpunësve civilë dhe e them qysh në fillim se do ta përkrah dhe votoj, në parim.

I kemi disa vërejtje konkrete. Te memorandumit shpjegues, pika 8, është bërë një lëshim dhe do të ishte mirë mos të... Kanë qenë të tepërta fjalitë... A prek Projektligji në kompetencat e rezervuara? Projektligji nuk bie ndesh me kompetencat e rezervuara të PSSP-së, thuhet aty. E tash, merre me mend, domethënë sa kohë ka kaluar dhe ende askush në administratë nuk i këqyrë këto fjali, të thotë pse këto s’duhet të hiqen. Një.

E dyta, është lajm i mirë përpjekja për rritjen e kualitetit të punës në administratë, ajo që është përshkruar në Projektligj, në nenin 19. Me shtesat në pagë që parashihet për kushtet e tregut, rregullohet një çështje që shpresojmë se forcon administratën tonë. I dimë të gjithë ikjet e kuadrove nga administrata, nga shërbimi civil, nga institucionet dhe ministritë dhe shkuarja gjithkrah kah ka pasur paga më të mira. Për më tepër, në disa raste kanë shkuar huq edhe trajnimet e kushtueshme për aftësimin e këtyre kuadrove.

Rreth nenit 23. Shumë mirë e përcakton punën gjatë festave zyrtare, por për mendimin tim nuk është llogaritur mirë kostoja e shpenzimeve buxhetore, aty ku është specifikacioni për të.

Gjithashtu, më lejoni të them se unë qysh tash pajtohem me vërejtjet që kam dëgjuar se i ka bërë Sindikata e shërbyesve civilë në nenin 6, 8, 11 dhe 14 lidhur me këtë projektligj. I di saktë cilat janë ato vërejtje, por ata më mirë do ta argumentojnë vetë gjatë dëgjimit publik këtë, që besoj se nuk do të anashkalohen sepse kanë ankesa që po anashkalohen gjatë bërjes së ligjeve dhe trajtimit të tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Xhemajli!

Në radhë është zoti Naim Rrustemi, ose mos ka mbetur nga hera e kaluar ndonjë...?

NAIM RRUSTEMI: Gjithçka e përzier, zoti kryesues! Faleminderit, kryesues!

Unë do të jem shumë i shkurt. Kisha për t'i sugjeruar të gjithë ata që bëjnë pjesë në grupet punuese të cilët përgatisin ligjin për leximin e dytë që të jenë më të saktë në vlerësimin e ndikimit buxhetor dhe saktësisht të na vijjnë me shifra të sakta se sa është ky ndikim në buxhetin e Kosovës. Ne të gjithë e dimë se Qeveria e Kosovës ka konkurruar në Konferencën e Donatorëve me një kornizë afatmesme të shpenzimeve, kështu që mirë është të jemi në harmoni me korniza afatmesme të shpenzimeve dhe mos të bëhen tejkalime të shumta që të jenë bazë për kritika më pastaj në raporte të progresit e tutje, sepse unë mendoj që ky ligj mund të sjell efekte anësore, posaçërisht në buxhetin e Kosovës. Por, si do që të jetë, shërbyesit civilë ka kohë që kanë kërkuar një tretman më të mirë, që e kanë merituar një tretman më të mirë edhe nga këndvështrimi i pagesës për punën që e bëjnë.

Do ta bëj një vërejtje në nenin 7, më duket... Neni 11 i këtij ligji, pika 4, në të cilin përcaktohet se si mund të bëhet avancimi në pozitën e shërbyesit civil. Kjo pikë nuk e rregullon mirë sistemin e menaxhimit, e bën pak sa të kufizuar dhe rigid jo shumë të... jo në gjendje që të jetë adapt me zhvillimet e kohës, sepse në njëfarë forme e bën shtypjen e punës ekipore. Vetë vetëvendosja e numrit dhe të përqindjeve se sa mund të konsiderohen si të shkëlqyeshëm dhe shumë të mirë, bën që kjo të jetë njëfarë mase kuantitative, ndoshta, dhe jo masë e vlerësimit të cilësisë së kryerjes së punëve. Kjo ma përforcon bindjen... ma përforcon bindjen sepse edhe shkruarit e këtij ligji e kanë pasur pak sa të vështirë që të vendosin pragje, se sa mund të vlerësohen si të shkëlqyeshëm, shumë të mirë, sepse në këtë nen thuhet se deri 5% të nëpunësve civilë mund të vlerësohen si të shkëlqyeshëm për çdo vit dhe më pastaj ceket jo më shumë se 15% të nëpunësve civilë në një institucion mund të vlerësohen si shumë të mirë në cilindo vit, duke vazhduar jo më shumë se 30%, me fjalinë e njëjtë me 15%-shin dhe 30%-shin. Unë plotësisht e kuptoj se është vështirë të caktohet se sa mund të jenë, të vlerësohen të mirë, shumë të mirë, të shkëlqyeshëm, por nuk e kisha përkrah të vendoset me shifra të sakta, sepse mund të ndodhin raste ku bëhet punë ekipore dhe i tërë ekipi mund të vlerësohet si i shkëlqyeshëm dhe kjo automatikisht paraqet pengesë në vlerësimin e punës së tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Rrustemi! Radhën e ka zonja Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa za datu reč. Ja sam pažljivo slušala sve kolege oko izlaganja ova dva jako važna zakona kada su u pitanju Zakon o civilnim službenicima i Zakon o platama civilnih službenika. Kada je reč o zakonu, ovde o samom zakonu o platama za civilne službenike, hoću da dam do znanja i da bude jedan moj prilog danas da po prvi put imamo pred sobom zakon sa kojim je potrebno da se odredi nivelizacija i sistematizacija radnih mesta. Mogu da kažem u jednoj oblasti kao što je civilna služba, da to treba da bude početak za sve ostale bazične zakone, Zakon o radu, Zakon o platama javnih preduzeća i Zakon o zdravstvu i o svim oblastima koje stoje pred nama za rešavanje.

Ovaj zakon mogu da kažem da je jako prazan, da nije definisao prava merila, pokušalo se samo da se zadovolje potrebe, da tako kažem, prema MMF koji nam daje do znanja i koji nam daje domaći zadatak da više prepoznamo ovo šta je rad i radni odnos u svim sverama. Ali kažem iz jednog razloga da sa ovim zakonom nije data prava mera opisa i popisa posla i vrednovanja, kvalifikacija. Zna se da je kvalifikacija na osnovu školske spreme, da je kvalifikacija na osnovu obuke i postavlja se jako veliki prazan prostor za manipulisanje gde se kaže - najbolji, najvredniji, odličan... To dolazi sa samim poslom, a prilikom zapošljavanja i prilikom konkurisanja mora da postoje vrednosne kategorije, zakonske kategorije sa kojima može svako

da stupi na jedno radno mesto. Znači kategorizacija i potreba kvalifikacije. Zakon je u ovoj suštini jako prazan. Mi znamo da na tržištu i na terenu imamo velike anomalije, evo da damo primer, živi primer, u policiji imamo ljude sa fakultetom, da su policajci a ljudi sa osnovnom školom, sa školom fillore su njihovi komandiri. Molim vas, mi moramo jednom zauvek da definišemo zakone, da ih postavimo tako kako treba, jer neće u okruženju niko da nas primi sa ovakvim haosom. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Emrush! Kah ora 13:00, një grup i madh deputetësh ka një takim tjetër, kështu që ne do të merrnim pauzë, mirëpo kemi edhe dy... Për fat të keq, ministri duhet në orën 14:00, pastaj pas pauzës të vijë ta japë arsytimin. I kemi edhe dy diskutues në listë. Unë ju kisha lutur që në qoftë se është e mundshme, të jemi goxha të shkurtër, por pa humb nga përmbajtja e asaj që doni ta thoni, në mënyrë që ta ndërpresim dhe ta kemi pauzën deri në orën 14:00 për shkak se nja 18 deputetë kanë një obligim tjetër dhe këta janë zonja Syla dhe zotëri Smaka. A mund ta kemi miratimin tuaj dhe mirëkuptimin më shumë se deri në orën 14:00 do t'i mbaroni fjalimet. Faleminderit! Urdhëroni, zonja Syla!

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues! Me gjithë respektin, zoti kryesues, unë mendoj që Kuvendi duhet t'i përshtatet agjendës së ministrit. Megjithatë, unë do të përpiqem të jem kolegjiale ndaj deputetëve.

Lidhur me Projektligjin për pagat e nëpunësve civilë konsideroj se Projektligji për pagat e nëpunësve civilë e thekson edhe më shumë nevojën e rregullimit ligjor të statusit të të gjithë të punësuarve që marrin paga nga buxheti i Kosovës. Prandaj, si Projektligji për shërbimin civil, edhe ky duhet të jetë pjesë e pakos së projektligjeve që rregullojnë çështjen e statusit të të punësuarve. Deri më tash çështja e pagave të nëpunësve civilë është rregulluar me akte nënligjore, siç ish Udhëzuesi për sistemin e pagave dhe të gradimit dhe Udhëzimi administrativ i Ministrisë së Shërbimeve Publike për caktimin e nivelit të gradave në shërbimin civil. Momentalisht ekzistojnë akte të ndryshme ligjore që rregullojnë pagat e punonjësve të KEK-ut, të PTK-së, të shëndetësisë, të arsimit e tjerë. Prandaj, projektligji për pagat e nëpunësve civilë synon t'i rregullojë vetëm pagat për punonjësit në administratën shtetërore. Sipas Projektligjit, të cilin po e shqyrtojmë sot, paga e nëpunësve civilë përbëhet nga paga bazë dhe nga shtesat mbi pagën bazë. Me qëllim të përcaktimit të pagës bazë, pozitat në shërbimin civil ndahen në katër kategori funksionale dhe klasifikohen në njërin nga 14 gradat e pagës. Edhe pse janë caktuar pozitat në kuadër të kategorive funksionale dhe grada e pagës, faktori kryesor i cili paraqet edhe esencën e ligjit, që është vlera e koeficientit, e me këtë edhe paga, ngelin të papërcaktuara me ligj, sepse Qeveria e Kosovës mendon se duhet nxjerrë akte nënligjore për caktimin e koeficienteve. Çështja e klasifikimit të gradave të pagës përcaktohet me akt nënligjor që duhet të nxirret nga Qeveria, ndërsa në fund të çdo viti kalendarik nëpunësit civilë do të avancohen në bazë të vlerësimit të tyre pozitiv. Gjithashtu, puna e nëpunësve civilë kompensohet për punën jashtë orarit, për punën në kushte të jashtëzakonshme me rrezik për shëndetin, si dhe do të kenë shtesa nëpunësit civilë për kushtet e tregut. Shtesat për kushtet e tregut konsideroj se janë të rëndësishme sepse nënkuptojnë shtesa në paga për ata punonjës, puna e të cilëve paguhet më mirë në sektorin privat se në atë publik. Kjo bëhet me qëllim që kuadrot e tilla profesionale të mund të mbahen në punë. Avancimi në hapa në bazë të vlerësimit të punës fillon pas 2 viteve të hyrjes në fuqi të këtij ligji, kurse vetë ligji hyn në fuqi në datën e zbatimit të buxhetit të ardhshëm vjetor. Sipas përlllogaritjes së pagave, del se paga më e ulët në shërbimin civil është 143.22 euro. Zoti ministër, konsideroj se Qeveria duhet të jetë transparente në mënyrën e përlllogaritjes së pagës së nëpunësve civilë. Për 15.000 shërbyes civilë parashihet që të ketë kosto shtesë buxhetore me sistemin e ri të pagave dhe atë në shumën prej më shumë se 8 milionëve apo për 3 vite - më shumë se 26 milionë. Po ashtu, parashihet edhe kosto shtesë buxhetore gjatë zbatimit të akteve nënligjore. Meqenëse Projektligji përcakton pagën vetëm për nëpunësit civilë

dhe nuk rregullon pagat e të punësuarve tjerë, për të cilin konsideroj se Qeveria duhet urgjentisht ta kryejë këtë punë, ky projektligj mund të ndikojë edhe në projektligjet tjera që rregullojnë pagesat e të punësuarve tjerë. Po ashtu, kjo kosto buxhetore nuk është e parashikuar në Kornizën afatmesme të shpenzimeve, që ngrit shqetësimin tim për sfidat të cilat do t'i hasë ky ligj në zbatimin e tij. Megjithatë, me rëndësinë që ka ky ligj, në parim e përkrah. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Sylja! Vetëm t'ju sqaroj se nuk ish puna e ministrit që po ndërpritet puna e Kuvendit, ta kemi të qartë. Unë vetëm ju luta për mirëkuptim që mbrojtjen e këtyre vërejtjeve ta bëj në orën 14:00, kur ne do të kthehemi këtu. Zoti Smaka!

RIZA SMAKA: Zoti kryesues,

Duke e suportuar me sinqeritet këtë dokument, në parim disa vërejtje mendoj kështu që do të kishin qenë relevante në punën tonë vijuese. Do të isha angazhuar që të përcaktohen bazat dhe kriteret e objektivizuara, paraprakisht të definohen qartë në bazë të të cilave do të bëhej rangimi adekuat. Kjo një. Do të thotë, duke inkluduar kualifikimet medoemos, vëllimin, natyrën e karakterit të punëve, përgjegjësinë në punë dhe kushtet në punë se mund të jetë që me kualifikime të njëjta, punë të njëjta ama kushtet e punës të ndryshme dhe in meritum kush do të punonte me kushte më pak të volitshme do të duhej të kompensohej. Do të isha angazhuar që neni 21 paragrafi 1.3 të rishikohej me qëllim të harmonizimit me 23-shin dhe përfundimisht vlerësoj se do të duhej t'i përfshijmë disa dispozita ndëshkimore në funksion të zbatimit të këtij ligji dhe do të kisha shfrytëzuar këtë oportunitet që t'i adresohem zotëriut ministrit Bajrami që të meditojmë se çfarë të bëjmë me, sipas konsideratës sime, nëpunësit civilë, se ata do të duhej të ishin nëpunës civilë në organizatat, agjencitë, siç kanë pozitë të privilegjuar në treg, shkurt posta, bie fjala ose trusti i pensioneve, që janë jashtëzakonisht ekstra enormisht të privilegjuar jo në bazë të punës, të dijës, të rezultateve në punë, por të statusit të palogjikshëm të privilegjuar. Mendoj kjo çështje meriton një trajtim tepër serioz ndoshta, nëse jo me këtë ligj, atëherë me një dokument tjetër paralelisht sa më parë që është e mundur ta bëjmë, ta diskutojmë, ta miratojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zoti Smaka! Nuk kemi kuorum për ta kryer krejt para orës 13:00, nuk kemi kuorum. Vetëm ta verifikojmë një herë në mënyrë që... do të ishte shumë mirë ta kryejmë krejt rendin e ditës. A i mëshojmë ziles pak? Kishe regjia po dëgjon, se sa për ne pajtohemi sa të duash. Regjia, zilja! Ministër, a keni ju diçka në fjalën tuaj përmbyllëse... Shumë bukur, atëherë veç po e presim kuorumin dhe po e votojmë dhe pastaj marrim pauzën.

(Ndërprerje e shkurtër)

Tani kemi në sallë 62 deputetë të pranishëm, prandaj po shkojmë në votim. Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Dhe, rezultatet e votimit janë 63 “për”, 1 abstenon, asnjë “kundër”, kështu që është miratuar, në parim, Projektligji për pagat e nëpunësve civilë.

Në bazë të Rregullores së Punës, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, si komision funksional,
2. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
3. Komisionin për Buxhet dhe Financa,
4. Komisionin për Komunitete, dhe
5. Komisionin për Integritet Evropian.

Komisionet e dinë që brenda 2 muajve nga ky shqyrtim, Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime. Ju faleminderit!

Deri në orën 14:00 kemi pauzë.

Vazhdimi i seancës pas pauze

Drejtimin e seancës e merr Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë, në sallë janë 51 deputetë, andaj mund të fillojmë debatin.

Pika e pestë e rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Mërgatën e Kosovës**

Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj zëvendëskryeministrin, zotin Hajredin Kuçi, që para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Më lejoni që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës të prezantoj para jush Projektligjin për Mërgatën e Kosovës.

Kompletimi i infrastrukturës në fushën e legjislacionit është një nevojë e Qeverisë dhe besoj edhe tërësi e kompleksit të drejtësisë në Kosovë, kërkon që të bëhet përmbushja e detyrimeve kushtetuese dhe planeve të rregullimit të materies juridike edhe në fushën e ruajtjes së identitetit dhe zhvillimit të kulturës së mërgimtarëve tonë që jetojnë jashtë Republikës së Kosovës.

Projektligji në fjalë paraqet angazhimin direkt të Qeverisë për një plotësim të këtij detyrimi institucional përballë qytetarëve tonë që jetojnë jashtë vendit.

Qëllimi i këtij projektligji është ruajtja dhe zhvillimi i identitetit, i gjuhës, kulturës dhe mundësimi i rritjes së bashkëpunimit shumëpalësh veçanërisht në fushat kulturore, arsimore, shkencore, ekonomike, si dhe në fusha të tjera. Gjithashtu, ka për qëllim themelimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mërgatën të Republikës së Kosovës dhe qendrat kulturore të Kosovës që do të themelohen jashtë vendit. Me këtë projektligj për herë të parë në Kosovë do të rregullohen në detaje çështjet që kanë të bëjnë me Mërgatën e Kosovës. Projektligji për Mërgatën është përgatitur nga Zyra Juridike e Zyrës së Kryeministrit, e koordinuar edhe me mendimet e të tjerëve që janë të interesuar për këtë projektligj dhe është harmonizuar edhe me ligje të kërkuara nga Bashkësia Evropiane dhe standardet tjera të përcaktuara sipas acquis communautaire.

Më lejoni që në fund të theksoj se rëndësia e këtij ligji është gjithsesi për të gjithë qytetarët tonë që jetojnë jashtë vendit tonë dhe kërkoj nga ju, deputetë të nderuar, që të jepni kontributin për përmirësimin dhe plotësimin e këtij ligji dhe për miratimin e tij në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Diskutimet janë në parim. Vazhdojmë sipas grupeve parlamentare. Kryetari i Komisionit a e do fjalën? Jo. Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Rini, Sport, deputeti Agim Veliu.

AGIM VELIU: Faleminderit, Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport në shqyrtimin paraprak ka vlerësuar se ky projektligj është i domosdoshëm kur kihet parasysh përbindja e banorëve të Republikës së Kosovës që jetojnë përkohësisht në botën e jashtme.

Gjatë diskutimit në Komision janë përmendur edhe të metat e këtij projektligji, që herë-herë prekin edhe çështje përmbajtjesore, siç janë: koncentrimi i Agjencisë së Mërgatës së Kosovës, agjenci të cilën e themelon ky projektligj në Zyrën e Kryeministrit, defininimi i statusit mërgatë-diasporë, kostoja financiare dhe rreziku i paralelizmave me ambasadat e Republikës së Kosovës.

Komisioni me shumicë votash përkrah miratimin, në parim, të Projektligjit për Mërgatën dhe në shqyrtimin e mëtejshëm do të bëjë amendamentimin e këtij projektligji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, shumë deputet!

Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, fjalën e ka kërkuar deputetja Drita Kadriu.

DRITA KADRIU: Faleminderit, Kryetar!

Përshëndetje për ministrat dhe zëvendëskryeministrin!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Ligjin për Mërgatën e Kosovës dhe e ka analizuar. Ky ligj rregullon fushën e veprimtimit të ruajtjes së identitetit dhe të zhvillimit të kulturës së qytetarëve të Republikës së Kosovës të cilët jetojnë dhe veprojnë në mërgim. Qëllimi i këtij ligji është ruajtja dhe zhvillimi i identitetit, të gjuhës, të kulturës, si dhe ruajtja dhe zhvillimi i bashkëpunimit ekonomik dhe në fusha tjera.

Projektligji është përmbajtësor dhe i strukturuar në 17 nene, të cilat rregullojnë si organizimin e Agjencisë së Mërgatës së Kosovës, me ç'rast Zyra për Çështje Jorrezidente shndërrohet në Agjenci për Mërgatën, me shpresë se një ditë do të kemi edhe ministri, e cila do të merret me çështje të mërgatës. Gjithashtu rregullon themelimin e qendrave kulturore për Kosovën në mërgatë që fillimisht janë dy qendra gjithsej, me shpresë që këto të jenë edhe më shumë për t'i përbushur nevojat e mërgatës. Ligji gjithashtu rregullon përkrahjen e mësimt dhe të avancimit të gjuhëve zyrtare të Kosovës në mërgatë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës miraton, përkrah ligjin dhe jep mbështetje, si dhe do të ndihmojë në të gjitha organizimet që do t'i bëjë komisioni funksional për ta shqyrtuar dhe amendamentuar ligjin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, fjalën e ka kërkuar deputetja Fatmire Berisha.

FATMIRE BERISHA: Faleminderit, i nderuar Kryetar i Kuvendit!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Ministra,

Deputetë të nderuar,

Grupi Parlamentar i LDK-ës e ka shqyrtuar me kujdes Projektligjin për Mërgatën e Kosovës dhe i vlerëson përpjekjet për rregullimin e kësaj fushe të rëndësishme me infrastrukturë ligjore. Me këtë projektligj adresohet funksionalizimi dhe themelimi i qendrave kulturore të Kosovës për

mërgatën dhe i Agjencisë për Mërgatën e Kosovës, po ka edhe disa paqartësi rreth implikimeve buxhetore të këtij projektligji. Ne, si Grup parlamentar i LDK-së, në këtë fazë të shqyrtimit të këtij projektligji e mbështesim, në parim, Projektligjin për Mërgatën, ndërsa në shqyrtimin e tij të mëtejme do të kontribuojmë si grup parlamentar në komisione gjegjëse. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, kush e do fjalën? Deputetja Gjylnaze Syla, e ka fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Ndërtimi i shtetit të Kosovës patjetër kërkon edhe krijimin e lidhjeve institucionale me mërgatën. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës edhe në mandatin e kaluar pati iniciuar çështjen e krijimit të lidhjeve institucionale me mërgatën përmes Rezolutës për organizimin e diasporës dhe bashkëpunimin me institucionet e Kosovës. Një ndër pikat e Rezolutës ka qenë hartimi i Ligjit për diasporën dhe ne sot i gëzohemi që përpara e kemi këtë ligj, sidomos duke marrë parasysh kontributin e jashtëzakonshëm që Mërgata e Kosovës ka dhënë për mbrojtjen e interesave të përgjithshme të Kosovës. Është me rëndësi që Projektligji të mbrojë edhe interesat e mërgatës. Mendoj që esenca e Projektligjit duhet të jetë mbrojtja e mërgatës dhe përfaqësimi i interesave të mërgatës.

Megjithatë, pjesa më e madhe e Projektligjit për nga përmbajtja është më shumë e fokusuar në lidhjet kulturore, arsimore dhe sportive. Është vetëm një nen i cili flet për lidhjet ekonomike, ndërsa sa i përket ndërtimit të partneritetit në mes mërgatës dhe institucioneve, janë paraparë dy mekanizma, një është Agjencioni ekzekutiv në Kryeministri dhe tjetra është Qendra Kulturore e Kosovës për Mërgatën.

Sipas Projektligjit, parashihet që në të vërtetë Zyra e cila ka kryer funksionin e bashkëpunimit me mërgatën, Zyra për Çështje Jorezidente, tani të shndërrohet në agjencion ekzekutiv, i cili udhëhiqet nga drejtori. Por, sa i përket ndërtimit, funksionimit të qendrës kulturore, që gjithashtu udhëhiqet nga drejtori që zgjedhet nga Kryeministri, mendoj se duhet një zgjedhje tjetër, konsideroj se drejtori duhet të zgjedhet nga diaspora me qenë se ai duhet të përfaqësojë interesat e diasporës.

Edhe pse me legjislacionin evropian nuk rregullohet kjo fushë, meqenëse është lënë në kompetencë të shteteve të veçanta, përmes komunikatave të komisionit për këshill, Parlament Evropian dhe institucionet e tjera, theksohet rëndësia e mërgatës në dërgimin e mjeteve financiare në shtetin e origjinës, prandaj konsiderohet se mërgata është një aktor i rëndësishëm në zhvillimin e vendeve të origjinës dhe kjo duhet marrë parasysh në Projektligj.

Sa i përket ndikimit buxhetor, parashihet buxhet shtesë prej 500.000 deri në 1.110.000 për dy vite 2010 – 2011.

Në parim, Grupi Parlamentar i Aleancës e mbështet Projektligjin për mërgatën. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së kush e do fjalën? Deputeti Heset Cakolli e ka fjalën.

HESET CAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për Mërgatën e Kosovës është shumë i nevojshëm, sepse krijon një kornizë ligjore të domosdoshme për të ndikuar në ruajtjen e identitetit kulturor, gjuhësor dhe arsimor të pjesëtarëve

të mërgatës dhe krijon lidhje të përhershme dhe të qëndrueshme me institucionet e Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Siç dihet, mërgata jonë për shumë dekada ka ndihmuar popullin e Kosovës, andaj edhe institucionet e shtetit më të ri në botë duhet të përkujdesen dhe të ndihmojnë pjesëtarët e mërgatës nga të gjitha format e mundshme. Ky projektligj është i hartuar vetëm me 17 nene dhe këto nene nuk i sqarojnë shumë çështje me rëndësi. Për shembull, neni 6 pika 1.1. ku thuhet “Agjencia e Mërgatës zbaton dhe monitoron dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij”. Shtrohet pyetja, sa do të jetë numri i atyre akteve nënligjore kur kemi parasysh numrin e neneve kaq të vogël të këtij projektligji. Do të thotë, me akte nënligjore mbeten shumë punë për t’u rregulluar dhe nuk di si do të ketë mundësi të rregullohen të gjitha ato çështje.

Ky Projektligj ka edhe implikime buxhetore dhe këtë çështje e rregullon neni 11, ndërsa pika 1.1 nuk e sqaron sipas mendimit tonë sa duhet mënyrën e financimit të mërgatës, respektivisht të Agjencionit të Mërgatës.

Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re i jep mbështetje këtij projektligji sepse ne mendojmë se në fazat vijuese kur do të shqyrtohet projektligji mund të ndryshohet dhe të plotësohet në nene të caktuara me qëllim që të përmbushim synimin kryesor të tij. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të LDD-së, deputeti Mark Krasniqi e ka fjalën.

MARK KRASNIQI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Grupi Parlamentar i LDD-së e ka shqyrtuar këtë ligj dhe e përshëndet këtë iniciativë që ta ketë edhe mërgata vendin në legjislacionin tonë, por ne në diskutim e sipër kemi ardhur në konkludim se duhet të bëhen disa ndryshime në këtë ligj. Unë po i lexoj disa vërejtje që janë dhënë atje.

Projektligji për Mërgatën e Kosovës, të cilin po e shqyrtojmë, sot ka rëndësi të madhe dhe është i mirëseardhur, sepse mërgata jonë ka bërë shumë për Kosovën si nga aspekti material, ashtu edhe nga ai politik. Tash Kosova si shtet i pavarur duhet të kujdeset më shumë për mërgimtarët që i kemi në botën e jashtme. Ata kanë nevojë para se gjithash që të përkrahen për ruajtjen e identitetit të tyre kulturor e kombëtar, përveç nevojave të tjera të ndryshme. Megjithatë, dihet se procesi i asimilimit me kohë e bë të vetën.

Projektligji për Mërgatën e Kosovës përcakton themelimin e Agjencisë ekzekutive pranë Kryeministrit, kurse qendrat kulturore formohen në botën e jashtme, të cilat duhet të financohen nga buxheti i Kosovës. Mendojmë se ky projektligj është hartuar mirë për një shtet me standard të lartë ekonomik dhe politik. Mjerisht, Kosova në këtë fazë të zhvillimit të saj ekonomik dhe të konsolidimit politik nuk i ka këto mundësi. Prandaj, mendojmë se tash për tash duhet ta kemi një organizim më modest në këtë drejtim, i cili mund të jetë më i përshtatshëm për diasporën dhe më i lehtë nga ana financiare dhe organizative. Konkretisht, mendojmë se detyra e organizimit dhe e zbatimit të ndihmës mërgimtarëve tanë duhet të jetë në kompetencën e ambasadave dhe të konsullatave të Republikës së Kosovës e jo të asnjë ministrie tjetër në Kosovë. Kështu, mërgimtarët do të jenë në kontakt të përhershëm me këto institucione të rëndësishme shtetërore. Ministria është shumë larg dhe çdo punë e saj në këtë drejtim do të jetë më e vështirë dhe më e komplikuar. Ambasada ose konsullata do të kryente çdo punë të tillë shumë më shpejt e shumë më lehtë, madje edhe me më pak mjete financiare. Përveç kësaj, me themelimin e Agjencisë

ekzekutive në Kosovë dhe të qendrave të kulturës në diasporë do të krijohet, mund të krijohet njëfarë institucioni paralel në Kosovë. Shumë të shtrenjta do të jenë këto institucione dhe të komplikuar. Kështu, për shembull, me këtë projektligj parashihet rroga e sekretarit të Agjencisë ekzekutive të Mërgatës në nivelin e rrogës së sekretarit të ambasadës, neni 10. Por, edhe qendrat kulturore në diasporë do të kenë implikime përkatëse financiare e kështu me radhë.

Në nenin 11, thuhet se “mjetet për veprimtarinë e qendrave kosovare të kulturës për mërgatën sigurohen nga buxheti i Kosovës, nga donacionet dhe nga anëtarësimi”. Askund tjetër nuk përmendet anëtarësimi në këto qendra. Nëse duhet të ketë anëtarë qendra, atëherë duhet të shpjegohet, të paktën me një nen të posaçëm, kush mund të jetë anëtar, obligimet dhe të drejtat e anëtarësisë. Qendra të tilla duhet të ketë shumë, për shembull, në disa shtete siç është Gjermania, Franca, Italia dhe disa tjera, sepse e kanë hapësirën gjeografike shumë të madhe. Mendojmë se nuk ka shtet në Evropë pa mërgimtarë të Kosovës. Nuk është numër i vogël i tyre as në Amerikë dhe Australi. Qendra kulturore duhet të ketë në çdo shtet, madje diku edhe disa brenda një shteti. Ambasada ka mundësi të shoh situatën, rrethanat dhe nevojat e ndryshme të mërgimtarëve më mirë e më lehtë atje në vend se ne nga Kosova. Përveç kësaj, mendojmë se në nenin 3 të Projektligjit për mërgimtarët tanë duhet të thuhet qartë dhe haptas se ata janë shtetas të Republikës së Kosovës me status – punëtorë të përkohshëm në botën e jashtme, ku janë me qëndrim të përkohshëm ose të përhershëm. Shteti kujdeset për shtetasit e vet e jo për ata që kanë “prejardhje familjare nga Republika e Kosovës”, siç thuhet në projektligj. Lidhja sa më e ngushtë e mërgimtarëve tanë me ambasada e konsullata të Republikës së Kosovës do të jetë shumë e rëndësishme jo vetëm për ruajtjen e identitetit të tyre kulturor e kombëtar e tjera, por edhe me rastin e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë, i cili duhet të bëhet sa më parë. Mërgata kosovare mund të kontribuojë edhe në angazhimin e investitorëve për ndërtimin e objekteve dhe për punën ekonomike në Kosovë.

Grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë përkrah në parim këtë projektligj dhe do të japë kontributin e mëtejshëm të vetin në diskutimet tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit parlamentar” 7+” Enis Kervan e ka fjalën.

ENIS KERVAN: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar “7+” e ka shqyrtuar dhe e ka analizuar këtë projektligj. Në parim e mbështesim këtë projektligj, por natyrisht jemi të mendimit se duhet të bëhen disa ndryshime. Për shembull, janë do nene me të vërtetë kur flitet për gjuhët zyrtare të Kosovës, por është neni kur flet për identitetin, për gjuhën dhe identitetin kosovar, jo identitetin kombëtar, nuk flet për komunitetet, i cili është ai identitet kosovar e tjerë, e tjerë. Për shembull, është neni 13, ku flet për promovimin e trashëgimisë kulturore të Kosovës kurse brenda përmbajtja e tekstit të këtij neni nuk flet, do të thotë, për promovimin e tjera, e tjera. Prandaj kontributin do ta japim nëpër komisione. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së? Nuk ka. Atëherë, vazhdojmë me diskutimet e deputetëve. Fjalën e ka deputeti Emrush Xhemajli.

EMRUSH XHEMAJLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje të gjithëve!

Unë me vëmendje e kam lexuar Ligjin për mërgimtarët. Mendoj se ky ligj nuk përfshin gjithë materien që përbën një ligj që do të përfshinte të gjitha çështjet që duhet trajtuar në Ligjin për Mërgatën. Është vetëm një kategori e qytetarëve, është vetëm një anë e kësaj çështjeje dhe mendoj se definitivisht këtij ligji duhet t’i ndërrohet emri. Bile në ekspozenë e vet

zëvendëskryeministri gati se e nxori atë esencën e këtij ligji që mund ta mbante fare lehtë edhe titullin ky ligj – Ligji për identitet dhe kulturë për qytetarët e Republikës së Kosovës jashtë vendit, kjo po. Përndryshe, ky nuk është ligj për mërgatën. Për ta ilustruar këtë çka po them, jam një person që kam jetuar 14,5 vjet jashtë vendit dhe jam i ambientuar me këtë. Domethënë, në radhë të parë nuk janë përfshirë kategoritë e caktuara të qytetarëve të shtetit tonë që gjenden jashtë vendit në rrethana të caktuara dhe që kanë mbetur atje ose që kanë shkuar më vonë.

Elemente me rëndësi në këtë ligj do të ishin që në te të përfshihen të gjitha kategoritë e shqiptarëve që kanë kontribuar në forma të ndryshme në diasporë, që të kenë lehtësira dhe favore të merituara këtu në Kosovë.

E dyta, kategoria e të arratisurve politikë që për një arsye a për një tjetër nuk iu kanë krijuar kurrfarë kushtesh as lehtësirash për kthimin në Kosovë dhe nuk e kanë asnjë status momentalisht të qartë. Kategoria e atyre që mund të dëshmojnë jo me fjalë, por që mund të dëshmojnë se kanë dhënë kontributet e tyre në fondet e Republikës së Kosovës – fondin “Vendlindja thërret” ose në fondin e Republikës së Kosovës, me të cilat është mbajtur arsimi dhe është mbajtur shëndetësia këtu. Pastaj, strukturat e veprimtarëve të Kosovës jashtë që kanë punuar për pavarësinë e vendit, si dhe veprimtarë të klubeve dhe shoqërive shqiptare nga koha e pavarësimit të tyre nga klubet jugosllave e këndeje. Këtu mund të numërohen edhe kategori më të specifikuar që konstatohen nga ata që do ta precizojnë me një ligj për mërgatën, por kjo kështu qysh është, ky nuk është fare ligj për mërgatën. Së paku, nuk është fare ajo që Mërgata e Kosovës, kategoritë që janë atje që presin prej shtetit të tyre që ta rregullojë çështjet e tyre të parregulluara dhe të cilat janë të grumbulluara. Këtu duhet të përfshihen edhe të gjitha favorët që do të gëzonin të gjithë qytetarët e Kosovës që dëshirojnë të angazhohen në projekte dhe kapitalin e tyre për Kosovën. E them këtë, sepse mërgimtari që vjen të investojë në Kosovë e ka vështirë të vjen deri te fillimi i punës dhe kontrata e favorshme në kohën kur për investitorë të jashtëm dimë shumë mirë se shpesh arrijnë të bëjnë kontrata që lexohen dhe nënshkruhen shkel e shko nga zyrtarët e shtetit.

Duhet të them se edhe kështu qysh është, ky ligj nuk e ka një pjesë shumë të rëndësishme. E ka vetëm pjesën për ruajtjen e identitetit dhe të kulturës së qytetarëve të Kosovës jashtë vendit. Nuk e ka pjesën e integritetit të tyre që duhet të jetë edhe ajo e përfshirë, edhe shteti i Kosovës duhet të japë kontributin e tyre për integritet në vendet ku janë, nuk mund ajo të jetë njëanshëm vetëm detyrë e vendit ku janë, por duhet kjo të bëhet në bashkëpunim dhe në ligj duhet të përshkruhet forma se integriteti nuk do me thënë as asimilim as humbje e identitetit, as e kulturës, por përfshirja në jetën e shtetit ku jetojnë, si qytetarë normal që zhvillojnë talentin e tyre në ambient të caktuar, kështu që po them, ky ligj absolutisht nuk mund të quhet ligj për mërgatën. Ky është ligj thjeshtë për ruajtjen e identitetit dhe kulturën e qytetarëve të Republikës së Kosovës jashtë vendit. Kaq. Dhe, ju lutem, këtë ta marrim në konsideratë. Ne mund ta aprovojmë në parim për t’ia ndërrua emrin, por nëse nuk pranohet t’i ndërrohet emri, unë jam kategorik kundër, edhe në emër të Partisë që e përfaqësoj, na kemi njëfarë strukture edhe jashtë vendit – Partisë Socialiste të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ligjet miratohen me shumicën e votave. Fjalën e ka deputetja Mimoza Ahmetaj.

EMRUSH XHEMAJLI: Po, kuptohet ajo! Secili e ka votën e vet.

MIMOZA AHMETAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari zoti zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra dhe deputetë,

Shtetet e ndryshme çështjen e mërgimtarëve e kanë rregulluar qoftë me themelimin e ministrive përkatëse, të cilat përfaqësojnë mërgatën, qoftë me përfaqësimin e mërgimtarëve me numër të caktuar të deputetëve në parlamentet adekuate, me çka përfaqësojnë interesat në formën më të mirë të mërgimtarëve në vend.

E përshëndes ardhjen e këtij ligji edhe për faktin se Kosova vetëm në historinë e re supozohet të ketë mbi 500.000 shtetas të saj të cilët jetojnë jashtë, si dhe për faktin dhe kontributin e madh që mërgimtarët tanë në vazhdimësi e kanë dhënë për shtetin e Kosovës. Llogaritet që diku rreth 15% e të hyrave vjetore të buxhetit të Kosovës vijnë nga kontributet që mërgimtarët tanë i bëjnë për vendin. Po ashtu, edhe për faktin e themelimit dhe hapjes së qendrave kulturore, gjë që do t'i kontribuonte pa masë ruajtjes së identitetit kulturor të shtetasve tanë që jetojnë jashtë, prandaj në parim e përkrah këtë ligj dhe shpresoj se numri i qendrave të tilla kulturore në vazhdimësi do të shkojë duke u rritur, duke marrë parasysh se brenda një shteti ne kemi në shumë qytete të koncentruar popullatën tonë që jeton jashtë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Sanije Aliaj.

SANIJE ALIAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pengesat në realizimin e të drejtës për krijimin e identitetit shtetëror dhe nevoja për punë rezultoi me largimin e numrit të madh të qytetarëve të Kosovës për në shtetet e Perëndimit, të cilët për vite të tëra u vetorganizuan dhe me punën e tyre ndihmuan Kosovën në rrugën e saj drejt rrugëtimit për pavarësi. Duke e ditur se kjo fushë nuk është e rregulluar me ligj, Projektligji që ne sot po e shqyrtojmë synon organizimin e mërgatës me shtetet e ndryshme, kudo që ata jetojnë.

Projektligji ka për qëllim organizimin dhe ruajtjen e identitetit gjuhësor, kulturor dhe arsimor duke e ndërlidhur organizimin e mërgatës me institucionet e Kosovës.

Me këtë projektligj rregullohen përgjegjësitë dhe kompetencat e Agjencisë së Mërgatës, e cila nën udhëheqjen e kryeshefit të Agjencisë synon të zbatojë politikat për promovimin e vlerave të mërgatës, koordinon punën me qendrat kulturore të mërgatës, rregullon bashkëpunimin në mes institucioneve dhe shoqërisë civile për përmirësimin e pozitës së mërgatës. Nevoja për organizimin e pozitës së mërgatës është shumë e domosdoshme, po do të them se ky projektligj më tepër i ngjason një rregulloreje të punës së Agjencisë së Mërgatës, sepse përcakton përgjegjësitë dhe kompetencat e Agjencisë dhe të mërgatës me qendrat kulturore të Kosovës. Agjencia përmes planeve dhe programeve ndër të tjera mbështetin dhe organizojnë të rinjtë dhe grupmoshat e ndryshme të mërgimtarëve në veprimtarinë arsimore, kulturore dhe sportive. Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Agjencisë së Mërgatës dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë e Kulturës për realizimin e procesit mësimor do të bashkërenditë dhe koordinojë punët me vendet e rajonit me interesa të përbashkëta duke bërë shpërndarjen e librave shkollorë për mësimin dhe avancimin e gjuhëve zyrtare, duke shpërndarë libra letrarë, shkencorë dhe ato të trashëgimisë kulturore dhe duke organizuar seminare trajnuese për mësimdhënësit. Në nenin 9 të Projektligjit përcaktohen përgjegjësitë e qendrave kulturore për Kosovën, ku ndër të tjera Qeveria e Kosovës me plane kulturore nxit investimet kapitale në vendlindje. Por, çka i duhet nenit 9, pika 1.8, po e citoj: “Qendrat kulturore të Kosovës për mërgatën kryejnë detyrat tjera të përcaktuara nga Kryeministri” kur dihet që mekanizmi për zbatimin e këtij projektligji është Agjencia e Mërgatës e udhëhequr nga kryeshefi ekzekutiv i Agjencisë së Mërgatës, i cili në bashkëpunim i bashkërendit veprimet me Qendrën Kulturore të Kosovës për funksionalizimin e mërgatës. Ky paragraf mund të mbetet në kuadër të projektligjit

vetëm nëse definohej cilat janë detyrat të cilat duhet t'i zbatojë Qendra Kulturore e Mërgatës, sepse për ndryshe do të vihej në pikëpyetje demokracia për funksionalizimin e mërgatës.

Projektligji do të ishte mirë të emërtohet – Projektligji për Agjencinë e Mërgatës së Republikës së Kosovës, sepse projektligji definon vetëm përgjegjësitë dhe kompetencat e kësaj agjencie, e cila i bashkërendit veprimet për rregullimin e identitetit kulturor dhe arsimor të Mërgatës së Kosovës.

Edhe pse Projektligji definon se për zbatimin e këtij projektligji hartohen edhe akte nënligjore dhe brenda një viti pas hyrjes në fuqi të këtij projektligji hartohet dhe miratohet Planin strategjik për Mërgatën, nga Agjencia e Mërgatës janë skeptikë për problemet e mëdha të mërgatës që do të rregullohen me një projektligj që ka vetëm 17 nene, kur dihet se mbi 1/4 e popullsisë së Kosovës jetojnë jashtë Kosovës. Mërgata ka nevojë për trajtim të mirëfilltë ligjor.

Propozoj që të formohet Ministria e Mërgatës, e cila me kompetencë do të zbatonte Ligjin dhe Planin strategjik që pritet të hartohet dhe të miratohet, sepse një agjenci me një staf shumë të kufizuar të punëtorëve mbetet vetëm një dëshirë që të zgjidhen problemet e mërgatës dhe të rregullohen veprimtaria e tyre me ligj.

Projektligjin e përkrah në parim vetëm si nismë për organizimin dhe funksionimin e mërgatës, sepse ajo pjesë e popullsisë sonë problemet i zgjidhë vetëm përmes Ministrisë së Mërgatës. Propozoj që në procedim të mëtutjeshëm të këtij projektligji komisioni funksional të organizojë debate publike me ekspertë, në mënyrë që ligji kur të vjen për miratim në leximin e dytë, të jetë vërtet një ligj funksional për rregullimin e jetës së asaj pjese të popullsisë që jeton jashtë vendit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit për diskutimin! Kisha kërkuar që vërtet ta keni parasysh buxhetin e Kosovës. Fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zotëri Kryetar!

Duke iu bashkëngjitur shqetësimeve të kolegëve dhe duke pasur parasysh që rreth ose mbi ¼ e popullit të Kosovës është në mërgatë, nuk e besoj dhe nuk e mendoj se duke krijuar agjencion mund të zgjidhen një mori problemesh që kanë sot mërgimtarët tanë. Në rrethana normale dhe në rrethana të zakonshme Kosova do të duhej t'i kushtojë rëndësi të veçantë mërgatës duke themeluar, duke krijuar Ministrinë për Mërgatën, e cila do të ndërmerre të gjitha veprimet në mënyrë që t'u dalë në përkrahje dhe në nevoja mërgimtarëve tanë. Këtë duhet lidhur edhe me një çështje që ky draftligj për të cilin po diskutojmë dhe, nëse e shikoni nenin 8, 9 dhe 10 – krijimi i qendrave jashtë vendit, shihni se si zgjidhet drejtori. Këtu ka tendenca që të gjithëka të koncentrohet në fuqinë e një vendimmarrësi, sepse në vend që pra drejtorët e këtyre kryeqendrave të zgjidhen nga ana e agjencionit, udhëheqësit e këtyre qendrave zgjidhen nga një komision i caktuar nga Kryeministri i Kosovës, çka do të thotë se të gjitha përpjekjet janë dhe të gjitha këto ligje të cilat po i ndërtojmë, po e vendosin fuqinë vendimmarrëse vetëm në një person. Uroj që në komisione të ketë një përpunim më të mirë të këtij draftligji, por nuk e besoj në asnjë rast që përmbush kërkesat dhe nevojat që i ka mërgata. Sikurse e dini, në vazhdimësi mërgata ka kërkuar që të krijohet Ministria e Mërgatës dhe po ashtu që të parashihen edhe vendet e rezervuara për mërgatën në Kuvendin e Kosovës. Kam parasysh që këto i rregullojnë edhe ligjet e tjera, por gjithsesi përderisa kemi ¼ e popullit jashtë vendit, do të duhej që të kemi parasysh edhe përfaqësimin e saj në organin legjislativ të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Riza Smaka, le të përgatitet Armend Zemaj.

RIZA SMAKA: Faleminderit zotëri Kryetar!

Qeveritarë, deputetë të nderuar,

Në nenin 1, definimi, është fjala për një vërejtje parimore sepse do të ndryshohej në të mirë të funksionit të ligjit, ku thuhet, po e zëmë, qëllimi i Ligjit për mërgatën e Kosovës, është ruajtja si dhe kultivimi i identitetit gjuhësor, kulturor. Do të duhej medoemos të thuhej – mbrojtja. Mbrojtja është më relevante se sa edhe ruajtja. Prandaj, do të forconte funksionin, do t'i jepte ingerenca institucionit përkatës për t'i ushtruar funksionet e referuara me këtë.

Te neni 1, paragrafi 3, Agjencia e Mërgatës së Kosovës. Unë edhe më parë i jam adresuar Qeverisë për pyetje me mocion shkrimor parlamentar, për nevojën imediate të ngritjes së Ministrisë për Mërgatën. Prandaj, do të shfrytëzoj oportunitetin edhe këtu që të angazhohem – jo agjencion, por për ministri. Ja t'i marrim praktikën e shteteve që, fundi i fundit, kanë më pak mërgimtarë në botën e jashtme, kanë ministri. Çështja është tepër serioze, tepër e rëndësishme. Ne ndoshta numerikisht e kemi diku $\frac{1}{4}$, por në aspektet tjera nuk është $\frac{1}{4}$, ndoshta edhe $\frac{1}{2}$ e potencialit të vendit është në botën e jashtme që ka dhënë aq kontribut dhe vazhdon për të dhënë kontribute. Prandaj, tek e fundit, e kisha fuzionuar në dy qeveritë ekzistente, ama këtu do të kisha konstituar një ministri, se thashë dy qeveri – ishte llopsus lingua.

Te neni 7.3, ju lutem, emërimi dhe shkarkimi i funksionit të kryeshefit ekzekutiv, i rregulluar me dispozita relevante në fuqi. Cilat janë ato dispozita relevante. Më të parën here, s'ka dispozita relevante. Çdo dispozitë që është në fuqi, është relevante, obligative, fundamentale. Edhe nuk di që ka dispozita që qenkan në fuqi, që po e rregullokan këtë çështje. Prandaj, këtu shihet inercioni që të bëhet një ligj, të jepet një ligj, një projekt apo jo dhe të shkohet më tutje.

Te neni 8, paragrafi 1 – Qendra Kulturore e Kosovës për Mërgatën. Do të duhej të hiqej krejt “kulturorë”. Ja pse, sepse këtë vetë përmbajtja e dispozitës së nenit 15 e determinon edhe riformulimin e emërimit, se nuk është fjala veç për kulturën, segmentin e kulturës, por është, ju lutem, edhe komponentë për edukimin, për arsimimin, për bashkëpunimin ekonomik, për bashkëpunimin shkencor, teknik, teknologjik, sportiv. Këto bile thuhet edhe shprehimisht në dispozitën e nenit 15, kështu që nuk është koherente ose duket që kanë qenë dy autorë apo më pak a ma shumë dhe më pastaj nuk i kanë harmonizuar këto tekste.

Dhe, përfundimisht, si çdo akt ligjor, edhe ky do të duhej t'i kishte edhe dispozitat ndëshkimore, se synimi ynë është që ky ligj kur të miratohet, të aplikohet, e ne e dimë fare mirë se jo vetëm në vendin tonë, por edhe në vende tjera shumë të zhvilluara dispozita të caktuara nuk përfillen, por janë sanksionet dhe pikërisht sanksioni e bën aktin juridik ligj. Këtë nuk e ka, e duhet ta ketë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Armend, a e ke tërhequr fjalën?

ARMEND ZEMAJ: Po, po i them nja dy-tri fjalë. S'po i them 77 fjalë, por vetëm dy fjalë, shkurt.

Faleminderit, i nderuar Kryetar!

Po e kuptojmë qëllimin e mirë edhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës për prurjen e këtij ligji. Ka qenë kërkesë edhe e partive politike, edhe e qytetarëve, por duhet të kemi parasysh që edhe mbajtjen e këtyre kompetencave pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës ne të kemi kujdes pikësëpari nga emërimet. Unë e kam vërejtje numër një, do me thënë, këtu te ligji – Ligji për Mërgatën e Republikës së Kosovës. Duhet ta kemi të qartë, jemi shtet dhe i kemi pjesëtarët tanë, të shtetit tanë të Kosovës, sepse shqiptarë ka anëmbanë botës dhe ka edhe nga trojet dhe vendet tjera. Kjo është edhe aty te përkufizimi – qëllimi i ligjit, ku duhet decidivisht të përmendet

Republika e Kosovës. Kjo nuk i bën dëm, por do të thotë i bën mirë dhe e qartëson edhe pozicionin tonë si shtet, karshi qytetarëve që jetojnë jashtë vendit.

Ka shumë vërejtje. Unë thashë, është qëllimshëm, që mund t'i përmirësojmë por disa nuk mund të tejkalohen. Ajo çka është – formimi i agjencioneve, apo të agjencisë, që po na ndodhë që janë të shumta. Ne vetëm sot këtu me projektligje kemi dy-tri agjenci që do t'i formojmë dhe nuk e di sa do të jetë i përballueshëm buxheti i Republikës së Kosovës që t'i financojë këto agjenci, por mos po bëhen më shumë se të tepërta – borde, agjenci të ndryshme dhe këtu mendoj se si politikë, si vendimmarrës duhet të kemi kujdes të veçantë.

Çështja tjetër është te informimi. Nëse vendoset me ligj që Televizioni Publik i Republikës së Kosovës obligohet që përafërsisht qysh shkruhet këtu, 5 deri 7% të shemës programore të ofrojë program, cili do të jetë procesi i monitorimit dhe sa do të jenë të gatshëm Republika e Kosovës, institucionet ta përcjellin sa po transmetohet ajo 5 – 7%, sa kanë të drejtë qasjeje jashtë vendit. Dhe, është shumë anomali që sot, në ditët e sotme, të thuhet vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përdorimit të informimit modern elektronik.

Prandaj, edhe te ekonomia, te shkenca përmendet e njëjta, s'po flas për çështje tjera. Unë mendoj që duhet të kemi kujdes, edhe Qeveria në këtë rast, sepse i kuptojmë edhe shumë, gjatë hartimeve të ligjeve, patëm edhe rastin, për shembull, a prek projektligji kompetencat e rezervuara. Nuk kemi dyshim që tash pas 2 vjetësh të shpalljes së pavarësisë të Kosovës, hyrjes në fuqi të Kushtetutës që ka kompetenca të rezervuara. Prandaj, mendoj që Komisionit do t'i duhej shumë punë aktivisht dhe të shohë se cila është mënyra e definimit të këtyre çështjeve. Po, edhe një herë e them, të gjitha ligjet ku përmendet Kosova, nuk është e dëmshme por është krenari të thuhet Republika e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar deputeti Sabri Hamiti, le të përgatitet Hydajet Hyseni.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit!

Çështja me këtë projektligj nis që nga titulli. Nëse, si thonë latinët, emri është sendi, atëherë ajo që ka brenda, duhet të ishte edhe në titull. Problemi është në variacionet e titullit. Shqip thotë “Ligji për Mërgatën”, anglisht është “për diasporën” edhe serbokroatisht ose serbisht është “për diasporën”. Çështja është që nuk janë terma të barasvlershëm – diaspora dhe mërgata. Nuk janë një, as në kuptimin aktual, as në kuptimin historik. Mund të jetë që dikush..., këtu thuhet që ligji është ndërtuar duke pas konsultuar kroatë e sllovenë. Sa mbaj mend unë, ata i thonë “iseljništvo”, e kam një fjalë që e përdorin. Kjo po më duket edhe kalk e përkthyer “mërgata”, po nuk është. Pse? Duhet të definohet saktë, nëse është për diasporën apo është për diasporën dhe për mërgatën apo është vetëm për mërgatën. Problemet nuk janë veç kulturore, por janë edhe historike edhe janë politike. Prandaj, unë po insistoј në përcaktimin e saktë çka do të bëjmë ne me këtë ligj dhe çka do të bëjmë me emërimin e tij në 3 variantet. Unë po e shoh se është në tri variante, ashiqare, që secila duhet të korrespondojë me tjetrën. Çka është diasporë historike për Kosovën, çka është diasporë aktuale? Përkufizimi që i jepet çka është mërgatë këtu, nuk i përgjigjet kësaj që e lyp titulli, se thotë: “Pjesëtar i Mërgatës së Kosovës konsiderohet çdo person i cili ka vendbanim apo vendqëndrim jashtë Kosovës dhe i cili ka lindur apo ka prejardhje familjare nga Republika e Kosovës”. Përcaktimi është shumë i gjerë dhe i papërcaktuar. Sepse, diasporat ekzistojnë – historike, me të cilat ka kuptim të kodifikohet lidhja, kjo që po e quajmë ne këtu – kulturore, po ka edhe diaspora të reja të, cilat nuk e kanë këtë status. Për ta bërë pak më të qartë problemin, ka një diasporë në Amerikë - shqiptare, po e zëmë, e cila politikisht është totalisht e situuar në SHBA, ndërsa mban lidhje kulturore me Amzën, ta ketë Kosovën e Shqipërinë. Kemi ne një të ashtuquajtur diasporë historike 10 herë më të madhe në Turqi, e cila

origjinarisht ekziston atje – origjinë shqiptare, asnjë s’flet shqip, s’i ka asnjë a dy klasë fillore shqip.

Tutje, ajo që është diasporë politike e re, jashtë kufijve të Kosovës, a është diasporë ajo që po i themi tash me të renë – Kosova Lindore, ose komunat përtej Kosove, që janë në Serbinë e Jugut sot. Çka janë ata, a janë diasporë? Mërgimtarë s’janë, se te shtëpia e vet. Po është një realitet politik i vonshëm, i cili i bën diasporë, faktikisht.

Çfarë desha të them? Ligji si i tillë, me emërimet anglisht dhe në gjuhën serbo-kroate ose kroato-serbe ose serbe, thoni si të doni, paragjykon diçka tjetër, në shqip krejt diçka tjetër. Tjetër është nëse ne bëjmë ligj për ata që përkohësisht punojnë jashtë dhe kanë shtetësi të Kosovës. Kjo është kategori krejt tjetër. Se, keni kujdes, edhe politikisht një diasporist shqiptar në Gjermani, që ka shtetësi gjermane, nuk e ka të drejtën e dyshtetësisë, qysh po mendojmë ne që në Kosovë hyn e del kushdo, i bën dy shtetësi. Ajo është diasporë edhe politike, por nuk ka të drejtë, po e zëmë, të zgjedhet ose të zgjedh në Kosovë.

Unë u përpoqa të jap shembuj, pse më shtinë të mendoj që ligji duhet, nëse e pranojmë në lexim të parë ne, që ashiqare thamë, shumica e pranojnë, të punohet saktësisht në amendamentimin në disa pika, se janë shumë të ndjeshme, që ta ripunojë komisioni bashkë me propozuesin dhe, krejt në fund, unë mendoj që ky ligj s’duhet të jetë te Zyra e Kryeministrit, por nëse kemi krijuar dikastere boll, sepse Kosova më duket i ka 16 deri tash, tash po propozohen edhe nja dy, 18. Zoti na ruajt, sa më i vogël vendi, më shumë ministri. Një ditë kemi për të menduar se nuk është e thënë që çdo ide ose çdo veprimtari ta ketë një ministri. Është Ministria e Jashtme, le të bëhet dikaster i Ministrisë së Jashtme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni-Kaloshi, le të përgatitet Deputeti Arsim Rexhepi.

HYDAJET HYSENI-KALOSHI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zonja e zotërinj deputetë,

Të nderuar ministra,

Më lejoni që si njeri që ka qenë i angazhuar në strukturat që janë përkujdesur për mërgatën, të përshëndes sjelljen në Kuvend të këtij ligji dhe veçanërisht me këtë rast përshëndes zëvendëskryeministrin, i cili edhe ka pas premtuar që në fillim të kësaj qeverisje dhe ka qenë angazhuar për një avancim të trajtimit të mërgatës sonë. Për ata që nuk e kanë sa duhet të qartë, ka edhe tani një drejtori, që është e vendosur në kompetencat e Kryeministrit, por që është një avancim nga ajo që e kemi pasur me Departamentin e Çështjeve Jorezidente dhe ky është një hap, besojmë, kah zgjidhja përfundimtare që edhe për mendimin tim duhet të jetë një ministri e veçantë për mërgatën. Kosova ka një mërgatë vërtetë numerikisht shumë të madhe, kurse edhe funksionalisht shumë të rëndësishme dhe ka kuptim që perspektiva të përvijohet pikërisht te kjo që të instuticonalizohet një ministri e veçantë për mërgatën.

Ligji, si i tillë, meriton përkrahje, sepse është një hap në këtë drejtim. Mendoj se meriton edhe përkrahje për mënyrën si është hartuar, vërehet se është hartuar me kujdes, por është një materie shumë e ndërlikuar edhe për shkak të këtyre që u thanë paraprakisht.

Mua më bën përshtypje të mirë ajo që është marrë përvoja e të tjerëve përreth, sidomos përvoja kroate. Më ka bërë përshtypje pse janë injoruar përvojat tjera, që janë edhe më të afërta, por kam përshtypjen se nuk është sintetizuar e gjithë përvoja kroate. Është një strukturë, si të thuash, komplekse e organizimit. Ata e kanë Matica Hrvatska, që është, dhe nuk është vetëm ky segmenti kulturor.

Edhe për mendimin tim, ka një reduktim të fushave të cilat duhet të rregullohen me ligj dhe kjo është vërejtja ime e parë.

Pajtohem se titulli nuk është sa duhet adekuat. Edhe për mua qëndron ai dallimi diasporë – mërgatë. Do të ishte mirë që të jetë edhe njëra edhe tjetra, se objektivisht në rastin tonë janë të dyja. Kemi diasporë, por ka edhe mërgatë, që s'mund të futet lehtë në kallëpet e diasporës.

Nuk më prish punë ajo që u tha pse është mërgata vetëm e Kosovës, sepse edhe po të duam, mërgatën nuk mund ta ndajmë në kufij administrativë e tjera. Ajo është e organizuar atje mbi do baza tjera dhe mendoj që edhe organizimi duhet ta ketë parasysh këtë. Për më tepër, ne si shtet edhe jemi të obliguar, kemi edhe të drejtë të përkujdesemi edhe për pjesët e popujve që jetojnë si ... në Kosovë dhe kanë edhe pjesët e tyre jashtë kufijve të Kosovës.

Do të tërhiqja vërejtjen në mospërputhje, përveç tjerash, edhe në tekstet në gjuhë të ndryshme. Për shembull, në një gjuhë është emri i plotë, në tjetrën nuk është. S'po marr shembuj, për ta kursyer kohën. Në njërën përdoret akronimi, në tjetrën emri i plotë. Ose në nenin 9, ta zëmë, flitet për investimet në gjuhën shqipe “të kapitalit”, kurse në gjuhët tjera vetëm “investime”. Investimet mund të jenë edhe të teknologjisë, të dijes dhe në forma të ndryshme. Duhet të harmonizohen.

Për mendimin tim, duhet të eliminohen edhe formula të tilla dhe të rishikohen dhe besoj se ata që do të punojnë në amendamentim, do të kenë kujdes. Për shembull, formula të tilla “agjencia ka përgjegjësi zbatimin dhe monitorimin e dispozitave të këtij ligji”. Nuk mund t'i ketë agjencia edhe zbatimin edhe monitorimin. Ka, si të thuash, faktorë të tjerë që duhet të rezervohen për këtë të dytën.

Edhe mua më pëlqen ideja që të ketë qendra kulturore, por kam disa dilema, të cilat dua t'i shtroj. Së pari, qendrat kulturore në shumë vende organizohen nga vetë mërgimtarët atje ku janë duke i shfrytëzuar jo vetëm ligjet ekzistuese, por edhe mundësitë financiare. Ata janë taksapagues dhe në shumë vende kanë mbështetje për të krijuar organizata të tilla. Nuk është e mirë që ne të pretendojmë diçka që, objektivisht, zor edhe i dalim rreth. Nëse kjo eventualisht do të ishte si perspektivë për të ardhmen të cilën do ta pëlqeja shumë, mendoj se kësaj duhet t'i paraprijë një formë që e kanë vendet tjera – angazhimi i atashëve për kulturë, atje ku ka nevojë, dhe ata pastaj mund eventualisht ta zhvillojnë edhe në pretendime pak më serioze. Po, edhe nëse bëhet, pajtohem me ata që emri vetëm – qendra kulturore – është joadekuat. Ne edhe përpara kemi pasur formulime, si të thuash, që janë pak më gjithëpërfshirëse, sepse është aty informimi, është aty edhe zgjidhja e problemeve të shumta të mërgatës, që janë edhe sociale, kanë të bëjnë me dokumentet, kanë të bëjnë me pensionet, me udhëtimin e me shumëçka tjetër që Ligji për Mërgatën s'mund t'i përjashtojë. Mendoj se nëse zgjidhet që të kemi qendra, ato do të ishin qendra të Kosovës dhe pastaj le të jenë edhe ekonomike. Shumë vende i kanë odat ekonomike ose zyrat ekonomike me lloj-lloj emërtimesh, si alternativë për këtë formë organizimi.

Për ata që patën paqartësi, është rasti i parë. Vërtet, ka një rregullore të UNMIK-ut që e rregullon çështjen e mërgatës sonë dhe mendoj se është mirë që kjo tani të rregullohet me ligj dhe, si e tillë, mendoj se duhet përshëndetur.

Ajo që dëshiroj ta nënvizoj veçanërisht, është edhe një vërejtje. Ka dispozita që objektivisht janë formulime programatike, por jo edhe dispozita ligjore. Mendoj se duhet të marrin formën e dispozitave ligjore ose të hiqen fare nga ligji dhe ta kenë vendin atje ku e kanë, në programin e agjencisë.

Angazhohem që ky ligj t'i shtrohet një debati publik me mërgimtarët tanë, të cilët janë edhe më të thirrurit dhe më të informuarit për t'i pikëtuar, si të thuash, çështjet që duhet të rregullohen me një ligj për ta. E përshëndes edhe një herë nismën. Ju falënderoj për vëmendjen!

KRYETARI: Faleminderit! Bajram, s'je lajmëruar për fjalë. Fjalën e ka deputeti Arsim Rexhepi.

ARSIM REXHEPI: Faleminderit, zoti Kryetar!

(Ndërhyrje e deputetit)

KRYETARI: Urdhëro, Sabri Hamiti, plotësoje me replikë idenë!

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit!

Le të më lejohet ta plotësoj tutje idenë se me gjasë që s'donë, s'është kuptuar mirë çka po them unë. Tash po i shtroj 3 pyetje:

- A janë mërgatë e Kosovës, banorët e Kosovës që jetojnë në Shqipëri?
- A është mërgatë e Kosovës boshnjaku i Kosovës që shkon në Sarajevë?
- A është mërgatë e Kosovës familja me origjinë serbe që jeton në Beograd?

Pse i bëj këto pyetje? Definimi – thelbi i këtij ligji të propozuar nuk e tregon këtë. Unë po them se ka të precizohet shumëçka, sepse këto janë pyetje që i shtron jeta dhe a e ka fuqinë Kosova që t'i marrë me një ligj të këtillë përgjegjësitë, të krijojë dhe të mbrojë kultura dhe politika përtej vetvetes, që shpërndahen historikisht në të gjitha anët. Prandaj, unë insistoј që të diferencohet ç'është diasporë, ç'është mërgatë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Mendoj se kontributin është mirë ta jepni në komisione. Fjalën e ka deputeti Fatmir Rexhepi. Jo, Arsimi është shlyer. Tash Fatmiri e ka fjalën. Po, te unë nuk je i regjistruar, ti e tërhoqe fjalën. Arsim, merre fjalën, por te unë je tërheq. Te unë ka mbetur vetëm emri i Fatmir Rexhepit. Urdhëro, merre, ju të dy ndërrohuni.

ARSIM REXHEPI: Faleminderit shumë! Nejse, këto janë probleme me teknikën, që nganjëherë po ndodhin.

I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Është për t'u përshëndetur që Qeveria sjell, më në fund, Ligjin për diasporën. Ne edhe në komision, edhe në Grupin Parlamentar kemi diskutuar bujshëm rreth këtij ligji. Dikush edhe e ka kundërshtuar dhe ndër ata që e kanë kundërshtuar me ngulm, kam qenë unë, pikërisht edhe për arsytet që i përmendi më herët edhe profesori, por janë edhe disa arsye tjera të cilat shkojnë thellë në xhepin e varfër të këtij shteti.

Ky ligj, i sjellë në këtë Parlament ose ky projektligj tregon se është sjellë me panik dhe nguti dhe nuk ka konsulencën as më të përafërt të ndonjë eksperti, i cili sadopak do të mund të kishte njohuri, dije dhe përvojë jetësore se çka, si dhe ç'përjeton, ç'është dhe ç'mund të jetë diaspora apo mërgata e Kosovës. Ky projektligj, i sjellë kështu me nguti dhe pa fijen e ekspertizës, nuk pretendon dhe nuk zgjon asociacion tjetër përveç se tendencës së Qeverisë, të Kryeministrit për të marrë ingerenca të zhvillimit të politikave me atë pjesë të popullit të Kosovës, që po e quajmë mërgatë ose diasporë. Është një tendencë e pa llogaritur mirë, e cila nuk ia vlen të përkrahet dhe nuk duhet të përshëndetet.

E treta, sikur të kishte këtu ekspertë, në disa nene nuk do të përvijoheshin gabime të tilla siç është intenca për të emëruar arsimtarë për shkollat me plotësim në gjuhën shqipe. Veç nëse ndodh kështu... jo, jo, se kjo është me miliona e lidhur, por ligji, bash ligji thotë se QKMK-ja përmes Kryeministrit ka për t'i emëruar arsimtarët për mësim të shkollave shqipe. Nëse i emërojmë veç 100 arsimtarë atje, janë më shumë se gjysmë milioni euro në muaj. Ata arsimtarë nuk t'i financon më askush, sepse mësimi në shkolla shqipe, mësimi plotësues atje nuk po financohet më nga shtetet ku mërgata jonë është e pranishme dhe banon. Këtë më shumë se tërë tjerët e di unë që jam që 17 vjet atje.

Tjetër, sikur ky Kryeministër dhe kjo Qeveri të kishin pasur një interesim dhe një nguti të tillë për t'ua hequr ato pagesa në kufij nga 50 e 100 euro për secilin kerr të asaj mërgate, do të ishte për t'u përshëndetur dhe për t'ua liruar билетat e fluturimit. Do të ishte shumë kombëtare që atyre njerëzve që kanë kontribuar shumë për këtë vend, t'u krijojmë edhe lehtësira të tilla të cilat në tingëllimin e parë, të tingëllojnë ndoshta të lehta dhe banale, por atyre ju kushtojnë shumë.

Dhe, për fund, politikisht kjo që kërkon të strukturojë ky projektligj, s'është kurrëgjë tjetër veçse një paralelizëm i panevojshëm me ambasadat e Republikës së Kosovës kudo që kemi në mërgatën. Çështjet kulturore i zgjidh edhe i udhëheq atasheu për kulturë. Ne nuk kemi çka krijojmë paralelizma. Unë nuk di pse do të kemi në atashë kulture në një rast kur funksionojnë strukturat të tilla jashtë politike. Është e panevojshme krejtësisht. Ju faleminderit, shumë!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti i fundit, Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje zëvendëskryeministër,

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Projektligjin për Mërgatën, personalisht duke e lexuar, mendoj se duhet të përkrahet në parim për shkak të asaj që u tha dhe që Qeveria në shtetin e ri e ka parë rolin dhe rëndësinë e madhe që kanë nevojë qytetarët tanë që punojnë në botën e jashtme për t'iu ofruar disa nga mundësitë që i jep koha në shërbim të interesave të tyre për t'u organizuar dhe punuar më mirë, por edhe të lidhen me institucionet e vendit tonë. Këtë obligim, pra, e kemi në kuadër që e ka marrë Qeveria dhe e ka vendosur këtë projektligj.

Mirëpo, ajo që del këtu në sipërfaqe dhe që ka rëndësi të debatohet dhe komisionet parlamentare ta kenë parasysh gjatë debatit të mëtutjeshëm, është roli i agjencionit. Unë personalisht e kam lexuar dhe mendoj që nuk ka nevojë për agjencion, që u tha këtu nga kolegët e tjerë deputetë. Pra, do të ishte më mirë, në kuadër qoftë të Ministrisë së Punëve të Jashtme, apo në qoftë se Qeveria e ka vlerësuar se duhet të themelohet Ministria e Integritit, atëherë të bëhet edhe Ministria e Integritit dhe e Mërgatës për arsye se këtu mund të kodifikohet dhe të rregullohet më lehtë funksionimi i një trekëndëshi në mes të Ministrisë dhe Qeverisë, ambasadave apo konsullatave dhe të asaj pjesës tjetër që mendohet të organizohet mërgata apo diaspora në kuadër të këtij projektligji për disa çështje të cilat janë specifikuar aty. Ky trekëndësh do të rregullohet shumë mirë.

Pra, edhe një herë po e përsëris, qoftë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme apo nëse Qeveria e themelon Ministrinë e Integritit dhe të Mërgatës. Prandaj, mendoj të ndryshohet dhe të mos mbetet kështu qysh është ofruar në këtë draft kjo çështje e organizimit.

Unë mendoj se duhet të ripunohet dhe të merren në konsideratë këto gjatë debatit për shkak të rëndësisë së madhe dhe të borxhit të madh që e kemi të gjithë. E thatë ju, dhe ne bashkërisht, pavarësisht kush mbajti pak fjalime tjera, kush është më ngatë e më larg, ajo është çështje tjetër, por unë konsideroj se e kemi për obligim si shtet i ri, si Qeveri dhe si Parlament ta rregullojmë ashtu qysh duhet, pra, në funksion të asaj që thamë të trekëndëshit në Qeveri: ambasadë-konsullata dhe diaspora me krejt nevojat që mund të përmbliken në ato aktivitete të tjera. Ndërsa sot, këtë që e tha Ibrahim, unë veç thashë, ma vërtetoi, po e shfrytëzoj rastin, këtë që e tha Arsimi, unë tash mora vesh që kemi deputetë nga diaspora. Prandaj, pa keqkuptim, faleminderit edhe prej Arsimit.

KRYETARI: Faleminderit! Meqë më vonë u paraqit edhe deputeti Berim Ramosaj, le të urdhërojmë!

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit!

Unë nuk mendoj të flas shumë, por në përmbajtjen e ligjit shihet se është fjala për Ligjin që duhet të emërtohet kështu. Faktikisht është fjala për Ligjin për kujdesin ndaj mërgatës së Kosovës, sepse përmbajtja e këtij projektligji është kryesisht e natyrës së kujdesit, sepse çështja e mërgatës apo e diasporës në përgjithësi është çështje shumë komplekse, që nuk rregullohet vetëm me një ligj. Andaj, në qoftë se e emërtojmë – Ligji për kujdesin ndaj mërgatës, ky draft apo ky ligj mund t'i plotësojë ato kërkesat të cilat i ka pretenduar edhe Qeveria. Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në sallë kemi 61 deputetë, që do të thotë se mund të hyjmë në procedurën e votimit, mirëpo nga diskutimi, mund të them se neve na duhet një studim që ta dimë sa i kushton buxhetit të Kosovës një ministri për katër vjet, duke llogaritur vetëm stafin politik të saj.

Vazhdojmë. Lus regjinë dhe deputetët, të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 55 vota “për”, 1 “kundër”, 4 abstenime – Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për Mërgatën e Kosovës.

Në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit, ngarkohen këto komisione:

- Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, si komision funksional;
- Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi;
- Komisioni për Buxhet dhe Financa,
- Komisioni për Komunitete, dhe
- Komisioni për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që brenda 2 muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e radhës të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për financat e subjekteve politike**

Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim, të këtij projektligji.

Ftoj zëvendëskryeministrin, Hajredin Kuçi, që para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin në fjalë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë, anëtarë të Qeverisë,

Më lejoni që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës të paraqes para jush Projektligjin për financimin e subjekteve politike.

Ndërtimi i infrastrukturës juridike për rregullimin e materies për financimin e subjekteve politike në Kosovë, kriteret për ndarjen e tyre, mjetet, burimet financiare dhe përgjegjësinë për shfrytëzimin e tyre është një prej përgjegjësiave tona, besoj edhe si subjekte politike, po edhe si deputetë dhe institucione të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Qëllimi i këtij projektligji është rregullimi ligjor i financimit të subjekteve politike në Kosovë dhe gjithsesi rritja e transparencës dhe llogaridhënies përballë qytetarëve të Republikës sonë.

Me këtë projektligj rregullohen në detaje çështjet që kanë të bëjnë me financimin e subjekteve politike. Ky projektligj është harmonizuar edhe me Zyrën për Integritet Evropian, por njëkohësisht edhe me standardet e përcaktuara për financimin apo për ligjet që rregullojnë financimin e partive politike.

Ajo që dua të them, është se propozimi i këtij draftligji kërkon një diskutim të gjerë, besoj, në Kuvendin e Kosovës, një debat publik edhe me subjektet politike të cilat përfaqësohen në Kuvend dhe jashtë Kuvendit dhe me siguri me një konsultë të shtuar edhe nga ekspertët ndërkombëtarë për ta bërë një ligj i cili do të jetë, po e përsëris edhe një herë, në mënyrë të qartë dhe në mënyrë transparente të parasheh mënyrën e financimit dhe llogaridhënien për financimin e subjekteve politike.

Ne kemi pas premtuar që këtë ligj do ta dërgojmë me kohë, natyrisht që Kuvendi i Kosovës mund ta kryejë punën dhe besojmë shumë që në vitin 2010 do të jemi me këtë ligj dhe financimi i subjekteve politike do të rregullohet përmes këtij ligji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, fjalën e ka kërkuar deputeti Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari zoti zëvendëskryeministër, ministra,

Deputetë të nderuar,

Unë më pak do të flas në emër të Komisionit për Buxhet e Financa, por do të flas në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike lidhur me propozimin e këtij projektligji. Ne e kemi pritur dhe mirëpritur ardhjen e këtij drafti dhe kështu, si i tillë, mendoj se në parim do të duhej të miratohej, megjithëse është një ligj që rregullon një materie, siç e tha edhe zëvendëskryeministri, për të krijuar një bazë ligjore për financimin e partive politike mbi të cilën bazë do të krijohej edhe një transparencë më e madhe rreth shpenzimeve financiare të subjekteve politike po edhe llogaridhënien.

Meqë ka pak nene, ka diku 25, unë kam evidentuar disa të meta të këtij projektligji, që mendoj se do të duhej të plotësoheshin në procedurat e më tutjeshme.

Në radhë të parë, neni 4, që ka të bëjë me burimet financiare, nuk përcakton në mënyrë të qartë dhe të drejtë të gjitha burimet e mundshme financiare për financimin e subjekteve politike. Është

bërë një përpjekje që me nenin 5 të rregullohet pak a shumë edhe një nga burimet tjera financiare, prandaj konsideroj se neni 4 do të duhej t'i shtohet edhe një paragraf, paragrafi 5, që ka të bëjë me donacionet si formë dhe mundësi, ose si burim financiar për partitë politike. Nuk është e njëjtë kur themi donacionet me kontribute për subjektet politike që mund të jenë kontribute të personave fizikë dhe të personave juridikë, prandaj neni 5 dhe neni 4 duhet të harmonizohen dhe duhet të rregullohen në një nen të veçantë.

Një çështje tjetër, që është shumë e rëndësishme se edhe në Komisionin për Buxhet e Financa, gjatë gjithë kohës që e kemi pasur buxhetin e përgjithshëm të Kosovës, ka qenë pikëpyetje se ku duhet të qëndrojë fondi që ndahet nga buxheti i Republikës së Kosovës për këto subjekte politike, a duhet të jetë në linjën buxhetore të Kuvendit apo duhet të adresohet diku tjetër, për shembull, te Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, te i cili është adresuar edhe raportimi financiar.

Prandaj, si Grup Parlamentar mendojmë se në këtë çështje ne do të duhej në start të vendosim se ky fond a të jetë në kuadër të buxhetit të Kuvendit të Kosovës apo këtë fond ta administrojë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, qysh i administron ose qysh i rishikon të gjitha raportimet financiare që i bëjnë subjektet politike.

Kur është fjala te kjo, megjithatë ligji nuk rregullon çështjen e raportimit në mënyrë të drejtë dhe të saktë. Përderisa fondi është nga buxheti i Republikës së Kosovës, raportimi financiar duhet t'i nënshtrohet Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe të gjitha ligjeve tjera që rregullojnë çështjet e raportimeve financiare.

Kur është çështja te ndarja e fondit ose proporcionet, te neni 9, ne kemi dy paragrafë dhe këta dy paragrafë veç na thonë një tautologji që është e njëjtë dhe nuk e definon qartë se për çka është fjala ose cili është dallimi në mes vendeve në Kuvend dhe numrit të deputetëve të subjekteve politike në Kuvend.

Ne kemi pasur praktikën e deritashme të ndarjes së këtij fondi, ku 90% e atij fondi është ndarë në mes të subjekteve politike mbi bazë të numrit të vendeve në Kuvend, ndërsa 10% për qind është ndarë po ashtu në mes të subjekteve politike që janë në Kuvend, po është ndarë në mënyrë të barabartë, ndërsa paragrafi 2 është i ngjashëm me paragrafin 1 dhe kjo çështje duhet të rregullohet.

Një çështje tjetër, që mendoj se është shumë e rëndësishme është kuota që duhet të ndahet, që të përbëjë këtë fond që thuhet deri në 1%. Sipas një për llogarie deri në 1% ose po e marrim të fundit 1%, është sot gati 11 milionë. Ne i kemi pasur 1 milion e 900 mijë për këtë fond, prandaj edhe kjo kuotë duhet të zbresë në kuotën 0.3 ose 5% dhe jo në kuotën 1%.

Një çështje tjetër që për mua është shumë e rëndësishme, deri tash nuk e kemi pasur praktikë që të financohen ose të buxhetohen partitë politike gjatë kohës së zgjedhjeve, qoftë të nivelit lokal ose të nivelit qendror dhe tash me këtë ligj përcaktohet edhe mundësia e financimit politik të partive politike që marrin pjesë në procesin e zgjedhjeve. Dhe, mendoj se ka një ndarje të mirë ose ai proporcion është i rregulluar mirë, por një çështje nuk është thënë dhe do të duhej të ishte pjesë e këtij projektligji, se nga fondi për zgjedhjet përfitojnë të gjitha subjektet politike që marrin pjesë në zgjedhje dhe ato që kanë marrë dikur përpara dhe këto që certifikohen si të reja. Është, mendoj do të duhej të ishte, që nga ky fond përfitojnë edhe kandidatët e pavarur, sepse janë subjekt zgjedhor në rastin e zgjedhjeve, gjë që projektligji nuk e ka përcaktuar këtë formë. Dhe, duke pasur parasysh faktin dhe mënyrën, është kërkuar sa e sa herë gjatë fushatave zgjedhore për mënyrën e shpenzimeve dhe mos transparencën ose në deklaratimet e tyre

përfundimtare të raportimeve, është mirë që ky ligj t'i përcaktojë qartë edhe afatet se kur do të duhej dhe në cilat raste dhe kujt duhet t'i raportohet?

Për mua është shumë e çuditshme, neni 23 ose 24 thotë: “nxjerr akte nënligjore auditori i përgjithshëm për zbatimin e këtij ligji”, që nuk ka të bëjë, ai i kontrollon financat, por nuk nxjerr akte për zbatimin e këtij ligji, nxjerrin akte, nën akte normative, Komisioni Qendror dhe Qeveria. Thotë nuk është e përcaktuar qartë se kush, cili subjekt dhe në të cilat raste me një akt normativ, në mënyrë që të plotësohet dhe të bëhet i zbatueshëm ky projektligj. Dhe, krejt në fund, po e përsëris atë, Fondi për partitë politike konsideroj se duhet të jetë jashtë Kuvendit, duhet të jetë te Komisioni Qendror zgjedhor dhe për pjesën e këtij fondi, partitë politike, subjektet politike që përfitojnë, duhet të raportojnë në bazë të Ligjit për menaxhimin e financave publike.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Po megjithatë partitë politike duhet ta kenë një masë, masa janë zgjedhjet, qoftë të nivelit qendror, qoftë të nivelit lokal. Ne nuk mund të paguajmë as Kosova, buxheti i Kosovës nuk mund të paguajë parti me një kryetar. Fjalën e ka, se më duket e kreve edhe në emër të grupit parlamentar. Mirë bëre. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, kush e do fjalën? Fjalën e ka Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Kosova si vend demokratik dhe duke pasur synim anëtarësimin në BE, ka qenë e domosdoshme që të kemi Ligjin për financimin e partive politike si dhe subjekteve të tjera politike, duke vendosur rregulla në funksion të garantimit të mundësive të financimit, të aktiviteteve politike, si dhe shpenzimeve të tyre.

Edhe pse ky projektligj sot shqyrtohet në kohën e fushatës zgjedhore, mendojmë se përcaktimet kryesore për ngritjen e transparencës duhet të jenë shumë mirë të definuar si të kufizohen dhe zvogëlohen shpenzimet e partive politike, të garantohet parimi i barazisë midis partive, të sigurohet transparenca e financimit të partive, të përcaktohet një sistem i mbikëqyrjes së financimeve nga buxheti i Kosovës për partitë politike. Për financimet private duhet të ketë kufizime dhe dënime ekstreme kur shkelet ligji.

Grupi parlamentar e ka shqyrtuar me kujdes, sidomos me këto nenet 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10, të cilat kanë drejtpërdrejt të bëjnë me kontributet për subjektet politike. Ne mendojmë që ligji duhet të ketë parimet e qarta të financimit mbi të cilat duhet të vendoset ky ligj. Sugjerojmë që të jetë miks në këtë formë nga buxheti i shtetit, nga donacionet e personave fizikë dhe juridikë dhe nga kuotat, gjithnjë duke iu referuar GDP-s në vendin tonë. E tha edhe kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, se ne nëse i referohemi GDP-s së zhvillimit ekonomik, prapë do ta kemi kuotën e cila ndahet tani për tani dhe është e përbalueshme për buxhetin e Republikës së Kosovës. Dhe, për fund, ajo çka është më e rëndësishmja kontrolli financiar, mendojmë që duhet të ketë rregulla strikt dhe shumë transparente. Duke iu referuar nenit 19, nuk duhet të jetë në vullnetin e partive politike publikimi dhe raportimi financiar për shënimet financiare edhe pse thuhet që auditori i përgjithshëm, Ministria dhe Qeveria në këtë rast, ato duhet të jenë qartë të definuar periudhat kohore të raportimit si dhe donacioneve, në këtë rasat edhe origjina e donacionit, shuma e donacionit të ofruar nga çdo subjekt politik. Këtu duhet të kemi edhe kufizime, lista e donatorëve të bëhet publike. Nuk duhet të kenë të drejtë të ofrojnë

donacione të gjitha ato kompani që kanë marrë pjesë në tenderimin e fondeve publike, prandaj, të gjitha këto ky ligj duhet t'i përfshijë dhe të jetë sa më transparent dhe efikas.

Për të pasur një mundësi të kontrollit më të mirë duhet t'i përmbahemi edhe Ligjit për raportimet financiare, mos t'i jepet mundësi që KQZ-ja dhe në këtë rast të tjerët kanë të drejtë të nxjerrin akte nënligjore, por forma e raportimit të jetë mirë e definuar. Ne si grup parlamentar i japim përkrahje në parim dhe të gjitha këto me vërejtjet do të mundohemi që ky ligj të jetë sa më i implementueshëm në praktikë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Haki Shatri e ka kërkuar fjalën.

HAKI SHATRI: Grupi Parlamentar i Aleancës konsideron se ka qenë mirë që ky ligj të procedohet para shpalljes së zgjedhjeve lokale të nëntorit të këtij viti, me qëllim që ky ligj të shërbejë si bazë për mbështetjen materiale të fushatës. Sido që të jetë, Grupi Parlamentar i Aleancës e mbështet në parim miratimin e këtij ligji edhe pse kemi disa vërejtje që lidhen me tashmë të përmendurit nenin 5, nenin 7, nenin 9 e tjera. Kuota e propozuar deri në 1% po ashtu mendojmë që është e lartë kur marrim parasysh vëllimin e buxhetit aktual që, ashtu siç tha kryetari i Komisionit, mund të shkojë deri në mbi 10 milionë po të aplikohet sot dhe është shumë e madhe për kushtet tona, kurse kemi një mendim ndryshe të administrimi i këtyre fondeve. Mendojmë që Fondi për mbështetje partive politike, duhet të vendoset te ndonjë organizatë buxhetore, në qoftë se jo te Kuvendi, te Ministria e Shërbimeve Publike, te Ministria e Financave, kurse Fondi për mbështetje të fushatave parazgjedhore mund të administrohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Ky është një mendim yni që mendoj se është më praktik dhe do të hasë në përkrahje. Sido që të jetë, ne do të jemi të gatshëm për të kontribuar në periudhën ndërmjet dy leximeve, në mënyrë që ky ligj të jetë më i aplikueshëm. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, e ka fjalën kryetari Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Ligji për financimin e partive politike ka qenë i nevojshëm, jo vetëm për të rregulluar financimin e partive politike, por edhe për të mundësuar veprimin e tyre politik. Ligji e rrit besueshmërinë në praktikën e financimit dhe ruan veprimtarinë e rregullta financiare të partive politike dhe të gjitha zgjedhjeve.

Ligji duhet t'i mbulojë të paktën çështjet themelore, siç janë: burimi i financimit; donacionet private dhe publike, financimin e fushatës zgjedhore dhe dispozitat për zbulim, raportim, monitorim dhe sanksionim të cilat nuk them se i përmban ky draftligj. Ligji duhet të krijojë një ekuilibër të arsyeshëm midis financimit publik dhe privat, kritere të drejta në shpërndarjen e fondeve publike, rregulla të qarta për donacionet private, transparencën e plotë të llogarive, kontrollin e pavarur të financave dhe sanksionimin për partitë që shkelin rregullat.

Kur kihet parasysh që praktikën e vendeve në tranzicion ose me demokraci të brishtë, dëshmojnë se korrupsioni dhe krimi i organizuar përbën një çështje që ka lidhje me financimin e partive politike, shtrohet nevoja për rregulla strikt për disa lloj burimesh dhe shumës së donacioneve private që ato të mos kenë ndikim në vendimmarrje. Sa i përket mjeteve publike duhet t'i kushtohet kujdes i veçantë barazisë së mundësive për përkrahje politike, si të partive politike të themeluara prej kohësh, ashtu edhe të atyre të reja.

Transparenca e plotë e financimit të partive politike duhet të sigurohet me synimin për të shmangur ndonjë ndikim të mundshëm e të padëshirueshëm të parave në partitë politike dhe në politikën në përgjithësi. Draftligji ka edhe disa mangësi të cilat sigurisht që do të trajtohen gjatë shqyrtimit në komisione. Së pari, çka është kuptuar me termin fushatë parazgjedhore dhe fushatë zgjedhore, sepse nuk ekziston? Ka vetëm fushatë zgjedhore.

Së dyti, pse Fondi për demokratizim të funksionojë në kuadër të Kuvendit e jo në kuadër të Komisionit Qendror Zgjedhor, si trup që merret edhe me organizim të zgjedhjeve, por edhe me regjistrim dhe kontroll të partive politike?

Së treti, përkrahja financiare duhet të ndahet në dy nivele, sipas vendeve të fituara në zgjedhjet për Kuvend ose zgjedhjeve qendrore dhe sipas vendeve të fituara në zgjedhjet lokale, sepse jo të gjitha partitë politike garojnë edhe për nivelin qendror.

Ligji duhet t'i detyrojë partitë politike dhe jo të parasheh mundësinë sikur që thuhet në nenet 19 dhe 17, por duhet t'i obligojë partitë politike për kontroll të brendshëm financiar. Me gjithë defektet që ka draftligji, ka qenë koha e fundit që të nxirret ky ligj dhe Grupi Parlamentar i AKR-së e përkrah në parim projektligjin në fjalë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar atë LDD-së, Lulzim Zeneli e ka fjalën.

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, zotëri Kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e konsideron tejet të nevojshëm miratimin sa më parë të këtij projektligji, por njëkohësisht duke adresuar kritikën dhe vërejtjen tonë si grup parlamentar për papërgjegjësinë, së pari të Qeverisë, por lirisht kësaj papërgjegjësie nuk mund t'i ikë as Kuvendi i Kosovës, sa i përket këtij ligji dhe kësaj materie, kur dihet se është aq e nevojshme dhe bën pjesë në kuadër të pakove të ligjeve që lufton korrupsionin. Kur themi kështu, kemi parasysh tërë tregimin dhe ekspeditën e këtij projektligji që ka kaluar nëpër Kuvendin e Kosovës dhe duke ditur se debatet rreth këtij projektligji kanë filluar që në vitin 2004, atëherë kur Kuvendi i Kosovës e ka miratuar për herë të parë. Kur themi është shumë e papërgjegjshme nga ana jonë që të hyjmë në fushatë zgjedhore pa një projektligj të këtillë, fushatën e parë dhe zgjedhjet e para në shtetin e pavarur të Kosovës, bazohem në atë që ky projektligj, gjegjësisht seanca plenare e Kuvendit të Kosovës, më datën 30. 7.2008, me propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës është tërhequr nga procedura e miratimit të këtij projektligji dhe tash kemi më shumë se një vit që ky projektligj është sjell poshtë e lartë dhe në fund vjen në Kuvend për miratim. Prandaj, kjo nuk mund të arsyetohet asnjëherë se duke pasur parasysh dhe sot është pjesë e debatit dhe ka qenë vazhdimisht për burimet financiare të subjekteve politike të cilat janë cilësuar dhe cilësohen si të dyshimta.

Është shumë i nevojshëm, po e theksoj sidomos një dispozitë kur kemi të bëjmë me nenin 12, ndalimi i ushtrimit të presionit ndaj bizneseve. Në Kuvendin e Kosovës ka pasur edhe kritika dhe është drejtuar edhe gisht ndaj subjekteve politike që po reketojnë, mirëpo duke pasur parasysh përgjegjësitë që dalin nga ky projektligj për subjektet politike, sa i përket procedurave të raportimit, atëherë konsiderojmë tejet të nevojshme që të ndalemi, gjegjësisht dhe t'i shqyrtojmë praktikatat e vendeve tjera të cilat janë të dëshmuara sa i përket transparencës financiare.

Nëse marrim parasysh dispozitat ndëshkimore të këtij projektligji, atëherë vijmë në përfundim se kemi të bëjmë me një dispozitë që është tejet qesharake. Çka thotë neni 21? Subjektet

politike thotë do të gjobiten prej 3.000 deri në 10.000 euro për cenim të dispozitave të këtij ligji. Mund ta merrni me mend. Pra, subjektet politike gjatë tërë procesit të fushatës zgjedhore mund të përdorin fondet nga natyrat më të ndryshme, nga dyshimet, nga format po e them të nëntokës dhe gjobiten maksimalisht deri në 10.000 euro. Ja ky projektligj i ka ardhur Kuvendit të Kosovës dhe ne jemi dëshmitarë të asaj që subjektet politike veç për shkelje të Kodit të Etikës gjatë procesit zgjedhor, gjatë fushatës zgjedhore gjobiten në shumë deri, ndoshta deri si vitin e kaluar ka shkuar, po mendoj në zgjedhjet e kaluara ishte deri afër 100 mijë euro dhe mund ta merrni me mend se sa është ligj i mangët për të garantuar një transparencë dhe një rregullshmëri sa i përket transparencës së financave të partive politike.

Prandaj, konsideroj se këto vonesa që janë bërë në procedurën e procedimit të këtij projektligj tejet të nevojshme që krahas Ligjit për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë është ligj kyç që determinon transparencën dhe sidomos kontribuon në kuadër të procesit të luftës kundër korrupsionit, konsiderojmë se duhet të trajtohet seriozisht dhe të merren për bazë praktikatat e vendeve të cilat kanë ecur në këtë proces para nesh. Prandaj, ato çka i thanë parafolësit nuk do t'i përsëris, mirëpo do të duhej gjithsesi, pasi që edhe jemi vonë sa i përket këtij projektligji të mbahen edhe debatet publike, në mënyrë që përmes komisioneve parlamentare, që në fund ta kemi një projekt i cili do të jetë në shërbim të transparencës financiare. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Për ne nëntoka është krim dhe krimi s' mund të ndëshkohet me 10 mijë euro, kështu që kur flasim vërtet duhet të jemi të arsyeshëm. Nëntoka është krim dhe krimi dënohet dihet qysh e jo me 10 mijë euro, sepse me 10 mijë euro ndërrimi i postierëve mund të dënohet.

Në emër të Grupit Parlamentar "7+" Myfera Shinik e ka fjalën!

MÜFERA ŞINIK: Teşekkür ederim!

Sayın Başkan, Bakanlar ve Milletvekilleri

Siyasi partilerin finansi edilmesi Yasa Tasarısı çok önemli ve Kosova için gerekli bir Yasa Tasarısıdır. Oldukça iyi hazırlanmış, ancak varolan bazı maddelerdeki eklemeleri gerekli komisyonlarda sunarak, katkımızı vereceğiz. Onun dışında 7+ Parlamenter Grubu olarak bu Yasa Tasarısının birinci okunuşunu kabul ediyoruz.

Teşekkür ederim.

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, nuk ka. Vazhdojmë me diskutimet e deputetëve. Fjalën e ka deputeti Zef Morina, le të përgatitet deputetja Kaqusha Jashari.

ZEF MORINA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëendetje Kabinet qeveritar,

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Mendoj që Kosovës i është dashur një ligj i tillë dhe vërtet ky ligj ka rendësi shumë të veçantë pasi që një mënyrë, jo vetëm që e rregullon çështjen e financimit të partive politike, por i disiplinon partitë politike në mënyrën e shpenzimeve të mjeteve dhe i detyron që të jenë transparente gjatë funksionimit të tyre. Natyrisht që për mungesë të mjeteve, një numër i madh i subjekteve politike janë detyruar edhe të shuhen, disa nuk kanë pasur mundësi të zhvillojnë aktivitet, duke pasur parasysh që nëse i marrim të gjitha subjektet politike në Kosovë as 20% nuk kanë anëtarësi sa ka Kosova qytetarë. Mendoj që përmes këtij ligji do t'u mundësohet vërtet të krijojnë një aktivitet ashtu si duhet.

Ajo që më bëri përshtypje është se tek neni 7 nëse nuk gaboj ose neni 8, ku thuhet që mjetet apo Fondi për buxhetin e partive politike është më i vogël se 1%, këtu mendoj që duhet të precizohet saktë, nëse lihet hapësirë më e vogël është prej 0,001 deri në 1. Mendoj që këtu duhet të përcaktohet saktë dhe varësisht prej mjeteve që duhen të shpenzohen për aktivitetet e partive politike, duhet të caktohet, mund të lihet shembull një distancë shumë e afërt, për shembull të jetë nga 04 deri në 05 ose 03 deri në 04, por jo të lihet një hapësirë kaq e madhe, sepse kjo mund të japë për të kuptuar që ato mjete mund të ndahen sipas dëshirës së kujt do qoftë që do të vijë, qoftë nga KQZ-ja, apo kush do të jetë ajo që do të bëjë ndarjen e këtyre mjeteve.

Ajo që gjithashtu duhet të ndryshojë është edhe tek ndarja e mjeteve për fushatën, ku është 0,1% dhe përcaktohet që 60% t'u jepen partive të cilat kanë marrë më shumë vende, kanë marrë domethënë, vende, kanë fuqi zgjedhore në zgjedhjet e fundit. Mendoj që këtu nuk duhet të jetë pasi që nga vetë financimi i partive këto veç përfitojnë shumë, 90% të mjeteve i marrin për deputetët që janë në Parlament, ndërsa 10% si parti politike të cilat janë në Parlamentin e Kosovës. Kjo nuk duhet të jetë mbi 40%, ndërsa mjetet financiare 40% të ndahen për partitë të cilat kanë këshilltarë komunal dhe 20% për ato të cilat nuk janë, nuk do të thotë që ato parti të cilat sot nuk janë, qoftë në kuvende komunale, qoftë në Parlament nuk mund të jenë nesër. Ka sigurisht, ne e dimë- parti që e kanë qenë edhe para lufte, por për mungesë të mjeteve nuk kanë mundur të zhvillojnë aktivitet dhe simpatizuesit ose anëtarësia e tyre ka mbetur vërtet joaktive.

Këtu nuk përcaktohet kush e bën ndarjen e këtyre mjeteve si dhe, edhe unë pajtohem që dënimi për shkeljen e këtij ligji të jetë jo kështu si është, por të jetë vërtet në një vlerë ndryshe, sepse këtu shumë qartë thotë nuk është fjala ndoshta për shqyerje të postierëve apo gjë tjetër, por thjesht për keqpërdorim të mjeteve. Si për shembull, përveç mjeteve që i marrim nga fondi i shtetit, marrim mjete edhe nga personat ose nga kompanitë ose ku ta di, nga ndonjë burim tjetër, i cili do ta rrisë shumë dhe, nëse ato nuk deklarohen, dënimi duhet të jetë shumë më i lartë. Për një mospërputhshmëri, nëse nuk gaboj, prej 20 euro a 30 euro, ne jemi dënuar 3 mijë e 100 euro nga KQZ-ja, gjë që s' është normale, e lëre këtu në qoftë se është në pyetje me dhjetëra, mijëra apo qindra mijëra euro. Kështu që në parim e përkrah, vërtet është një ligj i domosdoshëm dhe mendoj që në Komision duhet të kihen parasysh këto vërejtje të cilat ne i dhamë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Kaqusha Jashari, le të përgatitet deputeti Bajram Kosumi.

KAQUSHA JASHARI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Unë mendoj se është mirë që këtë ligj sikur të tjerët që e thanë ta procedojmë më tutje dhe besoj që në diskutim edhe në komisione do të bëhen edhe disa përmirësime, prandaj mendoj se jo vetëm për shkak të përkrahjes financiare për partitë politike, këtu po rregullohen edhe: mbikëqyrja, transparenca, administrimi dhe gjërat tjera. Prandaj, unë e përkrah këtë ligj në parim, por kam disa vërejtje.

Në nenin 7, përcaktohet shuma deri 1% nga buxheti i Kosovës edhe unë mendoj si parafolësi që duhet të caktohet sa 1% apo vlera tjetër, por jo ta lëmë deri, por sa është ajo. Më tutje, përcaktohet edhe destinimi në nenin 7, ku fillon prej aktivitetit parazgjedhor dhe zgjedhor, pastaj vazhdon financimi i shpenzimeve materiale të grupeve parlamentare dhe nën 3 janë aktivitetet e rregullta të partie politike. Është një përshtypje se prioritet kanë aktivitetet parazgjedhore dhe zgjedhore që nuk është e vërtetë se 1% ndahet më së pari për aktivitete të rregullta të partive politike mbasandaj janë, duhet të jenë të gjitha këto të kundërta e jo të

fillojmë prej aktiviteteve parazgjedhore dhe zgjedhore se në nenin 10 caktohet shuma prej 01% të buxhetit për aktivitetin parazgjedhor dhe zgjedhor.

Te neni 8, kriteret janë të parapara mirë për çka dhe cilat janë ato kriteret për ndarjen e këtyre mjeteve? Nën një e kemi financimin e aktiviteteve të subjekteve politike, mbasandaj shkon me radhë financimi i degëve, grupet parlamentare dhe zgjedhjet lokale, sikur që kështu edhe duhet. Prandaj, propozoj që neni 7 të jetë sikur neni i 8-të.

Por, te neni 9, unë e kam një dilemë. Këtu definohet cilat janë ato parti politike që përfitojnë nga ky buxhet? Dy kriteret janë. Një kriter është vendet në Kuvend dhe numri i deputetëve. Unë pajtohem me ty zoti Kryetar, që partia me një kryetar nuk mund të jetë ajo që përfiton për aktivitete të rregullta, s'jam duke folur për aktivitetin zgjedhor, por për aktivitete të rregullta mendoj se nuk mund t'i diskriminojmë edhe ato parti që marrin pjesë gjithmonë në zgjedhje, qoftë lokale, qoftë parlamentare, kurse keni parti të cilat e kanë një kontinuitet në veprim, gjithmonë marrin pjesë, duhet për t'i gjetur edhe disa kriteret më të ashpra, jo të gjitha subjektet politike të regjistruara dhe të certifikuara nga Komisioni, por janë disa kriteret tjera. Këto parti që e kanë një kontinuitet të gjatë bile kanë obligim të mbajnë kuvende zgjedhore sipas statusit vetëm 2 vjet, në qoftë se nuk e mban, nuk e regjistron Komisioni zgjedhor, kurse për partitë më të mëdha, atë kriter nuk e merr parasysh. Prandaj, mendoj se këto parti nuk duhet diskriminuar, por përkundrazi duhet për aktivitete të rregullta të japin mundësi fuqizimin e tyre.

Gjithashtu, mendoj që neni 10, ku përcakton 01% të buxhetit për aktivitetin zgjedhor edhe parazgjedhor, të shikojmë edhe mënyrën e ndarjes që unë mendoj se përnjëmend për aktivitete të rëndomta, të rregullta marrin këto parti të mëdha mjaft mjete edhe për zgjedhjet për financimin e fushatës zgjedhore, e kanë një shumë të madhe. Edhe unë mendoj se kjo përqindje duhet të ndryshohet, jo 60, 30 edhe 10, por te kjo e fundit që është 10, le të shkojë pak më tepër, por le të sqarohet edhe kush përfiton këtu. Nuk është e qartë që po shkruan që 10% të mjeteve financiare ndahen për subjektet politike të posa regjistruara dhe të certifikuara nga Komisioni Qendror, por duhet të thuhet: "subjektet politike të regjistruara dhe të certifikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që nuk kanë këshilltarë në kuvendet komunale dhe deputetë në Kuvendin e Republikës së Kosovës", se këta përfitojnë prej pikës më të lartë 2.1 edhe 2.2. Sa për propozimin edhe dilemën kush duhet të menaxhojë me këto mjete, a duhet Fondi të jetë pranë KQZ-së apo pranë Kuvendit, unë mendoj se për KQZ-në duhet të jemi të orientuar 01% se është për aktivitetin parazgjedhor dhe zgjedhor, por dhjetëfish janë mjetet për aktivitete të rregullta edhe është 1% , ato janë mjete të mëdha, prandaj nuk mund të orientohet kah Komisioni Zgjedhor. Prandaj, mendoj se duhet të jetë buxheti në Kuvend ose në tjetër institucion ose në Qeveri. Këtu e kam dilemën, por adresa nuk duhet të jetë për të gjitha mjetet kah Komisioni Qendror. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bajram Kosumi, le të përgatitet deputetja Gjylnaze Sylja.

BAJRAM KOSUMI: Ju faleminderit, i nderuar Kryetar!

Të nderuar ministra,

Zëvendëskryeministër dhe

Kolegë deputetë,

Ligji për financimin e partive politike është hartuar brenda standardeve qysh hartohen ligjet në Kosovë dhe këtu nuk kam diçka të diskutoj. Ka të metat e veta për të cilat kolegët diskutuan deri më tash dhe për të cilat do të punohet në komisione që të evitohen.

Dëshiroj të theksoj po ashtu edhe unë nevojën që në Kosovë të ketë një ligj për financimin e partive politike për arsye se ky është hapi i parë që do të ndikonte pozitivisht në demokratizimin e partive politike në Kosovë, demokratizimin e brendshëm të partive, sepse rregullimi i çështjes të financave të partive politike, e determinon, e përcakton edhe më tutje pastaj demokratizimin e përgjithshëm të partive politike.

Unë dëshiroj t'ju përkujtoj se, duke qenë se Kosova është në vëzhgim të përgjithshëm ndërkombëtar, hulumtimin e para një viti të Transparensi International, ku një prej faktorëve më të korruptuar në Kosovë, evidentohen partitë politike, prandaj, miratimi i këtij ligji besoj do ta përmirësonte dhe do të hapte shtigje për demokratizimin e partive politike, por mendoj se, që në titull do të fillojë debati për këtë ligj. Titulli i ligjit është Ligji për financimin e partive politike, ndërsa do të duhej të ishte Ligji për financat e partive politike, sepse financimi e nënkupton vetëm një aspekt të financave, do të thotë, vetëm mënyra si financohen, ndërsa ligji në fakt e rregullon edhe mbikëqyrjen edhe kontrollin e financave të partive politike, prandaj, unë mendoj se Ligji do të ishte më e drejtë, më kuptimplote të quhet Ligji për financat e partive politike që nënkupton edhe financimin edhe mbikëqyrjen e financave të partive politike.

Janë dy nene për të cilat unë jam i interesuar të diskutoj sot, neni 10 dhe neni 7 që përcaktojnë dy mënyra të financimit të partive politike prej buxhetit të Republikës së Kosovës, do të thotë, prej parasë publike. Neni 10, përcakton financimin e partive politike gjatë fushatës zgjedhore ose për fushatën zgjedhore. Mendoj, është një zgjidhje shume e drejtë dhe financimi i partive politike për fushatën zgjedhore e ka edhe një mbështetje kushtetuese. Neni 45, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcakton angazhimin e institucioneve shtetërore që t'i nxisin qytetarët për të marrë pjesë në aktivitetet publike, politike e tjera e tjera.

Duke pasur parasysh faktin që në Kosovë ka rënë shumë numri i atyre që marrin pjesë në zgjedhje, pra i qytetarëve dhe duke pasur parasysh faktin se ky është një trend në tërë Evropën, mendoj se financimi i partive politike në fushata zgjedhore është i domosdoshëm dhe ka një mbështetje kushtetuese. Por, unë do të dëshiroja tash të debatojmë për nenin 7, i cili përcakton financimin e partive politike nga buxheti i Kosovës për aktivitetin e tyre të përditshëm. Pra, kjo do të thotë se buxheti i Kosovës, do t'i financojë partitë politike sipas këtij neni në tërë aktivitetin e tyre, jo vetëm zgjedhor, por aktivitetin e tyre të përditshëm. Për mua kjo është një çështje me një pikëpyetje të madhe mbrapa dhe është një çështje e cila do të ketë një debat, jo vetëm në Kuvend, por edhe një debat publik.

A mundemi ne si Kuvend ose Qeveria me propozimin e vet që të financojë aktivitetin e përditshëm të partive politike prej buxhetit të Kosovës, a ka mbështetje kushtetuese kjo? Unë i dëgjova diskutimet e kolegëve, është krejt e natyrshme, ne jemi deputetë dhe jemi anëtarë të partive politike dhe automatikisht themi po, sepse kjo prek interesat e secilit deputet dhe secilës parti politike. Por, unë e kisha ftuar Qeverinë, në këtë moment zëvendëskryeministrin që është këtu që e prezantoi ligjin, ku mund të ketë mbështetje kushtetuese, në cilin nen të Kushtetutës financimi i partive politike në jetën e tyre të përditshme?

Partitë politike zgjidhen, njerëzit e partive politike hyjnë në zgjedhje dhe formohet Qeveria, formohet Kuvendi, partitë politike i formojnë institucionet shtetërore në Kosovë dhe tash institucionet shtetërore marrin, miratojnë ligjin që do t'ua mundësojë partive politike financimin nga paraja publike. Mendoj se kjo është pika themelore e këtij ligji që është debat puro-politik, i pastër politikisht që duhet të debatohet edhe në Kuvend, por edhe jashtë këtij Kuvendi, duhet të debatohet edhe me strukturat tjera të shoqërisë në Kosovë.

Nëse partitë politike kanë të drejtë të financohen, ka edhe struktura tjera të organizuara që do të kërkonin të financohen, pse të mos financohen pastaj edhe OJQ-të? Ku është, cila është mbështetja kushtetuese që një parti politike për punën e saj ditore të financohet e një strukturë tjetër të mos financohet?

Kjo është praktikë që ka ndodhur më herët në Kosovë, do të thotë janë financuar partitë politike edhe më herët, nuk është kjo hera e parë që ndodh me këtë ligj, por unë tërheq vëmendjen që të bëhet një dallim midis fazës emergjente. Ju kujtohet të gjithëve që janë këtu, sapo ka përfunduar lufta në Kosovë, partitë politike nuk kanë pasur as zyra ku të ulen. Unë e mbaj në mend, jo vetëm ne, por edhe institucionet e jashtme që kanë qenë në Kosovë, OSBE-ja, ka paguar, ka financuar partitë politike që të konsolidohen nëpër zyra. Mirëpo, kjo fazë emergjente ka përfunduar, do të thotë, nuk jemi tash në fazën emergjente që t'i ndihmojmë partitë politike që të ngritën në këmbët e veta, prandaj, unë po them se duhet një debat dhe nuk besoj se financimi i partive politike jashtë fushatave zgjedhore, atë që e parasheh neni 7 ka mbështetje kushtetuese.

Siç u tha me të drejtë 1% e buxhetit të Kosovës, për buxhetin e vitit vijues nënkupton rreth 11 milionë euro. Për katër vjet që janë zgjedhjet qendrore, do të thotë, distanca midis dy palë zgjedhjeve, këto bëjnë 44 milionë euro, që duhet të ndahen nga buxheti i Kosovës për aktivitetin e partive politike. Edhe po ta zvogëlojmë këtë numër, që po e zvogëlojmë 50%, përsëri mbeten 22 milionë që ndahen për aktivitetin e partive politike, do të thotë, është një shumë e madhe e panevojshme që të ndahet nga buxheti i Kosovës. Ka 100 herë prioritete më të domosdoshme, më të nevojshme që të financohen dhe të shkojnë, të ndahen këto para të shkojnë të orientohen në prioritete tjera.

Partitë politike janë organizime vullnetare. Ata që themelojnë parti politike duhet të gjejnë burimet e financimit, duhet të ketë interes të popullit për të pasur partitë politike, interes të strukturave të ndryshme të shoqërisë dhe nuk mendoj se duhet që paratë e taksapaguesve t'i mbledhin ne taksat prej qytetarit dhe t'ia japim partisë politike që të bëjë aktivitet të përditshëm.

Prandaj, unë po ju ftoj edhe një herë, do të thotë, në parim pajtohem me këtë projektligj, që të bëhet debat edhe jashtë sallave të komisioneve me strukturat e ndryshme të shoqërisë të Kosovës që ta debatojmë çështjen e nenit 7 për financimin e punëve të përditshme të partive politike nga buxheti i Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla, le të përgatitet deputeti Hydajet Hyseni-Kaloshi.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, i nderuar zoti Kryetar!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Deputetë të nderuar,

Partitë politike janë element esencial i demokracisë pluraliste dhe për të luajtur rolin e vet legjitim duhet të financohen, por është me rëndësi që grupet e ndryshme të interesit të mos ndikojnë përmes këtyre financimeve në vendimet politike, prandaj, mirëpres Projektligjin për financimin e subjekteve politike.

Ky projektligj ka rëndësi se korniza rregullative duhet të parandalojë korrupsionin, por edhe humbjen e interesimit të qytetarëve për pjesëmarrje në jetën politike dhe sidomos në zgjedhje.

Projektligji duhet t'i definojë parimet mbi të cilat bazohet financimi i partive politike dhe fushatave zgjedhore, sidomos duhet të definohen qartë dhe strikt rregullat për donacionet private, pragu i shpenzimeve të partive, posaçërisht të lidhura me fushatën zgjedhore si dhe transparenca e plotë. Një vërejtje të veçantë e kam se është e paqartë vlera e shumës që mund të dhurojnë qytetarët e Kosovës brenda një viti, por edhe personat juridikë, që është përfshirë në nenin 5.1 dhe 5.2.

Mekanizmat tjerë kontrollues dhe mbikëqyrës po ashtu duhet të jenë të fuqizuar. Edhe në projektligj thuhet se këta mekanizma rregullohen kryesisht, sidomos kontrolli financiar përmes auditorit të përgjithshëm të Kosovës, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave në bazë të ligjeve ekzistuese dhe akteve nënligjore, por nuk përcaktojnë qartë se cilat ligje dhe cilat akte nënligjore janë këto?

Sa i përket përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së duhet cekur se BE-ja nuk rregullon këtë fushë ose fushën e financimit të subjekteve politike në mënyrë të veçantë, por kjo mbetet kompetencë e shteteve anëtare, ndërsa sa i përket implikimeve buxhetore mendoj se ka paqartësi lidhur me këto dhe se duhet menduar sidomos gjatë amendamentimit të ligjit, jo vetëm në komision, por gjithashtu i bashkëngjitem kolegëve se duhet të mbahet dëgjimi publik që të definohet mirë shuma e cila duhet t'u ndahet partive politike nga buxheti i Republikës së Kosovës. Në parim e përkrah.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni –Kaloshi, le të përgatitet deputetja Veriza Emrush.

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, kryetar!

Kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

E konsideroj të mirë dhe shumë të nevojshëm këtë ligj dhe e mbështes veçanërisht për faktin se ka qenë një nga kërkesat e raportit të progresit, ka qenë madje edhe një çështje që është përtypur e ripërtypur, por megjithatë nëse ka replika, le të krijojmë hapësira.

Theksoj përsëri faktin që është theksuar në Raportin e progresit si mangësi edhe pse ka pasur një rregullativë dhe nuk ka pasur vakum ligjor, por është e vërtetë se është përtypur dhe ripërtypur pastaj nga qarqe edhe këtu të brendshme edhe të jashtme si një mungesë e madhe. Unë uroj shumë që ky ligj ta rregullojë çështjen e financimit të partive politike, por më lejoni të shpreh dyshimin tim. Kam përshtypje që kjo pjesë që e rregullon financimin e partive politike që e konsideroj të rëndësishme është vetëm maja e Ajsbergut, mendoj problemet më të mëdha janë te forma alternative të financimit, pastaj e gjithë ajo që ndodh brenda, por pajtohem që nuk është koha më e mirë për ta shqyrtuar këtë ligj. Sidomos nuk mund të pajtohem aspak me ata që kërkojnë që pikërisht tash edhe të bëhen debate publike për këtë ligj. E mira do të ishte që ne ta miratojmë në parim, por pastaj ligji të pretë kohë më të mira për t'u miratuar përfundimisht.

Unë kam disa vërejtje të cilat desha t'i adresojë këtu me shpresë që pastaj kolegët që do të jenë të përfshirë drejtpërdrejt në amendamentim, t'i marrin e parasysh.

Në nenin 5, paragrafet 1, 2 është theksuar shuma sa mund të jenë donacionet për, në të vërtetë është krijuar hapësira, por është boshe, do të ishte mirë që sponzorizuesi ta plotësonte ligjin dhe si të tillë të na e sillte. Nuk është kjo çështje që mund ta bëjnë deputetët. Siç u theksua, mendoj se është e nevojshme të përfshihen edhe kandidatët e pavarur në financim, por veçanërisht kam vërejtje në neni 21 ku thuhet: “Nëse partia politike ose kandidati i pavarur cenon dispozitat e këtij ligji, atëherë partia politike është e detyruar t'i kthej mjetet”, e çka me

kandidatin e pavarur, sepse thuhet nëse edhe kandidati i pavarur... (flet dikush nga salla), por në të vërtetë nuk është për kandidatin e pavarur, është për partinë politike dhe duhet të korrigjohet.

Në nenin 11, është një dispozitë shumë e drejtë me ndalesa dhe vetëm këto unë i konsideroj dispozita, por në të vërtetë kam dilemë të madhe si mund të funksionojnë këto ndalesa për financime të jashtme, sidomos duke pasur parasysh mundësitë ose formula tepër poroze që na i ka imponuar pakaja e ligjeve të Ahtisarit. Uroj që Qeveria të jetë inventive dhe të gjejë zgjidhje.

Më del shumë problematike çështja e përjashtimit të ndërmarrjeve të cilat thuhet kanë raporte kontraktuese me institucionet e shtetit, si tepër hapët është kjo, sepse institucione të shtetit dihet çka mund të konsiderohen, kurse ndonjë kontratë edhe mund të ketë ndonjë kompani dhe ajo të përjashtohet nga mundësia e donacioneve, më del zor e zbatueshme dhe me pasoja.

Në nenin 14, kërkohet që për një vister çështjesh të përkujdesjes për financat e partisë, në gjuhën shqipe thuhet caktohet një zyrtar, do të thotë specifikohet një. Në gjuhën angleze është formë e papërcaktuar, por vetëm e pashquar, do të thotë, caktohet zyrtar, se sa i cakton subjekti është çështje e subjektit, sepse është e zorshme që një zyrtar t'i mbulojë të gjithë ato funksione që kërkohet. Kërkoj që kjo, do të thotë, propozoj të sqarohet, sepse do të kishte mundësi edhe abuzive.

Si të tillë e përkrah dhe besoj se pasi të kalojnë zgjedhjet do të miratohet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Vezira Emrush, le të përgatitet deputeti Riza Smaka.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč!

Ponovo pozdravljam sve kolege i Predsedništvo,

Ja sam našla za shodno da se javim pvodom člana 8. koji hoću da pročitam gde je ozvaničen, ustvari definisan cilj upotrebe sredstava iz fonda za podršku političkim subjektima, gde se daje sredstva iz fonda u koje svrhe mogu da se koriste.

Kao prvo, pod tačkom 1.1 ovog člana, finansijske afktivnsoti, finansiraju se finansijske aktivnosti političkog subjekta, znači same partije na centralnom nivou i po dva finansijska ogranka, finansijske partije poltičkih subjekata. Pod 3. su godišnji i materijalni troškovi poslanika i pod 4. troškovi za lokalne i centralne i vanredne izbore političkog subjekta.

Ovaj član 8. mora da se definiše malo bolje zato što imamo u praksi gde imamo političke subjekte sa više ogranka, gde kažem doslovce, gde imenjujem predsednike političkih partija koji vrše zloupotrebu i koriste sva finansijska sredstva političkog subjekta i nas zajednice u predizbornim kampanjama kada im donosimo glasove i poslanička mesta u Skupštini, gde se posle dalje finansira samo predsednik političke partije i njegova centrala. Ovaj član 8. mora dobro da se definiše, da se vidi, da se učešće stavi parcijalno učešće glasova koji su dobijeni po regijama i po ograncima i da se partija financira na onsovu te matematike, da dobija i deli sredstva tako.

Pod član 8, dalje bih imala primedbu na član 14. gde kaže: "Odgovornost za korišćenje sredstava" mi znamo da je danas pred nama Zakon o finansiraju političkih partija. Mi znamo da političke partije primaju sredstva, evidentiraju i normalno odliv sredstava evidentiraju. Kod ovog člana 14. regulisane su odgovornosti za korišćenje sredstava. Kaže se ponovo se daje u Zakonu mogućnost za dalju korupciju istih sredstava. Zašto? Zato što se kaže da politički

subjekat aodredjuje jednog finansijskog predstavnika, koji vodi odgovornost prilikom priliva i odliva sredstava za političku partiju. U ovom članu treba da postoji najmanje tri člana, od koja 2 treba da imaju deponovane potpise zbog balansa primanja i odliva sredstava. Mi imamo jake poteškoće koji dolazimo iz ostalih ogranaka, od samih svojih političkih subjekata i predsednika. Mislim da je u ovom Zakonu samo nastavljena sada ova praksa koja je bila punih 10. godina. Mora ponovo da se razmotri ovaj zakon, da se svaki član vidi, da se svaka zloupotreba sa merom, kaznenom merom obustavi. Zašto kažem kaznene odredbe kada su u pitanju, mi dobro znamo da su 10. godina korišćene pare za izbore i predizborne kampanje i za partije i niko nije davao finansijske izveštaje. Svakome se isplatilo da primi veliku svotu iz budžeta i od donatora i od svakog i da ne da finansijski izveštaj, da plati 3.000 eura. Svakome se isplati da uzme 100% a da plati 1%. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputeti i fundit për diskutim është Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Zoti Kryetar i Kuvendit!

Kolegë deputetë,

Qeveritarë,

Për dy pika do të isha përqendruar në parim. Me këtë dokument nuk janë precizuar çështjet e kontabilitetit, hyrja dalja, origjina e parasë dhe do të duhej me kaptinë të veçantë kjo tematikë të normohej, sepse ne e dimë fare mirë, ka bazë, mund të ketë pastrim parash nëpërmjet të ashtuquajtur grante, donacione. Kjo është relevante se paraja e pastër i jep edhe partisë politike figurë morale të pastër edhe autoritet edhe si e tillë mund të plasohet shumë më mirë edhe me këndshëm, qoftë edhe nëse humb, do të ketë autoritet moral më të lartë edhe anasjelltas, kjo është një. Dy, thuhet dënimet “gjoba”, “dënimet me të holla” do të duhej, duhet të precizohet medoemos procedura edhe organi i cili jo i shqipton, se shqiptimi bëhet në klasën e parë të shkollës fillore, por i cakton dënimet me të holla, do të thotë që mos të mbetet ligji i pa definuar se pastaj në praktikë paraqiten dilema jo, kam qenë, ato na quajmë, juristët e quajnë konflikti i kompetencave mund jetë pozitiv dhe negativ edhe ajo e qon deri te Ad Kalendas Grakes, domethënë, nuk përfillet fare. E bëjmë ligjin, prandaj edhe kjo çështje duhet të precizohet. Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Do të thotë nuk ka diskutues më. Mendoj se një sqarim duhet ta jap. Në projektligj ky përcaktim që bëhet është për zyrtarët e partisë për financa, mendoj që është i tepërt se mënyra e përdorimit të parasë publike nga buxheti i Kosovës është e përcaktuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe nuk mund të shfrytëzohen mjetet nga buxheti i Kosovës pa u mbështetur në Ligjin për menaxhimin e financave publike. Mendoj këtë duhet ta keni si sqarim po e them.

Vazhdojmë, jemi në procedurën e votimit. I lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Mirë, para se të hyjmë në votim, nuk e kemi numrin e caktuar. Ftoj deputetët që janë jashtë sallës të kthehen në sallë për të votuar.

Regjia le t’i bjerë ziles.

Nëse jeni dakord ne vazhdojmë me shqyrtimin e parë të Projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale pasi kemi numër, mund të debatojmë. Për votim nuk i kemi numrat. Vazhdojmë, 61, mirë u bë.

Lus deputetë dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Konstatohet se me 57 vota “për”, 3 “kundër”, 4 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për financimin e subjekteve politike.

Në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional,
- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisionin për Komunitete, dhe
- Komisionin për Integritet Evropian.

Pika e radhës është:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale

Në bazë të Rregullës 35, pika 1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji. Ftoj ministrin e Punëve të Brendshme, zoti Zenun Pajaziti, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë projektligjin.

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: Ju faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Më lejoni që ta prezantoj Projektligjin për mbrojtjen e të dhënave personale që është sponsorizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Ky është një ndër projektligjet që na ka munguar. I kemi bërë angazhimet e nevojshme që ta bëjmë një, ta prezantojmë para jush versionin më të mirë në mbështetje edhe të ekspertëve vendorë edhe ndërkombëtarë, të cilët kanë punuar, kanë filluar punën që nga muaji mars i vitit 2009.

Fushëveprimi i këtij projektligji është përpunimi i të dhënave personale nga organet publike dhe private, përveç kur grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave kryhet për qëllime krejtësisht personale. Ky ligj zbatohet edhe në zyrat diplomatike edhe konsullore si dhe në të gjitha përfaqësitë e tjera zyrtare të Republikës së Kosovës jashtë vendit. Për kontrolluesin e të dhënave i cili nuk është i themeluar në Republikën e Kosovës, por që për qëllim të përpunimit të të dhënave personale përdor pajisje automatike ose tjera në Republikën e Kosovës, përveç nëse pajisjet e tilla përdoren vetëm për qëllime të transitit nëpër territorin e Kosovës, në rrethana të tilla, kontrolluesi cakton përfaqësuesin e instaluar në Kosovë.

Ky ligj nuk zbatohet për të dhënat personale që përdoren gjatë hetimit të krimeve dhe procedurave gjyqësore, nuk zbatohet për informacionet e klasifikuara të sigurisë si dhe po ashtu nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave për qëllime të sigurisë kombëtare, parandalimit të krimeve dhe të mbrojtjes të shëndetit publik. Është ndër ligjet e fundit që kanë mbetur pa u prezantuar ose pa u kaluar që janë pjesë e procesit të integritetit evropian, por më tepër ky ligj është një nga kriteret themelore për procesin e liberalizimit të vizave. Unë kam prezantuar siç thashë një version i cili është punuar në mënyrën më të mirë të mundshme nga ana e ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë dhe kërkoj nga ju që të aprovohet dhe të procedohet më tej në procedurat e Kuvendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI EQREM KRYEZIU: Ju faleminderit, zoti ministër! Pas kësaj paraqitjeje, hapim debatin për diskutim në parim. Meqë kryetari i Komisionit nuk është paraqitur, kalojmë

menjëherë të deklarimet e shefave të grupeve parlamentare dhe Partia Demokratike e Kosovës. A është Selvie Halimi në emër të Partisë? Urdhëro, e keni fjalën!

SELVIE HALIMI: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Partia Demokratike e Kosovës ka shqyrtuar në parim Projektligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe mendon se ky ligj duhet të marrë përkrahjen në parim edhe nga Kuvendi i Kosovës. Të gjitha ndërhyrjet sipas Partisë Demokratike që mund të bëhen në këtë projektligj gjatë amendamentimit janë kryesisht ndërhyrje teknike të cilat nuk janë të ndonjë rëndësie substanciale, por megjithatë duhet të bëhet ndërhyrje teknike në amendamentimin e këtij projektligji dhe të gjitha këto besoj që shumë shpejt do të kryhen në komisionet funksionale dhe do të na vijnë sa më shpejtë për lexim të dytë në Kuvend.

KRYESUESI: Faleminderit, shumë zonja Halimi.

Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, fjalën e ka Anita Morina -Saraçi.

ANITA MORINA- SARAÇI: Faleminderit, zoti Kryesues!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Dhe, vijmë në përfundim se projektligji është i rëndësishë së veçantë siç e tha edhe ministri- përcakton drejt përgjegjësitë dhe masat e marra lidhur me grumbullimin, përfundimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Në përgjithësi projektligji është mirë i definuar, mirëpo ka paqartësi te neni 4, paragrafi 3, e shpjegoi ministri në fjalën e tij. Kisha dashur që arsytimi që e tha ministri të futet në projektligj. Gjithashtu, ka paqartësi edhe te neni 76 ku i jepet e drejta e ekspertit të mbrojtjes së të dhënave të kryejë kontrollin me vetë iniciativë. Gjithashtu edhe të heshtë të dhënat personale, dhe i lihet mundësia që në mënyrë vullnetare eksperti i mbrojtjes së të dhënave ta informojë subjektin e të dhënave ose mos ta informojë, do të thotë, thuhet mund ta informojë, nuk thuhet që duhet ta informojë.

Tash në përgjithësi është mirë i definuar, kështu që Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështet në parim, ndërsa këto dhe vërejtjet e tjera do t'i japim në komisionet përkatëse. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Saraçi!

Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, e ka fjalën zotëri Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zotëri Kryesues!

Të nderuar ministra,

Shfrytëzoj rastin të jap qëndrimet e Grupit Parlamentar të AAK-së në lidhje me këtë projektligj. Vlerësojmë se është një ligj i radhës- i mirë, që vjen nga kjo ministri në shqyrtim, në lexim të parë në Kuvendin e Kosovës, është i sistemuar mirë. I japim mbështetje në parim këtij projektligji. Vetëm një sqarim të vlerësimi i ndikimit buxhetor, po më duket se këto shifra duhet të rishikohen ose të përmirësohen, sa i përket edhe qirasë vjetore edhe të viti 2011, për shembull për 10 vende pune- 12 mijë euro, ndërsa 2010, 15 mijë euro. Mendoj se duhet të korrigjohen ose të plotësohen me rishikimet e radhës të buxhetit ose të hartimit të buxhetit për këto vite.

Në parim përkrahim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Maloku!

Për Aleancën Kosova e Re, zoti Smaka, apo Makolli? Zoti Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: Faleminderit!

I nderuar zotëri Kryesues,

I nderuar zotëri zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Deputetë të respektuar,

Ky dokument është një akt juridik i përgjithshëm, i nevojshëm, pa kurrfarë diskutimi. Ky ligj duhet të ketë funksion, jo vetëm mbrojtës, por edhe ruajtës të dhënave personale. Ky është një aksent tepër i rëndësishëm, jo mbrojtës, po plus ruajtës, te neni 1. Me nenin 2 janë ofruar shumë baza juridike për qasje, për elaborime, për përdorime, të mos them, spekulime se edhe spekulimi është njëfarë përdorim i të dhënave personale që janë aq tepër të ndejshme, sidomos në ambientin tonë ku me vend dominon gjithnjë ai mentaliteti ta quaj kështu në sensin pozitiv patriarkal.

Në nenin 1, paragrafi 19, thuhet, ndër tjera, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është agjencion i pavarur i ngarkuar për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale. Kjo thuhet kështu, ama në qoftë se i analizojmë edhe dispozitat pasuese nuk garantohej ky funksion bile, bile as nuk garantohej edhe mundësia që ky agjencion nëse do të themelohej u mor vesh po them nëse me një kushtimore se ndoshta në diskutim të mëtejshëm do të bjerë, se a thua mos do të ketë autorizime për përdorime arbitrare të dhënave personale?

Në nenin 4, ju lutem një formulim problematik thotë: “Ligji zbatohet për përpunimin e të dhënave personale nga organet publike dhe private”. Ju lutem, në qoftë se thashë organet private do të kishin pasur të drejtë për qasje e të tjera, do të ishte skandaloze, konsideroj. Kjo temë është shumë e ndjeshme.

Në nenin 4, paragrafi 6 thuhet:” Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për të dhënat personale gjatë procedurës penale”. Pse? Përderisa, në qoftë se do të hapej procedura penale ashtu e kështu do të duhej të kërkohejshin të dhëna të sakta, domethënë pse, në qoftë se ato veç do të ishin apo jo, sepse ato kushtojnë a dini për ekzaminime, domethënë është çështje për meditim.

Te neni 5, po lidhur me nenin 15 thuhet: “kjo dispozitë jep autorizim për përpunim të dhënave personale për nevojat e kontraktorëve”. Të mos harrojmë se kontrata është akt marrëveshje ndërmjet dy apo më shumë kontraktorëve, ju lutem është çështje eksprivate krejtësisht, qoftë shteti kur kontraktin me një entitet natyral, kjo çështje domethënë jus dispozitivum, prandaj pse atëherë po e zëmë institucioni shtetëror publik shtetëror të mbledhë të dhënat, të përpunojë, të klasifikojë, të sistemazitojë edhe t’ia afrojë një kontraktori që mund të jetë edhe malafidej-qëllimkeq?

Te neni 5, paragrafin 1, alinenë 4. thuhet: “Madje ky ligj hap mundësi për përpunim të dhënave personale për mbrojtjen e interesave jetike të subjektit të dhënave”. Do të thotë kinse paska autorizim, paska ingerencë, po e zëmë, organi apo institucioni publik që t’i marrë të dhënat top-sekrete, personale edhe ato për interesin e atij apo të asaj. Kjo është në kontradikcion.

Te neni 6, paragrafi 4. tri pika përpara, “Autorizohen për përpunim të dhënave personale edhe shoqatat”, ne sot kemi sa unë e di vetëm OJQ, Enzhio e kap shifrën një mijë e diçka ndoshta edhe më tepër. Asociacionet, sindikatat, punonjësit shëndetësorë, po atëherë të thuhet kushdo që i tekton ka të drejtë në qasje të dhënave personale. Kjo për mua nuk mund të jetë kurrësi e kuptueshme.

Te neni 16: “me këtë dispozitë krijohet bazë juridike për formësim të dosjeve, të katalogëve të sistemeve të dosjeve”, por nuk garantohet sigurimi efikas i tyre. Dosjet për popullin tonë në përgjithësi në Kosovë janë si t’i quaj kësisoj një formë tepër e frikshme e ethshme të trajtave të manipulimeve, të spekulimeve me të dhënat personale.

Me nenin 21 thuhet. Ju lutem “çdo person ka të drejtë pa pagesë të konsultojë regjistrin e sistemeve të dosjeve që mbahet nga Agjencia ta kopjojë, ta transkriptojë.” Kjo me të vërtetë nuk mund të ketë kurrfarë rezoni, çdo person. E tash person do të thotë fizik a juridik e tjera e tjera.

Përfundimisht me dispozitat e neneve 27, 29, 42 paragrafi 2, bëhet një konfuzion se me disa hapet baza juridike për procedim në procedurën gjyqësore, ndërsa me tjerat shprehimisht procedurë administrative, këto duhet të harmonizohen. Unë do të isha angazhuar se kjo çështje të trajtohet me procedurë administrative, sepse organet të cilat do të kishin autorizim për t’i marrë këto të dhëna për t’i përpunuar janë kryesisht të administratës edhe procedura administrative në parim është më efikase se sa kjo gjyqësore së paku- tani për tani. Edhe ju lutem te neni 42, paragrafi 2, ja çka thuhet: “Procedura ankimore normohet me akt nënligjor të agjencionit.” Aktet, çështjet procedurale janë ekskluzivisht të rangut e të nergut të ligjit, kem ligj për procedurën e përgjithshme administrative, ligj sistemor, edhe një numër të konsideruar të ligjeve procedurore të veçanta, këto me ligj qysh mund agjencioni të caktojë rregulla procedurore, këtë mund ta bëjë vetëm Kuvendi, ju lutem, edhe kjo do të delte se agjencioni do të kishte juridiksion te legjislativi.

Në nenin 79, nivelet e dënimeve me të holla janë të ulëta se të gjitha këto që janë të përcaktuara si dënime me të holla këto kanë elemente esenciale të krimeve të veprave penale. Prandaj, do të duhej të rishikohen edhe të ngritën edhe se gjobat që i quan ky dokument gjoba, dënime me të holla në këtë rast nuk janë distimulative për shkelësit e dispozitave të këtij ligji, por janë stimulative.

Edhe përfundimisht Grupi Kuvendor i AKR-së e mbështet këtë dokument edhe do të angazhohet me kapacitetet e veta për të dhënë kontribut që të bëhet më i mirë edhe të miratohet dhe me shpresë se do të aplikohet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Smaka!
Fjalën e ka zotëri Adem Salihaj, për LDD.

ADEM SALIHAI: Edhe Grupi Parlamentar i LDD-së e ka shqyrtuar këtë projektligj, është një projektligj i mirë që është i nevojshëm për qytetarët, për mbrojtjen e të dhënave personale, për mbrojtjen e personalitetit të tyre. Në këtë fazë nuk e shohim të nevojshme të zhvillojmë debate, ne do ta japim kontributin tonë dhe vërejtjet tona eventuale në procedurat e mëtutjeshme. Në parim e përkrahim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Salihaj.
Nga Grupi “7+” nuk ka të paraqitur. Tani e ka fjalën zotëriu Merxha, në emër të Grupit “7+”.

ZYLFI MERXHA: Zotëri kryesues,
Zotërinj ministra, zëvendësministër,
Ju përshëndes të gjithëve.

Edhe ne “7+” e përshëndesim kështu një ligj që erdh tashti, është dashur të vijë, normalisht në komisionet do ta përmbushim edhe më shumë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Merxha!

Nga Grupi SLS, nuk ka të paraqitur.

Së këndejmi kalojmë te lista e deputetëve të paraqitur për fjalë, dhe i pari është zotëri Adem Hajdaraj, të bëhet gati zotëri Ibrahim Makolli.

Adem Hajdaraj e ka fjalën.

ADEM HAJDARAJ: Faleminderit, zotëri kryesues!

Dhe ju qeveritarë,

Deputetë të nderuar,

Unë e mbështes këtë ligj, natyrisht e kam mbështetur edhe brendapërbrenda grupit parlamentar, është një ligj i rëndësishëm dhe i domosdoshëm, por ma ka tërhequr vëmendjen një gjuhë bukur e rrjedhshme, prandaj edhe hyra e lexova pak më me ëndje se do që po kanë gjuhë jo të rrjedhshme nuk po më tërheqin t'i lexoj, t'ju them të vërtetën.

Prandaj, kur e lexova unë mendova se krijimi i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk është i nevojshëm. Parimisht po them për arsye se po i krijojmë një mijë agjenci, me të gjitha agjenci, agjenci dhe nuk është i nevojshëm për arsye se krijon kosto buxhetore të panevojshme kur personi të cilit i janë shkelur të drejtat e tij mund ta bëjë këtë mbrojtje me anë të padisë në gjykatë ose me paraqitje të një propozimi për ndjekje penale, kreu IV, nën kreu b, neni 29 i këtij ligji merret me këtë çështje.

E dyta, me nenin 42 që e përmendën edhe disa deputetë të përcaktohet afati kohor i shqyrtimit, këtu me ligj nuk është përcaktuar afati kohor. Ai mund të shkojë në pafundësi dhe njeriu të mos marrë përgjigje fare, domethënë t'i cenohet e drejta, prandaj kjo dispozitë të formulohet si në vijim: "Agjencia duhet brenda afatit kohor prej 30 ditësh ta shqyrtojë ankesën edhe brenda këtij afati ta informojë ankuesin përkitazi me rezultatin dhe veprimin e ndërmarrë", nëse është agjencia, nëse s'është agjencia që unë nuk e shoh të arsyeshme këtu të ketë agjenci, por ka organe të tjera që merren dhe drejtpërdrejtë edhe me gjykatë apo jo si thashë më parë.

Me nenin 29, agjencisë në veçanti i janë dhënë të drejta dhe përgjegjësi ku me paragrafin 2.2 të këtij neni është përcaktuar zgjidhja e ankesave të atyre të cilët pretendojnë se e drejta e atyre për mbrojtjen e të dhënave u është shkelur, ndërsa me nenin 42.2 është përcaktuar procedura lidhur me ankesat

do të rregullohet me akt nënligjor nga agjencia. Mendoj se duhet të përcaktohet qartë++ kufiri i shqyrtimit të ankesës dhe zgjidhja e tyre, ndërsa me akt nënligjor të plotësohet procedura e paraqitjes së shqyrtimit të ankesës.

Kjo për arsye se na lind edhe një problem tjetër për sa i përket të dhënave që jepen për anketuesin, depërtimin edhe në shumë gjëra në bankën, të ardhurat e shumë të tjera që bie në kundërshtim edhe që është diskutuar në komisione edhe në Ligjin për prejardhjen e pasurisë dhe Ligjin kundër korrupsion, duke pasur parasysh rrethanat tona në Kosovë është e pamundur të jetë dhënë pasuria e plotë, sepse ende jemi në bashkësi familjare, kemi tokën e babës, babagjyshit që s'e kemi në emër tonë e kështu. Edhe këtu, në këtë ligj që të mos bie në kundërshtim, domethënë përpunimi i të dhënave personale me nenin 6, përpunimi i të dhënave personale të ndjeshme mendoj se duhet të përcaktohet shprehimisht se nuk i jepet e drejta Agjencisë Antikorrupsion të Kosovës dhe asnjë agjencie tjetër publike të dhënët, por as kësaj agjencie ose këtij organi që e kemi këtu për këtë ligj, asnjë subjekti pa pëlqimin e tij të shprehur qartë dhe me shkrim, se mund të hyhet në këtë, mund të bëhet këtë, përveç se nëse konstatohet se janë shkelur të rënda që, atëherë s'pyetet as personi as s'pyetet kurrkush po vijon procedura. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Hajdaraj!

Dhe për fjalë është paraqitur, zotëri Ibrahim Makolli,

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë do të përqendrohem vetëm në dy çështje, sepse po bëjmë fjalë për një prej ligjeve shumë të rëndësishme që e flet për mbrojtjen e të dhënave personale që janë të garantuara edhe me Kushtetutë, por edhe me norma ndërkombëtare, prandaj, duhet të kihet parasysh se kush mund të ketë qasje në këto të dhëna.

Do t'i referohem kreut IV ku flet për krijimin e një agjencioni shtetëror për mbrojtjen e të dhënave personale që thotë se është agjencion i pavarur dhe i ngarkuar për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe mbrojtjen e të dhënave. Dhe, po ashtu thotë se ky agjencion i përgjigjet drejtpërdrejt Kuvendit të Kosovës. Në një nen më poshtë ose në nenin 31 thotë kështu: Mbikëqyrësi kryesor shtetëror emërohet nga Kuvendi i Kosovës me propozimin e Qeverisë së Kosovës, andaj nuk mund të flitet për pavarësi të këtij organi, sepse një trup i cili i jep drejtpërdrejt është i pavarur dhe i jep drejtpërdrejt përgjegjësi Kuvendit të Kosovës nuk duhet të propozohet nga ana e Qeverisë, por në forma të tjera sikurse edhe në shumë, edhe në disa prej agjencioneve që ne i kemi. Sepse nuk mund të flitet për pavarësi, duhet një herë e përgjithmonë të ketë ndarje të pushteteve në këtë vend dhe po besoj që nuk i bën mirë dhe Qeverisë nëse gjithçka në këtë vend e koncentron në një njeri dhe ai është Kryeministri i vendit. Kështu e patëm edhe më herët edhe merrni me mend me të zgjedhurit që kanë për t' i udhëhequr disa klube në diasporë, do të thotë bie drejtpërdrejtë kompetencë e Kryeministrit, po flasim, nëse Kosova është shtet parlamentar megjithatë duhet kjo të respektohet.

Dhe, çështja e dytë që është shumë e rëndësishme të gjobat. Merrni me mend nëse këta njerëz e shkelin ligjin dhe bien në kundërshtim me këtë ligj dënohen me gjobë me mijëra euro, dhe ju e dini shumë mirë që ka të interesuar të cilët mund të paguajnë me qindra- mijëra euro ose me miliona euro për të pasur qasje në të dhënat personale të dikujt, sepse keqpërdoret dhe këtu ne kemi dënim me gjoba. E dini që në këtë vend ka pasur zyrtarë të lartë të institucioneve në të cilat ka edhe fshehtësi shtetërore dhe ata njerëz lëvizin prej këtyre vendeve, andaj çdo shkelje e këtij ligji do të duhej të paraqesë automatikisht vepër penale, sepse në të kundërtën nuk mund të garantohet mbrojtja e të dhënave personale të qytetarëve të vendit.

Zoti ministër,

Këto dy janë vërejtjet, unë e kuptoj që ju jeni të interesuar që kryeministri të zgjedhë çdo njeri, madje edhe drejtor të shkollave, por seriozisht nuk i bëni mirë vendit, nuk i bëni mirë as këtyre agjencioneve të cilat po krijohen. Nëse ky organ i përgjigjet drejtpërdrejt Kuvendit të Kosovës dhe asnjë institucioni tjetër, merrni me mend Qeveria duhet t'i propozojë Kuvendit se kënd ta zgjedhë, atëherë më mirë po e bëjmë që ky agjencion t'i përgjigjet Qeverisë drejtpërdrejt dhe le të bëjë çka dojë me to. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Makolli!

A dëshiron sponzoruesi ta marrë fjalën? E kemi edhe zotëri Sabri Hamitin.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zotëri kryesuesi i seancës!

Unë nuk do të interpretoj asnjë nen, vetëm mund t'ju them që jam i gëzuar që në Kuvendin e Kosovës ka ardhur një ligj i tillë. Kaq. E shoh fundamental për të drejtat e individit edhe të njeriut. Dhe, puna e amendamentimit do të jetë punë me rëndësi, unë mendoj që në seancën e kësaj, siç është ky leximi i sotëm, mund të jepen ide po nuk ka shanse që të bëhet funksionalisht kjo. Unë i thërras të gjithë këta që dhanë mendime shumë interesante që ose t'i shkruajnë vetë këto propozime ose t'i çojnë në komisionin që është funksional i rendit të parë për këtë ligj.

Edhe një herë po them, Kosova duhet ta ketë sa ma shpejtë këtë ligj dhe ta ketë në funksion. Faleminderit, zotëri kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Hamiti!

A dëshiron ministri ta marrë fjalën? Atëherë bëhuni gati për votim, por na duhet edhe një deputet, besoj që regjia mund t' i bjerë ziles pak.

Atëherë regjia dhe deputetët të bëhen gati dhe votojmë tash.

Konstatoj se me 58 vota “për”, 1 abstenim dhe asnjë “kundër”, miratohet ky projektligj në parim.

Në bazë të Rregullores së Punës Kuvendi ngarkon tani këto komisione.

1. Komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri, si Komision funksional,
2. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
3. Komisionin për Buxhet dhe Financa,
4. Komisionin për Komunitete, dhe
5. Komisionin për Integritet Evropian.

Komisionet duhen që brenda 2 muajve nga shqyrtimi i parë Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime. Ju faleminderit shumë!

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës:

Shqyrtimi i parë i projektligjit për shërbimet postare

Në bazë të Rregullës 35 pika 1 të Rregullores së Punës janë përmbushur tashmë kushtet për shqyrtimin dhe miratimin në parim të këtij projektligji.

Zotëri zëvendëskryeministri do ta paraqesë para deputetëve projektligjin.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit kryesues!

I nderuar Kryetar,

Më lejoni që në emër të Qeverisë së Kosovës të paraqes ekspozenë për Projektligjin për shërbimet postare. Qëllimi i këtij projektligji është sigurimi i ofrimit të shërbimit universal postar dhe shërbimeve të tjera postare, mbrojtja e interesave të shfrytëzuesve, sigurimi i trajtimit të barabartë dhe jo diskriminues të tyre, nxitja e konkurrencës së lirë dhe efektive në ofrimin e shërbimeve postare, nxitja e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit dhe sigurimit sekret e të korrespondencës për shfrytëzuesit në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Ky projektligj rregullon ofrimin e shërbimeve postare, mënyrën e kryerjes së shërbimeve postare, rolin e Qeverisë dhe të Ministrisë së Transportit dhe Postë Telekomunikacionit dhe të Rregullatorit në sektorin postar si dhe të drejtat dhe detyrat e operatorëve postarë për kryerjen e veprimeve operacionale dhe shfrytëzuesve të tyre.

Projektligji parasheh formimin e Autoritetit Rregullator për Shërbime Postare, i cili do të licencojë, rregullojë dhe monitorojë tregun e shërbimeve postare, parasheh futjen e shërbimeve të reja postare, gjopa dhe sanksione.

Ky projektligj parasheh edhe bashkëpunimin me administratat postare të shteteve të tjera.

Projektligji në pjesën hyrëse përmban përkufizimin dhe u jep kuptime të qarta nocioneve postare, pastaj ka të bëjë edhe me fushën e zbatimit të rolit dhe detyrat e Ministrisë, rolin dhe detyrat e Autoritetit Rregullator, mbrojtjen e shërbimeve postare, detyrat dhe obligimet e operatorit publik postar, bashkëpunimin me operatorë të tjerë postarë, procedurat dhe licencimin e operatorëve si dhe tarifën e shërbimeve postare duke përfshirë sanksionet për to.

Në hartimin e këtij projektligji kanë marrë pjesë ekspertët nga Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit, përfaqësues të grupeve të interesit që janë të përfshira të gjitha ministratë e interesuara dhe përfaqësues nga Qeveria të cilët kontributin e tyre kanë dhënë në këtë projektligj.

Duke u bazuar në faktin se organet përkatëse për zbatimin e këtij projektligji tashmë janë të themeluara dhe funksionale, parashikohet dhe vlerësohet se Projektligji për shërbimet postare nuk do të ketë efekte shtesë buxhetore dhe është në përputhje të plotë me direktivat e Unionit Evropian.

Ju lus ju, të nderuar deputetë, që të japin kontributin tuaj dhe ta miratoni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI JAKUP KRASNIQI: Faleminderit, zoti zëvendëskryeministër!

Kryetarja e Komisionit nuk e kërkon fjalën, mirë. Atëherë, vazhdojmë. Shefat e grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike kush e do fjalën? Fjalën e ka Sala Berisha.

SALA BERISHA – SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje zëvendëskryeministër,

Përshëndetje të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Unë do të bëj përpjekje që shkurtimisht të kursej edhe kohën edhe lodhjen e pasdites. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për shërbimet postare dhe ka arritur në përfundim që duhet ta mbështesim në parim. Kontributin tonë do ta japim në Komisionin funksional gjatë fazës së amendamentimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, shumë!

Në emër të Lidhjes Demokratike, Zef Morina e ka kërkuar fjalën.

ZEF MORINA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra, zëvendëskryeministër,

Kolegë deputetë,

Ky projektligj rregullon ofrimin e shërbimeve postare, mënyrën e kryerjes së shërbimeve postare, rolin e Qeverisë, gjegjësisht të Ministrisë së Transporteve dhe Telekomunikacionit dhe Rregullatorin në sektorin postar si dhe të drejtat e tyre operative- postare dhe shfrytëzuese.

Qëllimi i këtij projektligji është të bëjë sigurimin dhe trajtim të barabartë dhe jo diskriminues të operatorëve, nxitjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në ofrimin e shërbimeve postare, sigurimin e sekretit të korrespondencës për të shfrytëzuar në tërësi territorin e Republikës së Kosovës.

Këtu është një gabim, sa e kuptuam në zëvendëskryeministrin, në qoftë se bëhet fjalë për një rregullator të sektorit postar, atëherë në nenin 5 ku thuhet, që të gjitha funksionet për rregullimin e tregut të shërbimeve postare në territorin e Republikës së Kosovës i ngarkohen Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit, mendoj që kjo nuk është në rregull, sepse ART-ja merret

kryekëput me telekomunikacion, gjegjësisht me fushën e telekomunikacionit që është gjithsesi fushë e ndarë nga shërbimet postare.

Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah në parim projektligjin në fjalë dhe përmes anëtarëve të Komisionit do të japë kontributin në amendamentimin e këtij ligji. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ethem Çeku, e ka fjalën.

ETHEM ÇEKU: Faleminderit, zoti Kryetar!

Po ashtu, Grupi ynë Parlamentar në parim e mbështet këtë projektligj dhe besojmë se Qeveria do të marrë masa adekuate që ky projektligj të fillojë të implementohet në gjithë territorin e Kosovës dhe mos të na ndodhë si me disa nga ligjet e aprovuara nga Parlamenti i Kosovës që nuk mund ta aprovojmë dhe të implementojmë në gjithë territorin e Kosovës.

Sa i përket çështjes së rregullatorëve, mendoj që do të jetë një çështje që do të diskutohet edhe në komisionet parlamentare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të AKR-së, deputetja, Myzejene Selmani, e ka kërkuar fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, Kryetar!

Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re, ka shqyrtuar Projektligjin për shërbimet postare. Është një projektligj i cili është dashur të sillet ndoshta edhe më herët për arsye të rregullimit të shërbimeve postare në shtetin e ri të Kosovës në parim me legjislacionet e BE-së, mirëpo prapëseprapë në çështjet e përmbytjes është ligji mirë. Desha të potencoj, mirëpo e potencoi zotëri Zef Morina çështjen e ART-së dhe Autoritetit Rregullativ, në përgjithësi mund të them se ligji i përmbush kriteret që të kalojnë në shqyrtimin e parë, mirëpo të gjitha vërejtjet do t'i japim në Komisionin parlamentar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të LDD-së, Synavere Rysha.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e mbështet në parim Projektligjin për shërbimet postare dhe kontributin tonë do ta japim në komisionet funksionale.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, nuk ka. Në emër të SLS-së, nuk ka. Në emër të Grupit “7+”, fjalën e ka kërkuar deputeti Zylfi Merxha.

ZYLFI MERXHA: Zotëri Kryetar, ju përshëndes juve dhe stafin tuaj,
Përshëndes ministrat, zëvendëskryeministrin,

Edhe ne “7+”, në parim e pranojmë ligjin, se deri sot s'ka ardhur ligj më i mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti i lajmëruar për fjalë është Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar zoti Kryetar,

Do të angazhohem për disa terma shkurtimisht se po përsëriten nëpër akte tona që po i diskutojmë. Po e zëmë Konvikti i studentëve, konvikti është burg, duhet të thuhet Shtëpia e studentëve, fundi i fundit edhe Domi i studentëve se dom- domuz është nga latinishtja.

Edhe te neni 39 nuk është fjala për dëshmipërblim se shpërblehet ai apo ajo, ata apo ato kur bëjnë një punë të mirë. Këtu është fjala për kompensimin e dëmit, për zhdëmtimin, për reimbursesimin e dëmit ose gabimisht është përdorur letra me vlerë se nuk është letra me vlerë, ajo është shkresë me vlerë, a letrat me vlerë janë letrat komerciale, aty hynë: çeku, kambiali e garancioni, akreditivi, domethënë, është gabim material se jo në kuptim ashtu.

Te gjobat, rregullisht gjobat, gjobat, dënim me të holla, por do të duhej te neni 44 të precizohet kush i cakton dënimet me të holla, sepse i kemi gjykatat kundravajtëse, e kemi një projektligj që do të na vijë së shpejti, synohet që ato të abrogohen edhe funksionet e tyre në masë të konsideruar t'i supstitutojnë organet e administratës publike.

Edhe bie fjala thotë, të hyrat e krijuara sipas këtij ligji derdhen. Derdhen paratë kur humbin, kur gjuhen, kur gabimisht investohen. Ato, mirë është thënë në anglisht, depozitohen edhe në serbisht, kroatisht, boshnjakisht “prilivaju”, domethënë, paguhen në buxhet. Buxheti nuk është vendi kur derdhen paratë, po pikërisht ku depozitohen se kanë vlerë shtetërore, nacionale, prandaj ky term është ... është si të them ashtu krejt kontraverz në funksionin e vet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Pasi nuk kemi të lajmëruar të tjerë për debat, gjendja në sallë është 63 deputetë.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash:

Konstatoj se me 59 vota “për”, 2 abstenime, asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për shërbimet postare.

Në bazë të Rregullores së Punës, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si komision funksional,
- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisionin për Buxhet e Financa,
- Komisionin për Komunitete, dhe
- Komisionin për Integritet Evropian.

Vazhdojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit penal për të miturit**

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit penal për të mitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ftoj raportuesin e Komisionit funksional Ramadan Gashi, që para deputetëve të Kuvendit të prezantojë raportin me rekomandime.

RAMADAN GASHI: Faleminderit, zoti Kryetar,
I nderuar zoti zëvendëskryeministër,
E nderuara ministre,
Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në kuadër të kompetencave të veta, ka bërë edhe mbikëqyrjen e implementimit të Ligjit penal për të mitur, ku ka caktuar një grup punues që ka kontaktuar me të gjitha institucionet të cilat e bëjnë përcjelljen e zbatimit të Ligjit për të mitur dhe ka gjetur këto përfundime. Pra, ka mangësi dhe vonesa për nxjerrjen e udhëzimeve administrative nga Ministria e Drejtësisë për zbatimin e Ligjit penal për të mitur. Në mos zbatueshmërinë e ligjit kanë ndikuar edhe disa dispozita procedurale të ligjit të cilat kanë qenë nevojë e domosdoshme që të ndryshohen dhe të plotësohen siç janë: për shembull, formimi i institucioneve, mbikëqyrja e shtuar nga familja tjetër sipas nenit 21 apo dërgimi në institucionin për kujdes të posaçëm, neni 26 e të tjera.

Kapacitetet fizike profesionale, njerëzore dhe materiale janë të pamjaftueshme reflektojnë dukshëm në zbatimin e ligjit në Qendrën Edukative Korrektuese dhe në gjykatë.

Zbatimi i Ligjit penal për të mitur kërkon edhe ndërtimin e kapaciteteve të veçanta në sektorë përkatës për ekzekutimin e sanksioneve penale në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Ai sektor duhet t'i hartojë: strategjinë projektet, dhe programet për zbatimin e Ligjit penal për të mitur.

Është gjetur se ka mungesë të theksuar të gjyqtarëve dhe prokurorëve të specializuar për të mitur. Mundësia e gjyqtarëve për ta vizituar Qendrën Edukative Korrektuese në Lipjan është tepër e kufizuar, mungesa e Qendrës për Edukim dhe Qendrës Disiplinore konform Ligjit penal për të mitur, bashkëpunimi jo në nivel në mes të gjykatave dhe organit të kujdestarisë në Qendrën për Punë Sociale sa i përket dërgimit të raporteve.

Bazuar në këto përfundime Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka bërë këto rekomandime.

Të nxjerrën të gjitha aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit penal për të mitur, neni 155, të miratohen rregullat për rendin e brendshëm në institucionet korrektuese, të miratohen rregullat për rendin e brendshëm në Shërbimin Sprovues të Kosovës, të ngritët efikasiteti në dorëzim-pranimin e shkresave nga gjykatat tek personat e dënuar me theks të veçantë atyre shkresave që dërgohen me postë, të rriten kapacitetet ekzistuese të kujdesit, gjegjësisht trajtimit shëndetësor në Qendrën Edukative Korrektuese në Lipjan. Ngritja dhe themelimi i institucioneve të parapara me Ligjin penal për të mitur, siç është Qendra për Edukim dhe Qendra Disiplinore. Të shtohet numri i gjyqtarëve dhe i prokurorëve të specializuar për të mitur, të ndahet Qendra Edukative Korrektuese e Lipjanit nga Burgu për të Mitur në të cilën statusi i Qendrës të jetë ashtu siç është paraparë me ligj, të ngritën kapacitetet njerëzore dhe infrastruktura për Shërbimin Sprovues të Kosovës.

I rekomandohet Qeverisë së Republikës së Kosovës, gjegjësisht Ministrisë së Punëve të Brendshme që në kuadër të Policisë së Kosovës të krijojë një njësit të specializuar për punë me të mitur, të fillojë procedura për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit penal për të mitur të atyre dispozitave të cilat pengojnë zbatimin efikas të Ligjit penal për të mitur dhe, që Ministria e Drejtësisë t'i raportojë Komisionit pas 6 muajve pas marrjes së këtyre aprovimeve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Qeveria a e doni fjalën? Urdhëro, ministre e ke fjalën.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Falënderoj Komisionin për Legjislacion, Gjyqësi dhe Çështje Kushtetuese, i cili ka përcjell edhe ka bërë një raport të mrekullueshëm për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit penal për të mitur. Dakordohem plotësisht me rekomandimet që janë bërë, por dua ta njoftoj edhe Kuvendin edhe Komisionin se drejtësia për të mitur është në përfundim të reformimit të saj. Këto ditë pritet të shkojë në Qeveri draftligji që tani quhet Kodi për të mitur, në hartimin e të cilit kanë marrë pjesë shumë ekspertë, por edhe organizata si UNICEF-i, IOMI e të tjera, dhe të gjitha këto rekomandime që janë bërë dhe këto vërejtje do të eliminohen aq sa i përket Ligjit për të mitur dhe përputhjes së tij me standardet ndërkombëtare.

Ndërkaq, ky ligj ka një kosto shumë të madhe financiare dhe druaj se nuk mund të zbatohet në praktikë nëse nuk përcillet edhe me përkrahje financiare, përkatësisht buxhetore. Fjalën e kam për institucionet të cilat edhe vetë Komisioni i ka adresuar e këto janë institucioni apo Qendra për dërgimin e të miturve për kohë të caktuar, Qendra Edukative Korrektuese, pastaj ndërtimi i institucionit ku do të vendoseshin të miturit të cilët kanë të meta psikike dhe në atë gjendje psikike kanë kryer vepra penale për të cilat është paraparë dënimi me burg për të mitur e tjera e tjera.

Por, sa i përket akteve nënligjore këto janë përmbushur, megjithatë me që nxjerrët kodi i ri për të mitur do të hartohen edhe akte tjera nënligjore. E falënderoj komisionin për punën e bërë dhe unë kam vërejtje në rekomandime as në përmbajtjen e raportit.

KRYETARI: Faleminderit, zonja ministre!

Radha është e shëfave të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, kush e do fjalën? Po Ramadani e tha, më duket s'ka çka të thotë tjetër. Mirë, faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Armend Zemaj, e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zotëri Kryetar!

KRYETARI: Ty Armend është mirë të bëjmë shëf.

ARMEND ZEMAJ: Shëf kam qenë gjithherë veç, por zyrtarisht jo.

Faleminderit, zoti Kryetar! Kërkoj falje.

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar raportin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, duke marrë edhe informatat shtesë përmes anëtarëve të cilët kanë marrë pjesë direkt edhe në monitorimin e zbatimit të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Grupi Parlamentar i LDK-së pas shqyrtimit u shpreh përkrahje të plotë rekomandimeve të adresuara, Qeverisë në këtë rast Ministrisë së Drejtësisë. Duke marrë parasysh edhe atë që paraprakisht e tha edhe ministrja e Drejtësisë që ka një kosto financiare, por që është e domosdoshme për implementim për shkak të rëndësisë së veçantë në parandalimin e kryerjes së veprave penale dhe riedukimin e kryesve të veprave penale për të mitur.

Prandaj, edhe si grup parlamentar ne rekomandojmë që këto rekomandime të përcillen dhe të merren shumë seriozisht edhe pse e dimë që Ligji është në riprocedurë e sipër dhe ligjet tjera bazike që kanë të bëjnë edhe me riorganizimin e gjykatave dhe çështjeve të tjera që kanë të bëjnë me parandalimin e efekteve, domethënë, abuzive dhe negative, prandaj krijimi i kushteve për parandalimin dhe riedukimin është më se e domosdoshme. Këtë e kemi parë edhe si Komision gjatë monitorimit që kemi bërë ligjit, si në gjykata, ashtu edhe në këto që janë riedukuese apo edukuese që quhen, dhe ato mjete përcjellëse të cilat u mungojnë, sidomos të

miturve dhe me kalimin e kohës mund ta tejkalojmë edhe moshën dhe atëherë është shumë vonë të parandalohet që ata të jenë kryesit e veprave të mëdha penale.

Prandaj, si Grup Parlamentar e mbështesim këtë raport dhe u japim përkrahje rekomandimeve të dala nga monitorimi i zbatimit të këtij ligji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të AAK-së, deputetja Gjylnaze Syla, e ka fjalën. Mirë, s'e pata të shënuar këtu. Fjalën e ka deputeti Bajram Kosumi.

BAJRAM KOSUMI: Faleminderit, Kryetar!

Me të vërtetë këtu duhet një falënderim për grupin punues që kanë monitoruar implementimin e Ligjit penal për të miturit. Ju e keni në dokumentin dosjen këtu edhe punën që ka bërë grupi, takimet që ka pasur gjetjen që ka arritur dhe rekomandimet. Mendoj është një punë e mirë që është bërë nga grupi që ka monitoruar implementimin e këtij ligji.

Unë fillimisht shpreh përkrahjen e Grupit të Aleancës për grupin punues. Por dëshiroj t'i theksoj tri çështje që kam vërejtur duke qenë edhe unë vetë anëtar i këtij grupi gjatë mbikëqyrjes së implementimit të Ligjit penal për të mitur. Çështja themelore që është theksuar gjatë punës tonë ka qenë çështja e Burgut për të Mitur në Lipjan. Ne kemi qenë, e kemi vizituar besoj edhe një pjesë juaja e madhe ka qenë e ka vizituar. Ne po i themi Burgu për të Mitur, por zyrtarisht emri i burgut do të thotë është Qendra Edukativo- Korrektuese në Lipjan. Do të thotë, zyrtarisht kjo është qendër, nuk po flas për paraburgimin, por për Qendrën Edukativo- Korrektuese në Lipjan që në gjuhën e zakonshme i thonë burgu, por që zyrtarisht është Qendër Edukativo- Korrektuese dhe unë po e theksoj këtë dallim, sepse nuk është vetëm dallim në nocione, por është edhe një dallim thelbësor, përmbajtjesor.

Qendra Edukativo- Korrektuese në Lipjan nuk funksionon në përputhje me Ligjin penal për të mitur dhe me Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale për të mitur. Kjo qendër është një burg i vërtetë. Hyni, do të thotë- shikoni, po të vizitohet nëse doni Burgu për të Rritur në Dubravë ose Qendra Edukativo- Korrektuese, absolutisht janë njësoj, jo vetëm në dukje qysh e kemi evidentuar ne këtu në raport, por edhe në kushte të brendshme të miturit në Qendrën Edukativo- Korrektuese në Lipjan e vuajnë burgun, është një burg i vërtetë, prej pamjes së jashtme e deri te standardi, e deri te kushtet e jetesës aty është një burg i vërtetë.

Dhe, është edhe njëri prej rekomandimeve të grupit punues, por unë po dëshiroj ta theksoj edhe një herë këtu. Kjo Qendër Edukativo- Korrektuese nuk e kryen rolin rehabilitues, nuk e kryen rolin e risocializimit, riedukimit, pavarësisht prej vullnetit të mirë të personelit. Ne kemi parë një vullnet të mirë të personelit të burgut, por kushtet dhe regjimi i këtij enti në një mënyrë shumë të hapur është dënim, jo do të thotë masë korrektuese, por dënim, vuajtje për të miturit.

Prandaj, duke përkrahur fuqimisht rekomandimin për këtë çështje e ftoj edhe Ministrinë, por edhe institucione tjera që ndërlidhen me këtë fakt, që të ndërmarrin të gjitha veprimet e duhura që t'ia rikthejnë statusin juridik Qendrës Edukativo- Korrektuese në Lipjan, statusin ligjor që e ka kjo qendër, duke filluar nga heqja e telave gjemborë që e rrethojnë këtë qendër e deri te regjimi i burgut.

Ministria e Drejtësisë do të kishte mundur në këtë drejtim të ndihmojë duke udhëzuar komisaratin e Shërbimit Korrektues që të ndihmojë këtë qendër, disa institucione tjera që t'i zgjidhin disa prej problemeve që quhen teknike, por që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e përditshme të burgosurve. Për shembull në Qendrën Edukativo- Korrektuese në Lipjan, i riu që

dënohet dhe shkon ta vuajë dënimin aty, shkëputet prej familjes tërësisht gjatë periudhës sa është aty. Ta zëmë nuk është e rregulluar çështja e vikendit jashtë burgut, do të duhej të ekzistonte kjo e drejtë që të shtunave e të dileve i mituri të dalë në qytet dhe të bëjë disa orë pushim. Janë çështje teknike që nuk janë zgjedhur që disa vjet, por këto reflektojnë fuqimisht mjetin dhe në regjimin të cilit i nënshtrohen të rinjtë që janë të dënuar në atë qendër. Do të thotë i riu shkëputet një vjet, dy, totalisht prej familjes të vet, ai mund të jetë dhjetëvjeçar, mund të jetë dymbëdhjetëvjeçar, do të thotë aq që mund të flitet aty për masa edukuese- korrektuese. Pra, është një ndikim i kundërt.

Çështja e dytë që mendoj është e rëndësishme në këtë proces është profesionalizimi ose rritja e numrit të gjykatësve dhe të prokurorëve të profesionalizuar në çështjen e të miturve, e këtu futet edhe krijimi i një njësie profesionale të policisë që do të merret me të miturit. Është çështja thelbësore, do të thotë, i mituri kur bën një shkelje ligjore atë e merr në dorë së pari policia e cila do të thotë është e trajnuar për cilindo rast kriminal në Kosovë... policia e cila nuk është e trajnuar për çështjet e të miturve.

Dhe, çështja e tretë që e përmendi me të drejtë edhe ministria është Enti për Shërimin dhe Rehabilitimin e detyrueshëm edhe të miturve. Ky është një problem më i madh, për këtë çështje kem diskutuar edhe një herë më herët në Kuvend. Në Kosovë nuk ekziston Enti për Shërimin dhe Rehabilitimin e Detyrueshëm as të rriturve madhorë dhe as të miturve. Mendoj është e domosdoshme që: Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punëve të Brendshme të formojnë një grup dhe të kërkojnë nga Qeveria që të ndahet buxheti, të sigurohet lokacioni ku duhet të ndërtohet Enti për Shërimin dhe Rehabilitimin e Detyrueshëm të Dënuarve, atyre që bëjnë krime do të thotë duke qenë ose të sëmurë mentalë ose të varur prej drogës e tjera e tjera. Ju faleminderit edhe një herë shprehim përkrahjen për raportin e grupit dhe për punën e Ministrisë që është duke bërë në këtë drejtim.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Ibrahim Makolli, e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së e mbështesim këtë raport të Komisionit dhe po ashtu më duhet të them se kësaj është gjendja kur kopjohen ligjet pa ju përshtatur rrethanave të cilat ekzistojnë në vend. Dhe, do të jap arsyet pse e them këtë, sepse Komisioni gjatë monitorimit të zbatimit të këtij ligji ka hasur në një mori shkeljesh nga ana e autoriteteve të cilat janë të obliguara që ta zbatojnë këtë ligj.

Së pari, mungesa e institucioneve të parapara me ligj e që janë Qendra Disiplinore, institucioni edukativ, institucioni i kujdesit të posaçëm që sikur e dini përveç Klinikës së Psikiatrisë nuk ka tjetër. Përderisa po thuaj se $\frac{3}{4}$ e shqiptimit të këtyre dënimeve parashihen që të kryhen pikërisht në këto institucione. Në Kosovë nuk ka këso institucionesh dhe natyrisht pastaj duhet këta të mitur të dërgohen në Qendrën për Edukim në Lipjan.

Së dyti, mungesa e gjyqtarëve dhe e prokurorëve për të mitur. Në Kosovë mund të numërohen me gishta të një dore gjyqtarët që janë të specializuar për të mitur dhe prokurorët, ndërkaq po të njëjtit gjyqtarë nuk i kanë vetëm lëndët për të mitur, por po ashtu kanë edhe lëndët për madhorë, dhe gjithnjë jemi të vetëdijsëm se sa është rrit numri i veprave kundërvajtës ose edhe penale të miturve. Prandaj, kësaj do të duhej kushtuar një rëndësi të veçantë.

Ne kemi vizituar disa prej gjykatave edhe prokurorive të Kosovës dhe kemi parë se sa vështirë e kanë që t'i kryejnë detyrat e veta.

Në ligj, neni 123, thotë se çdo 6 muaj drejtori i institucionit apo Qendrës ku ekzekutohet masa edukative është i obliguar që shërbimit sprovues dhe gjykatës t'ia dorëzojë raportin e për sjelljen e të miturit dhe suksesit në ekzekutimin e masës, ndërkaq kjo në praktikë po thuhet se nuk ka ndodhur asnjëherë.

Po ashtu, në po në të njëjtin nen gjyqtari është i obliguar që për çdo 6 muaj t'i vizitojë të miturit e dënuar për të propozuar masa të mëturshme, ndërkaq edhe kjo në asnjë rast të vetëm nuk ka ndodhur dhe të miturit në momentin kur dorëzohen në institucion dhe deri në momentin kur lirohen nga ai institucion, nuk vizitohen më nga gjyqtarët për shkak të numrit të vogël.

Ajo që mund të thuhet se ka pasur sukses ndoshta në këtë ligj është sukcesi që ka treguar shërbimi sprovues, por që po ashtu janë vërejtur shumë herë dhe përzierje kompetencave me qendrat për punë sociale.

Ne si grup parlamentar e përkrahim këtë raport dhe natyrisht kërkojmë nga Ministria, dhe përgëzojmë Ministrinë që tashmë veç ka filluar që të mendojë dhe të punojë një ligj - kodin për të mitur. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Adem Salihaj, e ka fjalën.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë dëshiroj të them se Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi tashmë e bëri raportin e dytë përkundër faktit që është shumë i ngarkuar dhe ka një punë shumë voluminoze si Komision në trajtimin dhe rekomandimin e ligjeve për Kuvendin.

Ky është raporti i dytë dhe ne e kemi bërë një punë mjaft voluminoze, mjaft të lodhshme për t'i konstatuar këtë që e kemi sjellë këtu.

Kemi kontaktuar siç shihet me të gjitha institucionet relevante për ta konstatuar gjendjen dhe kemi parë se përkundër faktit se në pjesën më të madhe zbatohet Ligji penal për të mitur, megjithatë shihen edhe probleme në zbatimin e tij.

Problemet janë reflektuar në disa aspekte, pra në disa institucione përgjegjëse duke filluar prej Ministrisë, gjykatave dhe institucione për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Problemi i parë ka qenë te Ministria e Drejtësisë, së pari dëshiroj ta them edhe një aspekt teknik, ne s'kemi qenë të pritur si duhet në Ministri si Komision i Parlamentit të Kosovës. Pra, na është dashur të trokasim derë në derë që t'i gjejmë zyrtarët kompetentë që duhet të bisedojnë me ne dhe në fund pasi mezi i kemi gjetur në bisedën që kemi pasur me ta dhe në pyetjen pse nuk janë hartuar aktet nënligjore, përgjigja ka qenë që ne s'jemi kompetent por është kompetent Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm? Pra një pyetje qesharake që s'përkon me realitetin tonë të Kosovës së pavarur. Dhe, tash dëgjova ministren që i paskan hartuar aktet nënligjore, ne e përshëndesim këtë dhe mendojmë se puna e Komisionit dhe e këtij raporti, megjithatë ka pasur një efekt pozitiv.

Në anën tjetër ne kemi hasur në probleme te gjykatat. Kemi vizituar Gjykatën e Prizrenit e cila mbulon me sa mbaj në mend 5 komuna dhe ka vetëm një gjykatës për të mitur. Pra është i

stërngarkuar dhe natyrisht një gjykatës i vetëm për gjithë atë rajon nuk është në gjendje që ta kryejë punën si duhet, pavarësisht që ai kishte vullnet dhe ne kemi konstatuar se ishte një gjykatës i përkushtuar, por megjithatë një punë aq voluminoze është vështirë të kryhet me sukses.

Kemi hasur edhe në parregullsi dhe probleme dhe në Shtëpinë Edukative Korrektuese apo Burgun e Lipjanit. Edhe aty si pasojë e mungesës së akteve nënligjore, por edhe si pasojë e disa të metave të Ligjit penal për të mitur ka probleme në ekzekutimin e sanksioneve, po e zëmë, një kategori që kanë masa jo dënim kanë një regjim më të ashpër, janë më të diskriminuar në aspektin e trajtimit se sa ata që kanë dënime të mirëfillta ligjore dhe kjo si pasojë që kjo çështje nuk është e rregulluar si duhet me ligj. Pra, ata nuk kanë të drejtë vikendi, përkundër faktit që s'janë të dënuar, por kanë të shqiptuara vetëm masa, kurse të tjerët që janë të dënuar e kanë të drejtën e vikendit dhe kjo vjen thjesht si pasojë e mos rregullimit me ligj dhe akte nënligjore të këtyre çështjeve.

Të mos flasim edhe për trajtime, ne jemi në kushte tona çfarë i kemi, i kemi ato institucione dhe burgje çfarë i kemi. Nuk mund të themi se kemi një trajtim sikur në Zvicër, a Gjermani a ku e di ku. Ka raste edhe kur ka edhe masa që s'duhet të përdoren, janë të ndaluara me ligj e tjera, por të gjitha këto duhet t'i shohim në kontekst të rrethanave tona në Kosovë dhe natyrisht që nuk janë të lejueshme dhe Ministria dhe organet tjera nuk duhet ta tolerojnë një situatë të tillë.

Ne duhet të bëjmë përpjekje të mëdha që ata që janë në ato institucione qofshin të....., qofshin nën dënime të mos dalin nga ato institucione si kriminelë të aftësuar edhe më tepër si kriminelë që nuk do të përmirësohen, por të jetë një efekt i kundërt i të gjitha këtyre masave ligjore që i ndërmerr Ministria dhe institucionet përkatëse.

Grupi Parlamentar i LDD-së e përkrah dhe konsideron se ky raport me këto rekomandime do të ndikojë pozitivisht në përsosmërinë e zbatimit të Ligjit penal për të mitur. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar "7+", nuk ka.

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, nuk është paraqitur askush.

Për diskutim kemi të vetmin deputetë të lajmëruar deri më tani Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit!

I nderuar zoti Kryetar!

I nderuari zëvendëskryeministër,

Zonja ministre, ministër,

Të nderuar deputetë,

Unë dëshiroj që në fillim të përgëzoj Komisionin për Gjyqësi për një punë shumë të mirë të bërë për raportin e gjithanshëm, gjithëpërfshirës, por edhe mirë të strukturuar të cilin e ka sjell përpara Kuvendit.

Raporti pasqyron shumë mirë të gjitha të dhënat të cilat kanë të bëjnë me nivelin e zbatimit të Ligjit penal për të miturit, do të thotë duke përfshirë gjetjet të legjislatives se sa janë zbatuar dispozitat përkatëse ligjore, por gjithashtu edhe në praktikë, nëpërmes vizitave në terren, duke filluar nga gjykatat e qarkut, ato komunale, e pastaj institucionet korrektuese, shërbimet sprovuese si dhe vetë EULEX-in dhe Ministrinë e Drejtësisë, ka konstatuar mangësitë e zbatimit të këtij ligji, ka identifikuar problemet dhe në fund ka propozuar rekomandime.

Prandaj unë e mbështes të gjitha rekomandimet që i ka dhënë Komisioni. Të gjeturat që i ka ofruar Komisioni kanë të bëjnë me mekanizmat përkatës që ka gjet në takimet e zhvilluar me Ministrinë e Drejtësisë. Komisioni, pra ka konstatuar se tri udhëzime administrative ose akte nënligjore janë përpiluar sipas ligjit nga ana e Ministrisë së Drejtësisë dhe ky është udhëzimi administrativ për Shërbimin Korrektues të Kosovës, udhëzimi administrativ për kohën që duhet kaluar në institucionet korrektuese dhe tre, udhëzimi administrativ për menaxhimin zyrtar të arkivit në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Megjithatë, ndër problemet e identifikuara është se edhe pse nuk është zbatuar pra neni 196.2 për miratimin e rregullave për rendin e brendshëm në Shërbimin Sprovues të Kosovës edhe pse këto rregulla ekzistojnë. Gjithashtu nuk është bërë miratimi nga Ministria e Drejtësisë dhe të rregullave për rendin e brendshëm në institucionet korrektuese edhe pse ato ekzistojnë.

Gjithashtu nuk është zbatuar fare po thuaj se neni 69, megjithatë unë më tepër do të përqendrohem sidomos në pjesën e zbatimit të Ligjit që ka të bëjë me trajtimin e të paraburgosurve dhe personave të dënuar, pra neni 185.6. Është e qartë se nuk ekzistojnë as kapacitetet njerëzore, por as kushtet dhe rrethanat për trajtimin e rasteve të veçanta në institucionet e kujdesit shëndetësor, do të thotë në rastet kur gjykata shqipton masën e dënimit në bazë të rekomandimit të ekspertit të mjekësisë që të miturit të trajtohen në institucione të posaçme të kujdesit shëndetësor dhe jo në institucionet edukative ose edukativo- korrektuese, nga raporti del se kushtet e këtilla po thuaj se janë të limituara.

Nga ana tjetër gjetjet flasin edhe se gjykata pas një kohe të caktuar, gjegjësisht pas 6 muajve vazhdimisht rishikon nevojën e shqyrtimit të mëtejshëm të trajtimit të këtyre personave në institucionet e kujdesit të posaçëm si dhe kur ata i mbushin 18 vjet.

Gjithashtu një pjesë e dispozitës shumë e rëndësishme që ka të bëjë prapë me trajtimin shëndetësorë është mungesa e trajtimit shëndetësorë 24 orë, sidomos të atyre me probleme të mëdha dhe në veçanti të miturve të cilët duhet të trajtohen nëpër spitale, do të thotë, në institucionet publike, me qenë se nuk mund të zbatohen masat e sigurisë për të dënuarit.

Po ashtu një pjesë e problemeve ka të bëjë edhe me zbatimin e trajtimit të rehabilitimit të detyrueshëm, pra sipas nenit 182 sidomos të pjesës e cila ka të bëjë me rehabilitimin e detyrueshëm të kryesve të varur nga droga ose nga alkooli. Kjo mungesë e kapaciteteve, kushteve dhe rrethanave të limituara po ashtu paraqitet edhe në rastin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të specializuar për të mitur.

Unë edhe një herë e përsëris se që të 12 rekomandimet i përshëndes. Gjithashtu unë i propozoj Kuvendit dhe gjitha komisioneve tjera që të shfrytëzojë përvojën e Komisionit për Legjislacion ashtu që ministri përkatës të raportojë përpara Komisionit për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të propozuara nga Kuvendi i Kosovës. Pra, sipas këtij raporti, propozoj që Ministria e Drejtësisë të raportojë për nivelin e zbatimit të rekomandimeve çdo 6 muaj para Komisionit për Gjyqësi. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Pra, deputetja Gjylnaze Syla, ishte diskutuesja e fundit për këtë pikë të rendit të ditës.

Në sallë janë 63 deputetë, dhe lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, dhe votojmë tash.

Konstatoj se me 59 vota “për”, asnjë” kundër” dhe 1 abstencion, Kuvendi miratoi raportin me rekomandimet e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit penal për të mitur. Ju faleminderit! Mirë, shkoi.

Të nderuar deputetë, kemi edhe 4 pika të rendit të ditës. Nëse jeni dakord e vazhdojmë të hënën në orën 10.00. Vazhdimi i seancës. Mirë u pafshim!

E hënë, më 2 nëntor 2009, ora 10:00

Vazhdimi i seancës së filluar më 29.10 2009

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI:

Të nderuar deputetë,

I nderuari zëvendëskryeministër,

Ministra,

Kabinet qeveritar,

Para se të fillojmë me vazhdimin e seancës, ju lus që me një minutë heshtje, t’i përkujtojmë viktimat e tragjedisë të lumit Tisa. Ngushëllimet tona për familjet e viktimave.

Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar me 29 tetor 2009, për pikat e mbetura.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 62 deputetë, që do të thotë janë plotësuar kushtet për t’ia filluar punën.

Vazhdojmë me pikën e dhjetë të rendit të ditës:

**10. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti,
Industri, Transport dhe Telekomunikacion për korrigjimin e
referencave në Ligjin për gazin natyror, të miratuar në
Kuvend më 30 shtator 2009**

Ftoj raportuesin e komisionit funksional, zotin Ethem Çeku, që para deputetëve ta arsyetojë Raportin me rekomandime.

ETHEM ÇEKU: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke bërë pastrimin teknik të tekstit, na është përvjedhur në gabim që ka të bëjë me nenin 22, është hequr ai nen dhe duke larguar atë pjesë të nenit, janë larguar edhe disa pjesë tjetër e neneve, që e ka bërë ligjin jofunksional. Prandaj, si Komision, edhe një herë duke rishqyrtuar, i kërkojmë Kuvendit që të rikthehet tërësisht teksti i mëparshëm që ka të bëjë me nenin 22. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Shefat e grupeve parlamentare a donë deklaram: Jo. E përkrahni? Mirë. Ju faleminderit!

Në sallë kemi 64 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët, të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Tani në sallë janë 66 deputetë.

Me 58 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim Kuvendi miratoi rekomandimin e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Transport dhe Telekomunikacion për korrigjimin e referencave në Ligjin për gazin natyror, të miratuar në Kuvend, më 30 shtator 2009.

Vazhdojmë me pikëm 11 të rendit të ditës:

11. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Arsim Rexhepi me mbështetjen e deputetëve të tjerë për formimin e Komisionit hetimor për gjendjen në RTK

Deputeti Arsim Rexhepi, i përkrahur nga grupi i deputetëve nënshkrues, ka kërkuar nga Kuvendi themelimin e Komisionit hetimor për gjendjen në Radiotelevizionin e Kosovës.

Ftoj deputetin Arsim Rexhepin, që në emër të grupit të deputetëve nënshkrues ta arsyetojë propozimin.

ARSIM REXHEPI: I nderuari, zoti Kryetar!

Të nderuara deputete dhe deputetë,

Në bazë të Kushtetutës, 43 deputetë janë bashkuar me një kërkesë të nënshkruar, e cila derivon me automatizëm formimin e Komisionit hetimor i cili do t'i hetonte parregullsitë në keqmenaxhmin e Radiotelevizionit të Kosovës, të dëshmuara edhe me raportet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2007 dhe 2008.

Duke u bazuar në këtë ligj, unë i propozoj këtij Kuvendi, grupeve parlamentare që t'i propozojnë konform nenit 77 të Kushtetutës anëtarët e vet në këtë komision hetimor, pastaj gjatë konstituimit dhe punëve që do t'i marrë ky komision, ne do të shqyrtojmë edhe kontestin edhe lëndor edhe kohor se çka do të hetojmë.

Nga Lidhje Demokratike, kështu po flas edhe në emër të Grupit Parlamentar, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike në këtë komision hetimor propozon Arsim Rexhepin dhe deputetin Armend Zemaj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Unë jam i obliguar t'i them dy –tri fjalë. Ju e dini që kjo është përpjekja e dytë për të formuar Komisionin hetimor për gjendjen në Radiotelevizionin e Kosovës. Ju e dini që në emrat dhe nënshkrimet e përpjekjes së parë, ka pasur nënshkrime të pavullnetshme dhe është tërhequr nga rendi i ditës. Kisha kërkuar, nëse deputetët që i kanë parë emrat, a janë vërtet, a qëndrojnë prapa atyre nënshkrimeve dhe, një çështje tjetër që dëshiroj t'ia tërheq vërejtjen Kuvendit dhe deputetëve që e kanë propozuar, ju e dini se në kohën e fundit në adresë të institucioneve të Kosovës dhe mund të vjen edhe në adresën e Kuvendit të Kosovës, mos të konsiderohet kjo si ndërhyrje në Radiotelevizionin publik të Kosovës. Megjithatë, me Kushtetutë lejohet formimi i Komisionit hetimor me 1/3 e numrit të përgjithshëm të deputetëve.

Rendi është i shfave të grupeve parlamentare. Ramë Buja e ka fjalën.

RAMË BUJA: I nderuari, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Zoti zëvendëskryeministër,

Ministra të nderuar,

Ne edhe me Kushtetutë, por edhe në parim jemi për themelimin e komisioneve hetimore, atëherë kur shihet se diçka ka turbullirë në resorë të caktuar, por këtu nuk mund të jemi të pajtimit për faktin që ne po presim një raport financiar të Radiotelevizionit të Kosovës dhe akoma nuk e

kemi të qartë se ku jemi me pozicionet e kësaj natyre dhe për këtë, ne si grup parlamentar nuk jemi për të formuar tani për tani Komisionin hetimor për RTK-në. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të LDK-së, ju e thatë. Mirë. Në emër të AAK-së, Ardian Gjini e ka fjalën!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës i ka rezervat e veta në lidhje me krijimin e këtij komisioni, mirëpo për arsye krejt tjera prej asaj që e dëgjuam deri më tani. Ne mendojmë se financat e Radiotelevizionit të Kosovës që kanë të bëjnë me financimin e Radiotelevizionit, me mënyrën e menaxhimit të mjeteve publike, janë objekt i kontrollit të auditorit, rreth raporteve të cilat vijnë si rregull në Kuvendin e Kosovës, si themelues principiel i Radiotelevizionit të Kosovës. Sidoqoftë, ne si grup vërejtjet tona kryesore dhe mendojmë se problemet kryesore në Radiotelevizionin e Kosovës nuk kanë të bëjnë me këtë anë të medaljes, por kanë të bëjnë me interferimin e drejtpërdrejtë të institucioneve tjera publike të Kosovës në Radiotelevizionin e Kosovës dhe lidhjen e shkurtër, të shprehur me term teknik, të shumë njerëzve në Radiotelevizionin e Kosovës, gazetarët me tenderët e Qeverisë dhe me mjete tjera të punës përmes Qeverisë, të cilat e shkatërrojnë punën e institucionit publik. Këto janë çështje për të cilat ne si grup kishim dashur të bisedojmë, e jo drejtpërdrejtë si komision hetimor për financat, të cilat ashtu-kështu janë publike dhe janë objekt i auditimit si në çdo institucion tjetër publik.

Në këto rrethana, nëse ky komision hetimor nuk do të merret me aspektet për të cilat ne po flasim, ne nuk jemi të interesuar që ta mbështesim një komision i cili vetëm sa do të humb kohë edhe ta kryej një punë për të cilën ka institucione të themeluara nga ky Kuvend që i kryejnë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të LDD-së, Synavere Rysha.

SYNAVERE RYSHA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë i kemi rezervat tona ndaj formimit të këtij komisioni sepse, e para, forma se si po vjen kjo kërkesë në Kuvend, na duket pak sa e papranueshme dhe herë vjen në Kuvend, por në anën tjetër edhe tërhiqet, pas një presioni tjetër prapë vjen në Kuvend. Kjo është një formë që vërtet na duket që një lojë po bëhet me Kuvendin, prandaj në këtë mënyrë ne i kemi rezervat tona rreth formimit të këtij komisioni.

Është edhe çështja tjetër, e tha edhe kolegu nga AAK-ja, ka dhënë një raport EBU-ja, që vërtetë janë shqetësimet tona rreth këtij raporti, si duket këtu më tepër kemi të bëjmë me problemet, me ndërhyrjet nga jashtë, ndërhyrjet nga ana e Qeverisë, se sa që ka diçka më tepër në RTK. Prandaj, duke pasur parasysh që është formuar edhe bordi i RTK-së tash së fundi dhe do të merret kryesisht me RTK-në dhe do t'i qetë në dritë të gjitha ato dobësi dhe përparësi që do t'i ketë RTK-ja, ne do t'i mbajmë rezervat tona rreth këtij komisioni. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të AKR-së, deputeti Ibrahim Makolli e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, Kryetar!

Zoti Kryeministër,

Të nderuar kolegë,

Edhe Grupi Parlamentar i AKR-së ka rezervat e veta përkitazi me themelimin e këtij komisioni për shkak se shumica e arsyeve për të cilat u iniciua themelimi i këtij komisioni, tashmë janë të

paqena. Po ashtu, komisionet themelohen për një qëllim të caktuar. U tha edhe nga shumë kolegë këtu që të gjeturat e auditorit duhet të jenë objekt i vlefshëm për Kuvendin dhe duhet të jenë, natyrisht, objekt të cilin e trajton dikush tjetër dhe jo Kuvendi.

Nuk është mesazh i mirë për Kosovën krijimi i komisioneve kur kanë të bëjnë me mediet, sepse edhe ashtu Kosova po atakohet, po akuzohet që po e ngulfat fjalën e lirë dhe mediet dhe ne kemi rezervat tona, madje një prej deputetëve tanë, i cili është i nënshkruar në këtë listë, ka deklaruar që nuk është nënshkrimi i tij në këtë kërkesë dhe prandaj do të doja që të ketë një sqarim të qartë, nëse është kjo çështje e vërtetë ose jo. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit “7+”, deputeti Xhezair Murati e ka fjalën.

DŽEZAIR MURATI: Dozivolite predsedniče da vas pozdravim vas i zamenika premijera, ostale članove, minsitre, kolege i goste,

Mislim da u ovom trenutku ako bismo formirali taj anketni odbor, onda bi bili sami protiv sebe, samim tim što smo tek nedavno izabrali na jedvite jade bord RTK-a. Sada treba omogućiti, mislim, ovom javnom mediju da se konstituiše, da počnu da rade a kamo li odmah u početku sada da mi tu sa nekačim, ja bih rekao čvrstim stavovima i tako dalje. Mi nismo potpisnici ovog zahteva. Nijedan iz Grupe „7+“, nemamo dakle potpisnika. Mi podržavamo predloge nekih od prethodnih šefova grupa i partija da mi ostavimo jedno vreme da se Televizija konstituiše, da počne da radi pa da izvrši novo rukovodstvo analizu kako radi, dali ponavlja greške prethodnih, pa da onda razgovaramo. Znači, u ovom momentu mi smatramo nepotrebnim formiranje Anketnog odbora za proveru nepravilnosti rada u RTK-a.

KRYETARI: Ju faleminderit,deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS, a e do dikush fjalën? Nuk ka. Atëherë është radha e deputetëve. Vazhdojmë me deputetin Numan Baliq.

NUMAN BALIĆ: Ju faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit!

Ja ću svakako dati jedan malai doprinos ovom razgovoru oko ove važne teme. Radiotelevizija Kosova je javni medij koji se finansira iz sredstava građana i čiji je osnivač Skupština Kosova.

Smatram da je Radiotelevizija Kosova veoma važna i da je njen uticaj veoma visok, ponekad i presudan, ne samo u ova vremena, kao što su vremena izbornih kampanja, nego u svim vremenima kada se oblikuje javno mnjenje i kada se razgovara o mnogim stvarima.

Osnivač Radiotelevizije Kosova jeste ovaj Parlament i zato je vrlo bitno rad Radiotelvije Kosova. On se neposredno finansira iz onih izvora o kojima smo mnogo puta govorili, a to su javni izbori koji su veoma bliski sa budžetom Kosova. Moramo ponoviti neke stvari. Radiotelevizija Kosova ne može biti nezavisan niti ona jeste nezavisna, niti je bilo ko na zemlji nezavisan. Ovde samo je pitanje pod čijem će uticajem ona biti. Ako ne bude pod uticajem Parlamenta, onda će biti pod uticajem nekog drugog. Ja moram da spominjem jednu veoma važnu stvar da se nama poslanicima i parlamentu stalno spočitava jedna stvar koja se tiče toga da Parlament Kosova ima važnu ulogu u svim stvarima, u svim javnim stvarima, oko Vlade, oko finansija, oko mnogih programa, razvoja, nezapošljenosti, medija i tako dalje i tako dalje. I sada Radiotelevizija Kosova ostaje van našeg uticaja. Ja potpuno podržavam to da se formira Istražna komisija i da se istraže poslovi nunutar Radiotelevizije Kosova, ne samo onih koji se tiču poslovanja, ne asmo onih koji se tiču sumnjivih tendera, ne samao onih koji se tiču sumnjivih ugovora koji su donjeli koristi od milionske koristi mnogim ljudima koji su pomenuti, nego i zbog programa koji se tamo emitira. Taj program je prilagodjen ili onima koji imaju veliki uticaj u vlasti, ili onim strankama koje su jake i imaju puno novca, ili onima

koji imaju određene finansijske krugove ili bilo kojim ljudima koji imaju veliku moć. Moram veoma otvoreno da govorim.

Radiotelevizija Kosova je naklonjena ljudima od moći u ovoj zemlji i obični građani su daleko van uticaja te takozvane javne televizije koja je javna onoliko koliko je javan i rad onih koji je financiraju i koji stoje iza nje.

Da napomenem i to da na toj televiziji ima vrlo malo prostora za one koji su mali, koji su slabi, koji su nejaki, za male političke subjekte, za druge kategorije, za druge načine razmišljanja. Da napomenem i to da je vjerski program potpuno osiromašen, da su kulturni sadržaji veoma slabi, da je obrazovni nivo veoma nizak i da na karaju, evo završavam, neću vas opterećivati, onaj deo koji se tiče drugih zajednica. U onim programima na bosanskom i drugim zajednicama, program na bosanskom je onaj koj deluje na štetu Bošnjačke zajednice. Uredništvo te televizije radi godinama na štetu ili držite zatvorene oči i vi, gospodine predsedniče, i svi koji bi trebali odlučivati oko toga. Oni direktno nanose štetu i rade tako što favorizuju jedne, a potpuno omalovažavaju i isključuju druge. To je diskriminacija, to je nasilje u mediju sa kojim se mora konačno prestati. Ja sam o ovome mnogo puta govorio na medijima, meni se sjeku izjave. Ja nemam drugog načina osim da to kažem na govornicu Skupštine. Urednica Vlasi, koja stoji u tom programu, ona otvoreno radi na štetu te zajednice i mora se jednom stati na kraj tim ljudima, dok Zatrići je bio iza nje i dao je ostavku. Vreme je da i ona da ostavku. Ja vas molim da je vrlo bitno da Komisija za istraživanje istraži rad svih redakcija, svih programa, poslovanja i svega onoga što se traži. Hvala vam ljepa!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjala është për deputetin Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë, aq sa jeni këtu,

Kur është fjala për Radiotelevizionin e Kosovës, duhet ta dimë se ai është Televizion publik. Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për Radiotelevizionin e Kosovës. Një pjesë e buxhetit, pra të Radiotelevizionit të Kosovës, me vendim të këtij Kuvendi, kur është miratuar Ligji për RTK-në, financohet nga faturat, ai i famshmi 3.5 euro për çdo faturë të KEK-ut, pra ky Kuvend ka vendosur dhe emëron edhe Bordin e RTK-së. Pra, Kuvendi duhet të merret edhe me RTK-në për shkak të këtyre arsyeve që unë i thashë më parë.

Komisioni hetimor nuk është kërkuar për politikat programore të RTK-së, nuk është kërkuar për të hetuar anshmërinë apo jo të gazetarëve, të programeve, sa orë për cilin komunitet ka, pra replikoj me fjalën e parafolësit tim. Ky Komision hetimor është kërkuar vetëm për një shkak. Kur është dhënë raporti financiar i RTK-së, komisioni që e ka shqyrtuar dhe ne këtu bashkë, kemi parë se ka shumë argumente për të dyshuar se ka keqpërdorime, pra janë argumente, janë fakte që neve na shtinë për të dyshuar se ka keqpërdorime si në dhënien e tenderëve ku është konflikt interesi, keqpërdorime financiare e tjera e tjera. Pra, nëse ky Kuvend i Kosovës kishte për ta formuar një komision hetimor, që është kërkuar nga këta 44 deputetë, ky komision hetimor kishte për të hetuar vetëm këtë segment, pra menaxhimi i financave në RTK, jo tjerat, jo ndërhyrje në politikat redaktuese, jo hetimin e politikave redaktuese, jo hetimin e programeve ose ndërhyrje në to, por vetëm segmenti i menaxhimit të financave në RTK për shkak se është Televizion publik dhe ky Kuvend ka vendosur me Ligj, një pjesë e madhe e buxhetit me të cilën financohet RTK-ja është marrë nga Ligji për financimin e RTK-së, që është miratuar në Kuvendin e Kosovës.

I nderuari, zoti Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Pasi që në seancën e kaluar është zgjedhur bordi, është emëruar bordi i ri i RTK-së, unë propozoj që ky Kuvend të marrë sot një vendim që t'i japë një afat të caktuar këtij bordi që të hetojë menaxhimin e financave në RTK, pra bordi i ri dhe t'i raportojë Kuvendit të Kosovës për të gjeturat, në mënyrë që pastaj të ndërhyhet edhe nëse ka nevojë edhe nga Kuvendi i Kosovës. Pra, jam për atë që pasi është emëruar, kemi arritur më në fund ta emërojmë Bordin e RTK-së, ju e dini çfarë peripecish kemi pasur derisa nuk është emëruar Bordi i ri i RTK-së, propozoj që kjo pikë e rendit të ditës të mbyllet me një vendim të Kuvendit, kërkesë pra Bordit të RTK-së, për t'i dhënë një raport të jashtëzakonshëm, kisha për të thënë, se Bordi i RTK-së është i obliguar t'i japë raporte vjetore, por ne të kërkojmë një raport të jashtëzakonshëm, me një afat të caktuar njëmuajor, dymujor për segmentin e menaxhimit të financave në të kaluarën në RTK. Ky është propozimi im. Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Radha është për deputetin Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Zëvendëskryeministra,

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Mu kujtua një fjalë e urtë popullore, e kam dëgjuar nga të vjetrit, citoj: “Ne shqiptarët e presim me u zi fasulen 7 orë, ndërsa kur ta vëmë në tavolinë, nuk mund ta presin 2 minuta për ta ngrënë dhe ka raste që edhe përvëlohem”. Prandaj, duke marrë parasysh që ka kaluar një kohë e gjatë nga paraqitja e kërkesës së formimit të komisionit, që ka qenë shumë e arsyeshme që nga muaji qershor dhe ne kemi pritur që tri vjet radhazi të krijohet bordi, unë si deputet mendoj që arsyet për formimin tani të komisionit hetimor parlamentar, mendoj që duhet të pushojnë vetëm për një arsye. Jam i thirrur në atë që t'ju besojmë institucioneve, sidomos organeve të pavarura, në këtë rast Auditorit gjeneral. Jemi në fund të vitit 2009 dhe presim raportin final edhe për të gjitha shpenzimet e tjera. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Gani Koci e ka fjalën!

GANI KOCI: Ju faleminderit, Kryetar!

Unë do të flas në cilësinë e kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa. Ju e dini shumë mirë në të gjitha raportet ose shqyrtimet e raporteve të Radiotelevizionit, ne si komision i kemi pasur vërejtjet tona me të cilat vërejtje është pajtuar edhe Kuvendi. Vërejtjet tona kanë konsistuar pikërisht në formën e menaxhimit dhe të raportimit të financave publike, pa u përfshirë në segmentet tjera të këtij institucioni publik.

E dini fare mire se, siç e tha edhe kolegu im Armendi, ne, në qershor e kemi përfunduar shqyrtimin e raportit për shpenzimet buxhetore të Radiotelevizionit të Kosovës dhe Kuvendi nuk e ka miratuar atë raport dhe ka kërkuar që Radiotelevizioni i Kosovës të bëjë plotësimin e atij raporti, të cilin raport nuk e kemi akoma sot.

Në një seancë të kaluar, e dini, e kemi shqyrtuar raportin e përgjithshëm të Auditorit, të Revizorit Gjeneral të Kosovës edhe me pjesën e auditimit të Radiotelevizionit të Kosovës, që ky Kuvend e ka miratuar si të tillë raportin, pa pjesën e auditimit të Radiotelevizionit të Kosovës. Prandaj, i mbetet Revizorit Gjeneral edhe një herë që të bëjë plotësimin e raportit të tij lidhur me auditimin e Radiotelevizionit dhe pastaj mbi bazën e tij, ne si Kuvend do të mund të krijojmë qëndrimin dhe të marrim vendim lidhur me Radiotelevizionin e Kosovës. Një gjë është më se e sigurt dhe po të merret edhe si i tillë raporti i Revizorit Gjeneral, aty ka mjaft të gjetura që do të duheshin masa urgjente në përmirësimin e gjendjes për sa iu përket financave

publike, por duke pasur parasysh vërtet sot, ju e dini, ka edhe një vendim të Gjykatës Kushtetuese lidhur me atë tarifën për Radiotelevizionin e Kosovës dhe financimi i këtij mediumi publik është në pikëpyetje, sot është në pikëpyetje. Prandaj, duke pasur këtë fakt parasysh, unë mendoj që ne si Kuvend dhe si themelues i këtij mediumi publik do të duhej të bënim diçka që të përmirësonim gjendjen vërtet për sa i përket financimit të Radiotelevizionit, por gjithnjë duke kërkuar transparencë. Është krijuar një bindje dhe një qëndrim i përgjithshëm, po them, të gjitha mediumet, organet e pavarura në këtë rast, si Radiotelevizioni rreth fjalës pavarësi dhe kjo sikur është keqkuptuar, sepse ata i kanë duart e lira të bëjnë çka të donë dhe si të donë dhe mos t'i japin llogari askujt. Një gjë është e ditur, ata janë përgjegjës para ligjit dhe për sa iu përket financave publike, ata janë llogaridhënës para Kuvendit këtu dhe këtë duhet ta bëjnë. Në qoftë se Kuvendi kërkon një llogaridhënie lidhur me shpenzimet e buxhetit, sepse është para publike, atëherë kjo nuk do të duhej të konsiderohej si ndërhyrje në mediumin publik nga askush, as nga njerëzit brenda këtu në Kuvend, as jashtë Kuvendit dhe as nga faktorë të tjerë absolutisht. Gjithkund në botë paraja publike kontrollohet, mbikëqyret dhe mbikëqyret mënyra se si shpenzohet ajo. Përndryshe, në qoftë se në këtë drejtim ne krijojmë një lloj pavarësie çfarë e quajmë ose çfarë këta e konsiderojnë, atëherë ne duhet t'i qojmë duart absolutisht ndoshta edhe nga mënyra se si financohet përderisa nuk jep llogari për shpenzimet e tyre.

Nuk konsideroj sot që do të duhej një komision hetues, sepse besoj që edhe ai komision hetues nuk do të mund ta bëjë punën më mirë se sa Auditori i Përgjithshëm që ka një staf të profesional, prandaj do të duhej një kërkesë e Kuvendit që Auditori Gjeneral të bëjë një revizion, një rirrevizion për Radiotelevizionin e Kosovës dhe mbi bazë të asaj, ne të vijmë deri te përfundimet dhe konkluzionet si Kuvend. Përndryshe, askush, as deputeti Rexhepi dhe askush tjetër nuk ka qenë i interesuar për mënyrën e shpenzimit të parasë publike se sa Komisioni për Buxhet dhe Financa. Urdhëroni, i keni të gjitha rekomandimet e këtij komisioni dhe të qojnë në këtë pikë. Prandaj, në këtë rast vërtet do të duhej t'i bëhet thirrje Revizorit Gjeneral që të plotësojë raportin e auditimit lidhur me Radiotelevizionin e Kosovës.

KRYETARI: Kemi edhe 9 deputetë të lajmëruar për diskutim. Kisha kërkuar që vërtet të jeni më të shkurtër ose mbështetje ose nuk e mbështetni, por nuk kemi nevojë, mendoj kush e di se çka të themi. Po vazhdojmë. Radhën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar zoti Kryetar!

Zoti zëvendëskryeministër,

Ministra,

Deputetë të nderuar,

Në parim, kur mu ka dhënë rastin në Komisionin për Buxhet, e kam mbështetur ngritjen e komisionit për hetime, nuk duhet të hezitohet, ajo është një punë rutine e nevojshme, e dobishme, pse jo, se nuk e paragjykon as fajin, as krimin, as deliktin, as përgjegjësinë e askujt, por dyshimin e bazuar, e në qoftë se dyshon, ekziston dyshimi i bazuar nga një grup relevant i deputetëve, i Komisionit, edhe në këtë Kuvend është zhvilluar një diskutim i gjallë në këtë drejtim. Unë nuk e di pse bëhet rezistencë të mos ngrihet një komision hetimor dhe të hetohet gjendja edhe të raportohet, ju lutem, krejtësisht në konformitet me aktet që i kemi të miratuara. Do të thotë, kjo është në parim dhe për të mos bërë përsëritje, të gjitha ato që i tha zoti Koci, unë mendoj se ashtu janë edhe do t'i kisha mbështetur, por në këtë rast kam dalë këtu para jush me respekt që të potencoj një fakt që mua më ka deprimuar. Unë, në parim do ta kisha firmosur këtë mocion, mirëpo nuk mu ka ofruar rasti, kështu që unë nuk e kam nënshkruar, nuk është nënshkrimi im, është bërë një kuazi, pseudo parafim, që nuk është fare në rregull, prandaj nuk është nënshkrimi im, ama do ta kisha nënshkruar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Arsim, nuk po del mirë kjo. Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Unë dëshiroj të filloj që nga kërkesa, thotë - kërkesë për formimin e Komisionit Hetimor për hetimin e gjendjes në RTK. Tash ia kujtoj Kuvendit se ne e kemi shqyrtuar në Kuvend Raportin vjetor të auditimit për vitin financiar 2008 nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm dhe me këtë i kemi pranuar edhe rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm, i cili i bënë lidhur me auditimin e RTK-së.

Aty janë 5 rekomandime dhe do të përqendrohem në një rekomandim, i cili ka të bëjë, që është rekomandimi numër 5, e që thotë se duhet t'i jepet RTK-së mundësia të veprojë në tregun mediatik në atë mënyrë që institucioni t'i krijojë shërbimet e tij në mënyrë të suksesshme si dhe të jetë konkurrues. Si pikënisje në adresimin e kësaj duhet të jenë standardet evropiane të nxjerra nga Unioni Evropian i transmetuesve apo EBU. Nga ana tjetër, e dimë se EBU ka dërguar në letër Kryeministrit, në të cilën ka shprehur shqetësimin për ndërhyrjet dhe presionet politike dhe financiare nga Qeveria në RTK dhe stafin e saj, sidomos në periudhën e zgjedhjeve.

Ndërsa, nga ana tjetër konsideroj se Kuvendi në bazë të përgjegjësive që ka në bazë të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës, është që duhet kryesisht të përqendrohet në dy pika shumë të rëndësishme. Një është, sipas nenit 1.2 se Kuvendi i Kosovës duhet të mbrojë autonominë institucionale dhe pavarësinë editoriale të RTK-së. Kjo e dimë se nuk po ngjanë.

Tjetra është, financimi afatgjatë dhe i qëndrueshëm i RTK-së, që gjithashtu është përgjegjësi e Kuvendit të Kosovës dhe, e treta, do të sigurojë që të mos ketë ndërhyrje të Qeverisë se meqenëse...

KRYETARI: Ju kisha lutur, në rend dite, rendi dihet i cili është.

GJYLNAZE SYLA: Ky është rendi di ditës kryetar.

KRYETARI: Jo, nuk është rendi i ditës ajo që po diskuton ti.

GJYLNAZE SYLA: Prandaj, për çështjet të cilat janë përgjegjësi ligjore e Kuvendit të Kosovës, unë jam që Kuvendi të debatojë dhe të marrë rekomandime, përfundime të caktuara të cilat duhet të zbatohen. Ju faleminderit!

KRYETARI: Unë dua t'ju njoftoj se nga 7 grupe që i ka Kuvendi i Kosovës, një grup e mbështet formimin e Komisionit, 5 grupe nuk e kanë mbështetur dhe një grup nuk është deklaruar. Kjo është gjendja deri tash për këtë çështje.

Kemi të lajmëruar për diskutim, por unë mendoj që duhet ta qesim në votim kërkesën e... Lus regjinë dhe deputetët, të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Ju lutem, në sallë kemi 66 deputetë.

“Për” kanë votuar 9, “kundër” 19, 9 kanë abstenuar. Konsideroj që Kuvendi nuk e miraton formimin e komisionit.

Ju lutem, ka qenë obligim i shefave të grupeve t'i propozojnë anëtarët e komisionit. Vetëm nga një grup kemi të propozuar anëtarët e komisionit, nga asnjë grup tjetër nuk kemi të propozuar, prandaj ky është rezultati.

Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi lidhur me plotësimin e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka shqyrtuar propozimin e ministrit të Drejtësisë për plotësimin e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Kryetari i Komisionit ose raportuesi, Ibrahim Makolli, e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në mbledhjen e 5 tetorit 2009, shqyrtoi përfundimin e Kryesisë së Kuvendit, nr. 03 P151K të datës 22 shtator 2009.

Në ftesë të Komisionit, në këtë mbledhje ishte e pranishme edhe ministria e Drejtësisë, Nekibe Kelmendi, për të dhënë sqarime përkitazi me propozim-vendimin për plotësimin e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës. Komisioni vendosi që raporti i njëjtë, me rekomandime, të procedohet për shqyrtim në seancë plenare.

Duke u bazuar në nenin 65, pika 14 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në nenet 6.2 dhe 7.6 të Ligjit për Provimin e Jurisprudencës, në Rregullën 46 pika 1 dhe 2 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe në përfundimin e Kryesisë së Kuvendit, të datës 21 korrik 2009, Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në mbledhjet e mbajtura më 27 korrik dhe 7 shtator 2009, shqyrtoi Propozim-vendimin e Ministrisë së Drejtësisë për plotësimin e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës 01 nr. 840 të datës 16 korrik 2009. Lidhur me këtë vendosi që Kuvendit t'ia paraqes për shqyrtim në Seancën plenare këtë raport.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të kandidatëve, Komisioni, në bazë të të dhënave që ofrohen nga biografitë e kandidatëve, konstatoi se Rustem Qehaja nuk ka pengesa ligjore sipas Ligjit për Provimin e Jurisprudencës për t'u emëruar zëvendësanëtar i Komisionit për provimin në lëndën - E drejta tregtare. Komisioni po ashtu konstatoi se propozimi për të pestën herë i kandidatit Ruzhdi Berisha, i refuzuar katër herë nga Komisioni për anëtarë të Komisionit për lëndët civile, nuk është në pajtim me Ligjin për Provimin e jurisprudencës e as me Vendimin e Kuvendit të Kosovës, numër 03-119, të datës 11 qershor 2009.

Me këtë vendim nuk është vërtetuar se i përmenduri i plotëson kushtet ligjore për t'u emëruar anëtar i Komisionit të theksuar dhe është kërkuar nga Ministria e Drejtësisë të propozojë kandidatë tjetër për anëtar të Komisionit për lëndët civile. Për zëvendësantarin e Komisionit, Bardhyl Hasan Papaj, në bazë të njohurive që ofron biografia e tij, u konstatua se i plotëson kushtet sipas kualifikimit, por nuk është shtetas i Republikës së Kosovës dhe shfaqet dyshimi se a i plotëson kushtet ligjore të rekomandohet për t'u emëruar nga Kuvendi zëvendësanëtar i Komisionit në fjalë. Vlen të thuhet se i përmenduri ka ofruar një dokument përmes të cilit njofton se ka bërë kërkesë për marrjen e nënshtetësisë së Kosovës.

Komisioni, me rastin e shqyrtimit të Propozim-vendimit të theksuar vlerëson se propozimi i anëtarit të Komisionit për lëndët - E drejta ndërkombëtare dhe evropiane për të Drejtat e Njeriut, Iliriana Islami, e emëruar me Vendimin e Kuvendit të Kosovës, të datës 11 qershor 2009, anëtare e Komisionit për lëndën e theksuar me vendimin Presidentit, të datës 11

qershor 1009, anëtare, është emëruar gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, që sipas Ligjit për Gjykatën Kushtetuese nuk mund të ushtrojë funksion tjetër publik ose profesional për të cilën shpërblehet me pagesë. Prandaj, Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në bazë të vlerësimeve të theksuara, konstatoi se Propozim-vendimi i Ministrisë së Drejtësisë për plotësimin e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës nuk është i plotë dhe nuk është në tërësi në pajtim me nenin 7.6 të Ligjit për Provimin e Jurisprudencës dhe vendosi që Kuvendit të Republikës së Kosovës, t’ia paraqet këtë r e k o m a n d i m.

Të nderuar kolegë, rekomandimet i keni para vetes, kështu që nuk do t’ju marrë kohë t’i lexoj. Ju faleminderit, zoti Kryetar!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjala tani është për propozuesin, për ministren e Drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: I nderuari Kryetar i Parlamentit,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar zëvendëskryeministra,
Ministra,

Nëse nuk e kam të kufizuar kohën, do t’i lexoja vetëm dy nene të Ligjit për Provimin e Jurisprudencës, për të dhënë arsytimin pastaj. Ju faleminderit!

Ligji për Provimin e Jurisprudencës me dy nene, kreun 2 i rregullon kriteret se kush mund të jetë pyetës i lëndës. Për informimin tuaj, më duhet t’i lexoj këto dy nene.

Komisioni për dhënien e Provimit të Jurisprudencës është organ i pavarur profesional, i cili organizon provimet për kualifikimin e gjyqtarëve, prokurorëve, juristëve dhe specialistëve të tjerë ligjorë. Komisionin për dhënien e provimit të jurisprudencës, sipas paragrafit 1 të këtij neni, e emëron Kuvendi i Kosovës me propozim të Ministrisë së Drejtësisë. Komisioni për punën e vet i raporton së paku një herë në vit Kuvendit të Kosovës.

Përbërja dhe mandati i Komisionit për dhënien e Provimit të Jurisprudencës, apo thënë ndryshe, kriteret: Komisioni përbëhet nga kryetari dhe 6 anëtarë. Kryetarit të komisionit dhe anëtarëve u caktohen zëvendësit. Komisioni emërohet nga radhët e juristëve të diplomuar, të cilët e kanë të dhënë provimin e jurisprudencës, ekspertë të drejtësisë dhe nga radha e profesorëve të Fakultetit Juridik, të cilët me punën e tyre në shkencë dhe në organet e jurisprudencës janë treguar si ekspertë të dalluar. Komisioni vendos me shumicë votash. Mandati i komisionit zgjatë 2 vjet. Gjysma e anëtarëve mund të emërohen edhe për një mandat për shkak të kontinuitetit të punës. Dhe, kjo që është më e rëndësishmja dhe më e kontestueshmja për Ruzhdi Berishën. Me vendim mbi emërimin e komisionit do të caktohet se cilat lëndë do t’i pyet kryetari i komisionit, e cilat lëndë anëtarët e komisionit, përkatësisht zëvendësit dhe thotë:

1. “Pyetës i lëndës mund të jetë anëtari i komisionit, i cili lëndën e ka specializim të ngushtë”.
2. alternativa tjetër: “ka gradë shkencore nga ajo lëndë, për shembull, magjistër i shkencave ose doktor i shkencave” ose
3. “Ka përvojë pune pa ndërprerje dhjetë vjet si gjyqtar i lëndës”.

Në kohën kur Ruzhdi Berisha është propozuar për anëtar të këtij komisioni për pyetës të lëndës – E drejta civile, nuk ka qenë gjykatës, por ka qenë avokat, që do të thotë se ka mund të

propozohet për pyetës nga ajo lëndë. Por, edhe nëse kërkohet përvoja e punës pa ndërprerje, ai i ka dhe ju e keni në dokumentacionin tuaj, 13 vjet e 7 muaj punë pa ndërprerje në lëndën civile. Ka sjellë vërtetime dhe e ka sjellë krejt dokumentacionin përkatës.

Tash do t'i them dy-tri fjalë për kandidatët tjerë që po kontestohen. Kontestohet Bardhyl Hasan Papaj për shkak të asaj se nuk është shtetas i Kosovës. Është në rrugë për t'u bërë shtetas i Kosovës, por kjo nuk është formalisht dhe duhet të merret se nuk është formalisht për derisa nuk merr certifikatë nga organi kompetent se e pranon shtetësinë e Kosovës apo i pranohet shtetësia e Kosovës. Si do që të jetë, nga kreu II nuk kërkohet për asnjë kandidat që të jetë shtetas i Kosovës apo të mos jetë shtetas i Kosovës, kështu që ju siguroj se Ligji është respektuar edhe për Bardhyl Hasan Papajn.

Sa i përket kandidates Ilirijana Islamit, përkatësisht tanimë anëtares së votuar të Komisionit për Provimin e Jurisprudencës, këtu mëtohet që të vihet në dyshim konflikti i interesit. Nuk kemi të bëjmë me konflikt të interesit sepse komisioni është komision profesional e jo komision apo bord udhëheqës. Anëtarët e komisionit nuk janë në marrëdhënie pune në Ministrinë e Drejtësisë, që do të thotë nuk paguhet nga buxheti i Kosovës. Honorari për anëtarët e komisionit paguhet nga participimi i kandidatëve që i nënshtrohen provimit. Participimi është i caktuar, nuk jam në gjendje sot të ju them sa. Më duket 150 euro dhe nga ai participim mbulohen të gjitha shpenzimet e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës, kështu që kur është në pyetje Ilirijana, nuk kemi konflikt të interesit dhe nga ana tjetër ajo sot nuk është objekt për 'u votuar në këtë Kuvend.

Nga këto që i thashë më sipër, ju lus që ta votoni komisionin apo këta 3 anëtarë që janë propozuar për plotësimin e Komisionit për dhënien e Provimit të Jurisprudencës. Ju siguroj se Ministria e Drejtësisë nuk ka vepruar në kundërshtim me ligjin, as me Kushtetutën, as me ndonjë akt tjetër ligjor. Gjithashtu, ju siguroj se nëse sot kompletohet Komisioni për Provimin e Jurisprudencës, për çka do të jem shumë mirënjohëse, ne si Ministri e Drejtësisë i kemi bërë të gjitha përgatitjet që ta organizojmë provimin e jurisprudencës dhe deri në gjysmën e dhjetorit të mbahet provimi i jurisprudencës në mënyrë që mos të presin kandidatët të cilët i kanë plotësuar kushtet për t'ju nënshtuar provimit të jurisprudencës, për të cilët unë e kam nënshkruar edhe vendimin përkatës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministre! Radha është e kryetarëve të grupeve parlamentare. Kërkoj prononcimin. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Ramadan Gashi e ka fjalën.

RAMADAN GASHI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës shpreh keqardhje për zvarritje kaq të madhe për formimin e Komisionit të Jurisprudencës dhe pasi që jam edhe anëtar i Komisionit për Legjislacion, dëshiroj t'i them disa fjalë edhe rreth raportit të korrikut që e ka bërë Komisioni për Legjislacion dhe ne për tri rastet e cekura kemi kërkuar sqarime shitesë, sepse me legjislacion nuk ka qenë e precizuar saktësisht, por ato sqarime nuk kanë arritur dhe edhe në takimin e shtatorit nuk kemi mund të kemi përgjigje të saktë, kështu që komisioni ka qëndruar prapa rekomandimeve të korrikut, me të cilat ka kërkuar që Kuvendi të deklarohet për këto tri propozime, por e ka pasur edhe mendimin se komisioni mund të fillojë së punuari – Komisioni për Jurisprudencë, pasi që për secilën lëndë ka pasur ose pyetës ose zëvendës, kështu që ne mbështesim propozimet e komisionit që të bëhen këto sqarime dhe mendojmë se Kuvendi le të

deklarohet lidhur me këto raste, pasi që komisioni dhe propozuesi me këtë rast nuk kanë arritur pajtueshmëri për të gjitha rastet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Kolë Berisha e ka fjalën.

KOLË BERISHA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë dhe Kabinet qeveritar,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës pas shqyrtimit të procedurave të zhvilluara deri më tani lidhur me kompletimin e Komisionit për dhënien e Provimit të Judikaturës, që nënkupton shqyrtimin e Propozim-vendimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe të rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi të Kuvendit të Kosovës, konstaton se:

1. Kompletimi i Komisionit për dhënien e Provimit të Judikaturës është tepër i vonuar dhe i pajustificuar.
2. Deri te një vonesë të tillë ka ardhur nga dallimet në interpretimin e dispozitave që rregullojnë këtë materie nga ana e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, në njërën anë, dhe të Ministrisë së Drejtësisë, në anën tjetër.
3. Grupi Parlamentar i LDK-së është i bindur se haraçin më të madh të kësaj vonese e kanë paguar dhe vazhdojnë ta paguajnë qindra kandidatë të interesuar për dhënien e këtij provimi, ndër ta mbase edhe as që dhënien e provimit të judikaturës e shohin si të vetmen mundësi për punësim dhe mbajtjen e familjes, dhe
4. Për t'i dhënë fund kësaj odisejade të panevojshme disamujshme, duke pasur parasysh pamundësinë e tejkalimit të pengesave të deritashme, për t'i dhënë rrugë të mbarë këtij procesi, e në veçanti duke pasur parasysh numrin tepër të madh, madje gjithnjë në rritje, të kandidatëve që presin për të hyrë në këtë provim, Grupi Parlamentar i LDK-së e voton Propozim-vendimin e Ministrisë së Drejtësisë për kompletimin e këtij komisioni me këta kandidatë:

- Ruzhdi Berishën;
 - Bardhyl Hasan Papajn, dhe
 - Ilirijana Islamin.
- Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën e ka deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës sot do të abstenojë në votim për këtë pikë të rendit të ditës dhe për këtë i ka dy arsye.

Arsyeja e parë, është se për një çështje që ka qenë dashur të jetë tepër e thjeshtë dhe për shkak se partnerët e koalicionit dëshirojnë t'i tregojnë njëri-tjetrit se kush është më i fortë dhe kush i nxjerrë kandidatët e vet edhe në komisione kësisoj, ne jemi duke u marrë me këtë temë që një kohë, realisht kemi harruar edhe vetë se kur kemi filluar që të merremi me këtë temë dhe kjo është arsye e mjaftueshme që ne, si partia më e madhe në opozitë, të refuzojmë që të bëhemi pjesë e kësaj farse.

Arsyeja e dytë, ka të bëjë me një temë tjetër dhe ajo është kjo: Kur unë flas ose kur cilido deputet në Kuvendin e Kosovës flet para Kuvendit, flet me dy qëllime. Qëllimi i parë është për ta prezantuar qëndrimin e vet se a është “për”, “kundër” apo abstenon për një temë, mirëpo është edhe një qëllim tjetër, i vazhdueshëm, të cilin e kam përmendur më herët. Ai qëllimi tjetër është se ne kemi të drejtë dhe obligim të provojmë t’i bindim kolegët tanë deputetë për të votuar “për” ose “kundër” një qëllimi dhe kjo është esenca e parlamentarizmit, të provohet, të binden kolegët për një çështje për të cilën ne mendojmë se është e drejtë.

Dhe sot, zoti Kryetar, ju e keni ndërprerë debatin padrejtësisht dhe e keni shkelur parimin bazë të parlamentarizmit dhe, në fund të fundit, edhe demokracinë. Më vjen keq të them, nuk e kam thënë më herët, nuk keni të drejtë ta ndërprisni debatin kur ka deputetë që janë paraqitur për fjalë për një temë dhe provojnë t’i bindin kolegët e vet a të votojnë a jo. Kjo është arsyeja e dytë dhe për këtë arsye, për këtë shkelje të demokracisë që ka ndodhur sot, ne refuzojmë të marrim pjesë në votim. Faleminderit!

KRYETARI: Nejse, unë kisha kërkuar që vërtet mos ta përdorim foltoren për fushatë se....

(Ndërhyrje deputetësh)

Asnjë grup parlamentar, pesë grupe parlamentare nuk i kanë propozuar kandidatët për anëtarë të komisionit dhe mbi atë bazë unë kam marrë vendim në emër të grupeve parlamentare, nuk ka qenë i imi.

(Ndërhyrje deputetësh)

E di që jeni të pakënaqur, por nuk kemi çka ju bëjmë. Vazhdon pakënaqësia!
Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Riza Smaka e ka kërkuar fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuar zoti Kryetar,
Grupi Parlamentar i AKR-së solidarizohet me pikëpamjet e prezantuara nga zotëri Makolli në emër të Komisionit për Legjislacion dhe thekson edhe këtë se ne duhet të meditojmë qysh tash që ky komision të suprimohet përgjithmonë e të zëvendësohet me sistemin e studimeve serioze dhe të krijojmë specialistë për çështjet juridike-administrative, juridiko-civile, juridiko-penale, se ky komision edhe ashtu, besoni, flas nga eksperiencia, kurrfarë roli kreativ nuk ka, por aty formalizohen krejt çështjet dhe kalohet ai provim i judikaturës e më pastaj... tjera, e tjera.

Për momentin, do të thotë, Grupi Parlamentar e mbështet plotësisht pikëpamjen e prezantuar nga Komisioni për Legjislacion. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, deputeti Lulzim Zeneli e ka fjalën.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë është i mendimit se këto pozicione të cilat po mbahen dhe po vazhdojnë të ngurtësuara, qoftë nga Qeveria sa i përket kësaj materie, mirëpo edhe nga ana e vetë Kuvendit të Kosovës duke mos krijuar alternativë zgjidhjeje të kësaj problematike, është e padrejtë dhe faturën e krejt kësaj do ta paguajnë ata të cilët po presin dhe numri i tyre është mjaft i madh për t’iu nënshtruar një provimi të tillë.

Ne konsiderojmë, si Grup Parlamentar, se Kuvendi i Kosovës duhet të ofrojë zgjidhjen që të dilet nga ky qorrsockak, që me muaj të tërë po e mundon jo vetëm këtë materie, por po e vështirëson

edhe punën e komisionit, po nga ana tjetër e vështirëson edhe vetë përgjegjësinë apo raportet obligative që i ka Ministria sa i përket këtij komisioni.

Ne mendojmë dhe jemi të bindur për atë se komisioni parlamentar asnjëherë nuk ka thënë që kjo listë të mos votohet. Përkundrazi, ka dhënë rekomandime dhe arsyetime të nevojshme që duhet të kuptohen drejt dhe qartë nga secili deputet dhe grup parlamentar.

Por, për ne është e pakuptueshme në qoftë se një qëndrim, pavarësisht se si ka kaluar në Kuvendin e Kosovës, të riciklohet për herë të katërt dhe herën e pestë nga ana e Ministrisë në fjalë. Për ne, po ashtu është e pakuptueshme, si komision funksional, në këtë rast komisioni parlamentar të vazhdojë me retorikën e tillë të neglizhencës dhe të mospërfilljes së nevojave që janë imediate që ky komision të kompletohet dhe të funksionalizohet.

Në këtë rast, ne i mbështesim rekomandimet e komisionit funksional, duke konsideruar gjithmonë se ky komision funksional me rekomandimet e veta nuk është kundër këtyre propozimeve. Përkundrazi, nëse lexojmë rekomandimin e parë, thotë të emërohet, emrin nuk po ia përmendi... iksi në këtë funksion. Nën 2, kërkojnë sqarime dhe ato sqarime duhet t'i jepen komisionit parlamentar. Dhe, nëse këto të meta dhe këto dilema evitohen, unë besoj dhe jam i bindur që sot seanca plenare do të mund ta votojë dhe të ecë në mënyrë që të hap shteg në punën e këtij komisioni. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit “7+”, nuk është paraqitur askush.

Në emër të SLS? Nuk ka. Atëherë, vazhdojmë me deputetët. Kemi katër deputet që janë paraqitur për debat. E fillojmë me Armend Zemajn.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit shumë, Kryetar!

E tha edhe raportuesi në emër të komisionit, i cili elaboroi, do të thotë, pas takimit që kemi pasur me propozuesin – ministren e Drejtësisë dhe unë këtu dua të rikujtoj se në komision jemi të gjithë deputetë dhe nganjëherë e ndajmë edhe mendimin.

Unë, që nga paraqitja e formimit të këtij komisioni, do me thënë është hera e pestë që e përkrah propozimin e vendimit për të njëjtën arsye. Unë mendoj se nuk duhet të mbetemi peng të ligjeve të këqija, të ligjeve të cilat janë miratuar në kohën kur ka qenë UNMIK-u.

Një është arsyeja. Pika, në të cilën thuhet se duhet të ketë 10 vite përvojë pune pa ndërprerë, i takon së kaluarës, të nderuar kolegë deputetë, dhe mendoj se gjeneratat e reja, sidomos pas vitit 1998, nuk e kanë pasur atë mundësi dhe atë privilegj që të kenë 10 vjet përvojë në lëmi të caktuara apo mundësi të arritjes së gradës shkencore për ta pasur mundësinë që të jenë pyetës të lëndës.

Prandaj, për hir të të gjithë atyre që presin sot dhe janë numër shumë i madh, ne kemi marrë edhe ankesë nga Avokati i Popullit, unë mendoj se këto propozime duhet të kalohen, këto tri propozime. Ky është komision teknik profesional, nuk është komision politik.

Edhe herën e parë kur kanë qenë të propozuar profesorët e nderuar, që sot janë edhe ministra dhe zëvendëskryeministra, unë e kam përkrahur, sepse ky i takon profesionalitetit, nuk ka të bëjë me politikën, prandaj mendoj se nuk duhet të ndalemi në çështje të imëta por ta shohim perspektivën e gjeneratës së re, të juristëve të ri dhe të reja dhe të reformës gjyqësore, e cila na pret dhe është imediate që të ndodhë.

Prandaj, edhe në emër timin, si anëtar i komisionit, mendoj edhe të shumicës, edhe të gjeneratës së re, unë mendoj se duhet të kompletohet ky komision dhe i thërras të gjithë deputetët për hir të kësaj ta përkrahin, pa marrë parasysh që mund të kemi aty një diskrepancë kohore kur thuhet për kandidatin në fjalë, Ruzhdi Berisha, i cili nuk e ka një sqarim vetëm për disa muaj, që ka një pauzë kohore... Ajo nuk do të thotë që nuk i ka 10 vite pa ndërpre, i cili i ka 13 vite punë në lëmin përkatës. Prandaj, unë i lus deputetët, sot të gjithë juristët e ri janë duke pritur dhe me padurim, janë duke përdorur edhe metoda tjera të ankesave, thashë edhe te Avokati i Popullit, edhe të gjithë të tjerët, unë mendoj se deputetët sot duhet ta votojmë, të kompletohet dhe të ecim përpara. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Rita Hajzeraj.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Zgjedhja e këtij Komisioni për Jurisprudencë, jemi të vetëdijshëm, ka qenë shumë relevant dhe shumë i nevojshëm për kohën tonë, për çka kemi bërë vazhdimisht kërkesa. Mirëpo, duke pasur parasysh burimin dhe strukturën e këtij komisioni, shohim se forma e financimit të këtij komisioni është nga participimi i studentëve. Domethënë, po del se ky nuk është institucion publik, të cilin po e zgjedh Parlamenti, por është një institucion privat, në të cilin studentët vazhdimisht kanë për t'u neglizhuar për të mos e kaluar këtë provim për ta paguar stafin i cili i udhëheq këta studentë.

Nën dy, unë e shoh se ky provim i jurisprudencës apo ky drejtim kishte mund shumë më mirë të organizohet në kuadër të Fakultetit Juridik, ku kishte për të pasur profesionalistë shumë më të mirë se këta profesionalistë të cilët nuk mund të krahasohen me profesorë të Universitetit të cilët japin mësim në këtë universitet. Kemi anëtarë këtu, të cilët nuk janë shtetas të Kosovës dhe nuk e di pse neve bimë gjithmonë pre e politikës dhe vazhdimisht faji mbetet te deputetët e Parlamentit, se deri më tani asnjëherë faji nuk ka qenë te deputetët e Parlamentit. Ne kemi rënë viktimë e politikës që po zhvillohet këtu, sepse vazhdimisht shkohet në interesa personale, interesa të individëve të cilët kanë për ta udhëhequr këtë komision dhe jo në transparencë dhe me parandë publike. Parlamenti po e zgjedh këtë komision, Parlamenti dhe ministria gjegjëse duhet të gjejnë forma të financimit për këtë komision dhe jo të participohet nga studentët, sepse kjo gjë nuk shihet se është serioze dhe nuk shihet publike. Shtetasit që nuk janë të Kosovës, ju e dini shumë mirë që në parandë publike nuk guxojnë të kenë qasje, pse ekziston këtu emri. Andaj, kemi mjaft çalime në përbërjen e këtij komisioni dhe për atë arsye edhe ne jemi të hezituar që të marrim vendim se kah të mbajmë, edhe pse jemi për formimin e këtij komisioni, të gjithë jemi të interesuar, por duhet të bihet vendimi adekuat dhe duhet të dimë se çka po votojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kisha kërkuar nga deputetët që të mos ndikohen diskutuesit e tjerë. Realisht, po vazhdojnë lajmërimet të reja që po ndikohen nga diskutimet dhe kjo s'është mirë. Fjalën e ka deputeti Adem Hajdaraj.

ADEM HAJDARAJ: Zoti Kryetar, kaherë jam paraqitur, jo i ndikuar.

Zoti Kryetar,

Qeveritarë dhe deputetë,

Unë qysh tash po them se jam anëtar i këtij komisioni dhe duke pasur parasysh nevojën e madhe që të mbahen këto provime, disa gjenerata që sa vjet kanë mbetur pa hyrë në provim të judikaturës dhe kjo zhagjitje është e panevojshme. Unë edhe në komision kam thënë se duhet të zgjidhet ky problem sa më parë dhe janë dhënë disa arsyetime këtu për këta kandidatët, do të

thotë, për Bardhyl Hasan Papaj se nuk është shtetas i Kosovës, por është i Republikës së Shqipërisë, çka nuk i pamundëson këtij të mos jetë në komision, për arsye se unë si profesor mund të jap ... në Tiranë, mund të jap në Shkodër, ku të ketë nevojë, për shembull, si kuadër. Edhe ky, si kuadër, do të thotë, nuk është fare e arsyeshme të refuzohet se është shtetas i Republikës së Shqipërisë.

E dyta, për Ruzhdi Berishën është bërë shumë fjalë, jo s'i ka vitet, e jo... Unë kur kam shikuar në atë dokumentacionin në përgjithësi, në ligj, kam parë se asnjë nuk i ka 10 vjet të plota, 10 vjet të plota prej këtyre gjyqtarëve që kanë qenë, se e ka ndërpre një vit ose dy, ka kaluar prej një vendi në vend tjetër dhe mua më është mbushur mendja se Ruzhdi Berisha refuzohet për kurrfarë arsyeje. Edhe nëse refuzohet, është profesori i rregullt që pyet, deri sa të zgjedhet tjetri, po të mos ndërpritet puna e komisionit.

Dhe, në fund, për Iliriana Islamin, që ka shkuar në Gjykatën Kushtetuese, mua më duket nuk është konflikt i interesit, sepse ajo e merr pagën nga participimi dhe meqë e merr pagën nga participimi, jo nga buxheti i Kosovës, ajo mund të jetë pyetëse. Bile, bile është e nevojshme të jetë një kuadër i tillë pyetës në këtë komision.

Dhe, për këtë, po propozoj që të mos hidhet, por të votohet për t'u pranuar ashtu sikur që tha edhe ky kryesuesi – raportuesi i komisionit dhe të shkojmë më tej, se ndonjë zëvendës, për shembull zëvendësi i pyetjes mund të zgjedhet edhe më vonë. Dhe, kur është pyetësi - kryesori, nuk ka nevojë të zhargitet kjo çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Me shumicën e fjalëve të deputetëve jam dakord, por ne duhet ta kemi parasysh, ligjet nuk guxojmë t'i thyejmë si deputetë. Gjithnjë duhet ta kemi parasysh ligjin, një. Sa i përket shtetësisë, ne duhet ta kemi parasysh edhe një çështje. Nuk mund të kemi si Kuvend arshinë ose standarde të dyfishta për shtetësi të ndryshme dhe këtë duhet ta keni parasysh. Mendoj se këto dy çështje duhet t'i kemi parasysh – mos shkeljen e ligjit dhe nuk mund të përdorim standarde të dyfishta nëse na vjen në parlament votimi i një shtetasi tjetër. Fjalën e ka deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Jemi duke diskutuar për një komision tejet të rëndësishëm, që vërtet ka lënë peng një proces që i duhet edhe shtetit, edhe Gjyqësorit, por edhe sistemit juridik të Kosovës, në përgjithësi. Për mua është e pakuptueshme pse nuk respektohen rekomandimet e komisionit funksional, nën një. Në dy, pse insistohet në emra të përveçëm me kryeneçësi, kur ky Kuvend disa herë e ka thënë fjalën e vet. Dhe, vallë, paskemi mbetur peng e dëshirave të një ministri apo të njerëzve në Qeveri, apo edhe të diskrepancave të mëdha tani të procedurave në raport Qeveri – komision funksional i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Mos e sfidoni, ju lutem, Kuvendin e Republikës së Kosovës me standarde të dyfishta dhe me teke kryeneçe, sepse po mbesin peng njerëz të ri që e kanë karrierën dhe perspektivën përpara dhe ne si organi më i lartë legjislativ i shtetit, si njerëz të zgjedhur, nuk po jemi në gjendje që ta marrim një vendim konform respektimit edhe të kriterëve të përzgjedhjes së këtyre anëtarëve të komisionit, por edhe të shkeljes së ligjit. Andaj, zoti Kryetar, ju shumë bukur e potencuat, të respektohet ligji, kriteret e përzgjedhjes dhe mos të shkojmë me dy kute dhe me standarde të dyfishta. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Diskutuesja e fundit, deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala na datu reč! Pozdravljam Predsedništvo i kolege poslanike.

Meni je žao što sam se ovako kasno javila, ali je ovo spontano javljanje i mislim da našem Predsedništvu ne treba da smeta kada se neko od naših poslanika spontano javi.

Nešto što me je potenciralo da se javim jeste to da danas razmatramo jako važnu Komisiju za polaganje pravosudnog ispita i želim da dam do znanja da mi je jako žao što ne pripadam nijednoj poslaničkoj grupi i onda moram sama da se trudim ovde za doprinos.

Očekivala sam od dve grupe – „7+“ i Grupe SLS da reaguju na današnji predlog koji je dat od strane komisije za članove Komisije za polaganje pravosudnog ispita. Ja imam jednu primerku, ovde nema člana ostalih zajednica i ja dajem do znanja da ne želim naše zajednice da ostanu taoci ove komisije. Zašto? Zato što su službeni jezici po Ustavu albanski i srpski i želim da dam do znanja da je dosta naših studenata koji su završili u Turskoj, ovde u Mitrovici, u Srbiji, u Crnoj Gori, u Bosni koji da bi imali istu mogućnost za polaganje pravosudnog ispita, moraju da imaju svog člana u ovoj komisiji. Molim da se ovo ozbiljno razmotri i da se više ovakva diskriminacija nad ostalim zajednicama od strane Skupštine i funkcionalnih tela ne vrši. Hvala lepa!

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Pengesë, do të thotë, nuk ka qenë... Kryesia, por Kryetari i Kuvendit. Urdhëro, ministre! Fjalën e ka ministria e Drejtësisë, Nekibe Kelmendi.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Sot po diskutojmë për plotësimin e vendimit të Komisionit për Provimin e Jurisprudencës që nënkupton se 7 anëtarë kanë qenë të miratuar nga ky Kuvend dhe janë bërë, kanë statusin e anëtarit të Komisionit për Provimin e Jurisprudencës. Në mesin e tyre ka edhe anëtarë të komuniteteve pakicë, është Abedin Ferović, profesor dhe është Muharrem Shala, gjykatës. Nuk kemi pasur zgjedhje tjetër, sepse nuk ka nga komunitetet tjera njerëz që do t'i plotësonin kushtet.

Sa i përket kandidatit Ruzhdi Berisha, ai në Propozim-vendimin e Ministrisë së Drejtësisë është propozuar si avokat e jo si gjykatës, prandaj për të as që vlen stazhi prej 10 vjetësh që kërkohet me ligj. Këtë po ua them sa për qartësinë tuaj. Ruzhdi Berisha nga viti 2002 punon si avokat në Prizren, ekskluzivisht në lëndët civile. Edhe më parë, kur ka qenë gjykatës, ka punuar ekskluzivisht në lëndë civile, prandaj keni parasysh se ai nuk është propozuar si gjykatës, prandaj për të nuk vlen ky kriteri i paraparë me ligj – punë pa ndërpre 10 vjet. Faleminderit!

Vetëm edhe një sqarim. Pa e pasur pyetësin, se u shtrua këtu çështja, nuk mund të organizohet provimi. Pa qenë pyetësi, nuk mundet zëvendësi i tij të jetë pyetës.

KRYETARI: Faleminderit, ministre! Tani është lajmëruar për fjalë deputetja Myfera Shinik.

MÜFERA ŞİNİK: Teşekkür ederim.

Tabi ki hepimizin bildiği gibi Anayasadaki resmi diller belirtilmiştir. Onun dışında bir şey unutmayalım ki, Anayasadaki belediyelerdeki resmi dillerin statüsü de vurgulanmaktadır. Ek olarak da Türkiye Cumhuriyetinde mezun olan bütün öğrencilerimiz savunmalarını Türkçe yapma imkanına sahiptir.

Yalnız bu durumda lütfen Meclisteki mikrofonları seçim kampanyası için fırsat kullanmayalım. Çok teşekkür ediyorum.

KRYETARI: Faleminderit! Numan Baliq e ka kërkuar fjalën.

NUMAN BALIĆ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Ja sam htio samo jednu rečenicu i jedno pojašnjenje koju smatram važnim. Mislim da je svima nama stalo da se izabere ova komisija, stalo nam je da se izabere komisija uprkos razlike u stavovima. Podržavam poziv minsitricе Kelmendi i želim da je to jasno, da ne bude zabune oko

toga koji su i čiji stavovi. Podržavam dakle zahtjev, poziv ministricе Kelmendi i da se glasa, uprkos nedostatcima da se glasa predlog koji je naglašen. Hvala lepa!

KRYETARI: Nuk kemi deputetë të tjerë të lajmëruar për debat. Sipas rendit të ditës, ne duhet të deklaroheми për miratimin e rekomandimeve të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për plotësimin e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës. Ju e dini se kemi katër rekomandime dhe të gjitha janë të kundërta. A jeni dakord që të shkojmë të votojmë rekomandim për rekomandim?

Kush është që të shkojmë rekomandim për rekomandim?

Ju lutem, ne i kemi katër rekomandime që janë të ndryshme. Unë nuk mund t'i qes krejt përnjëherë. Janë të ndryshme dhe asnjë rekomandim s'është i njëjtë. Shkojmë një për një. A jeni dakord?

Atëherë, lus deputetët dhe regjinë, le të përgatiten për rekomandimin e parë të Komisionit për Legjislacion dhe gjyqësi.

Urdhëro, zëvendëskryeministër Manaj!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI RAMË MANAJ: I nderuari Kryetar!

Bëhet fjalë për një rekomandim, i cili ka katër elemente. Është një rekomandim i vetëm dhe do të duhej të procedohet si një rekomandim. Nuk bëhet fjalë për disa rekomandime. Është një rekomandim dhe duhet të procedojmë si për një rekomandim. Faleminderit!

KRYETARI: Të lutem, zëvendëskryeministër, me gjithë respektin, ne kemi katër rekomandime dhe janë të ndryshme, janë me emra e mbiemra dhe janë të ndryshëm. Është rekomandimi i parë: të emërohet Rustem Qehaja zëvendësanëtar i komisionit për lëndën - E drejta tregtare dhe unë mendoj se ky është rekomandim i veçantë nga rekomandimi i dytë... Të shqyrtohet propozimi që Bardhyl Hasan Papaj, shtetas i Republikës së Shqipërisë për zëvendësanëtar të Komisionit. Ne mund të shkojmë edhe kështu, por çka në fund. Do të thotë, janë krejt të ndryshëm dhe ne duhet të deklaroheми se a e votojmë rekomandimin apo votojmë diçka tjetër.

(Ndërhyrje e ministres Nekibe Kelmendi, nuk dëgjohet për transkriptim)

Ramë Buja e ka fjalën.

RAMË BUJA: Kryetar, ato propozime mua më duken të kundërta njëra me tjetrën, por në fakt të shkojnë në grup, sepse janë të qartësuara kush mbetet dhe kush nuk do të mbetet në ato propozime që janë, andaj të shkojë votimi në grup dhe ecim përpara.

KRYETARI: Kisha kërkuar nga raportuesi, deputeti Ibrahim Makolli, le të na japë një sqarim se si është zhvilluar puna në komision, a ka qenë komisioni unik, apo me shumicë votash.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Më duhet të them se në komision ka pasur mendime të kundërta, të ndryshme. Komisioni ka bërë përpjekje që të arrijë një pajtim me Ministrinë e Drejtësisë, por që nuk është arritur dhe ka vendosur, me kërkesë të ministres, që i njëjti rekomandim i cili është kthyer nga ky Kuvend, të bartet serish në seancë plenare.

Mirëpo, sa u përket rekomandimeve, më lejoni të sqaroj. Ta zëmë, rekomandimi 3: "të shqyrtohet propozimi i Ruzhdi Berishës për anëtar të komisionit". Më thoni kush duhet ta

shqyrtojë, nëse e miratojmë tash këtë rekomandim, e pranojmë ose e rrëzojmë. Kush duhet ta shqyrtojë, sepse rekomandimi i komisionit është – të shqyrtohet propozimi, prandaj duhet të kihet kujdes për këtë çështje.

Pra, problemi është tash se si duhet të procedohet me këto më tutje. Përndryshe, ta zëmë, rekomandimi numër 1, e thotë që i plotëson kushtet dhe mund të kalojë, por duhet të shqyrtohen 3 propozimet e tjera.

Po e them edhe këtë, pasi e mora fjalën, te çështja e rekomandimit të dytë. Ju e thatë se i përmenduri ka paraqitur kërkesë për t'iu pranuar nënshtetësia e Kosovës. Çka nëse nuk pranohet? Nuk mund të shkojmë me mendime – nëse ose jo. Konkursi nuk e ndalon dhe nuk e cakton a do të duhej, por po pajtohem me fjalën e Kryetarit të Parlamentit, që nëse krijojmë praktika të tilla, atëherë askujt nuk mund t'i thuhet nuk mund të aplikosh në Kosovë, sepse secili pastaj e ka këtë të drejtë. Edhe nëse nuk shkruan në ligj, natyrisht se shtetasit e Kosovës janë ata të cilët..., sepse kështu po pranojmë që në këtë vend nuk ka ekspertë të tjerë ndërkaq, sikur e dini, ekspertë të këtyre lëmive në Kosovë ka të mjaftueshëm.

KRYETARI: Faleminderit! Unë edhe një herë duhet të them diçka për rekomandimin 4. Konsideroj se komisioni nuk ka dashur të merret me këtë çështje. Kjo është çështje e drejtpërsëdrejti e kandidatit. Nëse kandidati për anëtar të Gjykatës Kushtetuese bie ndesh, ai duhet të bëjë kërkesë për ndërrim dhe kërkesën për ndërrim duhet ta bëjë Ministria e Drejtësisë dhe jo ne si Kuvend. Mendoj se kjo do të duhej të hiqej nga votimi. Prandaj, ne duhet të votojmë për emërimin e Rustem Qehasë, që e kemi rekomandim të emërohet nga komisioni, por nuk kemi rekomandim nga komisioni të emërohet Bardhyl Hasan Papaj dhe për këtë mendoj duhet të votojmë a ta bëjmë anëtar apo jo. Duhet të votojmë që a të jetë pyetës Ruzhdi Berisha apo jo. Këtë duhet ta votojmë ne sot, sepse nuk kemi zgjidhje tjetër. Do të thotë, nuk mund të shkojmë ndryshe, sepse po t'i rekomandojmë kështu si janë, ne s'dimë çka kemi bërë. Urdhëro, Hydajet Hyseni!

HYDAJET HYSENI-KALOSHI: Unë s'dua të diskutoj e të lëshohem në materie, por po bisedoj vetëm proceduralisht.

Vërtet është një shembull si nuk duhet të sillen rekomandime në Kuvend. Rekomandimi i komisionit praktikisht kërkon që ne të shqyrtojmë diçka dhe ne nëse pajtohemi, shqyrtimin duhet ta bëjë komisioni. Aq më tepër, unë vërtet pajtohem me fjalën e Kryetarit që nuk mund të lejojmë të krijohen presedenca që do të ishin me pasoja juridike edhe në të ardhmen. Vetëm dy fakte po i përmendi: Një, që në drejtësi nuk është e drejtë ajo që përshkruhet tekstualisht, por ajo që nuk ndalohet dhe nuk mund të jetë bazë, ta zëmë, nëse nuk është një dispozitë që e pengon shtetësinë, çështjen e shtetësisë në atë mënyrë të përjashtohet kandidati. Bëjmë shkelje të rëndë. Për më tepër, ju kujtoj se ne si Kuvend kemi pasur në praktikën tonë edhe procedurë të tillë në të cilën kemi lejuar edhe kandidatë që kanë aplikuar për shtetësi. Prandaj, unë mendoj që ose duhet të votojmë një për një dhe ne e kemi objektivisht vetëm një propozim që mund ta votojmë, sepse s'mund ta votojmë shqyrtimin. Unë propozoj që pavarësisht nga vonesat, ne t'ia kthejmë këtë vendim komisionit, komisioni në bashkëpunim me Ministrinë le të gjejnë zgjidhje. Nëse nuk janë të zotët të gjejnë zgjidhje, le të kërkojnë ndihmë tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar deputetë, nëse jeni dakord, ne votojmë për propozimin e parë, kurse të tjerët ose i lëmë për seancën tjetër, që Ministria e Drejtësisë me Komisionin për Legjislacion e Gjyqësi ta gjejnë një gjuhë të përbashkët. Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Kryetar, faleminderit shumë!

Ne e kemi materialin dhe besoj se kanë edhe të gjithë deputetët. Për komisionin kjo ka qenë çështje e përfunduar, por pas kërkesës së Kryesisë së Kuvendit dhe përfundimit, të cilin ju e keni prurë, që Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me komisionin ta gjejë një zgjidhje adekuatë, ne e kemi bërë atë dhe e kemi sjellë në Kuvend dhe ne duhet sot ta marrim vendimi “për” ose “kundër” këtui. Nuk ka më çka të kthehet në Komision. Lexojeni të gjithë dokumentacionin, që e tha edhe kolegu Ibrahim Makolli. Kërkesa e Ministrisë është që të bihet propozim-vendimi në Kuvend dhe ne sot duhet të procedojmë.

Çështja e Ilirijana Islamit duhet të sqarohet shumë mirë. Në momentin kur është votuar në Kuvendin e Kosovës, ajo nuk ka qenë e dekretuar nga Presidenti i Republikës për anëtare të Gjykatës Kushtetuese. Nëse e vlerëson Kuvendi që ajo mund të vazhdojë, është gjithçka në rregull. Nëse jo, atëherë ne mund të marrim prapë vendim. Unë mendoj se duhet të votohet një nga një, do të thotë të gjitha propozimet.

KRYETARI: Të nderuar deputetë, e kemi një vështirësi. Unë e kam të qartë, ne mund të vendojmë rekomandimin e parë, por të dytin, të tretin dhe të katërtin unë s’di si t’i votojmë. Mendoj se zgjidhja më e mirë është ta lusim edhe ministren, edhe komisionin që të ulen dhe të gjejnë një gjuhë të përbashkët dhe të na bien rekomandime për t’i votuar kandidatë që na vijnë. Unë mendoj se kjo kishte për të qenë zgjidhja më e mirë.

(Ndërhyrje e ministres Nekibe Kelmendi, nuk dëgjohet për transkriptim)

Jam dakord që të katërtin ta heqin prej rendi të ditës, por unë s’di çka të votojmë nën të dytin dhe të tretin.

(Ndërhyrje, nuk dëgjohet për transkriptim)

KRYETARI: Urdhëro, zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Mendoj se është një çështje që ka krijuar edhe dilema juridike, jo veç politike dhe profesionale. Unë pajtohem plotësisht që ky Komision e ka rëndësinë e vetë dhe dua të them që propozimi që ka ardhur nga ministria Kelmendi e ka pëlqimin e plotë të Qeverisë dhe nuk janë propozime të një individi ose një politike, po janë propozime tërësisht profesionale. Dua të ndalem te kandidatët veç e veç.

Për Ilirijana Islamin, është vendosur një herë në këtë Kuvend dhe duhet Kuvendi të marrë një vendim tjetër që ta heqë atë pastaj, nëse dëshiron. Por mendoj që sot nuk duhet të votohet kjo.

Komisioni nuk e ka bërë propozimin e mirë, po më vjen keq, po e them në kuptimin profesional, nuk i mbetet komisionit të thotë – të shqyrtohet propozimi. Komisioni duhet të thotë – propozohet, refuzohet. Ky komision momentalisht s’e ka dhënë një mendim të tillë.

Mendoj, për zotin Qehaja nuk ka problem që Komisioni e ka dhënë mendimin e tillë. Po ashtu, mendoj për zotin Hasan Papaj, që u përmend këtu, ka qenë këshilltar, ka pasur marrëdhënie pune me Qeverinë e Kosovës, ka qenë këshilltar i ish ministrit Jonuz Salihaj, është asistent në Fakultetin Juridik, do të thotë nuk është problemi a ka krijuar më herët marrëdhënie pune apo jo. Dhe, po ashtu, për zotin Ruzhdi Berisha, pengesa ligjore që ka menduar komisioni, nuk është më pengesë ligjore në kuptimin e asaj a është gjyqtarë me 10 vjet apo si avokat. Unë personalisht ju kisha ftuar, për hir të komisionit, mbi 300 deri 400 vetë janë një kohë të gjatë që po presin për të

hyrë në provimin e jurisprudencës dhe në një mënyrë po ua ndalim perspektivën. Unë nuk them se ata 400 e kalojnë, sikur që nuk e marrë përgjegjësinë të them që këta anëtarë të komisionit janë më të mirët në Kosovë. Por, mendoj që situata çfarë jemi sot, është mirë që të propozohet që Ruzhdi Berisha, Rustem Qehaja, Bardhyl Hasan Papaj të propozohen, të formohet komisioni. Mandati i tyre është 2 vjeçar, nuk bëhet kiameti 3- 4 herë do të kenë provime në tërësi. Nga ana profesionale askush s'ju bëri vërejtje dhe mendoj që të vazhdojmë më tutje.

KRYETARI: Urdhëro, raportuesi i Komisionit, Ibrahim Makolli e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit!

Edhe një sqarim, ju lutem!

Nuk do të duhej të akuzohej komisioni, zoti zëvendëskryeministër, sepse komisioni me përgjegjësinë më të madhe e ka përfunduar detyrën e vet. Dhe, ne i kemi rekomanduar Kuvendit të Kosovës ta shqyrtojë propozimin e Ruzhdi Berishës, sepse nuk i kemi dhënë vetes të drejtë që një njeri, të cilin një herë e ka kthyer mbrapa ky Kuvend, nuk e ka votuar, që ne ta kthejmë edhe një herë në listë. Sikur e dini, Kuvendi i Kosovës e ka refuzuar në listën e mëhershme kandidatin Ruzhdi Berisha dhe po i njëjti është sjellë, ne kemi respektuar një vendim të Kuvendit të Kosovës dhe e kemi kthyer që të shqyrtohet.

Së dyti, ky është provim shtetëror dhe nuk e besoj që në një vend në provim shtetërorë lejohen që të jenë shtetasit që nuk janë të atij vendi. Është provim shtetërorë, nuk është provim privat, universitete private që të inkuadrohen kushdo qoftë.

Dhe së treti, zoti zëvendëskryeministër, besoj që ju duhet ta dini më së miri që Ligji për Gjykatën Kushtetuese nuk lejon që gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese të ushtrojë edhe funksion tjetër dhe nuk e besoj që do të duhej të bëjë diçka për hir të njëjës çështje ose tjetrës, sepse ne në çdo rast po veprojmë sipas nevojave tona të përditshme. Duhet të respektohet ligji përderisa ekziston ligji. Faleminderit!

KRYETARI: Pasi komisioni ia ka lënë ta shqyrtojë Kuvendi, më lejoni që të kërkoj një prononcim nga shefat e grupeve parlamentare a janë që Bardhyl Hasanin dhe Ruzhdi Berishën, t'i qesim për votim për anëtarë të këtij Komisioni. Mirë, unë po kërkoj prononcim të shefave të grupeve parlamentare, nëse doni po e marrim një pauzë dhe shefat e grupeve të vinë me propozimet e tyre. Unë mendoj që kjo është zgjedhja më e mirë. Një pauzë prej 15 minutash dhe, ju lutem, shefat e grupeve...

(Ndërprerje e incizimit)

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Vazhdojmë seancën.

Prezentë janë 64 deputetë. Lus shefat e grupeve parlamentare të prononcohen. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Ramë Buja.

RAMË BUJA: Zoti Kryetar, ne pas konsultimit që bëmë me Grupin Parlamentar, vendosëm që këto rekomandime t'i votojmë një nga një dhe të jetë vullneti i secilit deputetë si të votojë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Lutfi Haziri e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, Kryetar!

Zëvendëskryeministër, ministra,

Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet qëndrimin tuaj si Kryetar në konsultime me grupe tjera parlamentare për votim. Është një vendim i rëndësishëm, duhet të funksionalizohet komplet komisioni në mënyrë që ta merr misionin e vet ta kryej sipas ligjit.

KRYETARI: Në emër të AAK-së, deputeti nuk do prononcim. Faleminderit!

Në emër të AKR-së, ku e keni shefin e grupit? Rita Hajzeraj e ka fjalën.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, Kryetar!

Edhe ne jemi dakord që t'i votojmë një nga një propozimet e komisionit dhe anëtarët e Grupit Parlamentar le të vendosin.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Lidhjes Demokratike të Dardanis, Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Po, në përputhje me propozimin dhe konsultimet që i patëm, do të thotë edhe ne e mbështesim që të votohen një nga një rekomandimet e komisionit funksional. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit “7”, Xhezair Murati, e ka fjalën.

DŽEZAIR MURATI: I u naše grupe, predsedniče, odlučeno je da glasamo, da prihvatimo predloge da se glasa po savesti i jedan po jedan.

KRYETARI: Faleminderit, shumë!

Grupi Parlamentar SLS, nuk ka. Atëherë, votojmë pra sipas propozimit të shefave të grupeve parlamentare, a jeni dakord? Do të thotë, shumica e shefave ishin që të votohet, përveç Aleancës, që nuk u deklarua, dhe respektojmë qëndrimin e Aleancës.

Po shkojmë në propozimin e parë, sipas rekomandimit, të emërohet Rustem Qehaja, zëvendësanëtar i Komisionit për lëndën – E drejta tregtare ekonomike.

Lus deputetët dhe regjinë, të përgatiten për votim, votojmë tash:

Konstatohet se me 53 vota “për”, 4 “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi emërimin e Rustem Qahajës, zëvendësanëtar të Komisionit për lëndën – E drejta tregtare, për plotësimin e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës. Faleminderit!

Rekomandimi i dytë është të shqyrtohet propozimi, mirëpo tash ne u morëm vesh, sipas propozimit të shefave të grupeve, që të propozojmë votimin e Bardhyl Hasan Papajt, anëtar të Komisionit për lëndën – E drejta ndërkombëtare evropiane.

Lus deputetët dhe regjinë, të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 15 vota “për”, 35 “kundër” dhe 6 abstenime, nuk miratohet propozimi që Bardhyl Hasan Papaj të jetë anëtar i Komisionit për Provimin e Jurisprudencës.

Shkojmë te rekomandimi i tretë. Do të thotë, Kuvendi merr vendim që të votojë për propozimin që Ruzhdi Berisha të jetë anëtar i Komisionit për Provimin e Jurisprudencës – për lëndën civile.

Lus deputetët dhe regjinë, të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 21 vota “për”, 29 “kundër” dhe 8 abstenime, Kuvendi nuk miratoi propozimin që Ruzhdi Berisha të jetë anëtar i Komisionit për Provimin e Jurisprudencës – për lëndën civile.

Të nderuar deputetë, e kemi dhe rekomandimin e katërt. Unë konsideroj që rekomandimin e katërt nuk duhet ta votojmë. Ajo është, do të thotë, e votuar, nëse është në kundërshtim me ligjin, ajo është anëtare e Gjykatës Kushtetuese dhe le të marrë vendimin së bashku me ministrin të vendosin. Mendoj që kjo u krye.

Vazhdojmë pikën e radhës të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i propozimeve për emërimin e anëtarëve në komisione parlamentare**

Në bazë të organizimit të ri të strukturës dhe numrit të anëtarëve të komisioneve parlamentare, me kërkesë të Kryesisë së Kuvendit, grupet parlamentare i kanë bërë propozimet për anëtarët në tri komisione të reja si dhe ristrukturimin e anëtarëve në 13 komisionet ekzistuese.

Propozimet e grupeve parlamentare për emërimin dhe ndërrimin e anëtarëve në komisionet parlamentare u janë shpërndarë deputetëve.

Mbi bazën e këtyre propozimeve është hartuar edhe vendimi për përbërjen e plotë të komisioneve parlamentare.

Nëse kanë shëfat e grupeve parlamentare diçka, mund ta kërkojnë fjalën.

Në Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion është një vend i zbraztë për Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike.
Lutfi Haziri e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Brenda kësaj jave në konsultime do ta bëjë propozimin për emërim final në këtë Komision nga ana e LDK-së, ka qenë lëshim teknik.

KRYETARI: Për Komisionin për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, SLS-ja nuk e ka anëtarin e vet.
Fjalën e ka kërkuar deputeti Slobodan Petroviq.

SLOBODAN PETROVIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Ono što je stav Samoslalne liberalne stranke jeste da čemo isto kao i kolege iz LDK u toku nedelje dati ime, s obzirom da smo imali priliku da imamo novu Komisiju i da je jako bitna, hoćemo da bismo konsultacije i sa našim partnerima tako, da čemo u toku sledeće nedelje dati ime.

KRYETARI: fjalën e ka kërkuar deputeti Bransilav Grbiq.

BRANISLAV GRBIĆ: Zahvaljujem se predsedavajući!

Uvaženo predsedništvo,

Uvaženi ministri, poslanici,

Ja bih u vezi Komisije nešto reko. Vi ste svedoci da je u ovoj Skupštini postojala još jedna poslanička grupa, grupa koja se zvala „Zajedno“ i koja četiri meseca nije imala nikakva prava. Ovde vidim da postojeća grupa koja se zove SLS ima sva prava i po tri člana u svakoj komisiji. Ono što zaista i mene začudjuje, to je da demokratski pristup Ahtisarijevom planu i ono što

Ahtisarijev plan pluža svim ostalim predstavnicima Srpske zajednice, kao interesne zajednice, ne poslaničke grupe, omogućuje i trebalo bi sigurno da svaki Srbin bude zastupljen makar u jednoj komisiji. I ono što zaista smatram da smo imali primer juče, nepristustvo dva srpska ministra na Skupštini koja je bila posvećena gostu Bilu Klintonu. Svi ministri su bili prisustni osim dva srpska ministra, što ukazuje na pogrešno tumačenje prisustva u institucijama Kosova. Ako neko ima stvoj stav i ako želi da ne bude prisutan na jednom tako važnom skupu, to je njegov lični stav, ali ako želi da bude član institucija Kosova, pogotovo ministar, onda mislim da treba da uvažimo nešto što je stav i princip Vlade Kosova. I mislim da zaista tako ponašanje, pogotovo od koalicionih partnera, koji se nazivaju koalicioni partneri, nije u redu i to dokazuje činjenica da zaista proizvoljno odlučivanje, ne samo prisustva Srba, utiče na neke demokratske kontekste ponašanja ostalih Srba u ovoj Skupštini i mislim da to želim da se ispravi ako je to ikako moguće. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Realisht, sipas Rregullores së Punës, grupet parlamentare kanë të drejtë të kenë anëtarët e tyre në komisione. Megjithatë, është mirë të bëhet një konsultë me SLS-në dhe vërtet i gjithë grupi i deputetëve të komuniteti serb të përfaqësohen edhe në komisione. Ky është vullneti ynë, por megjithatë duhet ju të merreni vesh në mes veti. Hydajet Hyseni, e ka fjalën, le të përgatitet Numan Baliq.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, Kryetar!

S'do mend që është për ta përshëndetur këtë përpjekje për rikonfigurim të komisioneve. Uroj që të jetë më funksionale, por lidhur edhe e vërejtjen që e bëri kolegu Grbiq, është e vërtetë që nuk është normale që në Komisionin për Integritet Evropian të mos ketë një përfaqësues të komunitetit serb. Mendoj që do të duhej krijuar mundësia që ajo të jetë.

Kurse, vërejtja tjetër është se në strukturën e re kemi një përbërje të larmishme të komisioneve. Një komision ka 13 anëtarë, një komision tjetër 12, disa nga 11 dhe shumica 9 anëtarë. Vërejtja ime ka të bëjë me Komisionin për Integritet Evropian. Është në rritje fushëveprimi i këtij komisioni. Ky komision shqyrton çdo ligj nga aspekti i përputhjes me parimet e *acquis communautaire*, prandaj edhe është bindje për se ky Komision do të duhej të kishte numër më të madh. Mendoj që propozimi im është që ky komision të ketë 11 anëtarë, sikur edhe komisionet tjera që nuk kanë aq fushëveprim sa ka ky komision, se nuk i shqyrtojnë të gjitha ligjet. Ju faleminderit, zoti Kryetar!

KRYETARI: Faleminderit, Hydajet!

Po, për numrin e anëtarëve në komisione është vendosur në seancë plenare, kështu që kemi votuar për këtë çështje dhe mendoj që kjo është e kryer, me kohë është dashur të..., kurse sa i përket, realisht nga Grupi i SLS-së është propozuar deputeti Mursel Halilaj. Numan Baliq e ka fjalën, le të përgatitet deputetja Zylfije Hundozi.

NUMAN BALIĆ: Faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit!

Ja želim ovde da dam jednu vrlo kratku i principijelnu primedbu koja se tiče načina donošenja odluke i donjete odluke.

Očigledno je da u rekonfiguraciji komisija koje su spomenute, ima nedostataka koji se tiču za nekoliko stranaka i predstavnika drugih zajednica. U vezi sa djelom zajednice koju predstavljam i delegatima odnosno poslanicima iz redova SDA, moram da kažem da nije obavljena nikakva konsultacija i da to u opšte nije u redu. Nemamo ama baš nikakvih ambicija niti želimo da radimo neke ko zna kakve stvari, ali mislim da je i nepravedno i nepošteno da se posebno za ljude koji su godinama prisutni ovdje, da absolutno budu eliminisani isključeni iz bilo kakvih konsultacija, iz bilo kakvih razgovora.

Ovdje je mesto takođe i da dodam da vezano za predstavljanje SDA u institucijama Kosova, kada su god donošene najvažnije odluke ili se recimo održavaju sednice, kao što je bila sjednica juče, ovo bi bilo dobro da to čuje onaj pored Predsednika, sekretar Skupštine, da uopšte ne dobijamo pozive za sjednice. To je isključivanje ljudi, omalovažanje, degradacija, ne znam čemu to služi. Absolutno amoralno i uopšte nije u redu. Tako da završim, evo završavam, predlažem da se ispravi ova nepravda a ako se ne ispravi, i da napomenem, zaboravio sam. Drugi poslanik iz redova SDA nije uključen ni u jednoj Komisiji, nije član ni jedne komisije. Mislim da je to neverovatno i da se to samo dešava u Parlamentu Kosova. I ako se, dok ne ispravi, neka služi na čast onima koji su doneli ovu odluku. Nemam šta drugo da kažem. Hvala ljepo!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Zylfije Hundozi.

ZYLFIJE HUNDOZI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë e di që ky vendim është votuar në seancën plenare. Po ashtu, siç e tha edhe deputeti Hydajet Hyseni, vëllimi i punëve të Komisionit për Integritet Evropian po rritet, sidomos pas këtyre tri dokumenteve që i ka pru Komisioni Evropian për Kosovës, kështu që kisha për t'ju lutë që të bëhet një përjashtim, që numri i deputetëve në Komisionin për Integritet Evropian të kthehet në numrin 11 dhe të kemi një përfaqësues serb për arsye se ne kemi kontakte me Këshillin e Evropës, me Komisionin Evropian, Parlamentin Evropian edhe kur po prezantohemi, në komisionin tonë nuk asnjë anëtarë të serbëve të Kosovës. Kështu që kisha për t'ju lutur, unë e kam bërë edhe një kërkesë me shkrim, që kërkesa ime dhe kërkesa e deputetit Grbiq edhe Hydajet Hysenit të merret parasysht edhe të bëhet një përjashtim. Faleminderit!

KRYETARI: Unë dua të lexoj Rregullën 48.5. Nuk dua të polemizoj, vetëm t'ju sqaroj çka thotë Rregullorja e Punës së Kuvendit: “Anëtarësia e të gjitha komisioneve funksionale duhet t'i reflektojë diversitetin dhe sjelljet e anëtarëve të Kuvendit. Nëse një grup parlamentar i përfaqësuar në Kuvend nuk ka asnjë anëtarë në një komision të caktuar funksional, ka të drejtë t'i dërgojë deputetët e vetë në cilësinë e vëzhguesit në të gjitha mbledhjet e atij komisioni”. Do të thotë, kjo është sipas rregullores.

Fjalën tani e ka Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, Kryetar!

E lexove shumë mirë Rregullën 48, komisionet kryesore dhe komisionet funksionale, por pika 7, citoj, lexoj, thotë: “Kryetari emëron deputetët – deputetët pa grup të Kuvendit, si anëtarë të komisioneve që marrin pjesë aktivisht në mbledhjet e komisioneve funksionale, pa të drejtë vote”. Prandaj, unë mendoj që është detyrë e juaja dhe e Kryesisë që deputetët pa grupe ta kenë të drejtën dhe t'i emëroni nëpër grupet funksionale. Faleminderit!

KRYETARI: Nëse ata e kanë vullnetin që të jenë pjesë e komisioneve pa të drejtë vote, nuk mungon vullneti im, unë e kam vullnetin e plotë në këtë drejtim që të emërohen këta deputetë në cilindo komision që e kërkojnë ata po pa drejtë vote, edhe ju e dini, pastaj janë edhe pa të drejtat tjera.

Fjalën e ka deputeti Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë do të shtroj një çështje tjetër, për të cilën ndoshta kemi folur kështu, por jo në Kuvend. Ka edhe një rregull të Rregullores që përcakton përbërjen e komisionit mbi bazë të fuqisë politike që e ka Kuvendi. Dhe, po të shikohet përbërja e komisionit, fuqia politike, subjektet politike, grupet parlamentare në Kuvend, nuk pasqyrohet proporcioni nëpër komisione. Prandaj, është mirë, nuk

di cilën formulë e keni përdorur ju atje në ndarjen e komisioneve, por është mirë që të shikohet dhe të rishikohet kjo, sepse në këtë rast Partia Demokratike e Kosovës është e dëmtuar në përbërjen e komisioneve të caktuara. Prandaj, ju lutem, kjo çështje, jemi në gjysmë të mandatit, po supozojmë se i kemi edhe dy vjet dhe është koha që kjo të rregullohet.

Nëse i marrim mandatet e kaluara, ne e dimë çfarë proporcionesh kemi pasur nëpër komisione. Prandaj, kjo çështje kërkoj që vërtetë të shqyrtohet. Unë e di që dikujt ndoshta nuk i shkon kjo shumë për shtati që po e them, por unë si deputet dhe si anëtar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike nuk mund të pajtohem me përbërjen dhe proporcionet nëpër komisione të ndara sipas grupeve parlamentare dhe forcës politike që paraqesin në Parlament.

KRYETARI: Faleminderit, shumë deputet!

Po, ju e dini që ne e kemi votuar këtë përbërje të komisioneve dhe mendoj që janë të tepërta disa diskutime. Dhe, ju lutem, për diskutime që kemi vendosur, mos të bisedojmë më.

Fjalën e ka deputeti Dragisha Miriq.

DRAGIŠA MIRIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Ja ovde u Skupštini tražim da se pročita Ahtisarijev plan o učešću Srba u institucije Kosova, Skupštine. Hvala!

KRYETARI: Me gjithë respektin për deputetët serbë, unë kisha kërkuar që ju t'i zgjidhni problemet në mesin e juaj, se nuk janë çështjet që vërtet ne ju pegnojmë. Zgjidhni në mesin e grupit dhe ne e kemi kënaqësinë që të gjithë deputetët e komunitetit serb të jenë, të përfaqësojnë një grup politik dhe të gjithë të jenë pjesë e komisioneve parlamentare.

Fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli, le të përgatitet Slobodan Petroviq.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë vetëm desha që të kërkoj nga ju që ta vëni këtë listë në votim, ne kemi marrë vendim kjo seancë plenare se sa komisione duhet të jenë dhe cila do të duhej të jetë përbërja e tyre. Tashmë ka mbetur në të drejtën e grupeve parlamentare që të përcaktohen se cilët deputetë në cilat komisione do të jenë dhe nuk e mendoj se duhet të hyjmë nga fillimi tash ta shqyrtojmë fuqinë politike. Madje dy subjektet më të mëdha politike nuk do të duhej të ankoreshin, sepse kanë në çdo komision nga 2 ose 3 anëtarë, ka edhe me 3. Prandaj, do të ishte mirë, zoti Kryetar, që ta vëni në votim këtë listë dhe të kalojmë më shpejt. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet Makolli!

Fjalën e ka i fundit, Slobodan Petroviq.

SLOBODAN PETROVIĆ: Hvala, predsjedniče!

Ono što sam imao za potrebu da se javim, jeste pre svega da ne budemo mi kao Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke krivi za..., pre svega Evropske integracije. Mi smo iz najbolje moguće namere dali kandidata iz naše poslaničke grupe. Sigurno da nismo dobili nikakvo pismo iz te komisije gde se zahteva da član te komisije bude iz srpske zajednice.

Koristim priliku da, ukoliko će to zaista da da doprinos i ukoliko je to neophodno, sa ovog mesta vam dajem obećanje da ćemo promeniti i člana ove komisije. Što se tiče članova iz grupacije srpskih poslanika, Samostalna liberalna stranka je jako otvorena u tom delu i sama činjenica da su na listama, odnosno u komisijama i članovi, odnosno poslanici koji nisu iz Samostalne liberalne stranke, jednostavno svi oni poslanici koji žele da uzmu učešće u političkom životu, odnosno u Skupštini Kosova su dobrodošli, ali pre svega trebaju da imaju adresu na koju mogu da se oni nađu, jer prosto mi namamo potrebu i nemamo načina kako ćemo doći do pojedinih

poslanika, ali evo koristim priliku, pošto su neki poslanici ovde, da im javno uputim poziv da naš Poslanički klub je ovde na prvom spratu i svakako da su dobrodošli ukoliko sa njihovim kapacitetima žele da poboljšaju rad kako našeg Poslaničkog kluba, srpskih poslanika, tako i ove institucije. Hvala!

KRYETARI: Unë kërkoj që vërtet ju ta shikoni të gjithë dokumentin e Presidentit Ahtisari dhe kërkesat e juaja t'i keni në raport me atë dokument. Mendoj që ajo që mund ta them, kërkoj nga deputetët që nuk kanë grup parlamentar, t'i bëjnë kërkesat e tyre në administratë se në cilin komision donë të jenë anëtarë, pa të drejtë vote. Do të thotë, kjo është e drejtë e tyre dhe unë e respektoj. Tjetër, ne si Kuvend mund t'i ndryshojmë, do të thotë, kur ta shohim të nevojshme plotësimin dhe ndryshimin e anëtarëve nëpër komisione dhe mendoj kjo nuk është ndonjë pengesë. Po, i kisha lutur deputetët që për vendimet që i kemi marrë, mos të na kthejnë, mos t'i harrojnë vendimet që janë marrë në këtë sallë, që janë edhe pjesë e vendimmarrjes.

Prandaj, e respektoj propozimin e deputetit Makolli që të hymë në procedurën e votimit dhe jeni dakord që të votojmë për përbërjen e komisioneve parlamentare.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:
Konstatojmë se me 59 vota “për”, 10 “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi vendimin për përbërjen e plotë të 16 komisioneve parlamentare.

Dhe, me këtë kemi përfunduar këtë seancë plenare. Mirupafshim në seancat e radhës!

Përgatiti:

Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale

